

ZIBER LATA

ARTI I KËNDIMIT
TË KUR'ANIT FISNIK

فَنُّ تِلَاوَةِ الْقُرْآنِ الْكَرِيمِ

Shkup, 2024

Titulli

ARTI I KËNDIMIT TË KUR'ANIT FISNIK

Autori

Prof. dr. Ziber LATA

Redaktorët:

Prof. dr. hfz. Hajredin HOXHA

Prof. dr. Naser RAMADANI

Dr. Islam ISLAMI

Botuesi:

Fakulteti i Shkencave Islame - Shkup

Shtypshkronja:

Focus Print – Shkup

Tirazhi: 500

Ky libër botohet me vendim të Këshillit Mësimor Shkencor të Fakultetit të
Shkencave Islame – Shkup, nr. 10-160/3, të datës 16.06.2022

Botimin e financoi miku ynë, z. Munir Maqellara.

Zoti e shpërbleftë!

CIP - Каталогизација во публикација

Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

28-23

LATA, Ziber

Arti i këndimit të kur'anit fisnik / فن تلاوة القرآن الكريم =

Ziber Lata. - Shkup: Fakulteti i Shkencave Islame, 2024. - 293 стр.: илустр. ; 25 см

Дел од текстот и на арап. јазик. - Фусноти кон текстот. - Fjalor i termave të texhvidit:

стр. 263-270 - Библиографија: стр. 291-293. - Содржи и: Poema e Xhezeriut = متن الجزرية

ISBN 978-608-66633-1-5

а) Ислам -- Свети текстови -- Куран

COBISS.MK-ID 63875845

PËRMBAJTJA

PËRMBAJTJA	3
DY FJALË ME RËNDËSI TË MADHE	9
HYRJE	15
LEXIMI, DËGJIMI DHE MËSIMI I KUR'ANIT FISNIK	21
1. LEXIMI I KUR'ANIT FISNIK	22
2. DËGJIMI I KUR'ANIT	33
3. MËSIMI I KUR'ANIT (për vete dhe të tjerëve)	36
NORMAT PARA LEXIMIT TË KUR'ANIT	41
Gusulli dhe avdesi	41
Pastrimi i gojës, i vendit dhe i petkut	42
Drejtimi kah kibra	43
Përzgjedhja e kohës	44
Fillimi me istiadhe dhe besmele	44
NORMAT GJATË LEXIMIT TË KUR'ANIT	46
Leximi teritl	46
Meditimi dhe përsëritja e ajeteve	46
Përgjigjja në disa sure	48
Sexhdja e leximit (shexhdetu tilaveh)	49
Zbukurimi i zërit	51
Shikimi në mus'haf	51
Leximi i pandërprerë dhe qëndrimi me edukatë	52
Mbajtja e rendit të sureve dhe ajeteve	52
NORMA TË PËRGJITHSHME RRETH LEXIMIT TË KUR'ANIT	53
Kushtimi i sevapit për të vdekurin	53
Leximi i Kur'anit në varreza	55
Përfitimi material nga Kur'ani	57
Edukata me mus'hafin	59
Mus'hafi i dëmtuar dhe i papërdorshëm	62
SHKENCA E TEXHVIDIT – عِلْمُ التَّحْوِيدِ	67
1. Përkufizimi	67
2. Objekti	68

3. Rezultati.....	68
4. Vlera.....	68
5. Pozita	69
6. Hartuesi	69
7. Emri	69
8. Përftimi.....	70
9. Dispozita	70
10. Tematika	71
ISTIADHEJA – اِسْتِغَاذَةُ	72
Dispozita e istiadhes	72
Format e istiadhes	73
Lidhjet e mundshme të istiadhes.....	74
Lidhja e istiadhes drejtpërdrejt me suren, pa besmelen	74
Dispozita e istiadhes kur e ndërpresim leximin	75
BESMELEJA – اَلْبَسْمَلَةُ.....	76
Dispozita e leximit të besmeles.....	76
Mënyrat e lidhjes së dy sureve me besmelen	77
Besmeleja në suren Teuvbe (Berae)	77
Mënyrat e kalimit nga sureja Enfal në suren Teube	78
RITMET DHE TIPAT E LEXIMIT	79
1. Et-Tahkik (التَّحْقِيقُ)	79
2. Et-tertil (التَّرْتِيلُ)	79
3. El-Hader (الْحَدَرُ).....	79
Leximi i preferuar.....	80
Llojet e urryera dhe të ndaluara të leximit.....	81
ALFABETI I GJUHËS ARABE – اَبْجَدِيَّةُ اللُّغَةِ الْعَرَبِيَّةِ	87
VENDARTIKULIMET E SHKRONJAVE – مَخَارِجُ الْحُرُوفِ.....	89
A) Zgavra (e gojës) - الْجَوْفُ.....	90
B) Fyti (gryka) – اَلْحَلْقُ	91
C) Gjuha – اللِّسَانُ	91
Ç) Buzët – الشَّفَقَان	93
D) Nazofaringu (zgavra e hundës) – اَلْخَيْشُومُ	94
VETITË E TINGUJVE – صِفَاتُ الْحُرُوفِ	96

I. VETITË E PËRHERSHME – الصِّفَاتُ اللَّازِمَةُ	97
A) VETITË ME OPONENCË	97
B) VETITË PA OPONENCË	103
II. VETITË E PËRKOHSHME – الصِّفَاتُ الْعَارِضَةُ	110
NYJËTIMI I THEKSUAR (التَّفْخِيمُ) DHE I PATHEKSUAR (التَّرْقِيقُ).....	113
A. Tingujt çdoherë të theksuar حُرُوفُ التَّفْخِيمِ	113
B. Tingujt çdoherë të patheksuar حُرُوفُ التَّرْقِيقِ	115
C. Tingujt herë të theksuar dhe herë të patheksuar	115
DISPOZITA E ELIFIT (ل) الْأَلِفُ اللَّيْنُ	116
DISPOZITA E SHKRONJËS “L” لَفْظُ الْجَلَالَةِ –	117
DISPOZITA E SHKRONJËS “R” حُكْمُ الرَّاءِ	118
A) R-ja çdoherë e theksuar (الرَّاءُ الْمُتَّخِمَةُ)	118
B) R-ja çdoherë e patheksuar (الرَّاءُ الْمُتَرَفِّقَةُ)	119
C) R-ja me dy mundësi: e theksuar dhe e patheksuar	120
ZGJATJET - الْمُدُّودُ	123
Përkufizimi i fjalës الْمَدُّ – el-meddu	123
Llojet e medeve	124
Njësitë matëse të zgjatjeve:.....	125
1. EL-MEDDU ET-TAB’IJJU - الْمَدُّ الطَّبِيعِيُّ	126
2. MEDDUL-BEDEL - مَدُّ الْبَدَلِ	128
3. MEDDUL-IVED - مَدُّ الْعَوَظِ	130
4. MEDDUS-SILEH - مَدُّ الصَّلَةِ	131
5. EL-MEDDU EL-MUTTASIL – الْمَدُّ الْمُتَّصِلُ	133
6. EL-MEDDU EL-MUNFASIL – الْمَدُّ الْمُتَفَصِّلُ	134
7. EL-MEDDU EL-ARID LIS-SUKUN – الْمَدُّ الْعَارِضُ لِلْسُّكُونِ	136
8. EL-MEDDU EL-LAZIM – الْمَدُّ اللَّازِمُ	137
A) El-meddu el-lazim el-kelimi - الْمَدُّ اللَّازِمُ الْكَلِمِيُّ	137
B) El-meddu el-lazim el-harfij - الْمَدُّ اللَّازِمُ الْحَرْفِيُّ	138
9. MEDDU EL-LIN – مَدُّ الْيَنِّ	140
LEXIMI I SHKRONJAVE ALFABETIKE NË FILLËM TË DËSA SUREVE.....	141
RENDITJA E ZGJATJEVE SIPAS FORTËSISË	143
1. Ndeshja e dy zgjatjeve në një rrokje të vetme.....	143

2. Raporti i dy zgjatjeve në vende të ndryshme	144
RREGULLAT E NUNSAKINIT (ن) DHE TENVINIT (ت) ... أَحْكَامُ النَّونِ السَّكِينَةِ وَالْتَّنُونِ (ت)	149
1. EL-IDH'HAR - الإِظْهَارُ	150
2. EL-IDGAM MEALGUNNEH - الإِذْغَامُ مَعَ الْغَنَةِ	153
3. EL-IDGAM BILA GUNNEH - الإِذْغَامُ بِلاَ غَنَةٍ	155
4. EL-IKLAB - الإِقْلَابُ	156
5. EL-IHFA' - الإِخْفَاءُ	158
TENVINI DHE TINGULLI ME SUKUN.....	161
RREGULLAT E M-së ME SUKUN (م) - أَحْكَامُ الْمِيمِ السَّكِينَةِ (م)	163
1. EL-IHFA ESH-SHEFEVIJ - الإِخْفَاءُ الشَّفَوِيُّ	163
2. EL-IDGAM ESH-SHEFEVIJ - الإِذْغَامُ الشَّفَوِيُّ	164
3. EL-IDH'HAR ESH-SHEFEVIJ - الإِظْهَارُ الشَّفَوِيُّ	165
IDGAMET TJERA	168
IDGAM EL-MUTEMATHILEJN - إِذْغَامُ الْمُتَمَاتِلَيْنِ	169
IDGAM EL-MUTEXHANISEJN - إِذْغَامُ الْمُتَجَانِسَيْنِ	171
IDGAM EL-MUTEKARIBEJN - إِذْغَامُ الْمُتَقَارِبَيْنِ	172
EL-IDGAM EL-KAMIL DHE EN-NAKIS - الإِذْغَامُ الْكَامِلُ وَالنَّاقِصُ	173
El-Idgam el-kamil (الإِذْغَامُ الْكَامِلُ)	173
El-Idgam en-nakis (الإِذْغَامُ النَّاقِصُ)	174
MIMI DHE NUNI TË DYFISHUARA - إِذْغَامُ الْمِيمِ وَالنُّونِ الْمُسَدَّدَتَيْنِ	175
NDALJA APO PUSHIMI - الْوَقْفُ	179
1. PUSHIMI TESTUES - الْوَقْفُ الْإِخْتِيَارِيُّ	181
2. PUSHIMI I IMONUAR - الْوَقْفُ الْإِضْطِرَّارِيُّ	182
3. PUSHIMI PRITËS - الْوَقْفُ الْإِنْتِظَارِيُّ	183
4. PUSHIMI I VULLNETSHËM - الْوَقْفُ الْإِخْتِيَارِيُّ	184
4.1. Pushimi i plotësuar - الْوَقْفُ التَّامُّ	184
4.2. Pushimi i mjaftueshëm - الْوَقْفُ الْكَافِي	186
4.3. Pushimi i kënaqshëm (i mirë) - الْوَقْفُ الْحَسَنُ	187
4.4. Pushimi i shëmtuar - الْوَقْفُ الْقَبِيحُ	188
4.5. Pushim i domosdoshëm - الْوَقْفُ الْأَزْرَمُ	189
SEKTEJA - السَّكْتَةُ	190

Sekteja e domosdoshme	190
Sekteja vullnetare	191
REUMI DHE ISHMAMI – الرَّؤْمُ وَالْإِشْمَامُ	192
Reumi – الرَّؤْمُ	192
Ishmami – إِشْمَامٌ	193
SHTATË ELIFËT – الْأَلِفَاتُ السَّبْعَةُ	196
SHENJAT E NDALJES – عَلَامَاتُ الْوَقْفِ	198
A) Shenjat e Kompleksit për Botim të Kur'anit “Mbreti Fahd”	198
B) Shenjat e Ministrisë për Çështje Fetare të Turqisë	200
FILLIMI ME HEMZEN LIDHËSE	202
TES'HILI – التَّسْهِيلُ	205
IMALE – الْإِمَالَةُ	206
THEKSI – التَّكْسِيرُ	207
GABIMI GJATË LEXIMIT TË KUR'ANIT – اللَّحْنُ	211
Gabimi i qartë اللَّحْنُ الْجَلِيُّ	211
Gabimi i fshehur اللَّحْنُ الْخَفِيُّ	213
Dispozita e gabimeve	214
Gabimet më të shpeshta tek ne.....	215
LEXIMI SISTEMATIK DHE HATMEJA	219
Leximi më i ngadalshëm	219
Leximi më i shpejtë	220
Leximi sistematik i Muhamedit [alejhi selam]	220
Përfundimi i njërës hatme dhe fillimi i tjetrës.....	221
Tehlili, tekbiri dhe tahmidi	222
Tubimi i njerëzve për hatme.....	223
Mbyllja e hatmes me lutje	224
HIFZI, NXËNIA E KUR'ANIT	226
Vlera dhe rëndësia	226
Parimet e përgjithshme për nxënien e Kur'anit	229
Mënyra e nxënies përmendësh të një faqeje	233
Metodat e hifzit	234
Përsëritja pas përfundimit të hifzit	237
METODOLOGJIA E MËSIMIT TË TEXHVIDIT.....	240

Fazat e mësimit të texhvidit	241
HYRJE NË KËRAETE.....	249
Përkufizimi.....	249
Nocione të rëndësishme	249
Etapat e zhvillimit	250
Tri kriteret e leximeve të pranuara	253
Dhjetë lexuesit e Kur'anit.....	254
Lexuesi Asim dhe transmetuesi i tij Hafs.....	255
Urtësia e ekzistimit të kiraeteve.....	257
FJALOR I TERMAVE TË TEXHVIDIT	263
POEMA E XHEZERIUT – مَنُ الْجَزَرِيَّة	271
FIGURA TË VENDARTIKULIMEVE.....	283
PËRFUDIM	289
LITERATURA E KONSULTUAR	291

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

Më zmrin e Allahut, Mëshiruesit, Mëshirëplotit!

DY FJALË ME RËNDËSI TË MADHE

E falënderojmë Allahun [xhel-le she'nuhu] për të mirat e Tij të paku-fishme që na i ka falë! Salate dhe selame për të dashurin tonë, Muhamed Mustafanë, dërgojmë hiq pa ia ndarë, i cili ka thënë: *"Më i mirë dhe më i dashur tek Allahu [xhel-le she'nuhu] është ai i cili e mëson Kur'anin, (e studion, e komenton, e mirëlexon atë) dhe ua mëson të tjerëve"*. Kënaqësia e Allahut të Lartësuar qoftë për shokët dhe familjen e tij të dashur që flijuan jetën dhe pasurinë për Kur'anin.

E falënderojmë Allahun *er-Rahman, er-Rahim* i cili e dërgoi Muhamedin [alejhi selam] udhëzues, përgëzues dhe qortues për tërë njerë-zimin: *"Ne të kemi dërguar ty për tërë njerëzimin – përgëzues dhe paralajmërues, por shumica e njerëzve nuk dinë"* (Sebe: 28). Allahun e falënderojmë nga thellësia e zemrës, i Cili e zbreti Kur'anin dhe e bëri atë argument (bur'han) dritë (nur), shërim (shifa), forcë, dinjitet, krenari (dhikr),¹ udhëzim (huda), litar i Tij i fortë për shpëtim (hablu-llahi el-metin) dhe e shpalli në zemrën e Muhamedit [alejhi selam] nëpërmjet melekut Xhibril për mbarë njerëzimin: *"O Pejgamber, Ne të kemi dërguar dëshmitar, përgëzues dhe paralajmërues."* (el-Ahzab: 45). Allahu e zbreti Kur'anin në gjuhën arabe të qartë e të pastër: *"Me të vërtetë, ai (Kur'ani), është Shpallja e Zotit të gjithësisë, atë e ka sjellë Shpirti i Besueshëm (Xhibrili) në zemrën tënde që të bëhesh nga paralajmëruesit, në gjuhën e qartë arabe."* (esh-Shu'ara': 192-195). Allahu garantoj dhe e mori përgjegjësinë e ruajtjes së tij nga ndryshimi, humbja dhe keqpërdorimi: *"Ne, me të vërtetë, kemi shpallë Kur'anin dhe, Ne, gjithsesi, do ta ruajmë atë (origjinalitetin e tij)"* (el-Hixhr: 9). Pastaj, Zoti kërkoi nga Muhamedi [alejhi selam] ta lexonte me *tertil* atë, sipas leximit të melekut Xhibril: *"E, kur ta lexojë Xhibrili atë (Kur'anin), përcille leximin e tij!"* (el-Kijame: 18), *"dhe lexo Kur'anin me kujdes dhe qartë!"* (el-

¹ Te gjithë komentuesit e Kur'anit e kanë komentuar kështu fjalën (ذِكْرُكُمْ) në ajetin:

﴿لَقَدْ أَنْزَلْنَا إِلَيْكُمْ كِتَابًا فِيهِ ذِكْرُكُمْ أَفَلَا تَعْقِلُونَ﴾ *"Ne, ju shpallëm një Libër, këshillë e lavdi për ju. Vallë, a nuk po kuptoni ju?!"* (el-Enbija: 10)

Muzzemil: 4). Pastaj kërkoi ta përcillte, ta predikonte, ta komenonte dhe t'ua kumtonte shokëve të tij të ndershëm, popullit dhe mbarë umetit: *"O Pejgamber! Trego atë që të është shpallur nga Zoti yt! – Në qoftë se nuk e bën këtë, atëherë nuk e ke kryer pejgamberllëkun tënd."* (el-Maide: 67) Pastaj e autorizoi të Dërguarin e Tij për interpretim dhe predikim: *"Ne, ty ta kemi dërguar Kur'anin që t'ua shpjegosh njerëzve dispozitat e shpalljes, dhe që të mendojnë."* (en-Nahl: 44). E më pas Allahu kërkoi të veprohet sipas udhëzimeve dhe parimeve: *"Dhe thuaj "punoni!", Allahu, Pejgamberi i Tij dhe besimtarët do të shohin punën tuaj."* (et-Teube: 106). Në fund, Allahu i Madhëruar kërkoi t'i referohemi atij (Kur'anit) dhe të jetë gjykues për ne, për shoqërinë dhe për mbarë njerëzimin deri në Ditën e Gjykimit: *"(Ne të dërguam Librin) të gjykosh me atë që të ka shpallur Allahu, e mos i ndiq dëshirat e tyre!"* (el-Maideh: 49)

Ky gradualitet i zbritjes dhe i aplikimit të urdhrave kur'anorë tregon metodologjinë e bashkëveprimit me Kur'anin (*mësimin dhe aplimin e tij*) në jetën e përditshme. Këtë metodologji ndoqën edhe shokët e Muhamedit [alejhi selam], të cilët e përjetuan zbritjen e Kur'anit dhe e mësuan mënyrën e aplikimit të tij në jetën e përditshme. Kështu demonstruan para botës një metodologji praktike, dinamike dhe aplikative se si duhet të jetë një individ, një shoqëri dhe një umet ideal që e do Allahu dhe i Dërguari i Tij. Si rezultat i këtij mishërimi dhe integrimi të fjalës dhe të veprës, sahabët u bënë referencë, dëshmi dhe model për gjeneratat e ardhshme të muslimanëve, se si të sillen, si ta kuptojnë dhe si t'i aplikojnë mësimet dhe parimet kur'anore në jetën e tyre.

Sahabët ishin gjeneratë kur'anore-unike dhe shumë e veçantë për njerëzinë, sepse e mësuan Kur'anin teorikisht (*u bënë hafizllarë të denjë*) dhe praktikisht (*punëtorë aktivë*), gjë e cila fatkeqësisht sot na mungon nëpër institucionet tona, si në aspektin lokal, rajonal dhe atë global.

Apelojmë që urgjentisht të rishikohet veprimtaria jonë individuale dhe kolektive, të rishikohet dhe të korrigjohet metoda e muhafizëve dhe e hoxhallarëve nëpër mektebe dhe xhami, e profesorëve nëpër medrese dhe fakultete, e ustallarëve dhe e mjeshtërvë të Kur'anit që merren me përgatitjen e kurikulave dhe të silabuseve, që të sigurojnë një edukim të shëndoshë, me tefsirin dhe interpretimin e tij, në mënyrë që mësimet kur'anore të integrohen në sferat e jetës sonë bashkëkohore!

Nuk lejohet kurrresi të jemi të izoluar përbrenda mureve të xhamive, mektebeve, klasave, sallave të ligjëratave, mexhliseve të dhikrit e mevludit, e kelimeit teuhidit, por duhet dalë në terren dhe në mejdan: *“E, kush flet më bukur se ai që thërret te Allahu, bën vepra të mira dhe thotë: “Unë, me të vërtetë, jam musliman!”* (Fussilet: 33)

Allahu qoftë i kënaqur me imamët, hafizllarët dhe kurratë (lexuesit) e Kur'anit, që nga Muhamedi [alejhi selam], sahabët e tij të ndershëm, tabiinët dhe të gjitha gjeneratat që erdhën pas tyre dhe që na e transmetuan Kur'anin famëlartë, të pastër, të kulluar, të qartë dhe me zinxhir (sened) të artë të transmetuesve dhe të hafizllarëve profesionistë, ashtu siç ka zbritur me texhvid (*drejtlexim*) dhe me kiraete të ndryshme (*shtatë dhe dhjetë leximet e Kur'anit*), me versione të ndryshme të leximit, të cilat i ka shënuar Imam Shatibiu, Imam Ibnu el Xhezeriu, Imam el Dani etj. Hamdi i qoftë Allahu për këtë dhunti (*nimet*) që na e dhuroi dhe që na dalloi si umet-popull karshi të tjerëve, ashtu që të jemi dëshmitarë të kësaj feje dhe të këtij Libri (Kur'anit) në këtë jetë dhe në Ahiret. Këtë realitet e konfirmon Allahu [xhel-le she'nuhu], ku thotë: *“Ju, muslimanët, ishit populli më i mirë dhe më i përsosur që Allahu përgatiti dhe krijoi për njerëzimin, për të urdhëruar në të mirë, për të ndaluar nga e keqja dhe për të besuar në Allahun.”* (Alu Imran: 110)

Ky Kur'an i bereqetshëm, i mrekullueshëm dhe me shumë sekrete, u dallua prej librave tjerë që zbritën para tij (*Teurati, Zeburi, Inxhili, suhufet e Ibrahimit dhe të Musait etj.*), e në veçanti përsosmëria dhe origjinaliteti i tekstit të shenjtë të shpallur nga Allahu [xhel-le xhe'nuhu] i cili është përplot me tematika, parime, legjislacione, mesazhe universale, urdhra dhe me thirrje universale, jo me thirrje të kufizuar në vend dhe në kohë siç kanë qenë librat e mëparshëm.

Po ashtu, Kur'anin e bën të veçantë mrekullia e tekstit kur'anor, i cili është ruajtur në origjinal nga Allahu [xhel-le she'nuhu], është nxënë në zemrat dhe në kokat e hafizëve, të kurrave dhe të lexueseve anembanë botës që nga koha e shpalljes gjer më sot, dhe atë me tekst arkivor të saktë dhe të ruajtur 100 %. Ky proces i ruajtjes do të vazhdojë kështu deri në ditën e fundit të kësaj jete. Kur'ani do të vazhdojë të mbetet mu'xhize-mrekulli, libër hyjnor dhe udhëzues për tërë njerëzinë dhe për çdo kohë. Allahu i Madhëruar e ka bekuar këtë Libër, e ka bërë të bereqetshëm dhe e ka pajisur strukturën e teksteve kur'anore me kuptime dhe me mësim: *“(Ky) është një libër (Kur'ani), që ta kemi*

zbritur ty, libër i bekuar, për t'i studiuar argumentet e tij dhe për t'u këshilluar mendimtarët me të." (Sad: 29).

Mesazhi kur'anor ka qenë, është dhe do të jetë gjithmonë me karakter universal dhe global, ku raca, ngjyra dhe pozita gjeografike shkrihen në mëshirën e këtyre parimeve hyjnore dhe në drejtësinë e barazisë njerëzore, ndërsa më i dalluari dhe më i çmuari është më i devotshmi, më punëtori, më i sinqerti dhe më modesti: *"O njerëz! Ne, me të vërtetë, u krijuam ju prej një mashkulli dhe një femre dhe ju bëmë popuj dhe fise, për t'u njohur (me njëri-tjetrin). Më fisniku tek Allahu është më i devotshmi nga ju. Me të vërtetë, Allahu është i Gjithëdijshtëm dhe asgjë nuk i fshihet Atij."* (el-Huxhurat: 13)

Me këtë veçori, Kur'ani e dëshmon universalitetin, përsosmërinë dhe qenien e tij shpallje përmbyllëse e të gjitha librave të shpallur, duke e pëlqyer dhe përzgjedhur Islamin si fenë, sistemin dhe programin e vetëm të pranuar tek Allahu [xhel-le she'nuhu] për mbarë njerëzimin. Me këtë fakt bie poshtë fraza *religjionet qiellore*, madje nuk ka pasur dhe as do të ketë religjione qiellore. Frazën *religjione qiellore* e kanë trilluar hebrenjtë, të krishterët, orientalistët dhe shekullaristët. Pra, feja ka qenë, është dhe do të mbetet një dhe e vetme (*Islami*), por me sheriate (legjislacione) të ndryshme për çdo popull dhe çdo kohë. Ky realitet nuk duhet harruar kurrë, sepse Kur'ani fisnik e konfirmon këtë në shumë ajete, e sidomos në suren el-Bekare: 127-133, 135, 136, 137, 138, 140, në suren Alu Imran: 52, 64, 67, 80, 84, 102, në suren el-Maide: 3,111; el-En'am: 163; el-A'raf: 126; Junus: 84; el-Hixhr: 2; en-Nahl: 89, 102; el-Haxh: 78. Në këto ajete është vula ku Allahu na ka quajtur muslimanë. Libër tjetër të shpallur me këto veçori dhe specifika nuk do të ketë gjersa të ekzistojë jeta në këtë botë.

Ndaj këtij libri madhështor (Kur'anit) kemi shtatë obligime individuale, shoqërore, institucionale dhe shtetërore. Këto detyrime mund të klasifikohen në katër nivele edukative:

Niveli i parë: *detyrimi për ta lexuar dhe për ta nxënë përmendësh.*

Niveli i dytë: *detyrimi për ta medituar dhe për ta interpretuar.*

Niveli i tretë: *detyrimi për të vepruar sipas parimeve dhe urdhrave të tij, dhe për t'i thirrur njerëzit në të.*

Niveli i katërt: *detyrimi për ta dashur sinqerisht atë.*

Në trojet tona ballkanike dhe në shumë vende islamike, eksperiencia jonë akademike dhe edukativo-arsimore për tri dekada dhe gjer më sot, ka dëshmuar se shoqëritë islame, bashkë me institucionet akademike dhe fetare, disa studentë, hoxhallarë, profesorë dhe hafizllarë, mjerisht ende janë në nivelin e parë, madje nuk e zotërojnë mirëfilli leximin e Kur'anit, nuk janë të trajnuar siç duhet dhe nuk i praktikojnë rregullat e texhvidit.

Kështu që, populli dhe xhemati nuk janë familjarizuar ende me artin e leximit dhe të këndimit të Kur'anit. Ky konstatim nuk duhet kuptuar si demotivim, por si motivim dhe si ripërtëritje e forcave dhe e potencialeve tona për të bërë përpjekje maksimale që të dalim nga kjo gjendje dhe të kalojmë në nivelin e dytë, e më pastaj në të tretin dhe në të katërtin.

Për të kaluar në nivelet e lartpërmendura, patjetër duhet të përmbushet niveli i parë, përndryshe, sistematikisht, akademikisht dhe logjikisht nuk mund të arrihen qëllimet e shenjta të niveleve vijuese. Në Ballkan, muslimanët shqiptarë, turq, boshnjakë dhe të tjerë, në krahasim me popujt e disa vendeve aziatike (si Malajzia, Indonezia, Brunei, Turqia etj.), akoma janë shumë prapa, dhe atë shkaku i sistemeve edukativo-arsimore laike dhe kurikulave sekulare të cilat nuk e kanë integruar edukatën fetare në programet shkollore. Për këtë arsye, populli, xhemati dhe masa e thjeshtë nuk e zotërojnë leximin e Kur'anit në gjuhën arabe. Kjo krizë shpërfaq gjendjen tonë faktike dhe të mjerueshme.

Për të dalë nga kjo gjendje dhe nga niveli i parë, na duhet një katalog udhëzues, një libër sqarues dhe një skicë e qartë për ta mësuar drejtë leximin e Kur'anit sipas rregullave të duhura, për t'u njohur me shkencën e texhvidit dhe për ta lexuar atë siç e ka lexuar Muhamedi [alejhi selam] dhe shokët e tij. Gjithashtu, ky udhëzues na duhet për t'i mësuar sekretet e shkronjave arabe, cilësitë, vendartikulimet dhe vendformimet e tyre, rregullat e zgjatjeve, shkriret, dyfishimet dhe shumë rregulla tjera.

Për këtë qëllim të shenjtë dhe fisnik, Allahu [xhel-le she'nuhu] përzgjedh nga robërit e Tij shërbyes dhe studiues të singertë të Kur'anit me të cilët e realizon dhe e përmbush këtë nivel të rëndësishëm në drejtë leximin e Kur'anit. Ndër studiuesit e singertët, punëtorët e palodhur, dashamirët e dijes dhe të dijetareve, të cilët e kanë bërë veten kurban dhe vakuf në shërbim të Kur'anit (me lexim, mësim, studim, përkthim, komentim, publikim etj.) është edhe vëllai ynë i dashur, prof. dr. Ziber

Lata, profesor në Fakultetin e Shkencave Islame në Shkup. Sot profesori ynë i dashur del para publikut dhe para lexuesve me këtë vepër, punim dhe katalog madhështor, të titulluar “**Arti i këndimit të Kur’anit fisnik**”, të cilin ne e urojmë nga zemra për këtë sukses akademik dhe fetar. Gjithashtu, patëm nderin dhe ishim tejet të privilegjuar që e redaktuam, e recensuam, e korrigjuam dhe sugjeruam mendime të dobishme në këtë vepër madhështore të kolegut dhe të vëllait tonë. Libri në fjalë është një vepër serioze, sistematike, akademike dhe me standarde dhe me kriterë ndërkombëtare. Temat dhe njësitë që trajton ky libër, si drejtlëximi i Kur’anit dhe rregullat e texhvidit, mësohen dhe studiohen nëpër fakultete dhe universitete islame të nivelit ndërkombëtar në botën arabe dhe në atë aziatike. Vepra është shkruar me gjuhë të lehtë dhe të mirë, të shkëlqyer dhe jo të vështirë. Ky libër madhështor meriton respekt të veçantë, prandaj duhet të vendoset nëpër kurikulat e medreseve dhe të fakulteteve tona islame, përndryshe, të gjithë do të jemi mëkatarë për shpërfilljen e mësimëve dhe udhëzimeve të këtij libri në procesin e edukimit të gjeneratës sonë në leximin e Kur’anit.

I lutem Allahut [xhel-le she’nuhu] që ta shpërblejë vëllain, kolegun dhe profesorin tonë me Xhenet për mundin e dhënë dhe për kontributin e çmueshëm akademik, fetar, edukativo-arsimor. Gjithashtu, bëjmë dua që Allahu t’ia pranojë këtë vepër, t’ia bëjë munasib dhe të dobishme për umetin islam dhe për gjeneratat e ardhshme që do ta mësojnë leximin e Kur’anit!

Amin, amin, amin! Vel hamdu lil-lahi Rabil alemin!

Këto fjalë, për hir të Allahut, i shkroi shërbyesi i Kur’anit dhe i muslimanëve.

Prof. dr. hfz. Hajredin Hoxha,

Doha, Katar,

24.12.2023

Dita e 79-të e luftës, masakrës, gjenocidit dhe holokaustit gjakatar dhe barbar të Izraelit ndaj muslimanëve në Gaza



HYRJE

Hamde i thurim Zbritësit të Kur'anit!

Salavate i dërgojmë Sqaruesit të Bejanit!

Rizanë e Zotit ia urojmë lexuesit të Furkanit!

Ky libër është një prurje modeste në sferën e disiplinës së texhvidit. Në këtë fushë kanë kontribuar shumë shkencëtarë profesionistë, qofshin klasikë apo bashkëkohorë, prandaj vlen të thuhet se puna që kemi bërë në këtë libër është kryesisht e natyrës metodologjike, përmbledhëse, renditëse dhe sistemuese. Këtu kemi përmbledhur përvojat e mësuesve të Kur'anit, të hafizëve të njohur nga bota dhe nga vendi dhe përvojat tona me studentët. Diku është shtuar ndonjë sqarim, shembull apo trajtim më shumë, vende-vende diçka është thjeshtësuar për të qenë më e kuptueshme dhe më praktike për ata që interesohen të mësojnë drejtleksimin e Kur'anit Fisnik.

Për të qenë mirënjohës dhe referues ndaj kontributit të atyre që kanë shkruar në këtë lëmi, të gjitha librat dhe emrat e autorëve, ashtu siç kërkohet shkencërisht, do t'i gjeni në fund faqes në shumicën e mësimëve, por një pjesë do t'i gjeni edhe në *literaturën e konsultuar*, me të vetmin qëllim që të mos ngarkohet pjesa e rregullave të texhvidit.

Arti i këndimit të Kur'anit Fisnik numërohet si disiplinë e ulumul-Kur'anit, mirëpo mund të studiohet dhe të mësohet si disiplinë e mëvetësishme shkencore. Librat e përpiluar në këtë sferë, qofshin ato në gjuhën arabe, në gjuhën shqipe apo në gjuhë të tjera, shpeshherë janë të ngarkuar me mësimë që kryesisht ndërlidhen me ulumul-Kur'anin (shkencat kur'anore) sesa me shkencën e texhvidit. Sigurisht, texhvidi nuk mund të ndahet prerazi nga ulumul-Kur'ani, sepse tekefundit

është pjesë e tij, mirëpo është edhe e panevojshme që një sërë mësimesh të përgjithshme të ulumul-Kur'anit të jepen nëpër librat e texhvidit. Kjo më ka shtyrë që gjatë këtij studimi të veçoj vetëm temat që ndërlidhen me leximin e Kur'anit apo të ngjashme.

Ky libër është rezultat i punës disavjeçare me lëndën e Kur'anit në Fakultetin e Shkencave Islame - Shkup, ku për shkak të shumë rrethanave, lënda e Kur'anit m'u besua mua. Në fillim refuzova ta pranoja, sepse nuk ishte lëndë që lidhej drejtpërdrejt me specializimin tim, por me sugjerimin e profesorit paraparak të asaj lënde, njëherësh edhe profesori im, h.fz. Bajram Ajeti (Allahu e mëshiroftë!), në fund pranova. Kështu vendosa t'i përkushtohem tërësisht asaj që m'u besua me kaq besnikëri. Gjatë punës me lëndën e Kur'anit, paralelisht kemi përfutur bashkë me studentët, por ngaqë studentët ndërroreshin, unë nga viti në vit i zhvilloja njohuritë dhe metodat e kësaj fushe shkencore. Prandaj, aq sa në këtë libër do të gjeni të shpalosura përvojat e të tjerëve, po aq do të gjeni edhe përvojat tona.

Një çështje duhet kuptuar mirë: ky dhe të gjitha librat tjerë të kësaj disipline, sado mirë të jenë të punuar apo të ilustruar, ato mbulojnë vetëm pjesën teorike të texhvidit, pra trajtojnë vetëm gjysmën e problemit. Askush nuk duhet të mendojë se texhvidin mund ta mësojë vetëm nga librat, por patjetër i duhet një mësues i shkathët, një hoxhë gojëmbël apo një hafiz profesional.

Sigurisht, do të ishte shumë i zbehët dhe krejt i pa kuptimtë ky studim nëse botohej pa e lexuar profesorët dhe specialistët e fushave përkatëse. Në rend të parë është prof. dr. h.fz. Hajredin Hoxha, i cili e ka lexuar punimin me shumë kujdes dhe në formë profesionale ka ndërhyrë në pjesë të rëndësishme të këtij punimi, si në aspektin përmbajtësor, ashtu edhe në atë shkencor, pa kontributin e të cilit ky libër do të ishte i varfër dhe i mangët. Gjithashtu, libri është lexuar edhe nga prof. dr. Naser Ramadani, i cili krahas sugjerimeve shkencore, ka dhënë një kontribut të madh në strukturimin dhe shtrirjen e materies duke u përmbajtur standardeve akademike dhe pedagogjike. Po ashtu, meqë një periudhë kohore lëndën e Kur'anit në Fakultetin e Shkencave Islame – Shkup e kemi ligjëruar bashkërisht me dr.

Islam Islamin, përgjatë shkrimit të këtij libri, profesori i nderuar kohë pas kohe e ka pasuruar këtë libër me materiale, me referenca shtesë dhe me sugjerime të rëndësishme. Të gjithë i falënderoj për zemërsisht për kontributin e dhënë dhe e lus Allahun që t'i shpërblejë me gjitha të mirat në këtë botë dhe në botën tjetër.

Gjithashtu, i lutem Allahut ta shpërblejë edhe familjen time, të cilët kanë qëndruar përkrah meje në çdo situatë të jetës sime!

Çfarëdo që është thënë mirë, drejt dhe bukur në këtë libër, ajo është falë mirësisë së Allahut ndaj nesh, e çfarëdo që është e gabuar apo jo adekuate, ajo është nga dobësia ime.

KREU I

VLERA E LEXIMIT TË KUR'ANIT



- Vlera e leximit
- Vlera e dëgjimit
- Shpërblimi i atij që nxit leximin

LEXIMI, DËGJIMI DHE MËSIMI I KUR'ANIT FISNIK

Kur'ani është libri i fundit i shpallur Muhamedit [alejhi selam] nga Allahu [xhel-le she'nuhu] përmes melekut Xhibril [alejhi selam]. Ky libër është mrekullia (mu'xhizja) më e madhe që ndonjëherë i është dhuruar njerëzimit nga Zoti Fuqiplotë. Me këtë u përfundua dhe u përsos cikli i kontaktit hyjnor me njerëzimin, prandaj i tillë do të jetë derisa të ekzistojë kjo botë dhe do të mbetet i pasfiduar deri në ditën e fundit të kësaj bote, pavarësisht arritjeve, avancimeve dhe përparimit njerëzor. Para së gjithash Kur'ani zbriti për ta udhëzuar njerëzimin në rrugë të drejtë dhe për t'i qëndruar pranë atij në çdo situatë të jetës, qoftë ajo e mirë apo e keqe.

Vlerat që Kur'ani ia ofron mbarë njerëzimit, veçanërisht atyre që e besojnë, e lexojnë, e studiojnë dhe e praktikojnë, është mundësia për të kontaktuar me Qenien Absolute (Allahun [xhel-le she'nuhu]), zhveshja e petkut krijesor, mposhtja e relativitetit, tendenca për të kuptuar botën metafizike dhe heqja nga sytë perden e quajtur dynja.

Në pamundësi për t'i prekur të gjitha dimensionet dhe vlerat që reflektojnë ajetet kur'anore, në këtë kapitull do të trajtohen vetëm segmentet që ndërlidhen me vlerën e leximit të Kur'anit, gjegjësisht: me vlerën e leximit, të dëgjimit dhe të mësimi të Kur'anit për vete dhe të tjerëve.

1. LEXIMI I KUR'ANIT FISNIK

Çdo lexim është i dobishëm dhe i rëndësishëm, por leximi i Kur'anit është më shumë se kaq, sepse kur lexon Kur'an, nuk ke lexuar thjesht një libër, por para vetes ke një vepër ku është sintetizuar gjithë krijimtaria. Leximi i Kur'anit llogaritet si një dritare që të jep qasje të shikosh dhe të përjetosh çfarë të të dojë zemra. Kuptohet, nga ai do të marrësh vetëm aq sa do të jesh i aftë.

Çdokush nga Kur'ani në përgjithësi dhe nga leximi i tij në veçanti do të marrë në varësi të mjeteve dhe aftësive pranuese që posedon. Pra, Kur'ani nuk e ka lënë çdo kuptim apo ndjesi të hapur, por i ka koduar ato, kurse çelësin e ka fshehur në aftësitë perceptuese dhe në ndjesitë tona shpirtërore.

Në vazhdim do të shtrohen disa vlera dhe dobi që përfitohen nga leximi i Kur'anit:

a) Zbatim i urdhrit të Allahut

﴿وَرَتِّلِ الْقُرْآنَ تَرْتِيلًا﴾ *"Recito me ritëm Kur'anin."* (el-Muzzemmil, 4)

Lexuesi i Kur'anit, para së gjithash e çon në vend një urdhër të Allahut. Andaj, vetë këndimi duhet përjetuar si nënshtrim dhe dëgjueshmëri ndaj Allahut [xhel-le she'nuhu]. Çdo ibadet reflekton ndonjë dobi të caktuar individuale, shoqërore, shkencore etj., por nijeti themelor i përkushtimit ndaj një ibadeti çfarëdoqoftë ai duhet të jetë zbatimi dhe nënshtrimi ndaj urdhrit të Allahut, bile ky është edhe çelësi i pranimi të tyre te Zoti. Në të njëjtën kohë, ky parim është edhe çelësi i reflektimit të tyre në këtë botë.

Leximi i Kur'anit është krenari e veçantë për besimtarin sepse e përmbyll një obligim ndaj Krijuesit duke bashkëbiseduar me Atë përmes leximit të Librit të Tij.

b) Leximi i Kur'anit është tregues i besimit në Kur'an

﴿الَّذِينَ ءَاتَيْنَهُمُ الْكِتَابَ يَتْلُونَهُ حَقَّ تِلَاوَتِهِ ۖ أُولَٰئِكَ يُؤْمِنُونَ بِهِ ۚ وَمَن يَكْفُرْ بِهِ ۖ فَأُولَٰئِكَ هُمُ
الْخٰسِرُونَ﴾

“Ata të cilëve u dhamë Librin dhe e lexojnë drejt atë, ata e besojnë atë. Kurse ata të cilët e mohojnë, janë vetë të humburit.” (el-Bekare, 121)

Ky ajet, leximin e Kur'anit e lidh drejtpërdrejt me besimin në të. Pra, ai që e lexon Kur'anin, dëshmon se e beson atë, kurse ai që e lexon rrallë tregon se nuk ka dashuri të madhe ndaj tij. Jeta na ka mësuar se njeriu më shumë shoqërohet me shokun që e do dhe që i beson më shumë, prandaj besimtari lexon më shumë Kur'an, sepse e beson dhe e do më shumë se çdo libër tjetër.

Për frazën *“lexim me hak”* komentuesit kanë dhënë mendime të ndryshme, por këtu do ta veçojmë vetëm mendimin e imam Gazaliut, i cili thotë: **“Fraza *lexim me hak* nënkupton që në lexim të marrin pjesë paralelisht gjuha, mendja dhe zemra. Gjuha t'i shqiptojë shkronjat drejt, mendja t'i deshifrojë mirëfilli kuptimet dhe zemra të përulet, të këshillohet dhe të bindet.”**² Nëse këndimit të Kur'anit i mungon njëra nga këto tri veti, atëherë këndimi është i mangët dhe nuk do të japë frytin e duhur.

c) Dhuron përfitime shumë të mira

﴿إِنَّ الَّذِينَ يَتْلُونَ كِتَابَ اللَّهِ وَأَقَامُوا الصَّلَاةَ وَأَنفَقُوا مِمَّا رَزَقْنَاهُمْ سِرًّا وَعَلَانِيَةً يَرْجُونَ تَجَرَّةً لَّن تَبُورَ
لِيُؤْتِيَهُمُ أَجْرَهُم بِزِيدِهِمْ مِّن فَضْلِهِ ۚ إِنَّهُ غَفُورٌ شَكُورٌ﴾

“Ata të cilët lexojnë Librin e Allahut, falin namazin dhe kontribuojnë fshehtas e haptas nga ç'u kemi dhënë, shpresojnë një shitblerje që nuk humb. Që Ai t'ua plotësojë shpërblimet dhe t'u japë ende më shumë me mirësinë e Vet. Ai është Falës, Mirënjohës.” (Fatir, 29-30)

² Ebu Hamid El-Gazali, *Ihja ulumi ed-dini*, botimi I, Daru Ibni Hazm, Bejrut, 2005, f. 340

Në këto ajete Allahu [xhel-le she'nuhu] shpalos tre veprime shumë të rëndësishme të cilat besimtarit i sjellin mirësi të pashtershme dhe nuk humbasin kurrë. Ato janë: a) *leximi i Kur'anit*, b) *falja e namazit*, dhe c) *kontributi nga ajo që je furnizuar*. Megjithatë, duhet vënë re se punët që ndjellin këtë shpërblim fillojnë me lexim të Kur'anit. Kështu, sipas këtyre ajeteve çelësi i mirësive është leximi i Librit të Allahut, sepse ai është platforma e çdo mirësie në këtë botë. Po ashtu, ky ajet na mëson se Kur'ani është çelësi i sukseseve në këtë botë dhe në tjetrën.

ç) *Leximi i Kur'anit privilegj i besimtarëve*

﴿وَإِذَا قَرَأْتَ الْقُرْآنَ جَعَلْنَا بَيْنَكَ وَبَيْنَ الَّذِينَ لَا يُؤْمِنُونَ بِالْآخِرَةِ حِجَابًا مَسْتُورًا﴾

“Kur reciton Kur'an, bëjmë perde të fshehur mes teje dhe atyre që nuk besojnë të Ardhamen.” (el-Isra, 45)

Ky ajet kur'anor tregon se leximi i Kur'anit është privilegj i besimtarëve, kurse jobesimtarët, ateistët dhe të tjerët janë të privuar prej kënaqësisë së leximit të Kur'anit, sepse u mungon besimi për ta shijuar këtë kënaqësi.

d) *Lexuesi i Kur'anit dallohet nga të gjithë*

فَعَنْ أَبِي مُوسَى الْأَشْعَرِيِّ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ، قَالَ: قَالَ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ: «مَثَلُ الْمُؤْمِنِ الَّذِي يَقْرَأُ الْقُرْآنَ كَمَثَلِ الْأَنْزَجَةِ: رِيحُهَا طَيِّبٌ وَطَعْمُهَا طَيِّبٌ، وَمَثَلُ الْمُؤْمِنِ الَّذِي لَا يَقْرَأُ الْقُرْآنَ كَمَثَلِ الثَّمَرَةِ: لَا رِيحَ لَهَا وَطَعْمُهَا حُلُوٌّ، وَمَثَلُ الْمُنَافِقِ الَّذِي يَقْرَأُ الْقُرْآنَ كَمَثَلِ الرَّيْحَانَةِ: رِيحُهَا طَيِّبٌ وَطَعْمُهَا مُرٌّ، وَمَثَلُ الْمُنَافِقِ الَّذِي لَا يَقْرَأُ الْقُرْآنَ كَمَثَلِ الْحَنْظَلَةِ: لَيْسَ لَهَا رِيحٌ وَطَعْمُهَا مُرٌّ» متفق عليه .

Ebu Musa el Esh'arij [radijall-llahu anhu] ka thënë: Pejgamberi [alejhi selam] ka thënë: “Shembulli i besimtarit që lexon Kur'an është si shembulli i qitros, era dhe shija e saj është e mirë. Ndërsa shembulli i besimtarit që nuk lexon Kur'an është si shembulli i hurmës, ajo nuk ka erë por shija e saj është e ëmbël. Ndërsa shembulli i hipokritit, që e lexon Kur'anin, është si shembulli i borzilokut, era e tij është e mirë, por ka një shije të hidhur. Ndërsa

shembulli i hipokritit, që nuk e lexon Kur'anin, është si shembulli i kungullit të egër, nuk ka erë dhe ka shije të hidhur".³

Thelbi i këtij hadithit trajton dy aspekte shumë domethënëse: brendinë e njeriut e cila përfaqësohet nga shija dhe dukjen e cila përfaqësohet nga era. Kështu që, vetëm besimtari që lexon Kur'anin ka siç duhet të dyja këto anë.

dh) Lexuesi i Kur'anit lakmohet për begatinë e dhënë

فَعَنِ ابْنِ عُمَرَ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُمَا، عَنِ النَّبِيِّ ﷺ، قَالَ: لَا حَسَدَ إِلَّا فِي اثْنَتَيْنِ: رَجُلٌ آتَاهُ اللَّهُ الْقُرْآنَ، فَهُوَ يَقُومُ بِهِ آتَاءَ اللَّيْلِ وَآتَاءَ النَّهَارِ، وَرَجُلٌ آتَاهُ اللَّهُ مَالًا، فَهُوَ يُنْفِقُهُ آتَاءَ اللَّيْلِ وَآتَاءَ النَّهَارِ. مُتَّفَقٌ عَلَيْهِ.

Transmeton Ibni Omeri se i Dërguari i All-llahut ka thënë: “Nuk ka zili⁴ përveçse në dy gjëra: njeriut të cilit All-llahu ia ka dhënë Kur'anin dhe bën ibadet me të ditë e natë, dhe njeriut të cilit i ka dhënë pasuri, dhe ai e shpenzon atë në hak ditë e natë”.⁵

Ky hadith na tregon se lexuesi i Kur'anit është për t'u xhelozuar për shkak të sevapeve dhe rëndësisë që fiton tek Allahu [xhel-le she'nuhu]. Kështu që, këto fjalë të Pejgamberit [alejhi selam] ngërthejnë thirrjen për të garuar për punë të mira, e veçanërisht për leximin e Kur'anit dhe për pasurinë që shpenzohet në rrugën e Zotit [xhel-le she'nuhu].

e) Leximi i Kur'anit të ngre në dynja dhe në ahiret

فَعَنِ عُمَرَ بْنِ الْخَطَّابِ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ، أَنَّ النَّبِيَّ ﷺ، قَالَ: إِنَّ اللَّهَ يَرْفَعُ بِهَذَا الْكِتَابِ أَقْوَامًا وَيَضَعُ بِهِ آخَرِينَ. مُسْلِمٌ.

Transmeton Omer bin Hatabi se i Dërguari i All-llahut ka thënë: “All-llahu, me këtë libër, disa popuj i ngre dhe disa të tjerë i poshtëron”.⁶

³ Buhariu, *El-Xhamiu es-sahih*, hadithi nr. 5427, Kajro, El-Mektebetu es-Selefijjetu, 1400 h.; Muslimi, *Sahihu Muslimi*, hadithi nr. 797, Daru Ihjai el-Kutubi el-Arabijjeti, 1991 m./1374 h., f. 549

⁴ Lakmi për të mbërritur diçka, por pa dashur që tjetri të privohet prej saj.

⁵ Buhariu, *El-Xhamiu es-sahih*, hadithi nr. 7529; Muslimi, *Sahihu Muslimi*, hadithi nr. 815

⁶ Muslimi, *Sahihu Muslim*, hadithi nr. 817,

Kur e kemi parasysh faktin se Kur'ani është kushtetuta e përkryer për mbarë njerëzimin, atëherë apriori kuptohet se ai popull që do t'i përmbahet kësaj kushtetute të pagabueshme do të ngrihet në nivele shumë të larta, kurse ai që nuk do ta trasojë këtë rrugë është i dënuar të poshtërohet. Këtu nuk bëhet fjalë vetëm për lexim të thjeshtë të Kur'anit, por për lexim të shoqëruar me meditim, vëmendje, vetëdijesim dhe praktikë.

ë) Leximi i Kur'anit është bereqet për të dy botët

فَعَنْ أَبِي ذَرٍّ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ قَالَ: قُلْتُ: يَا رَسُولَ اللَّهِ أَوْصِنِي! قَالَ: «عَلَيْكَ بِتَقْوَى اللَّهِ؛ فَإِنَّهُ رَأْسُ الْأَمْرِ كُلِّهِ». قُلْتُ: يَا رَسُولَ اللَّهِ زِدْنِي. قَالَ: «عَلَيْكَ بِتِلَاوَةِ الْقُرْآنِ، فَإِنَّهُ نُورٌ لَكَ فِي الْأَرْضِ، وَذُخْرٌ لَكَ فِي السَّمَاءِ».

Transmeton Ebu Dherri: e pyeta Muhamedin [alejhi selam]: “O i Dërguari i All-llahut, më porosit diçka!” Ai iu përgjigj: “*Ki frikë All-llahun, sepse ajo është esenca e gjithçkaje!*” I thash: “Më këshillo edhe diçka tjetër!”, ai tha: “*Lexo Kur'an, sepse ai është nur (dritë) për në tokë dhe furnizim për në qiell*”.⁷

Nga hadithi në fjalë duket qartë se si Krijuesi u dhuron lexuesve të Kur'anit nur (dritë) në tokë dhe furnizim në qiell. Kjo do të thotë se lexuesi i Kur'ani e sheh mirë rrugën nëpër të cilën lëviz dhe vepron në këtë botë. Krahas faktit se këtë rrugëtim të quajtur dynja e ka të ndritur, ai është i pajisur me furnizim edhe për në Botën Tjetër.

Ibni Abasi [radijall-llahu anhu] ka thënë: “*All-llahu, ndjekësit e Kur'anit, i ka siguruar se nuk do të devijojnë në këtë botë dhe nuk do të pikëllohen në Botën Tjetër.*”⁸ pastaj e lexoi ajetin “*ai i cili ndjek udhëzimin Tim, nuk do të humbë dhe as do të pikëllohet*” (Taha: 123). Pra, leximi është rruga e parë për të filluar mësimin dhe ndjekjen e mësimëve kur'anore. Do të ishte e paimagjinueshme që të punohet dhe të zbatohet një libër i caktuar pa e lexuar mirë dhe pa e studiuar hollësisht atë.

⁷ El-Mundhiri, *Et-tergibu ve et-terhibu*, vëllimi II, Kajro, Daru el-Fexhri li et-Turath, 1421 h., f. 298

⁸ Ibn Kethiri, *Tefsiru el-Kur'ani el-adhim*, vëllimi V, Rijad, Daru Tajjibeh, 1997, f. 322

f) Leximi i Kur'anit është më me vlerë se gjithë dynjaja

فَعَنْ عُقْبَةَ بْنِ عَامِرٍ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ قَالَ: خَرَجَ عَلَيْنَا رَسُولُ اللَّهِ ﷺ وَنَحْنُ فِي الصُّفَّةِ فَقَالَ: «يُكْمُ يُحِبُّ أَنْ يَغْدُو كُلَّ يَوْمٍ إِلَى بُطْحَانَ أَوْ إِلَى الْعَقِيقِ فَيَأْتِي مِنْهُ بِنَاقَتَيْنِ كَوْمَاوَيْنِ فِي غَيْرِائِهِمْ وَلَا يَقْطَعُ رَحِمٍ؟» فَقُلْنَا: يَا رَسُولَ اللَّهِ كُلُّنَا نُحِبُّ ذَلِكَ. قَالَ: «أَفَلَا يَغْدُو أَحَدُكُمْ إِلَى الْمَسْجِدِ فَيَعْلَمُ أَوْ يَفْرَأُ آيَتَيْنِ مِنْ كِتَابِ اللَّهِ عَزَّ وَجَلَّ خَيْرٌ لَهُ مِنْ نَاقَتَيْنِ، وَثَلَاثٌ خَيْرٌ لَهُ مِنْ ثَلَاثٍ، وَأَرْبَعٌ خَيْرٌ لَهُ مِنْ أَرْبَعٍ وَمِنْ أَعْدَادِهِنَّ مِنَ الْإِبِلِ».

Transmeton Ukbe bin Amir: Kur ne ishim në Suffa (kënd në xhaminë e Muhamedit [alejhi selam]), i Dërguari i Allahut doli dhe tha: “Cili prej jush do të donte të shkonte çdo mëngjes në But’han ose el-Akik dhe të sjellë dy deve të majme pa bërë mëkat ose pa ndërprerë lidhjet farefisnore?” Ne i thamë: “O i Dërguari i Allahut, të gjithë do ta dëshironim atë.” Me këtë rast ai tha: “A nuk shkon ndonjëri prej jush në xhami që të mësojë ose të lexojë dy ajete nga libri i Allahut?! Kjo është më e mirë për të sesa dy deve, tre ajete janë më mirë për të sesa tri deve, katër ajete janë më mirë për të sesa katër deve dhe kështu me radhë, sa herë shtohet numri i ajeteve, po aq është edhe vlera në deve.”⁹

g) Për çdo shkronjë të lexuar, dhjetë sevape

فَعَنِ ابْنِ مَسْعُودٍ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ، قَالَ: قَالَ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ: «مَنْ قَرَأَ حَرْفًا مِنْ كِتَابِ اللَّهِ فَلَهُ حَسَنَةٌ، وَالْحَسَنَةُ بِعَشْرِ أَمْثَالِهَا، لَا أَقُولُ: {الْم} حَرْفٌ، وَلَكِنْ: أَلِفٌ حَرْفٌ، وَلَا مٌ حَرْفٌ، وَمِيمٌ حَرْفٌ»

Transmeton Ibn Mesudi se Muhamedi [alejhi selam] ka thënë: “Kush lexon një shkronjë nga Libri i Allahut ka një shpërblim, kurse çdo shpërblim dhjetëfishohet. Nuk them se “eliflammimi” është një shkronjë, por elifi është një shkronjë, lami është një shkronjë dhe mimi është një shkronjë.”¹⁰

Ky hadith flet për sevapet e dhjetëfishta që i fiton besimtari për çdo shkronjë të leximit të Kur'anit. Njësoj si lexuesi i Kur'anit, po ashtu edhe studiuesi, medituesi etj., duhet t'i vështrojnë në imtësi

⁹ Muslimi, *Sahihu Muslim*, hadithi nr. 803, Daru Ihjai el-Kutubi el-Arabijjeti, 1991 m. /1374 h., f. 552

¹⁰ Tirmidhiu, *Xhamiu et-Tirmidhiij*, Bejrut, hadithi nr. 2910, Bejtu El-Efkar ed-Duvelijjeh, 2004, Bejrut, f. 365

problematikat kur'anore, dhe jo vetëm të bëjnë qasje të përgjithshme rreth fenomeneve të ndryshme kur'anore.

Përderisa shohim se çdo shkronjë dhuron dhjetë sevape, atëherë duhet medituar, sepse çdo shkronjë mund të ofrojë edhe dhjetë kuptime, porosi, ndjesi shpirtërore etj.

gj) Lexuesit e Kur'anit janë afër Zotit

فَعَنْ أَنَسٍ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ قَالَ: قَالَ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ: «إِنَّ لِلَّهِ أَهْلِينَ مِنَ النَّاسِ». قَالُوا: يَا رَسُولَ اللَّهِ مَنْ هُمْ؟ قَالَ: «هُمْ أَهْلُ الْقُرْآنِ، أَهْلُ اللَّهِ وَخَاصَّتُهُ».

Transmeton Enesi, se Muhamedi [alejhi selam] ka thënë: “Zoti i lartësuar ka familjarë (të dashur) prej njerëzve.” Dikush, i çuditur e pyeti: “E kush janë këta, o i Dërguar i Allahut?” Pejgamberi [alejhi selam] tha: “Janë familjarët e Kur'anit (ata që janë të lidhur me Kur'anin). Ata janë njerëzit më të dashur dhe më të afërt me Zotin.”¹¹

Sigurisht, këtu nuk bëhet fjalë për familje konkrete, por për afërsi ndaj Zotit për ata që e lexojnë Kur'anin, sepse ata që lexojnë fjalën e Tij në një mënyrë llogariten se bisedojnë me Allahun [xhel-le she'nuhu]. Po ashtu, anëtar i familjes llogaritet ai me të cilin kalon një pjesë të madhe të kohës bashkërisht, prandaj Pejgamberi [alejhi selam] këtu potencon se familjarë të Allahut janë ata që janë familjarizuar me Kur'anin Fisnik.

h) Mburojë në këtë botë

عَنْ أَنَسٍ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ قَالَ: قَالَ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ: مَنْ جَمَعَ الْقُرْآنَ مُتَّعَ بِعَقْلِهِ حَتَّى يَمُوتَ.

Përcillet nga Enesi [radijall-llahu anhu] se i Dërguari [alejhi selam] ka thënë: “Kush e mbledh (lexon, studion, vepron, praktikon...) Kur'anin, do të begatohet me aftësi mendore derisa të vdesë.”¹²

¹¹ Ibn Maxhe, *Sunen Ibni Maxhe*, hadithi nr. 215

¹² Muhamed Xharullah es-Sa'dij, *En-nevafihu el-atiretu*, hadithi nr. 374; Ebu El-Fadl Er-Razi, *Fedailu el-Kur'an*, 148

Transmetohet se Ibni Abasi ka thënë: “*Kush lexon Kur'an nuk do të kthehet në moshë të thyer për të harruar pasi që dinte.*”¹³

Leximi, studimi apo shoqërimi me Kur'anin e çliron besimtarin nga ngarkesat e kësaj bote. Kur njeriu shkarkohet nga barra e rëndë e kësaj bote, nuk ka më stres dhe mërzë të pakontrolluar, prandaj edhe është më i qetë shpirtërisht dhe mendërisht. Lehtësimi psikik që Kur'ani i dhuron besimtarit përgjatë gjithë jetës nuk e lë atë të dobësohet mendërisht kur të hyjë në moshë të thyer. Përveç kësaj, Allahu i Madhërishëm nuk e lë të dështojë dhe nuk e turpëron askënd që merret me Fjalën e Tij.

i) Leximi i Kur'anit i ngre derexhetë në Xhenet

رَوَى عَبْدُ اللَّهِ بْنُ عُمَرَ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُمَا عَنِ النَّبِيِّ ﷺ قَالَ: يُقَالُ لِصَاحِبِ الْقُرْآنِ أَفْرَأُ وَارْتَقِ وَرَتَّلَ كَمَا كُنْتَ تُرَتِّلُ فِي الدُّنْيَا، فَإِنَّ مَنْزِلَتَكَ عِنْدَ آخِرِ آيَةٍ تَقْرَأُ بِهَا.

Transmeton Abdullah bin Amër, se Pejgamberi [alejhi selam] ka thënë: “*Do t’i thuhet shoqëruesit të Kur’anit (Ditën e Kiametit): lexo, ngjitu dhe këndo siç ke kënduar në dynja! Vendi yt (në Xhenet) është në ajetin e fundit që do ta lexosh.*”¹⁴

Në këtë hadith flitet për lexuesit e vazhdueshëm të Kur'anit, për atë që lexon shpesh, prandaj është përdorur fraza صَاحِبُ الْقُرْآنِ *shoqërues i Kur'anit*. Pra, këtë shpërblim nuk e gëzojnë ata që lexojnë Kur'an shumë rrallë.

Po ashtu, nga ky hadith kuptohet një mësim tjetër i rëndësishëm, se lexuesi i Kur'anit qysh në këtë botë vepron një punë që do të vep-rohet edhe nga banorët e xhenetit. Kështu që, çdokush kur lexon Kur'an duhet të ndjejë se vepron një punë të banorëve të Xhenetit

¹³ El-Hakim, *El-mustedrek ala es-sahihajn*, hadithi nr. 4006, vëllimi III, Daru el-Marifeh, Bejrut, 2006, f. 382 Hakimi thotë: “Ky hadith është sahih (i saktë), por nuk e kanë dhënë Buhariu dhe Muslimi”

¹⁴ Tirmidhiu, *Sunen et-Tirmidhi*, hadithi nr. 2914; Ebu Davudi, *Sunen Ebi Davud*, hadithi nr. 1464

j) Kur'ani do të ndërmjetësojë në Botën Tjetër

رَوَى أَبُو أُمَامَةَ   عَنْ رَسُولِ اللَّهِ   قَالَ: اقْرَأُوا الْقُرْآنَ إِنَّهُ يَأْتِي يَوْمَ الْقِيَامَةِ شَفِيعًا لِأَصْحَابِهِ

Transmeton Ebu Uname [radijall-llahu anhu] se Pejgamberi [alejhi salam] ka thënë: “Lexoni Kur’anin! Ai Ditën e Kiametit do të vijë ndërmjetësues për shoqëruesit e vet.”¹⁵

Përveç faktit se Kur’ani do të ndërmjetësojë për ta shpëtuar lexuesin në Botën Tjetër, po ashtu, Allahu [xhel-le she’nuhu] do t’u mundësojë lexuesve të Kur’anit që të ndërmjetësojnë për dhjetë anëtarë të familjes të cilët e meritojnë hyrjen në zjarr. Për këtë Muhamedi [alejhi salam] ka thënë: “Kush e lexon Kur’anin, e mëson përmendësh atë, e lejon hallallin dhe e ndalon haramin, Allahu e fut në Xhenet dhe i mundëson ndërmjetësimin e dhjetë anëtarëve të familjes që janë përcaktuar për zjarr.”¹⁶

k) Leximi i Kur’anit sjell qetësi, mëshirë dhe mburojë

رَوَى أَبُو هُرَيْرَةَ   عَنْ رَسُولِ اللَّهِ   قَالَ: وَمَا اجْتَمَعَ قَوْمٌ فِي بَيْتٍ مِنْ بُيُوتِ اللَّهِ يَتْلُونَ كِتَابَ اللَّهِ وَيَتَدَارَسُونَهُ بَيْنَهُمْ إِلَّا نَزَلَتْ عَلَيْهِمُ السَّكِينَةُ وَعَشِيَتْهُمْ الرَّحْمَةُ وَحَفَّتْهُمُ الْمَلَائِكَةُ وَذَكَرَهُمُ اللَّهُ فِيمَنْ عِنْدَهُ.

Transmeton Ebu Hurejre [radijall-llahu anhu] se Pejgamberi [alejhi salam] ka thënë: “Çdo popull (grup) që tubohet në një shtëpi të Zotit: lexojnë librin e Allahut dhe ia mësojnë atë njëri-tjetrit, mbi ta zbret qetësia, i mbulon mëshira, i rrethojnë melaqet dhe Allahu i përmend (i vendos) te ata të cilët ka konsideratë.”¹⁷

Në këtë hadith, bashkë me leximin e Kur’anit theksohet edhe mësimi i ndërsjellë i tij.

Efektin e parë që e jep leximi i Kur’anit është qetësia, rehatia e zemrës dhe pengimi i trazimeve shpirtërore. Pra, krahas efekteve kuptimore, Kur’ani lë gjurmë në zemrën dhe shpirtin e njeriut edhe

¹⁵ Muslimi, *Sahihu Muslim*, hadithi nr. 804

¹⁶ Tirmidhiu, *Sunen et-Tirmidhi*, hadithi nr. 2905; Ibn Maxhe, *Sunen Ibn Maxhe*, hadithi nr. 216 dhe të tjerë.

¹⁷ Muslimi, *Sahihu Muslim*, hadithi nr. 2699

përmes tingujve, madje edhe nëse nuk e kupton atë. Kështu që, duke parë se njerëzit jetojnë brenda një bote të mbushur me stres, plogëshi, depresion dhe zbrazëti të shpirtërore, atëherë leximi i Kur'anit në radhë të parë është nevojë e domosdoshme, pastaj edhe mësimi dhe studimi i tij.

Po ashtu, transmetohet një tregim i bukur i Muhamedit [alejhi selam] me Ubejin, të cilit i Dërguari i Zotit një ditë i tha: "Allahu më ka urdhëruar të të lexoj ti (Kur'an)". Ubeji tha: "A Allahu më ka përmendur mua?!" Muhamedi [alejhi selam] tha: "Allahu të ka përmendur". Pastaj Ubeji filloi të qante.¹⁸

Njashtu, Berra bin Azib [radijall-llahu anhu] tregon: "Një njeri e lexonte suren Kehf dhe pranë ishte një kalë i lidhur me dy litarë. Në një moment zbriti një re dhe filloi t'i afrohet, ndërsa kali filloi të ikte prej saj. Pasi agoi, njeriu erdhi te Pejgamberi [alejhi selam] dhe i tregoi për atë që kishte ndodhur. Pejgamberi [alejhi selam] tha: *"Kjo është qetësia, zbriti për hir të Kur'anit."*¹⁹

Qetësia dhe mëshira në këtë hadith paraqiten të materializuara dhe të drejtpërdrejta, me qëllim që besimtarëve t'u jepet mësim për vlerën e leximit të Kur'anit dhe të inkurajohen për atë. Mëshira dhe qetësia mund të jenë të ndryshme, në varësi të personave dhe rrethanave.

1) Zoti i jep lexuesit të Kur'anit çdo të mirë

رَوَى أَبُو سَعِيدٍ عَنِ رَسُولِ اللَّهِ ﷺ قَالَ: يَقُولُ الرَّبُّ عَزَّ وَجَلَّ: مَنْ شَغَلَهُ الْقُرْآنُ وَذَكَرَنِي عَنْ مَسْأَلَتِي، أُعْطِيَتْهُ أَفْضَلُ مَا أُعْطِيَ السَّائِلِينَ.

Transmeton Ebu Seidi [radijall-llahu anhu] se Pejgamberi [alejhi selam] ka thënë: "Zoti [xhel-le she'nuhu] thotë: "Atij që Kur'ani dhe përmendja Ime (dhikri) nuk i lënë kohë për të m'u lutur Mua, Unë do t'i jap më të mirën e asaj që u jap lutësve."²⁰

¹⁸ Ibn Hiban, *Sahih Ibn Hiban*, hadithi nr. 7144

¹⁹ Buhariu, *Sahih el-Buhari*, hadithi nr. 5011; Muslimi, *Sahih Muslim*, hadithi nr. 795

²⁰ Tirmidhiu, *Sunen et-Tirmidhi*, hadithi nr. 2926

Sipas këtij hadithi kemi dy tipa besimtarësh: një pjesë bëjnë ibadet për ta shpëtuar veten në Botën Tjetër dhe disa të tjerë thjesht për dashurinë që kanë për Allahun [xhel-le she'nuhu]. Këta të fundit janë besimtarët që me pasion dalldisen në dhikër dhe në lexim të Kur'anit, saqë lutjet personale i kanë më të rralla. Megjithatë, njerëzve të këtillë Allahu do t'u japë më të mirën nga ajo që njerëzit luten.

Ky hadith përcjell edhe mesazhin e altruizmit dhe lufton fuqishëm egoizmin.

2. DËGJIMI I KUR'ANIT

Kur'ani i Madhërishëm është libër që besimtarëve u ndan sevape kur lexohet dhe kur dëgjohe, madje pa iu pakësuar asnjërit, as lexuesit dhe as dëgjuesit. Krahës sevapit, Kur'ani ka efekte shumëdimensionale në jetën e njeriut kur dëgjohe. Tingulli kur'anor ka fuqi të çuditshme emotive dhe ndikuese i cili në shumë raste nuk mund të shpjegohet apo të analizohet, por vetëm ndjehet dhe përjetohet si i tillë, siç është rasti i Velid bin Mugires, i cili pati kërkuar nga Pejgamberi [alejhi selam] t'i lexonte Kur'an dhe e kishte pranuar kënaqësinë e dëgjimit të Kur'anit.²¹

Dëgjimi i Kur'anit pa avdes (pa e prekur mus'hafin) është i lejuar, megjithatë nuk është etike që të dëgjohe Kur'ani pa avdes për respekt ndaj fjalës së Zotit [xhel-le she'nuhu].

Sipas doktrinės së shkollës juridike hanefite, kur lexohet Kur'an jashtë namazit dhe kur ti je i pranishëm, dëgjimi i tij është vaxhib. Bazuar në ajetin kur'anor ﴿وَإِذَا قُرِئَ الْقُرْآنُ فَاسْتَمِعُوا لَهُ وَأَنْصِتُوا لَعَلَّكُمْ تُرْحَمُونَ﴾ *"Kur të lexohet Kur'ani, dëgjojeni atë dhe vëni veshin për të qenë të mëshiruar!"* (El-A'raf, 204). Kurse shkollat tjera juridike mendojnë se dëgjimi i Kur'anit jashtë namazit është mendub apo mustehab (i preferuar), duke pohuar se ajeti i mësipërm është zbritur për ta ndaluar të folurit në namaz. Ata që pohojnë vaxhibin u përgjigjen se dispozita e këtij ajeti nuk merret nga shkaku i zbritjes, por nga tërësia kuptimore e vetë fjalëve.²²

Nga kjo kuptojmë se dëgjimi i Kur'anit ka dy situata: dëgjim i detyruar dhe dëgjim i vullnetshëm. Pavarësisht kësaj, dëgjimi i Kur'anit ka vlerë, rëndësi dhe efekt në jetën e njeriut.

- Vlerë kryesore e dëgjimit të Kur'anit është bindja ndaj një urdhri (vaxhibi) të Zotit [xhel-le she'nuhu]:

²¹ Shih: Bejhekiun, *El-I'tikad li el-Bejhekiij*, Daru el-Fedileh, Egjipt, 1420, nr. 310

²² Mensur bin Junus el-Behutij, *Sherhu munteha el-iradati*, vëllimi I, f. 242

﴿وَإِذَا قُرِئَ الْقُرْآنُ فَاسْتَمِعُوا لَهُ وَأَنْصِتُوا لَعَلَّكُمْ تُرْحَمُونَ﴾

“Kur të lexohet Kur’ani, dëgjojeni atë dhe vëni veshin për të qenë të mëshiruar!” (El-A’raf, 204).

Madje, aq më mirë kur kryerja e këtij obligimi rezulton me mëshirë. Përderisa një nga synimet e besimtarit është që ta fitojë mëshirën e Zotit për të hyrë në Xhenet, e jo ta fitojë vetë Xhenetin, atëherë dëgjimi i Kur’anit përfaqëson portën më të madhe përmes së cilës rob mund të hyjë në mëshirën e pashtershme të Zotit Mëshirëplotë.

- Dëgjimi i Kur’anit u dhuron dritë dhe shpërblim të dyfishtë dëgjuesve. Ibn Abbasi transmeton se Muhamedi [alejhi selam] në një rast ka thënë:

مَنْ اسْتَمَعَ إِلَى آيَةٍ مِنْ كِتَابِ اللَّهِ تَعَالَى كَانَتْ لَهُ نُورًا

*“Kush dëgjon një ajet nga Libri i Zotit (Kur’ani), do t’i bëhet dritë.”*²³

Në një hadith tjetër, Pejgamberi [alejhi selam] ka thënë:

مَنْ اسْتَمَعَ إِلَى آيَةٍ مِنْ كِتَابِ اللَّهِ تَعَالَى كُتِبَ لَهُ حَسَنَةٌ مُضَاعَفَةٌ وَمَنْ تَلَاهَا كَانَتْ لَهُ نُورًا يَوْمَ الْقِيَامَةِ

*“Kush dëgjon një ajet nga Libri i Zotit, i shkruhet një e mirë e dyfishuar, e kush e lexon atë, do t’i bëhet dritë Ditën e Kiametit.”*²⁴

- Dëgjimi i Kur’anit mund të jetë shkak i udhëzimit në rrugë të drejtë. Mjafton që dikush t’i dëgjojë disa ajete kur’anore dhe Zoti [xhel-le she’nuhu] mund t’ia hapë zemrën për ta pranuar fenë islame apo për të hequr dorë nga një mëkat i caktuar. Historia islame dëshmon se shumë personalitete, qysh në kohën e Muhamedit [alejhi selam] dhe deri më sot, kanë përqaftuar fenë islame vetëm nga dëgjimi i Kur’anit, madje edhe ata që nuk e besonin, kishin dëshirë ta dëgjonin fshehurazi në mbrëmje Muhamedin [alejhi selam] kur lexonte Kur’an. Allahu [xhel-le she’nuhu] dëgjimin e cilëson si hapin e parë të punëve të mira, prandaj në suren Zumer, i Gjithëdijsmi thotë:

﴿فَبَشِّرْ عِبَادَ (17) الَّذِينَ يَسْتَمِعُونَ الْقَوْلَ فَيَتَّبِعُونَ أَحْسَنَهُ﴾

“Përgëzoji robërit e Mi, të cilët e dëgjojnë fjalën (Kur’anin) dhe e ndjekin më të mirën e saj!” (Ez-Zumer, 17-18).

²³ Abdurrezzak, Musannef Abdurrezzak, hadithi nr. 6012; Darimiu, Sunen ed-Darimij, hadithi nr. 3367

²⁴ Ahmed, Musned Ahmed, hadithi nr. 8494

Vlerën dhe efektin e dëgjimit të Kur'anit e pohojnë edhe vetë xhinët.²⁵ Allahu i Madhërishëm këtë situatë e përshkruan kështu:

﴿وَإِذْ صَرَفْنَا إِلَيْكَ نَفَرًا مِّنَ الْحَيِّ يَسْتَعِينُونَ الْقُرْآنَ فَلَمَّا حَضَرُوهُ قَالُوا أَنصِتُوا فَلَمَّا قُضِيَ وَلَّوْا إِلَىٰ قَوْمِهِمْ مُنْذِرِينَ ۝ قَالُوا يَاقَوْمَنَا إِنَّا سَمِعْنَا كِتَابًا أُنزِلَ مِن بَعْدِ مُوسَىٰ مُصَدِّقًا لِّمَا بَيْنَ يَدَيْهِ يَهْدِي إِلَى الْحَقِّ وَإِلَى طَرِيقٍ مُّسْتَقِيمٍ ۝﴾

“E (Përkujto) Kur disa prej xhinëve i drejtua të ti që të dëgjojnë Kur'anin dhe kur u afruan dhe e dëgjuan atë, thanë: “Dëgjoni me vëmendje!” dhe kur u krye, u kthyen te populli i vet dhe e këshilluan. Thanë: “O populli ynë, ne dëgjuam një libër të shpallur pas Musait, që vërteton atë para tij, udhëzon në të vërtetën dhe në rrugën e drejtë!” (El-Ahkaf, 29-30).

Zejd bin Erkam transmeton se Muhamedi [alejhi selam] ka thënë: “Allahu i Gjithëfuqishëm e do heshtjen në tri raste: kur lexohet Kur'an, gjatë të ecurit dhe pranë xhenazes.”²⁶

Për vlerën e dëgjimit të Kur'anit mjafton të kujtohet ajeti i dytë i sures El-Enfal, ku Allahu për besimtarë të vërtetë i cilëson ata të cilëve kur u lexohen ajetet e Tij, u shtohet besimi:

﴿إِنَّمَا الْمُؤْمِنُونَ الَّذِينَ إِذَا ذُكِرَ اللَّهُ وَجِلَتْ قُلُوبُهُمْ وَإِذَا تُلِيَتْ عَلَيْهِمْ آيَاتُهُ زَادَتْهُمْ إِيمَانًا وَعَلَىٰ رَبِّهِمْ يَتَوَكَّلُونَ﴾

“E, besimtarë të vërtetë janë vetëm ata, të cilët kur përmendet Allahu u rrëqethen zemrat, kur u lexohen ajetet e Tij u shtohet besimi, dhe që vetëm te Zoti i tyre janë të mbështetur.” (El-Enfal, 2).

Folja “u lexohen” është dhënë në trajtën pësore, d.m.th. nuk flitet për lexuesin, por në qendër të vëmendjes është dëgjuesi. Kjo gjithashtu, nënkupton se dëgjuesi i Kur'anit asnjëherë nuk duhet të shohë se kush e lexon atë, por prej tij kërkohet që kurdoherë që lexohet nga dikush, ai ta dëgjojë me vëmendje atë dhe t'i shtohet besimi.

²⁵ Ahmed Husejn Abdulkerim, *Fedaili el-Kur'ani el-Kerimi ve tilavetihi*, Dar el-Gauthani, Damask: 2007, f. 227

²⁶ Et-Taberani, *El-Mu'xhemu el-kebiru*, hadithi 5130, vëllimi III, f. 29 (hadith i dobët)

3. MËSIMI I KUR'ANIT (për vete dhe të tjerëve)

Mësimi i leximit të Kur'anit për vete është parakusht për t'ua mësuar atë të tjerëve. Nuk ka mundësi që dikush t'ua mësojë të tjerëve leximin e Kur'anit pa e ditur për vete. Po ashtu, jo çdokush që di të lexojë Kur'an mund të bëhet mësues për të tjerët, sepse dikush e mëson vetëm për vete dhe nuk është i aftë që t'ua përçojë atë të tjerëve, e dikush tjetër mëson dhe përgatitet që atë ta përvetësojë për vete dhe të jetë i aftë t'ua mësojë atë edhe të tjerëve.

Fillimisht kërkohet që Kur'ani të mësohet mirëfilli për vete, pastaj i njëjti t'u mësohet të tjerëve me shumë kujdes. Pejgamberi [alejhi selam] ka thënë:

خَيْرُكُمْ مَنْ تَعَلَّمَ الْقُرْآنَ وَعَلَّمَهُ

*“Më i miri prej jush është ai që e mëson Kur'anin (për vete) dhe ua mëson atë të tjerëve.”*²⁷

Shpërblimi dhe sevapi i lexuesit i takon edhe nxitësit, pa iu pakësuar asnjërit, sepse Muhamedi [alejhi selam] në një rast, duke vendosur një rregull të përgjithshëm, ka thënë: مَنْ دَلَّ عَلَى خَيْرٍ فَلَهُ مِثْلُ أَجْرِ فَاعِلِهِ *“Kush nxit për një punë të hairit, atij i takon njësoj sa shpërblimi i vepruesit.”*²⁸ Kjo tregon se nga leximi i Kur'anit i ndahet shpërblim edhe stimuluesit, pavarësisht nëse ai di apo nuk di për vete, siç është rasti i prindërve, për të cilët Muhamedi [alejhi selam] ka thënë:

مَنْ قَرَأَ الْقُرْآنَ، تَعَلَّمَ وَعَمِلَ بِهِ، أُلِيسَ وَالِدَاهُ يَوْمَ الْقِيَامَةِ تَاجًا مِنْ نُورٍ صَوُّهُ مِثْلُ صَوِّ الشَّمْسِ، وَبُكْسَى وَالِدَاهُ حُلَّتَيْنِ لَا يَقُومُ لَهُمَا الدُّنْيَا، فَيَقُولَانِ: بِمِ كَسِينَا هَذَا؟ فَيَقَالُ: بِأَخَذِ وَلَدِكُمَا الْقُرْآنَ.

Transmeton Burejde [radijall-llahu anhu] se Pejgamberi [alejhi selam] ka thënë: *“Kush e lexon Kur'anin, e mëson dhe vepron me të, Ditën e Kiametit prindërve të tij do t'u vihen mbi kokë kurora nga drita, si drita e diellit, dhe do t'u vishen tesha që si gjen në botë, kurse ata do të pyesin: përse*

²⁷ Buhariu, *Sahihu el-Buhari*, hadithi nr. 5027

²⁸ Muslimi, *Sahihu Muslim*, hadithi nr. 1893

jemi veshur kështu? U thuhet: Sepse fëmija juaj i është përkushtuar Kur'anit.”²⁹

Në këtë sferë hyjnë të gjithë nxitësit, stimuluesit, investuesit, inkurajuesit etj., sepse të gjithë kanë një qëllim të përbashkët, që fjala e Allahut të lexohet dhe të jetë më e larta.

Pyetje:

- Trego disa ajete për vlerën e leximit të Kur'anit!
- Thekso disa hadithe për vlerën e leximit të Kur'anit!
- Çfarë di për vlerën e dëgjimit të Kur'anit?
- Si e sqaron Imam Gazali frazën “hak i leximit”?
- Cila është dispozita e dëgjimit të Kur'anit?
- Çfarë vlere ka mësimi i Kur'anit të tjerëve?

²⁹ Mundhiriu, *Et-tergibu ve et-terhibu*, 2/303; Hakimi, *El-mustedreku ala es-sahihajni*, hadithi nr. 2086

KREU II

NORMAT E DETYRUESHME DHE NORMAT ETIKE



- Normat para leximit të Kur'anit
- Norma gjatë leximit të Kur'anit
- Norma të përgjithshme rreth leximit të Kur'anit

NORMAT PARA LEXIMIT TË KUR'ANIT

Leximi i Kur'anit është një adhurim (ibadet) shumë i dashur te Zoti [xhel-le she'nuhu]. Lexuesi i tij në një mënyrë konsiderohet se komunikon me Krijuesin, prandaj duhet të respektojë disa norma të detyrueshme (farze apo vaxhibe) dhe disa të tjera të preferuara (mustehabe).

Normat që do t'i numërojmë në vazhdim vijnë vetëm pasi lexuesi ta ketë pastruar njetin dhe leximin ta bëjë vetëm për Allahun. Normat detyruese janë thelbësore, kurse normat e preferuara janë dytësore dhe vetëm e kristalizojnë apo e plotësojnë leximin e Kur'anit.

Gusulli dhe avdesi

Papastërtia në jurisprudencën islame ndahet në dy lloje: papastërtia e vogël dhe papastërtia e madhe. Papastërti e madhe është xhunub-llëku, hajzi (menstruacionet) dhe nifasi (lehonia), të cilat largohen me gusull, kurse papastërtia e vogël largohet me avdes, ose në mungesë të ujit, të dyja largohen me tejemum.

Të gjithë dijetarët ndajnë mendimin se prekja e mus'hafit dhe leximi i Kur'anit janë të ndaluara (haram) për xhunubin (të papastrin),³⁰ për gruan gjatë periudhës së menstruacioneve dhe për lehonën. Prekja e mus'hafit ndalohet me këtë ajet «لَا يَمَسُّهُ إِلَّا الْمُطَهَّرُونَ» *“Atë e prekin vetëm të pastruarit.”* (El-Vakia, 79), kurse leximi i Kur'anit ndalohet me disa hadithe të Muhamedi [alejhi selam], ndër të tjerash është edhe ky: لَا تَقْرَأُ الْحَائِضُ وَلَا الْجُنُبُ شَيْئًا مِنَ الْقُرْآنِ *“Gruaja në menstruacione dhe xhunubi nuk lexojnë asgjë nga Kur'anit.”*³¹

Vlen të theksohet mendimi i malikive, të cilët e lejojnë prekjen e mus'hafit dhe leximin e Kur'anit për gruan gjatë të përmuajshmeve dhe për lehonën vetëm kur bëhet fjalë për mësim. Ndërsa nuk lejohet

³⁰ Ministria e Vakfit dhe e Çështjeve Fetare, *El-Meusuatu el-Fikhijetu el-Kuvejtijetu*, vëllimi 33, Daru Es-Safvetu, Egjipt: 1995, f. 59

³¹ Trimidhiu, *Sunen et-Tirmidhij*, hadithi nr. 131

për xhunubin, sepse ai mund ta evitojë papastërtinë me gusul apo me tejemum.³² Kurse hanefijtë preferojnë që kjo prekje (e gruas në të përmuajshme dhe e lehonës) të mos jetë e drejtpërdrejtë, por me ndonjë mbështjellës, me majë lapsi etj.³³ Po ashtu, janë të lejuara lutjet që përmbajnë ajete të Kur'anit, nëse lexohen me nijet të lutjeve, pavarësisht papastërtisë së madhe apo të vogël. Bashkëshortja e Muhamedit [alejhi selam] për këtë çështje është prononcuar kështu: *"Muhamedi [alejhi selam] bënte dhikër (përmendte Allahun) në çdo situatë."*³⁴

Nëse është evituar papastërtia e madhe (xhunubllëku, menstruacionet dhe lehonja), atëherë leximi i Kur'anit pa avdes është i lejuar nga të gjithë dijetarët, kuptohet pa e prekur mus'hafin.

Marrja avdes për të lexuar Kur'an, pa e prekur mus'hafin, është mustehabb (e preferuar).

Pastrimi i gojës, i vendit dhe i petkut

a) Pastrimi i gojës para leximit të Kur'anit është një veprim i pëlqyer dhe një traditë e Muhamedit [alejhi selam]. Transmetohet se imam Aliu [radijall-llahu anhu] i kishte porositur besimtarët që ta pastronin gojën me misvak, sepse Muhamedi [alejhi selam] ka thënë: *"Kur robi e pastron gojën, pastaj ngrihet e falet, pas tij menjëherë ngrihet meleku dhe e dëgjon leximin e tij. I afrohet derisa ta vendosë gojën pranë gojës së tij, ashtu që, çdo lexim i Kur'anit që del nga gjuha e tij depërton brenda melekut. Prandaj, pastroni gojët tuaja për leximin e Kur'anit!"*³⁵

Sipas këtij hadithi preferohet që para leximit të Kur'anit të pastrohet goja nga çdo papastërti, veçanërisht nga ushqimet dhe pijet që kundërmojnë erë të keqe.

b) Zgjedhja e vendit të pastër është një veprim tjetër që preferohet para leximit të Kur'anit. Imam Neveviu ka thënë: *"...prandaj një grup dijetarësh e kanë preferuar leximin e Kur'anit në xhami, sepse*

³² Malik ibn Enes, *El-mudevvenetu el-kubra*, vëllimi I, f. 112

³³ El-Kasaniu, *Bedaiu es-sanai'i fi tertibi esh-sherai'i*, vëllimi I, f. 156

³⁴ Muslimi, *Sahihu Muslim*, hadithi nr. 373

³⁵ Bezzari, *Musnedu Bezzar*, hadithi nr. 603

aty është vendi më i pastër dhe më i ndershëm...”³⁶ Gjithashtu, leximi i Kur'anit sot është i preferuar edhe në shtëpi, në vendin e punës, në zyrë apo në vende tjera të pastra, sepse niveli i pastërtisë sot është i lartë gjithandej ku vepron besimtari.

Hanefitët, malikitët, shafitët dhe hanbelitët e urrejnë leximin e Kur'anit në vende të ndyra, ndërsa malikitët e lejojnë vetëm leximin e ajeteve të mbrojtjes apo të ngjashme. Pra, hanefitët e urrejnë leximin e Kur'anit në thertore, në banjë (pa nevojtoje) dhe në vende tjera të papastra. Sipas hanefive, leximi në banjë të pastruar mirë (pa nevojtoje) dhe nëse aty nuk ka njeri me avret të zbuluar, është i lejuar me zë dhe në vete pa kerahet (urrejtje), në të kundërtën, atëherë lejohet pa kerahet (urrejtje) vetëm leximi në vete, kurse leximi me zë është i urryer.³⁷ Sa i përket leximit në vendet me papastërti të madhe, siç është nevojtoja, është i ndaluar rreptësisht (haram).

c) Pastrimi i petkut të lexuesit të Kur'anit është një preferencë tjetër e rëndësishme. Duke e ditur se leximi i Kur'anit është adhurimi më i dashur për Zotin, sepse lexohet fjala e Tij, atëherë çdo gjë që lidhet me të duhet të jetë e pastër, në mesin e tyre edhe teshat apo petku i lexuesit.

Drejtimi kah kibla

Drejtimi kah kibleja është një veprim tjetër i preferuar gjatë leximit të Kur'anit. Muhamedi [alejhi selam] në një rast, ndër të tjerash, është shprehur kështu: *إِنَّ لِكُلِّ شَيْءٍ شَرْفًا وَإِنَّ أَشْرَفَ الْمَجَالِسِ مَا اسْتُقْبِلَ بِهِ الْقِبْلَةُ* “Çdo gjë ka denjësinë e vet, kurse vendi më i denjë është ai që është drejtuar kah kibla.”³⁸

Leximi pa u drejtuar kah kibla është padyshim i vlefshëm, por drejtimi kah kibla vetëm sa ia shton bukurinë dhe sevapin atij leximi.

³⁶ Imam Neveviu, *Et-Tibjan fi adabi hameleti el-Kur'ani*, botimi II, Daru el-Min'haxhi, Arabi Saudite – Xhide: 2011, f. 95-96

³⁷ Ministria e Vakfit dhe e Çështjeve Fetare, *El-Meusuatu el-Fikhijetu el-Kuvejtijetu*, vëllimi 33, Daru Es-Safvetu, Egjipt: 1995, f. 62

³⁸ Ebu Abdullah El-Hakim En-Nisaburi, *El-Mustedreku ala es-sahihajni*, vëllimi IV, Daru el-haramejni li et-tibaati ve en-neshri ve et-tevzi'i, Kajro: 1997, nr. 7787, f. 404

Përzgjedhja e kohës

Përzgjedhja e kohës së përshtatshme ka një rëndësi të veçantë në leximin e Kur'anit. Koha luan një rol të madh në kualitetin e leximit, të kuptimit dhe të meditimit të Kur'anit.

Lexuesi duhet ta zgjedhë kohën më të mirë për leximin e Kur'anit, kur ai është më i pushuar dhe më i kthjellët, sepse Muhamedi [alejhi selam] ka thënë:

إِذَا قَامَ أَحَدُكُمْ مِنَ اللَّيْلِ فَاسْتَعَجَمَ الْقُرْآنُ عَلَى لِسَانِهِ فَلَمْ يَدْرِ مَا يَقُولُ فَلْيُضْطَجِعْ

"Nëse ndonjëri nga ju ngrihet natën për t'u falur, të cilit nuk i merret vesh leximi i Kur'anit, nuk di çfarë thotë, atëherë më mirë le të bjerë të flejë!"³⁹

Po ashtu, duhet ta gjurmojë edhe kohën më të përshtatshme për mësuesin, në mënyrë që edhe ai të dëgjojë me më shumë vëmendje atë që i lexohet.

Krahas kohës së përshtatshme të lexuesit dhe të mësuesit, Allahu [xhel-le she'nuhu] ka theksuar disa kohë të preferuara për leximin e Kur'anit, ku ndër të tjerash thotë:

﴿أَقِمِ الصَّلَاةَ لِذُلُوكِ الشَّمْسِ إِلَى غَسَقِ اللَّيْلِ وَقُرْآنَ الْفَجْرِ إِنَّ قُرْآنَ الْفَجْرِ كَانَ مَشْهُودًا﴾

"Kryeje namazin prej kthimit të Diellit (nga gjysma e qiellit) deri në errësirën e natës (së plotë) dhe leximin e Kur'anit në agim (namazin e sabahut); vërtet, namazi i sabahut është i dëshmuar." (El-Isra, 78).

Po ashtu, diku tjetër është theksuar edhe koha e syfyrit, por ajo është koha më e mirë e veçuar për adhurimin në përgjithësi dhe jo vetëm për një adhurim të caktuar.

Fillimi me istiadhe dhe besmele

Veprim tjetër i preferuar para leximit të Kur'anit është leximi i istiadhes dhe besmeles. Këto dyja e përgatisin lexuesin që leximi të

³⁹ Muslimi, *Sahihu Muslim*, hadithi nr. 787

jetë më i dobishëm dhe më i dëlirë, sepse përmes istiadhes e shmang simbolin e së keqes, shejtanin, kurse me të dytën lidhet me të Mirin Absolut (Allahun).⁴⁰

Pyetje:

- Cilat janë normat para leximit të Kur'anit?
- A lejohet leximi i Kur'anit pa avdes, pa e prekur?
- Çfarë mendojnë dijetarët për prekjen e mus'hafit pa avdes?
- A lejohet leximi i Kur'anit dhe prekja e mus'hafit për xhunubin, gruan në menstruacione dhe lehonën?
- Cila është koha më e preferuar për leximin e Kur'anit?

⁴⁰ Më gjerësisht, për dispozitat, normat dhe format e këtyre dy frazave, shih kreun III "Hyrije në shkencën e texhvidit", titujt: "Istiadhja" dhe "besmeleja"

NORMAT GJATË LEXIMIT TË KUR'ANIT

Lexuesi i Kur'anit, krahas veprimeve përgatitore, duhet të respektojë edhe disa norma të detyrueshme (farze apo vaxhibe) dhe të preferuara (mustehabe) edhe gjatë vetë procesit të leximit të Kur'anit, në mënyrë që ky i fundit të dallohet nga leximet e rëndomta.

Shumica e normave gjatë leximit të Kur'anit janë norma të preferuara (mustehabe).

Leximi tertil

Mënyrat e lejuara të leximit të Kur'anit janë disa, megjithatë preferohet leximi tertil.⁴¹ Ky ritëm i leximit përfaqëson formën më të pëlqyer të leximit të Kur'anit, sepse ka shpejtësi mesatare përmes së cilës mund të arrihen paralelisht dy gjëra të rëndësishme: sevapi dhe meditimi.

Allahu [xhel-le she'nuhu] në Kur'an thotë: ﴿وَرَتَّلِ الْقُرْآنَ تَرْتِيلًا﴾ "*Lexo Kur'anin tertil (me ritëm mesatar)!*". Po ashtu, transmetohet nga En-Nesaiu dhe të tjerë se Ummu Selemja e ka cilësuar leximin e Pejgamberit [alejhi selam] si shpjegues dhe të qartë shkronjë për shkronje.⁴²

Meditimi dhe përsëritja e ajeteve

Leximi i Kur'anit e afron robin me Krijuesin [xhel-le she'nuhu]. Ky afrim, gjegjësisht ky lexim, është më i dashur kur bëhet me vetëdije dhe duke i kuptuar e medituar kuptimet kur'anore.

Meditimi dhe përsëritja e ajeteve ishte një veprim i zakonshëm i Muhamedit [alejhi selam], i cili ndonjëherë e kalonte tërë natën duke e përsëritur, duke e medituar, duke u lutur dhe duke qarë vetëm me një ajet. Në një transmetim, Ebu Dheri [radijall-llahu anhu] ka thënë: "Një

⁴¹ Për tertilin, shih gjerësisht në kreun III, te "Ritmet dhe tipat e leximit".

⁴² En-Nesai, *Sunenu En-Nesai*, hadithi nr. 1629, "Bejtu el-efkari ed-duvelijjeh", Liban: 2004, f. 192

natë i Dërguari i Allahut falej dhe e lexonte ﴿إِنْ تُعَذِّبُهُمْ فَإِنَّهُمْ عِبَادُكَ وَإِنْ تَغْفِرَ لَهُمْ﴾ natë i Dërguari i Allahut falej dhe e lexonte ﴿إِنْ تُعَذِّبُهُمْ فَإِنَّهُمْ عِبَادُكَ وَإِنْ تَغْفِرَ لَهُمْ﴾ *“Nëse i dënon, ata janë robërit e Tu, e nëse i fal, Ti je i Gjithëfuqishëm dhe i Urtë.”* (El-Maide: 118), me të cilin filloi t’i bënte edhe rukutë edhe sexhdet. Në të gdhirë, i thashë: “O i Dërguari i Allahut, ende e lexon këtë ajet?” Muhamedi [alejhi selam] tha: “I kërkova Zotit ndërmjetësimin për umetin tim dhe ma dha, të cilin, në dashtë Zoti, do ta fitojë secili që nuk i ka përshkruar shok Zoti.”⁴³ Kështu ndodhte shpesh me ajete të ndryshme.

Muslimanët e mëhershëm (selefët) e përsërisnin një ajet disa herë për ta meditaruar hollë e mirë. Sa herë që e përsërisnin, u shpaloseshin horizonte të reja kuptimore rreth atij ajeti.

Ibn Kajimi ka thënë: “Kur’ani duhet lexuar me meditim. Kur të kalohet pranë një ajeti të nevojshëm, i cili e shëron një ligësi të zemrës, të përsëritet njëqind herë, madje edhe tërë natën. Leximi i një ajeti me meditim dhe përsiatje është më i mirë se leximi i një hatme të tërë spontanisht dhe pa meditim; (leximi me meditim) është më i dobishëm për zemrën dhe më i përshtatshëm për ta arritur besimin (e vërtetë) dhe ëmbëlsinë e leximit të Kur’anit.”⁴⁴

Dijetari i njohur Ibrahim El-Havvas, Zoti qoftë i kënaqur me të, ka thënë: “Pesë gjëra janë melheme të zemrës: leximi i Kur’anit me meditim, mbajtja e barkut të zbrazët, namazi i natës, lutja në kohën syfyrit dhe shoqërimi me njerëz të mirë.”⁴⁵

Përsëritja e ajeteve është vepër e preferuar, sepse përmes saj arrihet meditim i kuptimeve kur’anore. Megjithatë, nëse përsëritja bëhet thjesht për ta zbukuruar leximin, atëherë kjo është e urryer, sepse humb thelbi i leximit të Kur’anit, sinqeriteti. Mirëpo, nëse zbukurimi i leximit nuk ka synim kryesor vetëm paraqitjen e bukur, atëherë nuk është i urryer.

⁴³ Ahmed bin Hanbel, *Musnedu Ahmed*, vëllimi XXXV, Er-Risaletu, Damask, 2001, nr. i hadithit: 21328, f. 256

⁴⁴ Ibn Kajim El-Xheuzij, *Miftahu Dari es-Seadet ve menshuru vilajeti el-ilmi ve el-idareti*, Daru el-Kutubu el-Ilmijeti, Bejrut, (pa vit botimi), f. 187

⁴⁵ Abdullah Seraxhuddin, *Tilavetu el-Kur’ani el-Mexhidi*, botimi IV, Daru El-Felah, Haleb: 2002, f. 132

Përgjigjja në disa sure

Tradita pejgamberike tregon se Muhamedi [alejhi selam] kur kalonte pranë disa ajeteve apo sureve, lutej dhe përgjigjej varësisht sipas kontekstit të ajetit apo sures, prandaj ky veprim është i preferuar të bëhet nga çdo lexues i Kur'anit.

Në vazhdim do të paraqesim disa shembuj nga kjo sferë:

Transmeton Ebu Hurjeje [radijall-llahu anhu] se i Dërguari [alejhi selam] ka thënë: “Kush e lexon: ﴿وَالَّذِينَ وَالَّذِينَ﴾ *“Pasha fikun dhe ullirin”* dhe e përfundon me ﴿أَلَيْسَ اللَّهُ بِأَحْكَمَ الْحَاكِمِينَ﴾ *“A nuk është Allahu më i drejti i të drejtëve?”*, le të thotë: بَلَىٰ وَأَنَا عَلَىٰ ذَٰلِكَ مِنَ الشَّاهِدِينَ *“Gjithsesi, edhe unë jam dëshmitar për këtë!”*. Kush e lexon ﴿لَا أَقْسِمُ بِبَوْمِ الْقِيَامَةِ﴾ *“Betohem në Ditën e Kiametit!”* dhe përfundon me ﴿أَلَيْسَ ذَٰلِكَ بِقَادِرٍ عَلَىٰ أَنْ يُخْرِجَ الْمَوْتَىٰ﴾ *“A nuk është Ai i Fuqishëm që t'i ringjallë të vdekurit?”*, le të thotë: بَلَىٰ *“Gjithsesi!”*. Kush e lexon ﴿وَالْمُرْسَلَاتِ﴾ *“Pasha erërat e njëpasnjëshme!”* dhe përfundon me ﴿فَبِأَيِّ حَدِيثٍ بَعْدَهُ يُؤْمِنُونَ﴾ *“Pra, cilës fjalë i besojnë pas kësaj?”*, le të thotë: ءَامَنَّا بِاللَّهِ تَعَالَىٰ *“Besuam Allahun e Lartësuar.”*⁴⁶

Transmeton Ibn Abbasi [radijall-llahu anhu] se Pejgamberi [alejhi selam] kur e lexonte ﴿سَبِّحْ اسْمَ رَبِّكَ الْأَعْلَىٰ﴾ *“Lartëso emrin e Zotit tënd të Lartësuar!”*, thoshte: سُبْحَانَ رَبِّيَ الْأَعْلَىٰ *“Qoftë i lartësuar Zoti im!”*⁴⁷

Transmeton Zubejr ibn Avvami [radijall-llahu anhu], i cili ka thënë: “E kam dëgjuar të Dërguarin në Arafat duke e lexuar këtë ajet kur'anor ﴿شَهِدَ اللَّهُ أَنَّهُ لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ وَالْمَلَائِكَةُ وَأُولُوا الْعِلْمِ قَائِمًا بِالْقِسْطِ لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ الْعَزِيزُ الْحَكِيمُ﴾ *“Allahu dëshmoi se s'ka zot veç Tij. Edhe engjëjt e të diturit, me drejtësi: “S'ka zot veç Tij, të Plotfuqishmit, të Urtit.”* (Alu Imran, 18). Kur e lexonte, thoshte: وَأَنَا عَلَىٰ ذَٰلِكَ مِنَ الشَّاهِدِينَ يَا رَبِّ *“edhe unë jam dëshmitar për këtë, o Zoti im!”*⁴⁸

⁴⁶ Ebu Davudi, *Sunen Ebi Davud*, hadithi nr. 887

⁴⁷ Ebu Davudi, *Sunen Ebi Davud*, hadithi nr. 883; Ahmed, *Musned Ahmed*, hadithi nr. 2067

⁴⁸ Ahmed, *Musned Ahmed*, hadithi nr. 1424

Transmeton Xhabiri [radijall-llahu anhu]: doli i Dërguari i Allahut [alejhi selam] para sahabëve dhe e lexoi suren er-Rahman nga fillimi deri në fund, ku heshtën të gjithë, Pejgamberi [alejhi selam] në fund u tha: “Ua lexova atë xhinëve, e ata përgjigjeshin më mirë se ju. Sa herë që e përsërisja ajetin ﴿فَبِأَيِّ آلَاءِ رَبِّكُمَا تُكَذِّبَانِ﴾ “*E cilën begati të Zotit tuaj e mohoni?!”, thoshin لَا يَنْفِي مِنْ نَعِيمِكَ رَبَّنَا نَكْذِبُ، فَلَكَ الْحَمْدُ “Asnjë begati Tënden nuk e mohojmë, o Zoti Ynë! Ty të takon falënderimi!”⁴⁹*

Gjithashtu, ka transmetime se Pejgamberi [alejhi selam] në fund të sures el-Fatiha dhe el-Bekare ka thënë آمين Amin!

Të gjitha këto janë të lejuara gjatë leximit të Kur'anit jashtë namazit, kurse brenda në namaz, farz apo nafile, sipas medhhebit hanefi janë të ndaluara rreptësisht për xhematin, por edhe për imamin janë mekruh t'i thotë (qoftë edhe në heshtje, përpos Aminit). Motivi i kësaj ndalese është i ditur, ngase xhemati e ka të ndaluar të lexojë pas imamit, pra është i obliguar vetëm të dëgjojë leximin e Kur'anit. Pra, në medhhebin hanefi është e ndaluar brenda namazit në të gjitha aspektet: për imamin, për xhematin dhe për atë që falet vetëm,⁵⁰ kurse në medhhebet tjera ka mendime të ndryshme.

Sexhdja e leximit (shexhdetu tilaveh)

Gjatë leximit të Kur'anit, pas përfundimit të disa ajeteve kërkohet rënia në sexhde për lexuesin dhe dëgjuesin. Sipas hanefitëve zbatimi i sexhdes së leximit është vaxhib (detyrim), kurse sipas të tjerëve sunnet (veprim vullnetar).⁵¹ Hanefitë mbështeten në fjalët e Othmanit (hadithin mevkuf): “Sexhde duhet të bëjë ai që e dëgjon (ajetin e sexhdes)”.⁵²

⁴⁹ Trimidhiu, *Sunen et-Tirmidhi*, hadithi nr. 3291

⁵⁰ Bedruddin El-Ajnij, *El-Benajetu sherhu el-hidajeti*, vëllimi II, Daru El-Kutubi El-Ilmijeti, Bejrut: 1999, f. 321

⁵¹ Ministria e Vakfit dhe e Çështjeve Fetare, *El-Meusuatu el-Fikhijetu el-Kuvejtijetu*, vëllimi 24, Daru Es-Safvetu, Egjipt: 1995, f. 213

⁵² Ibn Haxher el-Askalani, *Fet'hu el-bari*, vëllimi II, El-Mektebetu es-Selefijetu, Kajro, 1407 h., f. 649 (hadith sahih); Neveviu, *El-Mexhmu'u sherhu el-muhedhdheb*, vëllimi IV, Dar el-Fikr, Damask, f. 58

Sexhdeja e leximit bëhet me avdes, i drejtuar kah kibla, me një sexhde (ruk'n) dhe me dy tekbire (sunset) të shqiptuara me zë: tekbiri i parë thuhet para rënies në sexhde, kurse i dyti pas ngritjes së kokës nga sexhdeja. Gjatë shqiptimit të tekbireve nuk ngrehen duart.⁵³ Gjatë kohës kur jemi në sexhde është sunset të thuhet këto fjalë: (سُبْحَانَ رَبِّيَ الْأَعْلَى) “Pa të meta është Zoti im i Lartësuar”, pastaj pas tekbirit të dytë kur çohemi nga sexhdeja preferohet të thuhet lutja: (سَمِعْنَا وَأَطَعْنَا غُفْرَانَكَ رَبَّنَا وَإِلَيْكَ الْمَصِيرُ) “Dëgjuam dhe u nënshtruam. Na fal, o Zoti ynë! Vetëm te Ti është kthimi!”. Nëse jemi ulur, preferohet që para realizimit të sexhdes të ngrihemi në këmbë.

Sexhdeja e leximit bëhet njësoj në namaz dhe jashtë namazit. Nëse në namaz e përfundon leximin me ajetin e sexhdes, atëherë sexhden e mbulon rukuja dhe sexhdeja e zakonshme e namazit. Nëse lexon dy apo më shumë ajete pas ajetit të sexhdes, atëherë merr tekbir, shkon drejt në sexhde, pastaj çohesh me tekbirin e dytë dhe e vazhdon namazin.

Të gjitha sexhdet që kalohen brenda një seance leximore plotësohen me një sexhde të vetme. Sa seanca kalohen, aq sexhde obligohen, kuptohet nëse është lexuar ndonjëri nga ajetet e sexhdes.

Po ashtu, sipas hanefive numri i ajeteve të sexhdes është 14:

1. El A'raf, 206	8. En-Neml, 25
2. Er-Ra'd, 15	9. Es-Sexhdeh, 15
3. En-Nahl, 50	10. Sad, 24
4. El Isra, 109	11. Fussilet, 37
5. Merjem, 58	12. En-Nexhm, 62
6. El Haxh, 18	13. El Inshikak, 20
7. El Furkan, 60	14. El Alek, 19

⁵³ Në shkollën juridike hanefite ngritja e duarve bëhet vetëm në tekbirin tahirim (fillestar). Tekbiri i parë i sexhdes së leximit nuk llogaritet tekbir tahirim, prandaj nuk ka edhe selam.

Zbukurimi i zërit

Leximi i Kur'anit me zë të bukur është një preferencë (mustehab) e aprovuar nga dijetarët e të gjitha kohëve dhe vendeve: sahabët, tabiinët dhe gjithë dijetarët e hershëm apo të vonshëm.⁵⁴ Pejgamberi [alejhi selam] ka thënë: *يَتَنَوُوا الْقُرْآنَ بِأَصْوَاتِكُمْ فَإِنَّ الصَّوْتَ الْحَسَنَ يَزِيدُ الْقُرْآنَ حُسْنًا* "Zbukuroni Kur'anin me zërat tuaj, sepse zëri i bukur ia shton hijeshinë Kur'anit!"⁵⁵

Zbukurimi i zërit gjatë leximit të Kur'anit është mustehab (i preferuar), megjithatë ndonjëherë mund të jetë edhe i ndaluar (haram), si p.sh. nëse zbukurimi e dëmton kualitetin e leximit ose bëhet me kryelartësi dhe vetëpëlqim, atëherë ky lloj i zbukurimit është i urryer.

Gjithashtu, mustehab (e preferuar) është që të kërkohet nga dikush tjetër që ta lexojë Kur'anin me zë të bukur. Ky veprim është i legjitimuar nga praktika e Muhamedit [alejhi selam], i cili ka kërkuar nga Ibn Mes'udi që t'i lexonte Kur'an personalisht atij. Kështu kanë vepruar edhe sahabët, tabiinët dhe gjithë dijetarët e tjerë.

Shikimi në mus'haf

Shikimi në mus'haf gjatë leximit të Kur'anit është një veprim i preferuar (mustehab), sepse bashkohen dy ibadete: leximi dhe shikimi në mus'haf. Këtë çështje e ka potencuar Imam Gazaliu, Neveviu dhe shumë dijetarë të tjerë.⁵⁶

Përveç faktit se shikimi në mus'haf është ibadet, shikimi i mundëson lexuesit (jo të shkathët) që t'i meditojë më mirë ajetet që i lexon. Leximi përmendsh e ul kualitetin e meditimit tek ata që nuk e kanë nxënë mirë pjesën që e lexojnë, sepse koncentrohen në përkujtimin e tekstit të nxënë përmendsh.

⁵⁴ Imam Neveviu, *vep. e cit.*, f. 127

⁵⁵ Ebu Davudi, *Sunen Ebi Davud*, hadithi nr. 1468

⁵⁶ Imam Neveviu, *vep. e cit.*, f. 118-119

Leximi i pandërprerë dhe qëndrimi me edukatë

Preferohet që leximi i Kur'anit mos të ndërpritet me bisedë, me të qeshur apo me veprim të panevojshëm, ose lexuesi gjatë leximit të shohë lart e poshtë në formë të pakontrolluar.

Nëse lexuesi e konsideron leximin e Kur'anit si bashkëbisedim me Krijuesin e Gjithësisë, atëherë edhe forma e komunikimit duhet të jetë e përkryer, duke ia kushtuar gjithë vëmendjen Atij. Po ashtu, shpërqendrimi gjatë leximit flet për mungesë të seriozitetit dhe e ul mundësinë e përfitimit nga thesari kuptimor i Kur'anit. Sot preferohet që edhe telefonat të mos i kemi afër gjatë leximit të Kur'anit, pra t'i fikim apo të mos i kemi para syve, sepse prania e tyre e shpërqendron vëmendjen nga leximi i mirëfilltë i Kur'anit.

Mbajtja e rendit të sureve dhe ajeteve

Preferohet që leximi i Kur'anit të bëhet me rend, pa u kapërcyer ndonjë sure apo ajet. Nëse kapërcehet një apo më shumë ajete ose sure, atëherë një veprim i tillë është i urryer (mekruh). Ndërsa, nëse leximi i hatmes bëhet nga surja e fundit (Nas) te e para (Fatih), apo një sure e vetme lexohet nga ajeti i fundit te i pari, atëherë një veprim i tillë është i ndaluar unanimisht (haram), sepse vjen ndesh me mrekullinë e renditjes së sureve dhe të ajeteve. Pra, kapërcimet e pjesshme janë mekruh, kurse ato të tërësishme janë haram.

Pyetje:

- ❧ Cili është ritmi më i preferuar gjatë leximit dhe pse?
- ❧ Trego disa përgjigje që thuhet pas leximit të disa ajeteve!
- ❧ Sa sexhde leximi ka në Kur'an?
- ❧ Çfarë dispozite i japin hanefitët sexhdes së leximit?
- ❧ A lejohet leximi i Kur'anit mbrapsht?
- ❧ Çfarë dispozite ka shikimi në mus'haf dhe pse?

NORMA TË PËRGJITHSHME RRETH LEXIMIT TË KUR'ANIT

Krahas normave para dhe gjatë leximit të Kur'anit, ekzistojnë disa norma tjera që ndërlidhen me Kur'anin në përgjithësi dhe me mus'hafin, por që i hyjnë në punë lexuesit të Kur'anit.

Kushtimi i sevapit për të vdekurin

Leximi i Kur'anit bëhet vetëm për hir të Allahut dhe për askënd tjetër, kurse sevapi i leximit të Kur'anit mund t'i ndahet edhe të vdekurit sipas mendimit të një pjese të konsiderueshme të dijetarëve.

Hanefitët, hanbelitët, malikitët e vonshëm dhe shafitët e vonshëm mbajnë mendimin se sevapi i leximit të Kur'anit mbërrin tek i vdekuri dhe si i tillë është i lejuar. Malikitët e hershëm dhe shafitët e hershëm mendojnë se sevapi i leximit të Kur'anit nuk mbërrin tek i vdekuri, prandaj është mekruh.⁵⁷

Dijetarët që mbajnë mendimin se sevapi i leximit të Kur'anit mbërrin tek i vdekuri mbështeten në këto prova:

Allahu [xhel-le she'nuhu] thotë: **“Edhe ata që kanë ardhur pas tyre e thonë: “Zoti ynë, falna ne dhe vëllezërit tanë që para nesh u pajisën me besim dhe mos lejo në zemrat tona urrejtje ndaj atyre që besuan. Zoti ynë, Ti je i Butë, Mëshirues!”** (El-Hashr, 10) Muhamedi [alejhi selam] ka thënë: *“Kur të vdes njeriu, veprat e tij ndërpriten përveç tri (vepra): bamirësia (lëmosha) e vazhdueshme, dituria që njerëzit përfitojnë nga ajo, apo një fëmijë i drejtë (i hajrit) i cili lutet për të.”*⁵⁸ Ajeti dhe hadithi konfirmojnë se parimisht besimtari i vdekur ka dobi nga besimtari i gjallë.

Muhamedi [alejhi selam] ka thënë: *“Lexojuni të vdekurve tuaj suren Jasin!”*⁵⁹ Disa studiues këtë hadith e përdorin për të justifikuar leximin e sures Jasin vetëm kur njeriu është në agoni të vdekjes, mirëpo dijetarët

⁵⁷ Shih: Ministria e Vakfit dhe e Çështjeve Fetare, *El-Meusuatu el-Fikhijjetu el-Kuvejtijjetu*, vëllimi 33, Daru Es-Safvetu, Egjipt: 1995, f. 60-61

⁵⁸ Muslimi, *Sahihu Muslim*, hadithi nr. 1631

⁵⁹ Ibn Hiban, *Sahihu Ibn Hiban*, hadithi numër: 3002. Ky hadith transmetohet edhe nga Ibn Kajjimi, Bejhekiu, Taberaniu etj.

tjerë u përgjigjen se kuptimi real është më me përparësi sesa kuptimi alegorik, prandaj këtu bëhet fjalë për çdo të vdekur pa marrë parasysh nëse vdes tani apo ka vdekur shumë kohë më parë. Kështu interpretohet edhe nga Sheukani. Ngjashëm me këtë është edhe hadithi: *“Zemra e Kur'anit (është Jasini). Çdokush që e lexon atë duke synuar Allahun dhe Botën Tjetër, Allahu e fal atë. Lexojuni atë të vdekurve tuaj!”*⁶⁰

Hadithi *“Kur njeriu vdes, i ndërpritet puna e tij përveç në tri raste...”*, tregon se njeriut i ndërpritet aktiviteti i veprimit dhe jo përfitimi nga puna e të tjerëve, ngase atëherë do të ishte e ndaluar edhe haxhi, sadakaja etj.

Pretendimi se “për haxhin, sadakanë etj. ka tekst fetar që e arsyeton, kurse për leximin e Kur'anit nuk ka,” është pretendim i pasaktë, sepse Muhamedit [alejhi selam] vetëm për këto iu parashtrua pyetje, madje nuk transmetohet se është pyetur për diçka të ngjashme dhe të ketë dhënë përgjigje negative.

Po ashtu, vetë pranimi i haxhit është dëshmi se pranohet edhe leximi i Kur'anit, sepse gjatë kryerjes së haxhit ka edhe lexim Kur'ani. Nuk mund të thuhet se atij i pranohet vetëm një pjesë e haxhillëkut, kurse tjetra jo.

Ata që e marrin për bazë ajetin e sures Jasin **“Për t'ia tërhequr vërejtjen atij që është gjallë (me mend e zemër) dhe dënimi të bëhet meritë për jobesimtarët.”** (Jasin, 70), u themi se ky ajet nuk flet aspak për këtë problematikë, sepse nuk është marrë si provë nga asnjë imam (dijetar) i vjetër.

Një dëshmi tjetër është vetë fakti se në namazin e xhenazes lexohet surja Fatiha, veprim që është i konfirmuar edhe nga imam Buhariu, i cili një kapitull e quajti “Leximi i Fatihës së Librit të xhenazja”.

Disa dijetarë, si p.sh. Ibn Salahu, e kanë preferuar që pas leximit të Kur'anit, pavarësisht sasisë, të bëhet lutje dhe në atë lutje të theksohet se sevapi i këtij leximi i ndahet apo i dhurohet edhe filanit⁶¹ etj. Një

⁶⁰ Mundhiriu, *Et-tergibu ve et-terhibu*, 2/319. (hadithi: sahih, hasen apo i ngjashëm).

⁶¹ Muhamed Sherbini, *Mugni el-muhtaxhi ila marifeti meani elfadhi el-minhaxh*, vëllimi IV, Bejrut, Daru el-Kutub El-Ilmijeti: 2000, f. 111

dedikim i sevapit të leximit bëhet kështu, ku ndër të tjera, lutjes i shtohen edhe këto fjalë apo të ngjashme:

﴿...اللَّهُمَّ بَلِّغْ ثَوَابَ مَا قَرَأْنَاهُ وَنُورَ مَا تَلَوْنَاهُ إِلَى رُوحِ سَيِّدِنَا مُحَمَّدٍ ﷺ، وَإِلَى أَرْوَاحِ جَمِيعِ الْأَنْبِيَاءِ وَالْمُرْسَلِينَ صَلَوَاتُ اللَّهِ عَلَيْهِمْ أَجْمَعِينَ، وَإِلَى آلِهِ وَأَوْلَادِهِ وَأَزْوَاجِهِ وَأَصْحَابِهِ وَأَتْبَاعِهِ وَجَمِيعِ ذُرِّيَّاتِهِ رِضْوَانُ اللَّهِ تَعَالَى عَلَيْهِمْ أَجْمَعِينَ، وَإِلَى أَرْوَاحِ آبَائِنَا وَأُمَّهَاتِنَا وَإِخْوَانِنَا وَأَخَوَاتِنَا وَأَوْلَادِنَا وَأَقْرَبَائِنَا وَأَحْبَائِنَا وَأَصْدِقَائِنَا وَأَسَاتِدَتِنَا وَمَشَائِخِنَا وَلِمَنْ كَانَ لَهُ حَقٌّ عَلَيْنَا، وَلِجَمِيعِ الْمُؤْمِنِينَ وَالْمُؤْمِنَاتِ وَالْمُسْلِمِينَ وَالْمُسْلِمَاتِ وَالْأَحْيَاءِ مِنْهُمْ وَالْأَمْوَاتِ ...﴾

“... O Allah, sevapin e asaj që e lexuam dhe nurin e asaj që e kënduam, kushtoja shpirtit të zotërisë sonë, Muhamedit [alejhi selam], shpirtrave të të gjithë pejgamberëve dhe të dërguarve [alejhim selam], shpirtrave të familjes së tij, të fëmijëve të tij, të bashkëshorteve të tij, të shokëve të tij, të ndjekësve të tij dhe të gjithë pasardhësve të tij; shpirtrave të baballarëve tanë, të nënave tona, të vëllezërve tanë, të motrave tona, të fëmijëve tanë, të të afërmve tanë, të dashamirëve tanë, të shokëve tanë, të profesorëve tanë, të hoxhallarëve tanë, të gjithë atyre të cilëve u kemi hak, dhe shpirtrave të të gjithë besimtarëve dhe besimtareve, muslimanëve dhe muslimaneve, të gjallëve dhe të vdekurve!...”

Leximi i Kur'anit në varreza

Të gjithë dijetarët janë të mendimit se leximi i Kur'anit në varreza nuk është haram (i ndaluar), bile shumica e hanefitëve, shafitëve dhe hanbelitëve e preferojnë këtë (mustehabb). Madje ka edhe prej tyre që këtë çështje e konsiderojnë të lejuar me ixhma, si p.sh. Ibn Kudame Makdisiu (hanbelit).⁶² Po ashtu, imam Ahmedi ka thënë: “Te i vdekuri mbërrin çdo e mirë. Kjo justifikohet me tekstet fetare të transmetuara në këtë sferë dhe me faktin se njerëzit tubohen në çdo qytet, lexojnë Kur'an dhe atë ua dhurojnë të vdekurve të tyre, gjë të cilën nuk e urren askush, prandaj është ixhma.”⁶³

⁶² Ibn Kudame Makdisiku, *El-Mugni*, 2/225

⁶³ Muhamed Emin bin Umer Abidin, *Reddu el-muhtar ala ed-durri el-muhtar (hashijetu ibn Abidin)*, 1/605

Këtë qëndrim e mbështesin në hadithin (merfu') të transmetuar nga Enesi [radijall-llahu anhu]: “Kush hyn në varreza dhe e lexon aty suren Jasin, atëherë u lehtësohet atyre, kurse për lexuesin ka po aq sevape (të mira).”⁶⁴ Po ashtu, transmetohet nga Ebu Hurejre: “Kush hyn në varreza, e lexon *Fatihane*, Kul *huvalahu ehad* dhe *el'hakumut-tekathur*, pastaj thotë “*Sevapin e asaj që lexova nga fjala Jote ua dedikoj banorëve të varrezave, besimtarëve dhe besimtareve, të tillët do të jenë ndërmjetësues për të*”.”⁶⁵

Transmetohet se Ibn Omeri [radijall-llahu anhu] preferonte që mbi varrin e të sapovarrosurit të lexohet fillimi (pesë ajetet e para) dhe fundi i sures Bekare.⁶⁶ Po ashtu, Abdurrahman bin el-Alai bin el-Lexhlaxhi transmeton: “Im at më pat thënë: “Kur të vdes, më vendos në varr dhe kur të më vendosësh thuaj: *bismil-lahi ve ala mil-leti resulil-lahi* “me emrin e Allahut dhe sipas traditës së resulullahut”, pastaj më hidh dhe (truall) dhe te koka lexoma fillimin dhe fundin e sures Bekare, sepse e kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut ta thotë atë.”⁶⁷

Gjithashtu, leximin e Kur'anit në varreza dijetarët e argumentojnë edhe me këtë hadith: “Ibn Abasi [radijall-llahu anhu] transmeton se i Dërguari i Allahut kaloi pranë dy varreve dhe tha: “*Këta dy tash po dënohen, jo për diçka të madhe: njëri prej tyre ka bartë fjalët ndër njerëzit kurse tjetri nuk është kujdesur nga stërpikja me urinë gjatë urinimit*” Pastaj e mori një degë të njomë, e theu në dysh dhe i mbolli në të dy varret. Të pranishmit e pyeten: “Përse veprove kështu, o i Dërguari i Allahut?” Ai tha: “*Ndoshta derisa janë të njoma do të ndihmojnë në lehtësimin e dënimit të atyre dyve*.”⁶⁸ Imam Neveviu gjatë sqarimit të “Sahihu Muslimit” thotë: “Bazuar në këtë hadith, dijetarët e preferojnë (mustehabb) leximin e Kur'anit te varri, sepse nëse shpresohet lehtësimi nga degët, atëherë leximi i Kur'anit është më me përparësi se ato.”⁶⁹

⁶⁴ Sehaviu, *El-Exhvibetu el-merdijjetu*, 1/169; Thalebiu, *El-Keshfu ve el-bejanu*, 8/119

⁶⁵ Mubarekfuri, *Tuhfetu el-Ahvedhij sherhu xhamii et-tirmidhij*, 3/77

⁶⁶ Neveviu, *El-Edhkaru*, f. 212. (Senedi hasen).

⁶⁷ Hejthemiu, *Mexhmeu Ez-zevaidi*, 3/47. Transmetuesit e këtij hadithi janë të besueshëm.

⁶⁸ Ibn Hibani, *Sahihu Ibn Hibani*, hadithi numër: 3128

⁶⁹ Neveviu, *El-minhaxh sherhu en-Neveveijj ala Muslimi*, vëllimi III, Daru Ihjai et-Turath el-Arabij, Bejrut, 1392 h., f. 202

Edhe pse ky veprim është i lejuar me sheriat, megjithatë nuk lejohet siç veprohet në disa vise tona, që dikush ditën e Arifes, netët e Bajramit, netët e xhuma apo netët e mëdha të qëndrojë nëpër varreza duke lexuar Kur'an nga varri në varr për përfitime materiale. Ky lloj leximi ndalohet për shkak të abuzimit me leximin e Kur'anit.

Përfitimi material nga Kur'ani⁷⁰

Leximi i Kur'anit bëhet vetëm për hir të Zotit, prandaj çdo përfitim tjetër që bëhet me nijet jo të pastër për Zotin, qoftë jomaterial apo material është i ndaluar. Nëse dikush e lexon Kur'anin për të fituar famë apo pozitë të caktuar, atëherë sevapi i leximit nuk arrin tek Allahu Fuqiplohtë, përkundrazi, leximi i tillë ndjell ndëshkim, sepse fjala e Zotit shfrytëzohet vetëm për interes personal.

Sa i përket përfitimit material, kemi dy mundësi: përdorimi i Kur'anit vetëm për përfitim material, siç veprojnë disa lexues të famshëm nëpër mexhliset arabe dhe nëpër viset tona, dhe përdorimi i Kur'anit si profesion, ku fitimi material është i pranishëm, por jo qëllim parësor. Nëse i analizojmë këto dy ndarje, atëherë shohim se në grupin e parë bëjnë pjesë njerëzit që përfitimin material e kanë në rend të parë, dhe ky përfitim është i ndaluar, kurse te grupi i dytë bëjnë pjesë njerëzit që përfitimin e kanë domosdoshmëri jetike (rrogë), dhuratë apo diçka dytësore.

Në vazhdim do t'i shtjellojmë disa situata të përfitimit material nga Kur'ani: a) Marrja e rrogës për mësimin e Kur'anit të tjerëve; b) Marrja e shpërblimit për lexim apo mësim të Kur'anit.

Nuk ka asnjë kundërshtim mes juristëve islamë që mësuesi i Kur'anit të marrë rrogë apo kompensim material për punën e tij nga arka e shtetit⁷¹ apo nga institucioni përkatës.

⁷⁰ Shih: Muhamed Seker dhe Ammad Zejadat, *Hukmu ahdhi el-uxhreti ala talimi el-Kur'ani el-Kerim fi el-fik'hi el-islamiiji*, në revistën "El-mexhel-letu el-Urdunijetu fi ed-dirasati el-islamiijeti", 2009, numri 2B

⁷¹ Ministria e Vakfit dhe e Çështjeve Fetare, *El-Meusuatu el-Fikhijetu el-Kuvejtijetu*, vëllimi 13, Daru Es-Safvetu, Egjipt: 1995, f. 14-15

Mirëpo, dijetarët islamë janë ndarë në dy blloqe për marrjen e shpërblimit për leximin apo mësimin e Kur'anit.

- Hanefitët e vonshëm, malikitët, shafitët, hanbelitët në një transmetim tjetër dhe dhahiritët e lejojnë marrjen e shpërblimit apo kompensimit.
- Hanefitët e hershëm dhe hanbelitët nuk e lejojnë marrjen e shpërblimit.⁷²

Në vazhdim do t'i shtjellojmë argumentet e atyre që e lejojnë marrjen e shpërblimit nga Kur'ani.

Transmeton Ibn Abbasi [radijall-llahu anhu] se disa nga shokët e të Dërguarit [alejhi selam] kaluan pranë një fisi të arabëve, ata as nuk i nderuan dhe as nuk iu bënë konak. Ndërkohë një akrep helmoi të parin e fisit, kështu që ata erdhën tek sahabët dhe i pyetën: "A keni ndonjë rukje (kurë), apo (thanë) a është ndokush nga ju mjek (që kuron)?" Sahabet u përgjigjen: "Po, mirëpo ju nuk na nderuat, kështu që s'do bëjmë asgjë derisa të na caktoni ndonjë shpërblim." Atëherë ata caktuan si shpërblim për këtë disa krerë dele. Njëri nga ne filloi të lexonte mbi të sëmurin Suren el-Fatiha, dhe ai u ngrit në këmbë sikur të mos kishte lënguar më parë. Ne thamë: Të mos ngutemi (të mos bëjmë gjë) derisa të shkojmë tek i Dërguari [alejhi selam]. Kur shkuam tek ai dhe e njoftuam çfarë ndodhi, ai tha: "*Shpërblimi më meritohet që keni marrë është nga Libri i Allahut.*"⁷³ Ky hadith flet për rukjen, mirëpo dispozita mbështetet në fjalët e përgjithshme të Pejgamberit [alejhi selam] dhe jo në rastin e veçantë.

Po ashtu, transmetohet nga Ebu Hurejre [radijall-llahu anhu] se Pejgamberi [alejhi selam] në një rast për mehr martese kishte caktuar pjesë Kur'ani, ku i ka thënë: "*Çohu mësoja asaj njëzet ajete! Atëherë ajo bëhet grua ja jote.*"⁷⁴ Përderisa Kur'ani mund të jetë kompensim për mehrin, atëherë edhe kompensimi për lexim është i lejuar.

Disa transmetime nga sahabët dhe të tjerët:

⁷² Po aty.

⁷³ Ibn Hibban, *Sahihu Ibni Hiban*, hadithi numër: 5146

⁷⁴ Sujutiu, *El-Xhamiu es-sagiru*, hadithi numër: 6137 (hasen).

- Sad bin Ebi Vekasi [radijall-llahu anhu] u kishte dhënë disa njerëzve që lexonin Kur'an.⁷⁵
- Amar bin Jasiri [radijall-llahu anhu] u kishte dhënë disa njerëzve që lexonin Kur'an në Ramazan.⁷⁶
- Vedin bin Ata ka thënë: "Në Medine kishte tre mësues që i mësonin fëmijët, e Omer bin Hattabi [radijall-llahu anhu] e furnizonte secilin me nga pesëmbëdhjetë për çdo muaj."⁷⁷
- Transmetohet nga Hakem bin Utejbë të ketë thënë: "Nuk di ta ketë urryer dikush shpërblimin e mësuesit."⁷⁸
- Abdulxhebbar bin Omer ka thënë: "Secilin medinas që e kam pyetur, nuk sheh asgjë të keqe në shpërblimin për mësimin e fëmijëve."⁷⁹
- Transmetohet nga Atai dhe Ebu Kulabeh se shpërblimi i mësuesit të Kur'anit është punë e lejuar.⁸⁰
- Imam Maliku ka thënë: "Nuk më ka arritur asnjë informacion se dikush e ka urryer mësimdhënien e Kur'anit me shpërblim."⁸¹

Këta që e lejojnë marrjen e shpërblimit, thonë se këtu shpërblehet munda dhe koha që ai ka ndarë, dhe jo fjala e Allahut, sepse ajo nuk është mjet shitblerjeje.

Edukata me mus'hafin⁸²

Mus'haf do të thotë vendi ku janë tubuar shumë fletë, gjegjësisht libri i vendosur mes dy kopertinave. Mus'haf quhet libri fizik ku është shënuar teksti kur'anor. Kjo tregon se fjala mus'haf posedon edhe shumësin e vet, kurse Kur'ani është fjalë e përveçme dhe nuk përdoret në trajtën e shumësit.

⁷⁵ Ibn Hazm, *El-Muhal-la bi el-athari*, 9/14

⁷⁶ Po aty

⁷⁷ Po aty; Ibn Ebi Shejbe, *El-Musannef*, 4/346

⁷⁸ Ibn Hazm, *vep. e cit.*, f. 15;

⁷⁹ Transmeton Malik bin Enesi, *El-Mudevvenetu el-kubra*, Rijad, vëllimi V, f.1691;

⁸⁰ Ibn Hazm, Po aty,

⁸¹ El-Keshnavi, *Es'helu el-medariki*, 2/133

⁸² Shih: Abdurrahman bin Abdulaziz Dehami, *Adabu et-teamuli me el-mus'hafi*, Rijad, pa vit botimi.

Çdo gjë që i shërben fjalës së Zotit ka rëndësinë dhe vlerën e vet. Nxënësi, studenti, mësuesi, lexuesi, dëgjuesi, praktikuesi, botuesi, investuesi dhe çdokush që lidhet drejtpërdrejt apo tërthorazi me fjalën e Allahut, meriton respekt dhe nderim, madje edhe sendet. Prandaj, vetë letra apo objekti në të cilin është shkruar fjala e Zotit, vetvetiu fiton vlerë. Kjo i ka shtyrë studiuesit e Kur'anit të hulumtonin në sferën e respektit ndaj mus'hafit apo objektin në të cilin është shkruar apo skalitur fjala e Allahut.

Imam Neveviu [radijall-llahu anhu] ka thënë: "Të gjithë muslimanët (dijetarët) kanë rënë në ujdi se ruajtja dhe respekti i mus'hafit është detyrim (vaxhib)." ⁸³, prandaj në vazhdim do t'i paraqesim disa norma etike-juridike për këtë çështje:

- Mus'hafi të preket vetëm nga të pastrit. Kjo çështje është shtjelluar më herët;
- Nuk duhet zgjatur këmbët në drejtim të mus'hafit. "Urrehet (mekruh tahrim) të zgjaten këmbët në drejtim të mus'hafit, qoftë në gjumë apo zgjuar, përveç nëse mus'hafi është i vendosur në vend më të lartë." ⁸⁴ Në "Fetava hindijeh" thuhet se qenia mekruh ndërldhet vetëm me këpucë, kurse zbathur jo.
- Nuk duhet vendosur asnjë libër tjetër mbi të, d.m.th. mus'hafi të jetë çdoherë sipër çdo libri apo çdo sendi tjetër, bile të mos vendoset as telefoni mbi të.
- Të mos hidhet apo të bartet pa kujdes. Marrja në dorë dhe bartja e mus'hafit të bëhet me edukatë: të mos kapet me shkujdesje, të mos hidhet, të mos mbahet me dorë të lëshuar nën mes dhe të mos tundet pa edukatë.
- Të mbahet, të jepet apo të merret me dorë të djathtë, sepse ana e djathtë është e preferuar në çdo punë të hairit, e mus'hafi është më me vlerë se gjithçka.
- Të mos vendoset në tokë pa nevojë, por të vihet në raft, tavolinë apo diçka të ngritur nga toka.

⁸³ Imam Neveviu, *Et-Tibjan fi adabi hameleti el-Kur'ani*, botimi II, Daru el-Min'haxhi, Arabi Saudite – Xhide: 2011, f. 191

⁸⁴ Zejnuddin ibn Nexhim, *El-Bahru er-raiku sherhu kenzu ed-dekaiki*, 2/36

- Të mos shfletohen fletët e mus'hafit me gishta të përlyer apo pështymë. Këtë e kanë urryer shumë dijetarë, sepse veprimet e tilla e ndyjnë atë.
- Të mos lihet i hapur. Imam Kurtubiu ka thënë: "Kur të lexohet mus'hafi, të mos lihet i hapur."⁸⁵
- Të mos vihet vend të ekspozuar ndaj rrezikut. Pra, të mos lihet në diell të nxehtë, pranë zjarrit, në lagështi, në vend ku mund t'i bie uji apo diçka dëmtuese ose e ndyrë. Shpeshherë me këtë shkujdesje vendoset nëpër çfarëdo vendi në veturë apo në vende tjera.
- Të puthet mus'hafi. Hanefitët dhe mendimi më i njohur te hanbelitët pohon se puthja e mus'hafit është veprim i lejuar, bile imam Ahmedi e preferon (mustehab) atë. Ky mendim bazohet në veprimin e Omerit [radijall-llahu anhu], i cili e puthte mus'hafin çdo mëngjes. Po ashtu edhe Othmani [radijall-llahu anhu] e puthte mus'hafin dhe e fërkonte për fytyrë atë.⁸⁶ Disa mendojnë se është bid'at sepse nuk është traditë e njohur te të parët (selefët). Mirëpo, mjafton veprimi i Omerit dhe Othmanit për ta justifikuar këtë sepse këta të dy janë të parët që e tubuan mus'hafin.
- Të ngrihet në këmbë për nder të mus'hafit. Imam Neveviu dhe Sujutiu pohojnë se ngritja në këmbë (apo drejtimi i trupit) kur sillt një mus'haf është veprim i preferuar (mustehab), sepse ngritja për dijetarët dhe njerëzit e zgjedhur është e preferuar, ndërsa mus'hafi është më me përparësi se këta.⁸⁷
- Lejohet stolisja e mus'hafit me ar, argjend, mëndafsh apo ndonjë stoli tjetër me vlerë, qoftë për burra apo për gra, ngase ky është respekt dhe nder ndaj Kur'anit. Ky është mendimi i hanefive dhe malikive. Disa maliki mendojnë se lejohet vetëm stolisja e kopërtinës. Shafitë mbajnë mendimin se argjendi lejohet për të gjithë,

⁸⁵ Kurtubiu, *Et-tidhkar fi efdali el-edhkar*, f. 182

⁸⁶ Ministria e Vakfit dhe e Çështjeve Fetare, *El-Meusuatu el-Fikhijetu el-Kuvejtijetu*, vëllimi 13, Daru Es-Safvetu, Egjipt: 1995, f. 133; Ibn Abidin, 5/246 etj.

⁸⁷ Sujuti, *El-Itkan*, 2/172; Neveviu, *Et-tibjan fi adabi hameleti el-Kurani*, f. 112

kurse ari lejohet vetëm për gra dhe fëmijë, ndërsa hanbelitë mendojnë se është e urryer (mekruh) stolisja e mus'hafit me ar dhe argjend. Këtë mendim mban edhe Ebu Jusufi.⁸⁸

- Lejohet parfumimi i mus'hafit.

Respekti dhe nderimi i mus'hafit pa dyshim shpërblehet tek Zoti [xhel-le she'nuhu], madje ka mirësi edhe vetëm nëse mbahet diku. Mirëpo, nëse mendohet se vetëm respekti ndaj mus'hafit i mbulon lëshimet e rënda në fe, siç keqkuptohet ndonjëherë në mjediset tona, atëherë kjo është risi dhe diçka e paligjshme sipas fesë. Ka shumë njerëz në mjediset shqiptare që fetarinë e justifikojnë vetëm me mbajtjen e mus'hafit në shtëpi dhe me pohimin se e kanë zemrën e mirë. Sigurisht kjo është një tregues, por është tepër i imët në krahasim me këshillat që i jep brendia e këtij libri, sepse tekefundit ky libër është zbritur për t'u këshilluar.

Mus'hafi i dëmtuar dhe i papërdorshëm

Mus'hafi është libër fizik i cili shkruhet ose botohet, pastaj vjetërsohet, dëmtohet dhe në fund bëhet i papërdorshëm. Në raste të këti-lla, duhet ndërmarrë këta hapa:

- Nëse dëmtimi është i pjesshëm dhe i riparueshëm, atëherë duhet riparuar apo të dorëzohet në ndonjë qendër për riparimin e librave të vjetër.
- Nëse dëmtimi është i madh dhe i riparueshëm, atëherë dijetarët kanë dhënë disa mundësi, por më të njohurat janë këto:
 - o Të mbështillet me pëlhurë të pastër dhe të varroset në vend ku nuk shkelet, njësoj siç varroset njeriut për respekt ndaj tij. Po ashtu duhet të mos hidhet dhe (truall) pa vendosur diçka mbi të. Ky është mendim i hanefitëve dhe i disa hanbelitëve.
 - o Të tjerët, malikitët dhe shafitët, mbajnë mendimin se duhet të digjet për të mos u shkelur, ngase kështu pat vepruar

⁸⁸ Ministria e Vakfit dhe e Çështjeve Fetare, *El-Meusuatu el-Fikhijetu el-Kuvejtijetu*, vëllimi 38, Daru Es-Safvetu, Egjipt: 1995, f. 16

Othmani [radijall-llahu anhu].⁸⁹ Nëse digjet, atëherë hiri të groposet në një vend që nuk shkelet apo të hidhet në një ujë të rrjedhshëm dhe të pastër.

Pyetje:

- A u shkon të vdekurve sevapi i leximit të Kur'anit?
- Trego argumentet e atyre që pranojnë se sevapi i leximit i shkon të vedekurit!
- A lejohet leximi i Kur'anit në varreza?
- Çfarë preferohet të lexohet në varreza?
- A lejohet marrja e të hollave për mësimin e Kur'anit?
- Trego disa rregulla edukative ndaj mus'hafit!
- Si duhet të veprohen me mus'hafin e dëmtuar?

⁸⁹ Shih: Ministria e Vakfit dhe e Çështjeve Fetare, *El-Meusuatu el-Fikhijetu el-Kuvejtijetu*, vëllimi 38, Daru Es-Safvetu, Egjipt: 1995, f. 23-24

KREU III

HYRJE NË SHKENCËN E TEXHVIDIT



- Shkenca e texhvidit
- Istiadheja
- Besmeleja
- Nivelet e leximit

SHKENCA E TEXHVIDIT - عِلْمُ التَّجْوِيدِ

Texhvidi është disiplinë shkencore e cila lexuesve të Kur'anit u ofron mundësinë e leximit të drejtë dhe pa gabime të Kur'anit. Kjo shkencë jep mundësinë e leximit autentik të Kur'anit, ashtu siç e ka lexuar Muhamedi [alejhi selam], sahabët, tabiinët dhe të gjithë myslimanët.

Për të pasur një pasqyrë më të kthjellët për këtë disiplinë, madje edhe për çdo disiplinë tjetër shkencore, duhet kristalizuar këto dhjetë *parime kryesore*:

1. Përkufizimi

Përkufizimi gjuhësor: fjala تجويد - texhvid, në aspektin gjuhësor do të thotë: تَحْسِين - përmirësim dhe اِتْقَان - perfeksionim. Pikërisht prej kësaj rrënje përftohet edhe fjala جُودَةٌ që do të thotë *kualitet*.

Përkufizimi terminologjik: në aspektin terminologjik shkenca e texhvidit është: ﴿عِلْمٌ يُعَرِّفُ بِهِ إِعْطَاءُ كُلِّ حَرْفٍ حَقَّهُ وَمُسْتَحَقَّهُ﴾ "*Disiplina shkencore me të cilën i jepet haku dhe merita çdo tingulli quhet texhvid.*"

Ky përkufizim është më i shkurtër, por e mbulon gjithë shkencën e texhvidit. Boshitet kryesore të texhvidit të përfshira në këtë përkufizim janë këto:

E para: kur thuhet "çdo tingulli (harf)", nënkuptohet njësia më e vogël gjuhësore nga e cila fillon kujdesi i leximit të Kur'anit. Sigurisht këtu renditen edhe diftongjet (teshdidet), rrokjet, fjalët etj.;

E dyta: *hakkahu* (e tingujve)" përfshin gjithë vendartikulimet (مَخَارِجُ الْحُرُوفِ) apo vetitë statike (الصَّفَاتُ الْأَلَزِمَةُ) të shkronjave; dhe

E treta: *mustehakku* (merita) e tingujve mbulon tërë pjesën e mbetur të texhvidit, gjegjësisht vetitë jostatike, rregullat, shkrirjet, zgjatjet etj. Në përkufizimet tjera të texhvidit nuk është thënë diçka më shumë, vetëm se janë sqaruar më gjerësisht fjalët *hakkahu* dhe *mustehakkahu*.

2. Objekti

Shkenca e texhvidit objekt studimi ka *fjalët kur'anore* duke filluar nga njësia më e vogël gjuhësore-fonetike (fonema apo grafema) deri te ajo më e zgjeruara. Pra, kjo disiplinë shkencore ka të bëjë vetëm me ligjërimin hyjnor, pra me fjalët e shpallura në Kur'an, e jo edhe me thëniet Pejgamberike, fjalët e Muhamedit [alejhi salam]

Askund nuk thuhet: “e lexon hadithin me texhvid”, por “e lexon Kur'anin me texhvid”, edhe pse disa rregulla të texhvidit praktikohen edhe jashtë Kur'anit dhe lidhen ngushtë me gramatikën e gjuhës arabe.

3. Rezultati

Fryt dhe rezultat i mësimit të shkencës së texhvidit është mbrojtja e gjuhës nga gabimi gjatë këndimit të Kur'anit; Kur Kur'ani të lexohet pa gabime, atëherë fitohet kënaqësia (rizaja) e Allahut të Madhërishëm.

4. Vlera

Texhvidi është një ndër disiplinat shumë të rëndësishme, ngase objekt studimi ka Kur'anin, fjalën, librin më të mirë, më të përsosur dhe të fundit të zbritur prej Zotit [xhel-le she'nuhu]

Vlera e kësaj disipline duket edhe në vlerat semantike (kuptimore) që reflektojnë vetë disa rregulla të texhvidit, ku një pjesë do t'i themi në këtë studim dhe një pjesë të madhe do të mbeten për në një studim tjetër të veçantë.

Po ashtu, vlera e mësimit dhe e zotërimit të kësaj shkence shihet edhe në bukurinë e leximit të Kur'anit, në artikulimin e drejtë të tingujve kur'anorë, në zgjatjen e tyre dhe në shumë sfera tjera të tij, por të gjitha këto vlera janë në tekstin kur'anor në gjuhën arabe.

5. Pozita

Pozita e texhvidit ndaj disiplinave të tjera fetare dallohet në këto dy vështrime:

- Nuk ka marrë nga asnjë disiplinë tjetër shkencore, por është burimore, ashtu siç është zbritur, bile në shumë situata u ndihmon edhe disiplinave të tjera shkencore;
- Kjo disiplinë nuk mësohet pa mësues të shkathët, pa hoxhë gojëmbël apo pa hafiz profesional i cili e zotëron mirëfilli atë. Çdo tingull kur'anor duhet të dëgjohet nga lexuesit të cilët e kanë mësuar nga lexuesit e mëhershëm, e kështu me radhë deri te Muhamedi [alejhi selam]

6. Hartuesi

Praktikuesi i parë i shkencës së texhvidit është Muhamedi [alejhi selam] i cili e ka lexuar ashtu siç e ka marrë nga meleku Xhebrail, kurse meleku nga Allahu i Madhërishëm. Pastaj Muhamedi [alejhi selam] ua ka transmetuar sahabëve, sahabët tabiinëve dhe kështu me radhë gjeneratë pas gjenerate deri në ditët e sodit është transmetuar në formë mutevatir (nga shumë rrugë).

Hartuesit e parë të teorisë (rregullave) të texhvidit janë vetë imamët e kiraeteve, kjo është më e saktë. Megjithatë, studiuesit e shkencës së texhvidit thonë se i pari që shkroi për rregullat e leximit është Hafsin bin Omer ed-Durij i cili vdiq në vitin 246 hixhri. Pra, fundi i shek. III dhe fillimi i shek. IV hixhri është periudha kur shumë autorë filluan të shkruajnë për rregullat dhe teknikat e leximit të Kur'anit Fisnik.

7. Emri

Shkenca që studion tërësinë e rregullave të drejtleximit të Kur'anit fisnik quhet عِلْمُ التَّجْوِيدِ (shkenca e texhvidit), فَنُّ التَّرْتِيلِ (arti i këndimit të Kur'anit) ose حَقُّ الْقِلَافَةِ (haku i leximit). Më i përdorur dhe më i njohur është emërtimi i parë, kurse dy të tjerët janë më të rrallë.

8. Përftimi

Shkenca e texhvidit ka rregulla të përfutuara nga Kur'ani fisnik dhe nga tradita e Muhamedit [alejhi selam], i cili ua mësoi sahabëve, pastaj sahabët tabiinëve, tabiinët dijetarëve dhe në këtë mënyrë erdhën deri te ne me *sened mutevatir*. Për formën e përfutimit dhe të transmetimit të kiraeteve dhe të texhvidit mund të lexohet më gjerësisht në kreun e kiraeteve.

9. Dispozita

Njohja e rregullave teorike të texhvidit është farzi kifaje (që i bie të jetë mendub për popullin e rëndomtë)⁹⁰, kurse zbatimi i tyre në praktikë është farzi ajn për çdo musliman. **Shkurt thënë, t'i dish rregullat e texhvidit me emërtime, si p.sh.: medu tabii, idgam mealgunneh, ihfa' etj., është farzi kifaje, kurse t'i praktikosh pa i ditur teorikisht është farzi ajn.** Nga kjo kuptojmë se shkenca e texhvidit ndahet në dy pjesë:

- *Texhvidi praktik* (التَّجْوِيدُ الْعَمَلِيُّ) përfshin praktikën e rregullave të lexi- mit të Kur'anit ashtu siç e ka lexuar Muhamedi [alejhi selam], edhe nëse nuk i di ato me emra. Ky është farzi ajn (detyrim individual).
- *Texhvidi teorik* (التَّجْوِيدُ الْعِلْمِيُّ / النَّظَرِيُّ) përfshin emërtimet e shkencës së texhvidit. Ky është farzi kifaje (detyrim kolektiv) dhe mendub (preferencë individuale).

Në vazhdim do të sjellim disa argumente për domosdoshmërinë e mësimit të texhvidit:

- ♦ Allahu i Madhërishëm thotë: ﴿وَرَتِّلِ الْقُرْآنَ تَرْتِيلًا﴾ "...dhe recito me ritëm Kur'anin" (El-Muzzemmil, 4); Gjithashtu, i Mëshirëploti thotë: ﴿الَّذِينَ آتَيْنَاهُمُ الْكِتَابَ يَتْلُونَهُ حَقَّ تِلَاوَتِهِ﴾ "Ata që u dhamë Librin dhe e lexojnë drejt atë..." (El-Bekare, 121).
- ♦ Muhamedi [alejhi selam] ka thënë: ((إِنَّ اللَّهَ يُحِبُّ أَنْ يُقْرَأَ هَذَا الْقُرْآنَ كَمَا أَنْزَلَ)) "Allahu dëshiron që ky Kur'an të lexohet siç është zbritur".⁹¹

⁹⁰ Iman Fet'hij, *Fennu texhvidi el-hurufi*, Daru Ibn Hazm, Kajro: 2011, f. 49

⁹¹ Ibn Huzejmeh, *Sahih Ibn Huzjmeh*, had. nr. 1897, i transmetuar nga Zejd bin Thabit.

- ♦ Ixhmai i dijetarëve thonë se nuk transmetohet që Muhamedi [alejhi selam], sahabët, tabiinët, të gjithë dijetarët dhe lexuesit e shkathët, që ndonjëri prej tyre ta ketë lexuar Kur'anin pa texhvid.

Këtë të vërtetë e ka thurur shkëlqyeshëm Imam Xhezeriu në vargjet e tij, ku ndër të tjera, thotë:

<i>Texhvidi, vërtet është obligim</i>	وَالْأَخْذُ بِالتَّجْوِيدِ حَتْمٌ لَا رَيْبَ
<i>Kush lexon Kur'an pa të është athim</i>	مَنْ لَمْ يُجَوِّدِ الْقُرْآنَ أَثِمَ
<i>Zoti atë, kështu e ka zbritur</i>	لِأَنَّهُ بِهِ الْإِلَهُ أَنْزَلَا
<i>Ashtu edhe neve na ka mbërritur</i>	وَهَكَذَا مِنْهُ إِلَيْنَا وَصَلَا

10. Tematika

Tematika e shkencës së texhvidit është gjithë ajo që studion kjo shkencë, si p.sh.: *medet* (zgjatjet), *idgamet* (shkrirjet), *ihfaja* (fshehja), *idh'hari* (shqiptimi i pastër), *iklabi* (përmbysja), *sekteja* (pushimi), *shqiptimi i drejtë* i shkronjave, *rregullat e ndaljes*, *gabimet në lexim dhe të gjitha rregullat tjera*, të cilat do t'i trajtojmë më gjerësisht në këtë punim.

Pyetje:

- ❧ Cili është kuptimi etimologjik i fjalës texhvid?
- ❧ Defino shkencën e texhvidit!
- ❧ Çfarë ka objekt studimi disiplina e texhvidit?
- ❧ Ç 'vlerë ka mësimi i saj?
- ❧ Cili është raporti i saj me disiplinat e tjera fetare?
- ❧ Trego tri emërtimet e njohura të kësaj disipline!
- ❧ Kush është hartuesi i parë i teorisë së texhvidit?
- ❧ Trego dispozitën e leximit të Kur'anit me texhvid!
- ❧ Trego dispozitën e mësimin të rregullave teorike të texhvidit!
- ❧ Cila është tematika e kësaj disipline shkencore?
- ❧ Trego një ajet, një hadith dhe një varg poetik për mësimin e texhvidit!

الِإِسْتِغَاذَةُ – ISTIADHEJA

Fjala *istiadhe* është shkurtesë e frazës ﴿أَعُوذُ بِاللَّهِ مِنَ الشَّيْطَانِ الرَّجِيمِ﴾, “Mbrohem me Allahun nga shejtani i mallkuar”. Të gjithë dijetarët ndajnë mendimin se kjo frazë si e tillë dhe në fillim të leximit të Kur’anit nuk është pjesë e Kur’anit, por është frazë hyrëse.

Studiuesit e Kur’anit mendojnë se *istiadhja* shqiptohet kur e fillojmë leximin e Kur’anit, gjegjësisht para leximit, por nuk përdoret kur kalojmë nga njëra sure në tjetrën. Istiadhja është frazë që përdoret edhe në situata të tjera, por ato sfera nuk janë lëndë e studimit tonë.

Dispozita e istiadhës

Shumica e dijetarëve (xhumhuri, në mesin e tyre edhe Ebu Hani-feja) mendojnë se leximi i istiadhës është *mustehab* (i preferuar), kurse një pjesë e vogël, me në krye Ibn Hazmin, thonë se ajo është *vaxhib*.⁹² Këta të fundit e mbajnë këtë mendim (vaxhib) sepse bazohen në kuptimin sipërfaqësor të këtij ajeti kur’anor, ku Allahu [xhel-le she’nuhu] thotë: ﴿فَإِذَا قَرَأْتَ الْقُرْآنَ فَاسْتَعِذْ بِاللَّهِ مِنَ الشَّيْطَانِ الرَّجِيمِ﴾ “*Kur lexon Kur’an, kërko mbrojtjen e Allahut nga shejtani i mallkuar*” (En-Nehl, 98), bazohen në kujdesin që Pejgamberi [alejhi selam] kishte në përdorimin e saj dhe në faktin se kjo frazë ndihmon në largimin e së keqes dhe të shejtanit. Kurse shumica e dijetarëve mendojnë se është musetehabb (i preferuar), pra pjesë e sunetit, sepse thelbi i ajetit nuk e përmban domosdoshmërinë (vaxhibin) dhe se Muhamedi [alejhi selam] nuk e ka përdorur çdoherë, pra, e ka përdorur shpeshherë, por jo çdoherë. Kështu që, kjo nënkupton se nuk është vaxhib.

Në qoftë se themi istiadhja është mustehab, atëherë lënia e saj është mekruh (e urryer) dhe lënësi i saj nuk ngarkohet me mëkat. Në

⁹² El-Xhezerij, *En-neshru fi el-kiraati el-ashri*, vëllimi I, Bejrut, Daru el-Kutubi el-Ilmijeti, f. 258

anën tjetër, nëse e pranojmë se ajo është vaxhib, atëherë lënësi i saj bën mëkat dhe do të përgjigjet para Allahut [xhel-le she'nuhu]

Krahas mendimeve të theksuara më lartë, është e sigurt se lexuesi dhe praktikuesi i saj do të jetë i mbrojtur nga shejtani dhe do të shpërblehet te Zoti [xhel-le she'nuhu]

Gjithashtu, duhet ditur se artikulimi i zëshëm i istiadhes para leximit të Kur'anit (jashtë namazit) është mustehabb (i preferuar). Pra, nëse e themi istiadhen në fillim të leximit, atëherë është mustehabb (e preferuar) të bëhet zëshëm kur lexojmë me zë dhe në heshtje kur lexojmë pa zë.


Format e istiadhes

Istiadhja ka shumë forma të transmetuara dhe të gjitha kanë mbështetje në Kur'an dhe në traditën e Muhamedit [alejhi selam], mirëpo në këtë libër do të paraqiten vetëm format më të njohura që dijetarët e shkencës së texhvidit dhe të kiraeteve i kanë përmendur nëpër librat e tyre:

- ﴿أَعُوذُ بِاللَّهِ مِنَ الشَّيْطَانِ الرَّجِيمِ﴾ - “Mbrohëm me Allahun nga shejtani i mallkuar”. Kjo formë është më e përdorura dhe e pranuar unanimsisht nga të gjithë lexuesit, madje e tillë është dhënë edhe në Kur'an: ﴿فَإِذَا قَرَأْتَ الْقُرْآنَ فَاسْتَعِذْ بِاللَّهِ مِنَ الشَّيْطَانِ الرَّجِيمِ﴾ - “Kur lexon Kur'an, kërko mbrojtjen e Allahut nga shejtani i mallkuar” (En-Nehl, 98)
- ﴿أَعُوذُ بِاللَّهِ السَّمِيعِ الْعَلِيمِ مِنَ الشَّيْطَانِ الرَّجِيمِ﴾ - “Mbrohëm me Allahun, Dëgjuesin dhe të Gjithëdijshtin, nga shejtani i mallkuar”. Kjo formë është e njohur te Hamza dhe Vershi.
- ﴿أَعُوذُ بِاللَّهِ الْعَظِيمِ مِنَ الشَّيْطَانِ الرَّجِيمِ﴾ - “Mbrohëm me Allahun e Madhërishëm nga shejtani i mallkuar”. Kjo formë është e njohur te Vershi, Ibn Kethiri dhe disa rrugë të Hafsit.
- ﴿أَعُوذُ بِاللَّهِ مِنَ الشَّيْطَانِ إِنَّ اللَّهَ هُوَ السَّمِيعُ الْعَلِيمُ﴾ - “Mbrohëm me Allahun nga shejtani. Allahu është Dëgjuesi dhe i Gjithëdijshti.” Kjo formë është e njohur te Ebu Amri, Nafiu, Ibn Amiri, Kesai dhe te Hamza.

Lidhjet e mundshme të istiadhes

Në vazhdim do t'i shohim mundësitë e lidhjes së *istiadhes* me *besmelen* dhe me *fillimin e sures*, apo ndarjen e tyre. Lexuesi kur fillon të lexojë Kur'an, para vetes i ka këto katër mundësi të lejuara:



Të gjitha format janë të lejuara, por më e preferuar është forma e parë.

Lidhja e istiadhes drejtpërdrejt me suren, pa besmelen

Istiadheja mund të lidhet drejtpërdrejt me suren, pa *besmelen*, por preferohet që fraza “shejtan i mallkuar” të mos lidhet me ndonjë emër apo përemër të Allahut, të Muhamedit [alejhi selam] apo me diçka të ngjashme. Tani do të jepen disa shembuj ku nuk preferohet të lexohen pa ndërprerë me një frymë, por duhet bërë ndalje mes tyre ose të lidhen me *besmelen*:

﴿اللَّهُ لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ الْحَيُّ الْقَيُّومُ...﴾	≠	أَعُوذُ بِاللَّهِ مِنَ الشَّيْطَانِ الرَّجِيمِ
﴿إِلَيْهِ يُرْدُّ عِلْمُ السَّاعَةِ...﴾	≠	أَعُوذُ بِاللَّهِ مِنَ الشَّيْطَانِ الرَّجِيمِ
﴿فُحَمَّدٌ رَسُولُ اللَّهِ...﴾	≠	أَعُوذُ بِاللَّهِ مِنَ الشَّيْطَانِ الرَّجِيمِ

Dispozita e istiadhes kur e ndërpresim leximin

Në qoftë se lexuesi e ndërpret leximin për një kohë relativisht të gjatë, atëherë duhet përsëritur istiadheja, e nëse e ndërpret për një kohë të shkurtër, atëherë kemi dy situata:

- Nëse ndërprerja është e domosdoshme, si p.sh. kollitja, teshtitja, fjalët që lidhen me leximin (përmirësimet, sqarimet e shkurtra të ajeteve) etj., nuk përsëritet istiadheja, por vazhdohet leximi;
- Nëse ndërprerja nuk është e domosdoshme apo nuk lidhet me leximin e Kur'anit, si p.sh. biseda private, madje qoftë edhe kthimi i selamit, në këto raste duhet përsëritur istiadheja. Po ashtu, istiadhja nuk përsëritet nëse kalojmë nga një sure në tjetrën, e as kur kalojmë nga një lexues te tjetri, d.m.th. kur lexojnë disa lexues me radhë, istiadhen e thotë vetëm i pari.

Pyetje:

- ❧ Çfarë do të thotë istiadhe?
- ❧ A është istiadhja pjesë e Kur'anit?
- ❧ A lexohet istiadhja kur kalojmë nga një sure në tjetrën?
- ❧ Çfarë dispozitë ka leximi i istiadhes?
- ❧ A ngarkohet me përgjegjësi lënësi i saj?
- ❧ Cilat janë format e istiadhes?
- ❧ Cilat janë lidhjet e istiadhes me besmelen dhe me suren?
- ❧ Si lidhet istiadhja drejtpërdrejt me suren?
- ❧ Si veprohet me istiadhen kur ndërpritet leximi?

BESMELEJA – بِسْمَلَةُ

Fjala بِسْمَلَةُ - *besmeleh* është shkurtesë e frazës ﴿بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ﴾ - “*Me emrin e Allahut, Mëshirëplotit, Mëshiruesit*”.

Të gjithë dijetarët islamë njëzëri e pranojnë se besmelja është ajet kur'anor në ajetin e 30 të sures Neml, ku Allahu [xhel-le she'nuhu] thotë: ﴿إِنَّهُ مِنْ سُلَيْمَانَ وَإِنَّهُ بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ﴾, kurse sa i përket besmeles në fillim të çdo sureje, ata kanë qëndrime të ndryshme.

Besmeleja ka vetëm një formë, pra atë të zakonshmen, dhe nuk transmetohen forma tjera të saj.

Dispozita e leximit të besmeles

Dispozita e besmeles ndryshon varësisht nga mendimi i dijetarëve islam për të, nëse është apo nuk është ajet në fillim të çdo sureje, por kjo nuk është sferë e studimit tonë.

Mendimi më i përfolur në mesin e dijetarëve të disiplinave kur'anore është se besmeleja në fillim të çdo sureje (përveç sures Teube) është vaxhib (obligative), kurse në mes të sureve (apo nga ajeti i dytë i çdo sureje) është mustehab (e preferuar).⁹³


Kurse në fillim të sures Teube ndalohet përdorimi i besmeles.

Pra, kjo tregon se besmeleja ka tretmanin e njëjtë me pjesën tjetër të tekstit kur'anon, sepse është e shënuar në mus'haf. Leximi me zë vlen vetëm kur lexohet Kur'an jashtë namazit, kurse në namaz ka dispozita të tjera të cilat studiohen në shkencën e fik'hu.

⁹³ Sipas “Shatibijes” lexuesi është i lirë ta thotë apo të mos e thotë besmelen në mes të sureve (pra pas ajetit të parë), kurse sipas rrugëve të “El-Filit” dhe “Zur'anit” nga “Tajjibetu en-neshri” është i detyrueshëm.

Mënyrat e lidhjes së dy sureve me besmelen

Mënyrat e mundshme të lidhjes së dy sureve përmes besmelesë janë katër:



Tri format e para janë të lejuara, kurse forma e katërt është e ndaluar, sepse besmeleja është për t'i filluar suret dhe jo për t'i përfunduar ato.

Gjithashtu, ka raste kur besmeleja nuk bën të lidhet (me një frymë) me ajetet që fillojnë me fjalë të papërshtatshme për t'iu bashkëngjitur emrave të Allahut apo me diçka të ngjashme, si p.sh.:

﴿بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ﴾ ≠ ﴿الشَّيْطَانُ يَعِدُكُمُ الْفَقْرَ﴾

Besmeleja në suren Teuvbe (Berae)

Të gjithë dijetarët islamë unanimisht mendojnë se nuk lejohet shqiptimi i besmeles në fillim të sures Teube. Ajo fillohet me istiadhe, por pa besmele.

Sa i përket nisjes në ajetet tjera të sures Teube, përveç ajetit të parë, studiuesit e disiplinës së texhvidit kanë dy qëndrime kryesore:

- Një pjesë mbajnë mendimin se mund të fillohet me besmele dhe nuk prish punë aspak.
- Kurse të tjerët mendojnë se dispozita e mosleximit të besmeles vlen për gjithë suren Teube dhe jo vetëm për fillimin e saj.

Mënyrat e kalimit nga sureja Enfal në suren Teube

Fillimisht duhet kujtuar se gjatë kalimit nga surja Enfal në suren Teube, besmeleja nuk gjen vend aspak. Pra, mënyrat e lejuara të kalimit prej njëres sure në tjetrën janë tri:

1. Lidhja e sures Enfal me seuren Teube, pa ndaluar aspak dhe pa shqiptuar besmelen, ashtu siç lidhen rëndom dy ajete të së njëjtës sure.
2. Ndalja në fund të sures Enfal (marrja frymë) dhe pastaj nisja e sures Teube pa besmele;
3. Ndalja në fund të sures Enfal për një çast dhe vazhdimi në suren Teube (pa marrë frymë). Pra, realizimi i *sekte*s mes këtyre dy sureve.

Këto tri mënyra të kalimit nga surja Enfal në suren Teube vlejné për të gjitha suret tjera që dëshirojmë t'i lidhim me suren Teube.

Pyetje:

- ❧ Çfarë do të thotë besmele?
- ❧ A është besmeleja ajet i Kur'anit?
- ❧ Çfarë dispozitë ka leximi i besmeles?
- ❧ Cilat janë mënyrat e lidhjes së dy sureve me besmele?
- ❧ A janë të lejuara të gjitha mënyrat? Cilat po dhe cilat jo?
- ❧ Çfarë dispozite mban besmeleja në suren Tevbe?
- ❧ Cilat janë mënyrat e kalimi nga surja Enfal në suren Tevbe?

RITMET DHE TIPAT E LEXIMIT

Leximi i Kur'anit, për nga shpejtësia e leximit, ka tri ritme të lejueshme dhe shumë të tjera të palejueshme dhe të urryera, e ndër të gjitha tipat veçohet tahkiku, por ne do t'i përmendim të tre tipat:

1. Et-Tahkik (التَّحْقِيقُ)

Fjala *tahkik* në aspektin gjuhësor do të thotë *realizim i plotë apo realizim me përpikëri*. Kurse në aspektin terminologjik nënkupton leximin e ngadalshëm, duke iu përmbajtur të gjitha rregullave të texhvidit dhe duke i medituuar kuptimet e ajeteve të lexuara.

Tahkiku zakonisht praktikohet për mësim me nxënësit dhe me fëmijët apo për meditim.

2. Et-tertil (التَّرْتِيلُ)

Et-Tertilu (التَّرْتِيلُ) është leximi me shpejtësi mesatare i cili praktikohet në gjithë botën islame dhe ritëm me të cilin ka kënduar Kur'an edhe Muhamedi [alejhi selam], prandaj Allahut [xhel-le she'nuhu] kur kërkon këndimin e drejtë të Kur'anit, e përdor këtë term ﴿وَرَتَّلِ الْقُرْآنَ تَرْتِيلًا﴾ **"Lexoni Kur'anin me tertil (ritëm mesatar)!"** (El-Muzzemil: 04)

3. El-Hader (الْحَدَرُ)

Fjala *hader* gjuhësisht do të thotë *nxitim*. Në shkencën e texhvidit e përfaqëson leximin me nxitim, por duke i respektuar të gjitha rregullat e texhvidit.

Haderi përdoret për të lexuar më shumë Kur'an brenda një kohe të caktuar, pra për të fituar më shumë sevape. Zakonisht këtë mënyrë e praktikojnë hafizllarët dhe imamët gjatë faljes së namazit të teravisë në Ramazan, e sidomos ata që falin me hatme.

Lexuesi që nxiton gjatë leximit, duhet të bëjë kujdes në teknikat e leximit: t'i zgjasë medet, t'i realizojë shkrirjet, t'i mbajë shkronjat e gunës etj., sepse ai që lexon sipas kësaj teknike shpeshherë është i predispozuar të bjerë në këto gabime.⁹⁴

Leximi i preferuar

Çdo lexim i cili i plotëson kriteret e leximit të pranuar, duke iu përmbajtur në përpikëri të gjitha dispozitave të texhvidit, është i pranuar dhe mund të lexohet sipas tij. Të tre ritmet e mësipërme janë të pranuar dhe mund të lexohet sipas tyre, mirëpo, kur flitet për preferencë brenda leximeve të drejta, dijetarët islamë kanë bërë disa analiza:

- a) Disa mendojnë se leximi i shpejtë është më i preferuar për shkak të sevapeve, kuptohet duke u respektuar rregullat e texhvidit. Ai që lexon Kur'an me shpejtësi, fiton më shumë sevape, ngase për një kohë të caktuar lexon më shumë ajete. Këtë e mbështesin në hadithin e Muhamedit [alejhi selam] ku thotë:
- (مَنْ قَرَأَ حَرْفًا مِنْ كِتَابِ اللَّهِ فَلَهُ بِهِ حَسَنَةٌ وَالْحَسَنَةُ بِعَشْرِ أَمْثَالِهَا لَا أَقُولُ الْم حَرْفٌ وَلَكِنْ أَلِفٌ حَرْفٌ وَلَا م حَرْفٌ وَمِيمٌ حَرْفٌ)

*“Kush lexon një shkronjë nga Libri i Allahut fiton një të mirë (sevap) dhe kjo e mirë shpërblehet dhjetëfish. Unë nuk them Elif Lam Mim një shkronjë, por Elifi një shkronjë, Lami një shkronjë dhe Mimi një shkronjë.”*⁹⁵

- b) Shumica e dijetarëve të hershëm dhe bashkëkohorë mendojnë se leximi i ngadalshëm (Tahkik), i shoqëruar me meditim, është më i preferuar, pavarësisht mund të mos lexojë shumë ajete. Ky mendim bazohet në këtë ajet kur'anor:

⁹⁴ Këtë renditje (tahkik, tertil dhe hader) e ka preferuar prof.dr.hfz. Hajredin Hoxha, i cili thotë: “Edhe pse teorikisht në shumë libra pranohet renditja: tahkik, hader dhe tevdir, përsëri kjo renditje (tahkik, tertil dhe hader) është më e realizueshme dhe më praktike.”

⁹⁵ Tirmidhiu, *Xhamiu et-Tirmidhiij*, Bejrut, hadithi nr. 2910, Bejtu El-Efkar ed-Duvelijeh, 2004, Bejrut, f. 365

﴿أَفَلَا يَتَذَكَّرُونَ الْقُرْآنَ أَمْ عَلَى قُلُوبٍ أَقْفَالُهَا﴾

“A nuk e meditojnë ata Kur’anin, apo zemrat kanë dryna?!”

(Muhammed: 24)

Ky tip i leximit është i preferuar edhe për arsyen se qëllimi final nga leximi i Kur’anit është kuptimi, mësimi dhe aplikimi i mësimave të tij.

Llojet e urryera dhe të ndaluara të leximit

Përveç llojeve të lejuara të leximit të Kur’anit ekzistojnë edhe forma të urryera dhe të ndaluara.

El-hedhdhu (الْهَذُّ) është leximi i shpejtë dhe i pakujdesshëm, por i kuptueshëm, ku medet zgjaten pak apo më shumë seç kërkohet, nuk realizohen idgamet mjaftueshëm apo bëhen idgame të panevojshme, nuk mbahen shkronjat e dyfishuara hundore, lëshohet ndonjë zanore pa nevojë etj. Pra, kryesisht vjen në shprehje kur për shkak të leximi të shpejtë nuk realizohet një nga rregullat e texhvidit. Ky lloj leximi është i urryer.

El-hedhremetu (الْهَذْرَمَةُ) është lexim i shpejtë, i cili përveç pakujdesisë në rregullat e texhvidit, është edhe i pakuptueshëm për dëgjuesin. Ky lloj leximi është krejt i palejueshëm.

Et-ter’idu (التَّرْعِيدُ) është lexim gjatë të cilit kalohet nga një notë muzikore në tjetrën brenda një zgjatjeje (apo rrokjeje) të vetme. Ky tip leximi përfaqëson edhe dridhjen e zërit, ndryshe quhet edhe *et-terkisu* التَّرْقِيسُ. Shumica e studiuesve e ndalojnë këtë lloj leximi.

Et-tetribu (التَّطْرِبُ) përfaqëson leximin e Kur’anit me melodi të ndryshme. Këtë tip të leximit disa studiues e urrejnë, si p.sh. imam Maliku, e disa të tjerë si Ebu Hanifja, shokët e tij dhe Shafiu e lejojnë duke u mbështetur në shumë hadithe, veçanërisht në rastin kur Muhamedi [alejhi selam] e dëgjoi Ebu Musa El-Esh’ariun duke lexuar Kur’an dhe e pëlqeu. Pastaj Ebu Musa tha: “Po ta hetoja se je duke më dëgjuar, do ta zbukuroja edhe më shumë.” Sidoqoftë, këtu bëhet

fjalë për zbukurim të leximit me melodi që nuk e prekin drejtleksimin e Kur'anit.

Et-tehzinu (التَّحْزِينُ) leximi i Kur'anit me pikëllim dhe i mërzhitur. Ky lloj leximi është i ndaluar nëse bëhet me qëllim apo sa për t'u dukur i tillë, por nëse ndjenja e pikëllimit del vetvetiu apo ngjyrimi i zërit është i atillë atëherë nuk është i ndaluar.

Et-temtitu (الْتَمِيطُ) do të thotë tërheqje, shtrirje apo zgjatje e panevojshme e një zanoreje të shkurtër apo mbajtja e një bashkëtingëlloreje të dyfishuar që nuk duhet mbajtur, p.sh.:

Trajta e gabuar		Trajta e saktë
(فَمَنْ يَعْمَلْ)	←	﴿فَمَنْ يَعْمَلْ﴾
(كُونْتُمْ)	←	﴿كُنْتُمْ﴾
(إِنَّ الدِّينَ)	←	﴿إِنَّ الدِّينَ﴾
(الَّذِينَ)	←	﴿الَّذِينَ﴾

Pa dyshim, ky lloj leximi është i ndaluar sepse shtohen tinguj që nuk janë pjesë e tërësisë kur'anore. Ndryshe ky lloj leximi quhet edhe إِدْحَالٌ (shtim).

El-Ihtilas (الإختِلَاسُ) do të thotë përvjedhje apo anashkalim. Në këtë lloj leximi nuk shqiptohen drejt rrokjet, por kalohen tërthorazi, si p.sh. كَتَبَ رَعِدُكُمْ, etj. Ky lloj leximi është e kundërta e temtitit.

Et-temdig (الْتَمِصُغُ) do të thotë të lexosh Kur'an sikur lexuesi të ketë ndonjë kafshatë në gojë.

Et-tek'iru (التَّقْعِيرُ) do të thotë të artikuloen tingujt nga thellësia e fytyrës, gjegjësisht nga pjesa e prapme e gjuhës. Në këtë lloj leximi tingujt dalin të afërt me tingullin ajn (ع).

Et-ta'vixh (التَّوْخِجُ) do të thotë anim, çalim apo shqiptim i tingujve me imaleh, me anim kah zanorja E.

Et-tet'ninu (التَّطَيْنُ) do të thotë dridhje e zërit gjatë mbajtjes së tingujve hundorë, kryesisht kur janë të dyfishuar.

El-hasremetu (الْحَضْرَمَةُ) do të thotë ngushtim apo ndërprerje p.sh. e bashkëtingëllores R të dyfishuar: R-ja e parë ndahet në artikulum nga R-ja e dytë, sepse ngushtohen tejzat e zërit.

Pyetje:

- ❧ Cilat janë ritmet e lejueshme të leximit të Kur'anit?
- ❧ Cilat janë leximet e urryera dhe të ndaluara?
- ❧ Çfarë është tertili?
- ❧ Për nga shpejtësia apo kualiteti, cili është leximi i preferuar?
- ❧ Trego disa gabime leximore që bëhet te lexuesit tanë!

KREU IV

ALFABETI DHE NYJËTIMET



- Alfabeti i gjuhës arabe
- Vendartikulimet e shkronjave
- Vetitë e përhershme
- Vetitë e përkohshme

ALFABETI I GJUHËS ARABE – أَبْجَدِيَّةُ اللُّغَةِ الْعَرَبِيَّةِ

Gjuha arabe i takon familjes së gjuhëve semite. Ajo ka 28 shkronja (sipas disa të tjerëve ka 29 shkronja) dhe të gjitha janë bashkëtingëllore. Zanoret i shkruan me shenja diakritike. Shkruhet dhe lexohet nga e djathta në të majtë.

Fonetika e gjuhës arabe, për nga formimi dhe cilësia, fonemat i ndan në dy grupe kryesore:

- ♦ Shkronjat (fonemat) themelore, ku bëjnë pjesë njëzet e tetë shkronjat e njohura të gjuhës arabe, pra i gjithë alfabeti, dhe dalin nga një vendartikulim i vetëm, pa u përzier me asnjë vendartikulim apo cilësi të një shkronje tjetër. Shkronjat themelore janë vetëm bashkëtingëllore.
- ♦ Shkronja (fonemat) dytësore. Këtu bëjnë pjesë tingujt të cilët formohen nga dy grafema, dy vendartikulime apo nga ndonjë kombinim i ngjashëm. Tinguj dytësorë janë këta:
 - 1) Tingulli (LL) në gjuhën arabe është i pranishëm vetëm te fjala Allah, por me kusht që përpara ta ketë zanoren *damme* (U) ose *fet'ha* (F), p.sh. ﴿مِنْ اللَّهِ﴾, ﴿عَبْدُ اللَّهِ﴾, ﴿وَاللَّهُ﴾.
 - 2) *Elifi mufahham* (elifi i gjatë nazal). Ky elif vjen vetëm pas shkronjave të forta, p.sh. ﴿أَبْصَارُهُمْ﴾, ﴿خَطَابًا﴾, ﴿خَالِقٌ﴾.
 - 3) *Elifun mumaleh* (الألف الممالة), elifi i gjatë i cili e prodhon tingullin mes Elifit dhe J-së së gjatë. sipas rivajetit të Hafsit e kemi në ajetin e 41 të suren Hud: ﴿بِسْمِ اللَّهِ تَجْرِلُهَا وَتُرسِلُهَا﴾, kurse disa lexime (kiraete) tjera e përdorin më të shpeshtë atë;
 - 4) *Hemzeja e tes'hilit* (الهمزة المسهلة), kur hemzeja lexohet mes hemzes dhe elifit të gjatë ﴿أَعْجَبِي﴾;
 - 5) Leximi i shkronjës *sad* në *za* (الصَّادُ الْمُسَمَّاةُ صَوْتُ الرَّأْيِ) tek fjala ﴿صِرَاطٌ﴾ në kiraetin e Hamzes;

- 6) Leximi i J-së së gjatë kah Vavi (الْبَاءُ الْمَشَقَّةُ صَوْتُ الْوَاوِ), pra lexohet mes kesres dhe damës. Kjo është në kiraetin e Hishamit, Kesaiut, Dhekvanit, Ruvejsit dhe Nafiut, p.sh. te fjalët ﴿قِيلَ﴾, ﴿سِيءٌ﴾, ﴿وَغِيضٌ﴾.
- 7) N-ja e fshehur (النُّونُ الْمُخْفَاةُ). Shkronja N në këtë rast fshihet në hundë dhe del një N që përzihet me shkronjën që vjen pas saj, p.sh. ﴿أَنْتَ﴾, ﴿مِنْ صَلَٰلٍ﴾, ﴿شَيْءٍ قَدِيرٍ﴾. Këtu përfshihet rregulli i ihfasë.
- 8) M-ja e fshehur (الْمِيمُ الْمُخْفَاةُ). Shkronja M në këtë situatë fshihet shumë pak apo vetëm fillimi i saj del i fshehur, p.sh. ﴿مِنْ بَعْدٍ﴾, ﴿أَنْبَاهُمْ﴾. Këtu përfshihet rregulli i iklabit.

Gjuha shqipe nuk i njeh të gjitha shkronjat e gjuhës arabe, prandaj shpeshherë shqipfolësit kanë vështirësi në artikulimin e disa tingujve. Megjithatë, përveç vështirësive, të cilat shqipfolësit i kalojnë me lehtësi, sepse kanë prirje në përvetësimin e gjuhëve të huaja, ata disa tinguj të tjerë i kanë edhe në gjuhën e tyre standarde apo në të folmet e ndryshme dialektore. P.sh. tingulli Ll njihet në mbarë botën shqiptare, prandaj dallimi i L-së nga Ll-ja është shumë i lehtë, mirëpo tingulli A i gjatë nazal është karakteristikë e gegërishtes, kurse tos-kërishtja e ka më të lehtë artikulimin e A-së së lehtë (jonazale).

Pak i vështirë është tes'hili dhe imalja, sepse nuk janë shumë të njohura këta tipa kombinimesh fonetike në fonologjinë shqiptare, e që janë të njohura dhe shumë të lehta për fonologjinë angleze.

Pyetje:

- ❖ Sa tinguj themelorë ka gjuha arabe?
- ❖ Cilët janë tingujt dytësorë?
- ❖ Si i njeh gjuha shqipe tingujt e gjuhës arabe?

VENDARTIKULIMET E SHKRONJAVE – مَخَارِجُ الْحُرُوفِ

Hapi i parë që duhet hedhur për një lexim të drejtë është mësimi i shqiptimit të drejtë të tingujve. Çdo tingull ka vendin e vet të nyjëtimin në aparatin e të folurit. Vendi ku formohet një tingull i caktuar quhet مَخْرَجٌ *vendartikulim*, shumësi مَخَارِجٌ *vendartikulime*.

Nyjetimi i drejtë i çdo tingulli kur'anor është i domosdoshëm. Kësaj i ka dhënë rëndësi edhe Muhamedi [alejhi selam], i cili në shumë raste i ka mësuar shokët e vet se si t'i artikulojnë tingujt kur'anorë. Imam Xhezeriu në "Mukaddimen" shprehet kështu:

<i>Pra, është obligim i patjetërsueshëm për ta,</i>	إِذْ وَاجِبٌ عَلَيْهِمْ مُحْتَمٌ
<i>fillimisht para leximit që të dinë:</i>	قَبْلَ الشَّرُوعِ أَوْلَى أَنْ يَعْلَمُوا
<i>vendartikulimet e shkronjave dhe vetitë,</i>	مَخَارِجَ الْحُرُوفِ وَالصِّفَاتِ
<i>t'i shqiptojnë me gjuhë më të dëlirë</i>	لِيَلْفِظُوا بِأَفْصَحِ اللُّغَاتِ

Nyjetimi i drejtë i çdo tingulli dëgjohet kur atë e vokalizojmë me sukun apo teshdid, dhe përpara vendosim një hemze të vokalizuar me damme, kesere apo fet'ha, p.sh.:

أَنَّ - أَلَّ - أَدَّ - أَظَّ	أُحْ - أُقْ - أُبْ - أُذْ	إِظْ - إِذْ - إِنْ - إِلْ	أَنَّ - أَلَّ - أَدَّ - أَظَّ
-------------------------------	---------------------------	---------------------------	-------------------------------

Nëse çdo shkronjë analizohet në formë të detajuar, atëherë del se secila prej tyre ka vendartikulimin e vet të veçantë, mirëpo, për shkak të afërsisë shumë të madhe të vendartikulimeve të disa shkronjave, dijetarët e texhvidit dhe të fonetikës arabe ato i kanë klasifikuar në shtatëmbëdhjetë (17) vendartikulime.⁹⁶ Këtë mendim e mban kolosi i gramatikës arabe Halil bin Ahmed dhe shumica e lexuesve (kurrave), me në krye Ibn Xhezeriun. Imam Xhezeriu thotë:

⁹⁶ Për klasifikimin e vendartikulimeve ka tri mendime kryesore:

- a) Halil bin Ahmed dhe shumica mendojnë se janë 17 vendartikulime;
- b) Sibevejhi, Shatibiu dhe të tjerë mendojnë se janë 16, pa zgavrën (xhevfîn);
- c) Ferrai dhe të tjerë mendojnë se janë 14 vendartikulime, pa xhevfîn dhe te gjuha i nxjerrin 8 vendartikulime (jo 10 si të tjerët), ku N, L dhe R i bëjnë bashkë.

<i>Vendartikulimet e tingujve janë shtatëmbëdhjetë,</i>	مَخَارِجُ الْحُرُوفِ سَبْعَةٌ عَشْرُ
<i>sipas përzgjedhjes së atij që e ka provuar atë</i>	عَلَى الَّذِي يَخْتَارُهُ مَنْ اخْتَبَرَ

Texhvidologët dhe fonologët, këto shtatëmbëdhjetë vendartikulime të veçanta i kanë grumbulluar në pesë grupe të përgjithshme:

- Zgavra (e gojës) - الْحَوْفُ. Ka një vendartikulum;
- Fyti - الْحَلْقُ. Ka tri vendartikulime;
- Gjuha - اللِّسَانُ. Ka dhjetë vendartikulime;
- Buzët - الشَّفَتَانِ. Ka dy vendartikulime, dhe
- Nazofaringu (zgavra e hundës) - الْحَيْشُومُ. Ka një vendartikulum.

A) Zgavra (e gojës) - الْحَوْفُ

Zgavër (e gojës) quhet zbrazëtira e gojës dhe e fytit. Nga ky vendartikulum dalin tri zanoret e gjata të gjuhës arabe:

- Elifi i pavokalizuar (me sukun) kur përpara ka *fet'ha*, p.sh. مَا;
- Jau i pavokalizuar (me sukun) kur përpara ka *kesre*, p.sh. فِي;
- Vavi i pavokalizuar (me sukun) kur përpara ka *dame*, p.sh. فُو.

Kur shqiptohen këto tri zanore të gjata, fryma e artikulimit nuk ndalet askund, por del jashtë, prandaj disa ekspertë këtë vendartikulum e quajnë الْمَخْرَجُ الْمُقَدَّرُ *vendartikulum i paramenduar*, kurse vendartikulimet e bashkëtingëlloreve i quajnë الْمَخْرَجُ الْحَقِيقُ *vendartikulum real*, sepse fryma e artikulimit të tyre mbaron brenda një organi të nyjëtimit.

Imam Xhezeriu e ka thurur kështu këtë vendartikulum:

Elifi i zgavrës dhe dy sivëllezërit (J dhe V), فَأَلِفُ الْحَوْفِ وَأُخْتَاهَا وَهِيَ
zanore të gjata që mbarojnë me frymë të lirë حُرُوفٌ مَدَّ لِلْهَوَاءِ تَنْتَهِي

Tingujt e këtij vendartikulimi quhen tinguj barkorë apo tinguj ajrorë حُرُوفٌ جَوْفِيَّةٌ apo حُرُوفٌ هَوَائِيَّةٌ.

B) Fyti (gryka) – الْحَلْقُ

Fyti përfshin pjesën e sipërme të gypit të frymëmarrjes. Këtu dalin tri vendartikulime:

1. Fundi i fytit (أَفْصَى الْحَلْقِ). Ky vendartikulim përfshin pjesën e poshtme të fytit, ku dalin këto dy tinguj: *hemzen* ء (أَ) dhe *haun* (أَ).
2. Mesi i fytit (وَسَطُ الْحَلْقِ). Ky vendartikulim përfshin vendin ku kryqëzohet gypi i frymëmarrjes dhe ai i ushqimit (epiglottis). Këtu dalin dy shkronja: *ajnun* ع (أَ) dhe *haun* ح (أَ).
3. Fillimi i fytit (أَذْنَى الْحَلْقِ). Ky përfshin pjesën e fytit që është më afër gojës, gjegjësisht pjesën para njerithit. Këtu dalin dy shkronja: *gajnun* غ (أَ) dhe *haun* خ (أَ).

Këto tinguj, bashkë me të tre nivelet, quhen tinguj grykorë apo të fytit الْحُرُوفُ الْحَلْقِيَّةُ, sepse të gjitha dalin nga gryka.

Imam Xhezeriu këto tri vendartikulime i ka përmbledhur në këto vargje kështu:

Pastaj në fund të fytit: hemzja (ء) dhe hau (هـ)	ثُمَّ لِأَفْصَى الْحَلْقِ هَمْزٌ هَاءٌ
Në mes të tij është ajni (ع) dhe hau (ح)	ثُمَّ لَوْسَطِهِ فَعَيْنٌ حَاءٌ
Në fillim janë gajni (غ) dhe hau (خ)	أَذْنَاهُ عَيْنٌ خَاوُهَا

C) Gjuha – اللِّسَانُ

Gjuha është organi i mishtë i lëvizshëm në gojën e njeriut, i cili është shkaktar i dhjetë vendartikulimeve:

1. Prapagjuha (që është afër fytit) e cila prek pjesën e butë dhe më të prapme të qiellzës së epërme. Kjo zonë është afër njerithit dhe është pika më e lartë e prapagjuhës. Këtu del bashkëtingëllorja *kaf* ق (أَ);
2. Prapagjuha e cila prek qiellzën e epërme të butë dhe të fortën. Ky vendartikulim është pak më përpara (më brenda gjuhës) se vendartikulimi paraprak. Këtu del bashkëtingëllorja *kef* ك (أَ);

Ky dhe tingulli paraprak quhet حُرُوفٌ لَّهْوِيَّةٌ tinguj velarë apo njerithorë.

3. Mesi i gjuhës, kur prek qiellzën e epërme, i jep këto tri bashkëtingëllore: *xhim* ح (حَجَّ), *shin* ش (أَشْن) dhe *jau i shkurtë* ي (أَيَّ);

Këto tinguj quhen tinguj qiellzorë حُرُوفٌ شَجَرِيَّةٌ.

4. Kur njëra anë apo të dy anët e gjuhës e prekin pjesën e brendshme të dhëmballëve të epërme, atëherë nyjëtohet bashkëtingëllorja *dad* ض (أَضَن);

Ky tingull quhet tingull i zgjatur حَرْفٌ مُسْتَطِيلٌ.

5. Kur njëra anë e gjuhës e prek pjesën e brendshme të dhëmballëve të epërme, pak para vendartikulimit të bashkëtingëllores *dad*, atëherë del bashkëtingëllorja *lam* ل (الْ);

6. Kur maja e gjuhës prek alveolën e sipërme të dhëmbëve të përparmë, atëherë e jep bashkëtingëlloren *nun* ن (أَنْ);

7. Kur maja e gjuhës prek alveolën e sipërme të dhëmbëve të përparmë, por pak nën vendartikulimin e nunit, atëherë del bashkëtingëllorja *ra* ر (أَرْ);

Këto tre tinguj (ل, ر, ن) quhen tinguj lëngëzorë حُرُوفٌ ذَلْفِيَّةٌ.

8. Kur maja e gjuhës prek rrëzën e dhëmbëve të përparmë të sipërm, ndërsa pjesa para majës së gjuhës ngrihet kah qiellza e epërme, atëherë artikulojnë këto tri bashkëtingëllore: *ta* ط (أَطْ), *dal* د (أَدْ) dhe *ta* ت (أَتْ);

Këto tinguj quhen tinguj dhëmborë apo dentalë حُرُوفٌ نَطْعِيَّةٌ.

9. Kur maja e gjuhës hyn mes dhëmbëve të epërm dhe të poshtëm, të përparmë, atëherë dalin këto tri bashkëtingëllore: *sad* ص (أَصَن), *sin* س (أَسَن) dhe *zaj* ز (أَزَن);

Këto tinguj quhen tinguj të majës së gjuhës حُرُوفٌ أَسْلِيَّةٌ.

10. Kur maja e gjuhës prek majën e dhëmbëve të sipërm të përparmë, atëherë dalin këto tri bashkëtingëllore: *dha* ظ (أَظْ), *dhal* ذ (أَذْ) dhe *tha* ث (أَثْ). Këto tinguj quhet tinguj alveolarë حُرُوفٌ لَثَوِيَّةٌ.

Imam Xhezeriu këto (10) vendartikulime i ka përmbledhur në vargjet në vijim:

..... dhe kafi është	وَالْقَافُ
në prapagjuhë sipër pastaj kefi pak para	أَفْصَىٰ لِّلْإِنسَانِ فَوْقَ ثُمَّ الْكَافُ اسْفَلُ
në mes: xhimi, shini dhe jau	وَالْوَسْطُ فَجِيْمُ الشَّيْنُ يَا
Sadi është në anë të gjuhës kur prek	وَالضَّادُ مِنْ حَافَتِهِ إِذْ وَلِيَا
dhëmballët e majta apo të djathta	لَا ضِرَاسَ مِنْ أَيْسَرَ أَوْ يُمْنَاهَا
Kurse lami në paragjuhë kur prek rrëzën	وَاللَّامُ أَذْنَاهَا لِمُنْتَهَاهَا
Nunin me majë të gjuhës pak më poshtë	وَالنُّونُ مِنْ طَرَفِهِ تَحْتَ اجْعَلُوا
R i afrohet N duke kthyer pak shpinën e gjuhës.	وَالرَّاءُ يَدَانِيهِ لِيُظْهِرَ أَذْخَلُوا
Ta, Dal e Te dalin prej (majës së gjuhës), nga	وَالطَّاءُ وَالذَّالُ وَتَا مِنْهُ وَمِنْ
dhëmbët e sipërm. Fishkëllyeset (Sad, Z, S) fshihen	عَلَيَا الثَّنَائِيَا وَالصَّفِيْرُ مُسْتَكِنُ
në të (majën e gjuhës), mbi dhëmbët e poshtëm,	مِنْهُ وَمِنْ فَوْقِ الثَّنَائِيَا السُّفْلَى
kurse Dha, Dhal dhe Tha me prerësit e epërm,	وَالطَّاءُ وَالذَّالُ وَتَا لِلْعُلْيَا
gjegjësisht mes tyre dhe majës së gjuhës	مِنْ طَرَفَيْهَا

Ç) Buzët – الشَّفَتَانِ

Buzët janë dy pjesët e mishta dhe të lëvizshme, të cilat i mbulojnë dhëmbët dhe e mbyllin gojën. Buzët kanë dy vendartikulime:

1. Kur brendia e buzës së poshtme i prek majat e dhëmbëve të epërm të përparmë, fitohet bashkëtingëllorja *faun* (فَافْ) ف;
2. Në vendartikulimin mes dy buzëve dalin tri bashkëtingëllore: *vavai* i shkurtër (وَ) و, *baun* (أَبْ) ب dhe *mim* (أَمْ) م.

Këto tinguj quhen tinguj buzorë حُرُوفٌ شَفَوِيَّةٌ.

Imam Xhezeriu këto dy vendartikulime i ka përmbledhur kështu:

..... nga barku i buzës (poshtme)	 وَمِنْ بَطْنِ الشَّفَةِ
me majat e prerësve të epërm del F-ja,	فَالْفَا مَعَ اطْرَافِ الثَّنَائِيَا الْمُشْرِفَةِ
kurse dy buzët japin vav, ba dhe mim	لِلشَّفَتَيْنِ الْوَاوُ بَاءٌ مِيمُ

D) Nazofaringu (zgavra e hundës) – الْخَيْشُومُ

Nazofaringu përfshin pjesën e prapme të zgavrës së hundës, gjegjësisht pjesën më të afërt të zgavrës së hundës me fytyrë.

Ky vendartikulum nuk artikulon ndonjë shkronjë të veçantë, por janë vetëm vendartikulum i artikulimeve hundore, pra vjen në shprehje vetëm tek *nuni* dhe *mimi* me sukun apo të dyfishuara, kup-tohet, atëherë kur shkaktohet shkrije dhe mbajtje e këtyre, si p.sh. idgam mealgunneh, ihfa, iklab, ihfa shefevij etj. P.sh. مِنْ بَعْدِ، أَنْفَقُوا، ثُمَّ، إِنَّ، مِنْ بَعْدِ، أَنْفَقُوا، ثُمَّ، إِنَّ، etj.

Imam Xhezeriu vendartikulimin në fjalë e ka përmbledhur në këtë gjysmëvarg:

.....

Mbajtja (gun'ja) vendartikulum e ka nazofaringun

.....

وَعُنَّةٌ مَخْرُجُهَا الْخَيْشُومُ

Pyetje:

- ❧ Si quhet vendi ku formohen tingujt?
- ❧ Kur e dëgjojmë artikulimin e drejtë të tingujve?
- ❧ Sa vendartikulime njeh gjuha arabe?
- ❧ Në sa grupe të mëdha ndahen vendartikulimet?
- ❧ Sa vendartikulime ka secili grup?
- ❧ Cilat tinguj bëjnë pjesë të secili grup?
- ❧ Çfarë dispozitë kanë vendartikulimet?

VENDARTIKULIMI	NR.	TINGUJT
1. Zgavra e gojës (الْجَوْفُ)	1.	وُ / يَ / اَ
2. Fyti (الْحُلُقُ)	2.	هـ / ء
	3.	ح / ع
	4.	خ / غ
3. Gjuha (اللِّسَانُ)	5.	ق
	6.	ك
	7.	ج / ش / ي
	8.	ض
	9.	ل
	10.	ن
	11.	ر
	12.	ط / ت / د
	13.	ز / س / ص
	14.	ظ / ث / ذ
4. Buzët (الشَّفَتَانِ)	15.	ف
	16.	و / ب / م
5. Nazofaringu (الْحَيْشُومُ)	17.	نُ / نّ - مّ / مّ

VETITË E TINGUJVE – صِفَاتُ الْحُرُوفِ

Në çdo gjuhë të botës, krahas vendartikulimit, tingujt kanë edhe vetitë e tyre specifike, qofshin ato veti të përhershme apo veti të përkohshme.

Çfarë janë vetitë dhe përse duhet mësuar ato?

Nëse dy apo më shumë tinguj ndajnë vendartikulimin e njëjtë, atëherë janë vetitë ato që i dallojnë këta tinguj nga njëri-tjetri, përndryshe do dilnin shumë tinguj njësoj, p.sh. tingujt (ط, ذ, ظ) i takojnë një nëngrupi të vendartikulimit të gjuhës. Nëse tingulli (ط) nuk do të posedonte vetinë e të qenit tingull emfatik (isti'la) dhe alveolar (it'bak), atëherë nuk do të dallohej nga tingulli (ذ). Po ashtu, nëse tingulli (ث) nuk do të ishte i shurdhët (hems), atëherë do të dilte (ذ).

Gjithashtu, përvetësimi i vetive të tingujve është i nevojshëm për të mësuar afërsinë mes tingujve, ashtu që të dihet se cili me cilin tingull mund të shkrihen.

Shikuar nga aspekti i qëndrueshmërisë së vetive në tinguj, studiuesit i kanë ndarë vetitë në dy grupe kryesore: veti të përhershme dhe veti të përkohshme.

I. VETITË E PËRHERSHME – الصِّفَاتُ اللَّازِمَةُ

Kjo fushë e texhvidit studion vetitë akustike të përhershme të tingujve, pra bën përshkrimin e tingullit dhe të mënyrës së realizimit të tij në vendartikulim. Vetitë akustike të tingujve dallohen gjatë mënyrës së nyjetimit/vendartikulimit dhe janë shtatëmbëdhjetë (17) veti: dhjetë veti janë të kundërta me njëra-tjetrën, pra pesë përballë pesë të tjerave, dhe shtatë (7) janë pa veti të kundërta.

A) VETITË ME OPONENCË

Vetitë që kanë oponencë në gjuhën arabe janë gjithsej dhjetë: pesë përball pesë të tjerave. Çdo shkronjë e gjuhës arabe, domosdoshmërisht është pjesë e secilit çift.

1.1. Tingujt e shurdhët (حُرُوفُ الْهَمْسِ)

Tingujt e shurdhët të gjuhës arabe janë këto dhjetë tinguj:

ت	ك	س	ص	خ	ش	ه	ث	ح	ف
فَحْتُهُ شَخْصٌ سَكَّتْ									

Gjatë artikulimit të këtyre tingujve, tejzat e zërit largohen nga njëra-tjetra, duke kaluar ajri mes tyre me lehtësi dhe shkakton dridhje të dobëta, prandaj edhe tingulli del i shurdhët. Po ashtu, presioni i ajrit nuk izolohet (ngushtohet) në vendartikulimin e tingullit përkatës.

Të gjithë tingujt e shurdhët nuk janë në një nivel, por disa janë më të fortë e disa më të zbehët, p.sh. më i forti është Sadi (ص), pastaj Ha (ح), Kef (ك), Ta (ت) dhe pastaj vijnë tingujt e tjerët.

1.2. *Tingujt e zëshëm* (حُرُوفُ الْجَهْرِ)

Tingujt e zëshëm të gjuhës arabe janë (18) tingujt që nuk bëjnë pjesë në grupin e tingujve të shurdhët, e ato janë:

ع	ظ	م	و	ز	ن	ق	ا	ر	ء
غ	ض	ذ	ي	ط	ل	ب	ج	د	
عَظْمَ وَزُنْ قَارِيٍّ عَصَّ ذِي طَلَبٍ جِدْ									

Artikulimi i tingujve të zëshëm bëhet duke i afruar tejzat e zërit shumë me njëra-tjetrën, të cilat e frenojnë dukshëm rrymën e ajrit që del nga mushkëritë. Po ashtu, bëhet frenimi i shtypjes së ajrit edhe në vendin ku artikulohet vetë tingulli. Kështu shkaktohen dridhje të shpejta dhe të koordinuara të tejzave të zërit, me ç'rast fitohet tingulli i zëshëm. Elementi më dallues mes tingujve të zëshëm dhe të shurdhët është se artikulimi i tingujve të zëshëm kryesisht bëhet me presion të rrymës së ajrit në vendartikulim, kurse tek tingujt e shurdhët ky presion pothuaj nuk ekziston.

Disa tinguj brenda këtij grupi janë më të zëshëm se të tjerët, varësisht prej vetive tjera që kanë tingujt, p.sh. tingulli Ta (ط) është më i zëshëm se tingulli dal (د), sepse krahas të qenët tingull i zëshëm, Ta (ط) është edhe tingull emfatik (isti'la) dhe alveolar (it'bak).

2.1. *Tingujt e fortë apo shpërthyes* (الشَّدَّة)

Tingujt e fortë apo shpërthyes të gjuhës arabe janë këto 8 tinguj:

ء	ج	د	ق	ط	ب	ك	ت
أَجِدُ قَطٍ بَكَتْ							

Këta tinguj ndryshe quhen edhe *tinguj mbylltorë*, sepse bëhet mbyllja e plotë e vendartikulimit, *tinguj shpërthyes* apo *pëlcitës*, sepse

pas mbylljes së vendartikulimit, rryma e ajrit shpërthen nga presioni, kurse botërisht njihen si *tinguj okluzivë*.

Nyjëtimi i tingujve të fortë bëhet vetëm nga presioni i fuqishëm i rrymës së ajrit në vendartikulim. Pra, artikulimi i këtyre bashkëtingëlloreve është i përqendruar tërësisht në vendartikulim, kur rryma e ajrit bën presion mbi një vendartikulim të mbyllur, i cili pastaj shpërthen menjëherë për ta dhënë tingullin e fortë apo okluziv.

Tingulli më i fortë në mesin e këtyre bashkëtingëlloreve është tingulli Ta (ط).

Nyjëtimi i tingujve të zëshëm (مَجْهُور) dallohet nga nyjëtimi i tingujve të fortë (شَدِيد) me atë se për fitimin e tingujve të zëshëm duhet frenuar fryma te tejzat e zërit dhe te vendartikulimi, kurse te tingujt e fortë bëhet frenimi i plotë i tingullit vetëm në vendartikulim.

2.2. *Tingujt e butë apo fërkimorë (حُرُوفُ الرِّخَاوَةِ)*

Tingujt e butë të gjuhës arabe janë gjashtëmbëdhjetë:

ث	ح	خ	ذ	ز	س	ش	ص
ض	ظ	غ	ف	ه	ا	و	ي

Këta mund të quhen edhe *tinguj fërkimorë* apo *frikativë*.

Pasi tingulli i butë është i kundërti i të fortit, atëherë edhe mënyra e nyjëtimimit është e kundërt. Kjo bën që artikulimi i tingujve të butë të mbështetet shumë pak në vendartikulim dhe rryma e tyre të mos bëjë presion në të.

Disa bashkëtingëllore nuk bëjnë pjesë as te tingujt e fortë e as te të butët, por cilësohen si tinguj të mesëm. Ato janë pesë:

ل	ن	ع	م	ر
لِنْ عُمْرٍ				

3.1. *Tingujt emfatikë* (حُرُوفُ الْإِسْتِعْلَاءِ)

Tingujt emfatikë apo të ngritur të gjuhës arabe janë shtatë:

ظ	ق	ط	غ	ض	ص	خ
حُصَّ صَعُطَ قُظْ						

Këta tinguj artikulohen duke e ngritur pjesën e pasme të gjuhës në qiellzën e epërme, prandaj quhen edhe *tinguj të ngritur*.

Tingujt emfatikë, pavarësisht vokalit që marrin, ato çdoherë janë tinguj të theksuar (مُتَعَمِّمَةٌ), pra, nuk mund të jenë në asnjë situatë tinguj të patheksuar (مُرَقَّقَةٌ).

Tingujt emfatikë nuk janë në një nivel të lartësisë (theksueshmërisë). Disa janë më të theksuar e disa më pak, prandaj shikuar nga ky prizëm, ato kategorizohen në këtë renditje duke filluar nga tingulli më i theksuar: ط, ض, ص, ظ, ق, غ dhe خ.

3.2. *Tingujt joemfatikë* (حُرُوفُ الْإِسْتِفَالِ)

Tingujt joemfatikë apo të ulët të gjuhës arabe janë njëzet e dy:

ز	ر	ذ	د	ح	ج	ث	ت	ب	ء	ا
ي	و	ه	ن	م	ل	ك	ف	ع	ش	س

Këta tinguj quhen joemfatikë apo të ulët, sepse gjatë nyjetimit të tyre pjesa e prapme e gjuhës nuk ngjitet në qiellzën e epërme, por zbret më poshtë, d.m.th. e kundërta e tingujve emfatikë.

4.1. *Tingujt alveolarë* (حُرُوفُ الْإِطْبَاقِ)

Tingujt alveolarë apo ngjitës të gjuhës arabe janë katër:

ظ	ط	ض	ص
---	---	---	---

Këta tinguj nyjëtohen duke i ngjitur anët e gjuhës në qiellzën e epërme dhe majën me alveolën.

Renditja e këtyre shkronjave nga më e forta në më të dobëtën është kështu: ط, ص, ض dhe ظ.

Siç duket, tingujt alveolarë të gjithë janë edhe tinguj emfatikë, por jo edhe e kundërta.

4.2. Tingujt joalveolarë (حُرُوفُ الْإِنْفِتَاحِ)

Tingujt joalveolarë të gjuhës arabe janë njëzet e pesë, të gjithë përveç tingujve alveolarë. Ato janë:

أ	ب	ت	ث	ج	ح	خ	د	ذ	ر
ز	س	ش	ع	غ	ف	ق	ك	ل	م
			ن	ه	و	ي			

Kjo veti tingullore është oponent e vetisë së mëparshme (alveolare), prandaj nyjëtimi i tingujve që bëjnë pjesë këtu është në mënyrë të kundërt, pra rryma e ajrit nuk pengohet nga gjuha dhe qiellza e epërme.

Dallimi mes tingujve joalveolarë dhe joemfatikë është se joalveolarët janë më të përgjithshëm, prandaj ka edhe më shumë tinguj.

5.1. Tingujt lëngëzorë apo likuidë (حُرُوفُ الْإِذْلَاقِ)

Tingujt lëngëzorë (likuidë) në gjuhën arabe janë gjashtë:

ب	ل	م	ر	ف
فَرَمَنْ لُبَّ				

Ndryshe mund të quhen edhe tinguj majorë, sepse disa dalin nga maja e gjuhës dhe disa nga maja e buzëve, prandaj dhe quhen اذلاق, e cila ka ardhur nga fjala ذلق që do të thotë *majë*.

5.2. Tingujt jolëngëzorë apo jolikuidë (حُرُوفُ الإِصْمَاتِ)

Tingujt jolëngëzorë (jolikuidë) në gjuhën arabe janë njëzet e tre:

ز	ذ	د	خ	ح	ج	ث	ت	ا	ء
ك	ق	غ	ع	ظ	ط	ض	ص	ش	س
							ي	و	ه

Këta tinguj artikuloohen më vështirë se tingujt lëngëzorë, sepse ato nuk nyjëtohen me majë të gjuhës. Ndryshe ato quhen edhe *tinguj privues*, sepse asnjë fjalë e gjuhës arabe nuk mund të ndërtohet vetëm me këta tinguj, pra patjetër duhet që në strukturën e fjalës të ketë edhe një apo më shumë tinguj lëngëzorë. Nëse ndonjë fjalë me katër apo pesë shkronja rrënjësore nuk ka asnjë tingull lëngëzor, atëherë ajo nuk është fjalë arabe, kure me tri mundet.

B) VETITË PA OPONENCË

Këto veti të tingujve të gjuhës arabe nuk kanë oponencë, d.m.th. nuk shkojnë në çifte. Ato dallohen mbi bazën e mënyrës së formimit dhe pjesëmarrjes së zërit gjatë artikulimit të tingujve.

Tingujt e gjuhës arabe mund të marrin një apo dy nga këto shtatë veti, me raste mund të mos marrin edhe asnjë. Pra, vetitë e këtilla janë shtatë lloje:

1. *Tingujt fishkëllyes apo sibilante (حُرُوفُ الصَّفِيرِ)*

Tingujt fishkëllyes në gjuhën arabe janë tre:

ص	س	ز
---	---	---

Këta tinguj quhen fishkëllyes sepse gjatë nyjetimit, presioni i rrymës së tingullit kalon mes majës së dhëmbëve të epërm apo të poshtëm dhe mes majës së gjuhës, ku si rezultat nxjerr një lloj fishkëllime.

Më e fortë është *sad* ص, pastaj *zaj* ز dhe më e dobëta është *sin* س.

Duhet vënë re që këta tinguj të mos dalin si tingujt shushuritës, gjegjësisht si tingulli (ش).

2. *Tingujt shpërthyes (حُرُوفُ الْفُلْقَلَةِ)*

Tingujt shpërthyes në gjuhën arabe janë pesë:

د	ج	ب	ط	ق
قُطِبُ جِدِّ				

El-kalkaletu ndahet në dy pjesë:

- a) El-kalkaletu es-sugra (الْفُلْقَلَةُ الصُّغْرَى), e cila vjen në shprehje kur njëra nga pesë bashkëtingëlloret shpërthyes vjen në mes të

fjalës, p.sh. ﴿يَقْتُلُونَ﴾, ﴿كَسَبْتُمْ﴾, ﴿أَطْعَمَ﴾, ﴿يَذْخُلُونَ﴾, ﴿يَجْزِي﴾ etj. Quhet *kalkale e vogël* (el-kalkalete es-sugra) sepse shpërthimi është më i zbehët se në el-kalkalen el-kubra.

- b) El-kalkale el-kubra (الْقَلْعَةُ الْكُبْرَى) vjen në shprehje kur njëri nga pesë tingujt shpërthyes vjen në fund të fjalës, gjegjësisht është tingulli i fundit që nyjëtohet me atë frymë, p.sh. ﴿الْقِسْطُ﴾, ﴿أَحَدٌ﴾, ﴿الْفَلَقُ﴾, ﴿قَرِيبٌ﴾, ﴿الْبُرُوجُ﴾ etj. Emërtohet *kalkale e madhe*, sepse shpërthimi është më i theksuar se te *kalkalja e vogël*.⁹⁷

Tingulli ط ka theksin e shpërthimit më të lartë, ج e ka të mesëm, kurse ق, د dhe ب e kanë më të ulët.

Gjatë leximit të Kur'anit duhet pasur kujdes që të shmanget kalkalja gjatë shkrirjeve të mundshme te idgami el-mutexhanisejn, p.sh. ﴿قَدْ تَبَيَّنَ﴾ mutekaribejn ﴿يَخْلُقُهُ﴾ apo te idgami nakis ﴿بَسَطَتْ﴾.

Ndonjëherë artikulimi i kalkales është më i vështirë, veçanërisht kur gjatë ndalimit paraqiten dy tinguj me sukun njëri pas tjetrit, p.sh. ﴿عَهْدٌ﴾, ﴿الْقُدْرُ﴾, ﴿فَيْسُقُ﴾ apo edhe më vështirë kur duhet artikuluar dy tinguj të kalkales njëri pas tjetrit, p.sh. ﴿رَطْبٍ﴾, ﴿بِالْعَبْدِ﴾ etj.

3. Tingujt e butë apo të lehtë (حُرُوفُ اللَّيْنِ)

Tingujt e butë në gjuhën arabe janë dy: vavi (و) dhe jau (ي) të pavokalizuara, por që shkronja para tyre të jetë me zanoren fet'ha, si p.sh. حَوْفٌ, صَيْفٌ etj.

Quhen të tillë sepse nyjëtimi i tyre është shumë i lehtë (i butë) dhe nuk sjell ndonjë ngarkesë të theksuar për gjuhën.

⁹⁷ Në disa libra bashkëkohorë të texhvidit paraqitet edhe një kalkale tjetër, أَشَدُّ الْقَلْعَةِ apo أَكْبَرُ الْقَلْعَةِ (kalkalja më e madhe), kur ndonjëra nga shkronjat e kalkales vjen me teshdid, p.sh. ﴿حَقٌّ﴾, ﴿نَبٌّ﴾ e të tjerë. Mirëpo, një ndarje e tillë nuk duket në asnjë libër klasik, sepse konsiderojnë se nuk ka asnjë dallim nga el-kalkalete el-kubra.

4. *Tingujt anësorë apo lateralë* (حُرُوفُ الْإِنْعِرَافِ)

Tingujt anësorë të gjuhës arabe janë dy: ل dhe ر.

Këta tinguj quhen anësorë sepse gjatë artikulimit gjuha e ndërpret rrymën e drejtpërdrejtë të zërit, e cila pastaj del nga anët e gjuhës. Pra, artikulimi i tyre duket se del nga vendartikulimi i vet dhe i afrohen një vendartikulimi tjetër.

L-ja anon kah maja e gjuhës, kurse R-ja anon kah shpina e gjuhës.

5. *Tingujt dridhës apo vibrantë* (حُرُوفُ التَّكْرِيرِ)

Kjo veti përfshin vetëm një tingull të gjuhës arabe, gjegjësisht tingullin ر.

Kjo bashkëtingëllore e ka këtë veti sepse gjatë artikulimit dridhet maja e gjuhës.

Dridhja është veti e përhershme e R-së, megjithatë duhet pasur kujdes që të mos teprohet dridhja, veçanërisht kur ajo është me teshdid, sepse atëherë e humb origjinalitetin e vet.

6. *Tingujt shushuritës* (حُرُوفُ النَّفْثِ)

Kjo veti haset vetëm te një bashkëtingëllore e gjuhës arabe, gjegjësisht te tingulli ش.

Ky tingull nyjëtohet duke u përhap rryma e ajrit dhe tingulli /sh/ në gjithë zgavrën e gojës derisa të mbërrijë në pjesën e brendshme të dhëmbëve të epërm të përparmë.

Shushurima e tingullit ش nuk është e njëjtë në të gjitha situatat. Kur është me teshdid është më shushuritëse. Kur është me sukun është pak më e dobët, ndërsa kur është me zanore, atëherë shushurima është më e dobët.

7. *Tingujt e gjerë* (حُرُوفُ الْإِسْطِطَالَةِ)

Këtu bën pjesë vetëm tingulli ض.

Ky tingull quhet kështu sepse gjatë formimit shfrytëzon një hapësirë shumë të gjerë në aparatin e nyjëtimit. Rryma e tingullit ض shtrihet nga anët e prapme të gjuhës dhe deri në majën e saj.

Përveç këtyre shtatë vetive pa oponencë, dijetarët tjerë kanë shtuar edhe dy veti të tjera. Ato janë:

(8). *Tingujt e fshehur* (حُرُوفُ الْخَفَاءِ)

Këtu bëhet fjalë për tinguj të cilët gjatë artikulimit nuk janë shumë të ekspozuar, por sadopak fshihen. Këtu bëjnë pjesë katër tinguj: ه dhe tri zanoret e gjata (ا, و, ي), të tubuara në sintagmën هَاوِي.

ي	و	ا	ه
هاوي			

Këtu nuk bëhet fjalë për *ihfanë* si *fshehje hundore*, sepse ajo është veti e përkohshme e nunit ose e tenvinit, kurse këtu bëhet fjalë për veti të përhershme të katër shkronjave paraprake dhe gjatë nyjëtimit të tyre nuk ka punë hunda.

(9) *Tingujt hundorë* (حُرُوفُ الْغُنَّةِ)

Dijetarët e texhvidit kanë veçuar disa tinguj dhe i kanë quajtur tinguj hundorë. Ato janë bashkëtingëllorja (م) dhe (ن). Në çfarëdo kombinimi qofshin këto dy bashkëtingëllore, tingëllimi hundor është pjesë e artikulimit të tyre.

Niveli i pranisë së hundës gjatë artikulimit të tyre nuk është çdoherë i njëjtë, por ndryshon në varësi të pozicionit apo të zanoreve që marrin në raste të caktuara, prandaj tingujt hundorë mund të kategorizohen në këto pesë nivele:

- *Tingull hundor më i plotë* (أَكْمَل). Prania më e theksuar e tingullit hundor është kur N-ja ose M-ja janë të dyfishuara (me teshdid), p.sh. **أَمَّا**, **إِنَّ** etj. Quhen tingull hundor më i plotë sepse gjatë nyjetimit të këtyre bashkëtingëlloreve, krejt tingulli del përmes hundës. Tingull më i plotë hundor quhet edhe tek *idgam meal gunneh* me N dhe M, p.sh. **مِنْ نَذِيرٍ**, **حِطَّةً نَغْفِرُ**, **مِنْ مَارِجٍ**, **قَوْلٌ مَعْرُوفٌ**, *idgam mithlejn* me N dhe M, p.sh. **مِنْ نَشَاءٍ**, **وَأَنْتُمْ مُعْرِضُونَ** dhe te *idgam mutexhanisejn* kur B-ja shkrihet në M **بِأَيِّ أَرْكَبٍ مَعَنَا**
- *E plotë* (كَامِلَة). Prania e plotë e tingullit hundor është kur N shkrihet në و ose ي, por mbetet tingulli hundor, p.sh. **مَنْ يَعْمَلُ**, **مِنْ وَلِيٍّ**, **لِكُلِّ وَجْهَةٍ**, **لِقَوْمٍ يَتَفَكَّرُونَ**.
- *E mesme* (مُتَوَسِّطَة). Prania mesatare e tingullit hundor është te Ihfaja, ihfa shefevije dhe iklabi, p.sh. **مِنْ دُونِ**, **تَرْمِيهِمْ بِحِجَارَةٍ**, **مِنْ بَعْدِ**.
- *E mangët* (نَاقِصَة). Prania e mangët e tingullit hundor është kur N-ja dhe M-ja janë me sukun dhe shqiptohen pastër, pra te idhhari dhe idhhar shefeviu, p.sh. **أَنْعَمْتَ**, **مِنْ حَكِيمٍ**, **عَلِيمٌ حَكِيمٌ**.
- *Më e mangët* (أَنْقَاصُ). Prania më e mangët e tingullit hundor është kur N-ja dhe M-ja vijnë të vokalizuara me njëren prej tri zano-reve, p.sh. **مَلَكٌ**, **نَهَارًا** etj.

Ky kategorizim ka të bëjë vetëm me praninë e tingullit hundor dhe jo shumë me kohën e zgjatjes. Zgjatja (mbajtja apo fshehja) në tri kategoritë e para është pothuaj e njëjtë, me dallime të imëta, të cilat mund të dallohen vetëm nga lexuesit profesionistë dhe studiuesit e fushës përkatëse.

Pyetje:

- Ku është dallimi mes vendartikulimeve dhe vetive të tingujve?
- Si ndahen vetitë e tingujve?
- Si ndahen vetitë e përhershme?
- Cilat janë grupet dyshe të vetive me oponencë?
- Cilat janë grupet e vetive pa oponencë?

TABELA E VETIVE TË PËRHERSHME

ME OPONENCË	1.	<i>të shurdhët</i> – هَمْسٌ	:	ف، ح، ث، ه، ش، خ، ص، س، ك، ت
	2.	<i>të zëshëm</i> – جَهْرٌ	:	ا، ء، ب، ج، د، ذ، ر، ز، ض، ط، ظ، ع، غ، ق، ل، م، ن، و، ي
	3.	<i>të fortë</i> – شِدَّةٌ	:	ء، ج، د، ق، ط، ب، ك، ت
	4.	<i>të butë</i> – رَخَاوَةٌ	:	ف، ح، ث، ه، ش، خ، ص، س، ا، ذ، ز، ض، ط، غ، و، ي
	5.	<i>emfatikë</i> – اِسْتِعْلَاءٌ	:	خ، ص، ض، غ، ط، ق، ظ
	6.	<i>joemfatikë</i> – اِسْتِفَالٌ	:	ا، ء، ب، ت، ث، ج، ح، د، ذ، ر، ز، س، ش، ع، ف، ك، ل، م، ن، ه، و، ي
	7.	<i>alveolarë</i> - اِطْبَاقٌ	:	ص، ض، ط، ظ
	8.	<i>joalveolarë</i> – اِنْفِطَاحٌ	:	ء، ب، ت، ث، ج، ح، خ، د، ذ، ر، ز، س، ش، ع، غ، ف، ق، ك، ل، م، ن، ه، ا، و، ي
	9.	<i>lëngëzorë</i> – اِذْلَاقٌ	:	ف، ر، م، ن، ل، ب
	10.	<i>jolëngëzorë</i> - اِصْطَاتٌ	:	ء، ا، ت، ث، ج، ح، خ، د، ذ، ز، س، ش، ص، ض، ط، ظ، ع، غ، ق، ك، ه، و، ي
PA OPONENCË	11.	<i>fishkëllyes</i> - صَفِيرٌ	:	ز، س، ص
	12.	<i>shpërthyes</i> - قَلْقَلَةٌ	:	ق، ط، ب، ج، د
	13.	<i>të lehtë</i> – لِينٌ	:	ـَ، يَ، ـوُ
	14.	<i>anësorë</i> - اِنْحِرَافٌ	:	ل، ر
	15.	<i>dridhës</i> - تَكْرِيرٌ	:	ر
	16.	<i>shushuritës</i> - تَفَشٌّ	:	ش
	17.	<i>i gjerë</i> - اِسْطِلَاطٌ	:	ض

TABELË E VETIVE TË TINGUJVE TË GJUHËS ARABE

صِفَاتٌ غَيْرُ مُتَضَادَّةٍ																صِفَاتٌ مُتَضَادَّةٌ															
الأَسْتِغْنَاءُ	النَّسْبِي	التَّكْرِيرُ	الْإِنْعِرَافُ	الْوَيْلُ	الْفَقْلَةُ	الصَّيْفُ	الْإِضْمَاتُ	الْإِذْلَافُ	الْإِنْفِخَافُ	الْإِطْبَاقُ	الْأَسْتِغْنَاءُ	الرَّخَاوَةُ	السَّيْرَةُ	الْعَجْزُ	النَّهْشُ	Alfabe															
							✓		✓			✓		✓		ا															
							✓		✓			✓		✓		ب															
					✓			✓				✓		✓		ج															
				✓			✓		✓			✓			✓	د															
				✓			✓		✓			✓		✓		هـ															
							✓		✓			✓				و															
							✓		✓			✓		✓		ز															
				✓			✓		✓			✓			✓	ح															
				✓			✓		✓			✓				ط															
				✓			✓		✓			✓				ع															
							✓		✓			✓				غ															
							✓		✓			✓			✓	ف															
							✓		✓			✓				ق															
							✓		✓			✓				ك															
							✓		✓			✓		✓		ل															
							✓		✓			✓		✓		م															
							✓		✓			✓		✓		ن															
							✓		✓			✓			✓	هـ															
							✓		✓			✓		✓		و															
							✓		✓			✓		✓		ي															

II. VETITË E PËRKOHSHME – الصِّفَاتُ الْعَارِضَةُ

Tingujt e gjuhës arabe, përveç vetive të përhershme, ato kanë edhe veti të përkohshme, të cilat paraqiten në situata dhe kombinime të caktuara të gjuhës arabe.

Këto veti të përkohshme tingullore mund të vijnë në shprehje të bashkëtingëlloret dhe të zanoret. Mosrealizimi i këtyre vetive nuk e tjetëron mëvetësinë e tingullit, kurse mosrealizimi i vetive të domosdoshme e ndryshon tingullin.

Realisht kjo materie e mbulon pothuaj gjithë materien e mbetur të shkencës së texhvidit, përveç vendartikulimeve dhe vetive të përhershme.

Vetitë e përkohshme të tingujve në gjuhën arabe janë:		
1	Nyjëtimi i theksuar	(التَّفْخِيمُ)
2	Nyjëtimi i patheksuar	(التَّرْقِيقُ)
3	Zgjatjet	(الْمَدُّ وَالْقَصْرُ)
4	Shkrirja – asimilimi	(الإِذْغَامُ);
5	Artikulimi i qartë	(الإِظْهَارُ);
6	Fshehja hundore	(الإِخْفَاءُ);
7	Shndërrimi	(الإِقْلَابُ)
8	Vokalizimi dhe vënia e sukunit	(التَّحْرِيكُ) و (الإِسْكَانُ)

Vetitë e përkohshme të tingujve të gjuhës arabe, më gjerësisht do të shtjellohen secila në një krye në vete, sepse përfshijnë pothuaj gjithë pjesën tjetër të mbetur të texhvidit.

KREU V

NYJËTIMI I THEKSUAR DHE I PATHEKSUAR



- Theksueshmëria dhe patheksueshmëria
- Dispozita e elifit të butë
- Dispozita e bashkëtingëllores L (fjala Allah)
- Dispozita e shkronjës R.

NYJËTIMI I THEKSUAR (التَّفْخِيمُ) DHE I PATHEKSUAR (التَّرْقِيقُ)

Një nga karakteristikat dhe vetitë e përkohshme të tingujve në gjuhën arabe është theksimi apo patheksimi i tyre.

Tingujt e gjuhës arabe, sipas theksimit apo patheksimit, ndahen në tri grupe:

- A. Tinguj çdoherë të theksuar تَفْخِيمٌ;
- B. Tinguj çdoherë të patheksuar تَرْقِيقٌ, dhe
- C. Tinguj herë të theksuar dhe herë të patheksuar.

A. Tingujt çdoherë të theksuar حُرُوفُ التَّفْخِيمِ

Me fjalën *tingull i theksuar* الصَّوْتُ الْمُفَخَّمُ nënkuptohet kur një tingull i caktuar, shikuar nga aspekti akustik, është më i rëndë apo më i vrazhdë sesa tingujt tjerë.

Tingujt çdoherë të theksuar në gjuhën arabe llogariten shtatë tingujt emfatikë (حُرُوفُ الِئْتِغَالِء):

ظ	ق	ط	غ	ض	ص	خ
حَصَّ صَغُطٍ قُظْ						

Nivelet e tingujve të theksuar

Të gjithë tingujt nuk kanë një nivel të theksimit, edhe pse të gjithë janë emfatikë. Ata mund t'i ndajmë në dy grupe:

- 1- tingujt emfatikë-alveolarë (الِئْتِغَالِءُ وَالِئْطَبَاقُ) ص, ض, ط, ظ janë më të theksuar dhe,
- 2- tingujt emfatikë-joalveolarë (الِئْتِغَالِءُ وَالِئْنِفْتَاخُ) ق, غ, خ janë më pak të theksuar.

Niveli i theksimit varet edhe prej zanoreve që marrin shkronjat. Në bazë të zanores që marrin, ato ndahen në pesë nivele, duke filluar nga më i forti deri te më i dobëti:

1. Më i fortë është kur shkronjat emfatike kanë *fet'ha* dhe pas tyre vjen *elifi* (i gjatë), p.sh. ﴿طَالِمُونَ﴾, ﴿قَالَ﴾, ﴿غَالِبَ﴾, ﴿أَصَاءَتْ﴾, ﴿صَابِرُونَ﴾, ﴿طَائِعِينَ﴾, ﴿خَالِدُونَ﴾;
2. Në nivelin e dytë janë shkronjat emfatike që kanë *fet'ha*, pa elif të gjatë pas, p.sh. ﴿طَعَنَ﴾, ﴿غَلَقَتْ﴾, ﴿صَرَبَ﴾, ﴿صَدَقَ﴾, ﴿خَتَمَ﴾;
3. Me theksim mesatar janë shkronjat emfatike që kanë vokalin dammeh, p.sh. ﴿صُحُفٍ﴾, ﴿ظُلُمَاتٍ﴾, ﴿طُغْيَانًا﴾, ﴿قُولُوا﴾, ﴿خُلِقَ﴾;
4. Me theksim të dobët janë kur shkronjat emfatike kur kanë sukun, p.sh. ﴿أَفْسِمَ﴾, ﴿يَغْفِرُ﴾, ﴿يَظْمَعُ﴾, ﴿فَضْلُ﴾, ﴿يُخْرِجُ﴾, ﴿أَصْحَابُ﴾;
5. Me theksim më të dobët janë kur shkronjat emfatike janë të vokalizuara me kesre, p.sh. ﴿قِيلَ﴾, ﴿خِزْيٍ﴾, ﴿طَبَاقًا﴾, ﴿صِرَاطُ﴾ etj.

B. Tingujt çdoherë të patheksuar حُرُوفُ التَّزْجِيقِ

Me fjalën *tingull i patheksuar* الصَّوْتُ الْمُرْقُوعُ nënkuptohet kur një tingull i caktuar, shikuar nga aspekti akustik, është më i lehtë dhe më butë.

Tingujt të cilët çdoherë llogariten të patheksuar në gjuhën arabe janë këta nëntëmbëdhjetë tinguj joemfatikë (حُرُوفُ الْإِسْفَالِ):

س	ز	ذ	د	ح	ج	ث	ت	ب	ء
	ي	و	هـ	ن	م	ك	ف	ع	ش

Pra, këtu bëjnë pjesë të gjithë tingujt e gjuhës arabe, me përjashtim të tingujve emfatikë خُصَّ ضَعْفُ قِطْ dhe të tingujve ا, ل, ر.

Nivelet e tingujve të patheksuar

Njësoj si tingujt e theksuar, edhe tingujt e patheksuar kanë disa nivele, pra nuk janë të gjithë në një nivel të patheksueshmërisë.

1. Kur shkronjat e patheksuara janë me *kesre*, janë më të patheksuarat e mundshme, p.sh.: ﴿كُتِبَ﴾, ﴿نُشِرَتْ﴾, ﴿تَجِدُوا﴾, ﴿قُتِلَ﴾, ﴿قُلُوبٌ﴾;
2. Kur shkronjat e patheksuara janë me *fet'ha*, janë pak më të theksuara se ato me *kesre*, p.sh. ﴿تَوَابٌ﴾, ﴿الْحَمْدُ﴾, ﴿ءَادَمُ﴾, ﴿يَحْزَنُونَ﴾, ﴿وَلَدٌ﴾;
3. Kur shkronjat e patheksuara janë me *damme*, janë më të theksuarat e mundshme, p.sh. ﴿يُحِبُّ﴾, ﴿هُدًى﴾, ﴿أَنْفُسِهِمْ﴾, ﴿نُسْكِ﴾, ﴿دُعَاءُ﴾;

C. Tinguj herë të theksuar dhe herë të patheksuar

Krahas faktit që disa tinguj çdoherë janë të patheksuar, e disa të tjerë çdoherë të theksuar, në gjuhën arabe ka tre tinguj që me raste mund të jenë të theksuar, e në raste tjera të patheksuar.

Tingujt që paraqiten ndonjëherë të theksuar e ndonjëherë të patheksuar janë tre:

ر	ل	ا
---	---	---

DISPOZITA E ELIFIT (اَلْاَلِفُ اللَّيْنُ)

Elifi në esencë llogaritet tingull joemfatik (i lehtë), i cili mund të vijë vetëm me funksion të zanores së gjatë. Kjo ka bërë që disa studiues të mos e njohin si shkronjë të mëvetësishme të gjuhës arabe.

Pasi elifi nuk është shkronjë e mëvetësishme, nuk mund të ketë as dispozitë të vetën për sa i përket theksimit apo mostheksimit, por çdoherë dispozita e tij është e varur nga shkronja paraprake.

1. Nëse shkronja paraprake është e theksuar (الْمُفَخَّمُ), atëherë elifi është i theksuar (i rëndë), p.sh:

﴿يَخَافُ﴾	﴿طَاقَهُ﴾	﴿يَغَافِلُ﴾	﴿رَمَضَانَ﴾	﴿صَاحِبُ﴾	﴿يُقَاتِلُ﴾	﴿ظَالِمٌ﴾
-----------	-----------	-------------	-------------	-----------	-------------	-----------

2. Nëse shkronja paraprake është e patheksuar (الْمُرْقَقُ), atëherë edhe elifi është i patheksuar (i lehtë), p.sh:

﴿دَارُ﴾	﴿سُبْحَانَهُ﴾	﴿جَاعِلُ﴾	﴿تَأْمِنُهُمْ﴾	﴿تَابُ﴾	﴿عِبَادُ﴾	﴿ءَامَنَ﴾
﴿كَافِرٌ﴾	﴿فَارَ﴾	﴿دَعَا﴾	﴿بِنَاءُ﴾	﴿حِسَابُ﴾	﴿جَزَاءُ﴾	﴿ذَاهِبٌ﴾
	﴿حَيَاةُ﴾	﴿وَأَسِعَ﴾	﴿هَادٍ﴾	﴿نَاسُ﴾	﴿مَاجِدُ﴾	﴿خِلَالُ﴾

Elifi është shkronjë që dallohet krejtësisht nga hemzja, por fatkeqësisht shpeshherë ngatërrohen me njëra-tjetrën. Edhe pse ndonjëherë hemzja mund ta ketë bartës elifin, ajo nuk quhet elif, por është hemze, p.sh. te fjalët: قَرَأَ apo سَأَلَ, أَكَلَ nuk është elifi shkronjë, por është hemzja. Siç u theksua më parë, elifi mund të vijë vetëm si zanore e gjatë, assesi e vetme.

DISPOZITA E SHKRONJËS “L” – لَفْظُ الْجَلَالَةِ

Shkronja L (ل) e gjuhës arabe ka dy variante: e patheksuar (الْمُرَقَّفُ), e cila lexohet L, dhe e theksuar (الْمُفَخَّمُ), e cila lexohet LL.

Leximi i L-së, e theksuar apo e patheksuar, vjen në shprehje vetëm te fjala الله (Allah), përndryshe çdoherë lexohet e patheksuar (L), prandaj ky rregull kryesisht është i njohur edhe si لَفْظُ الْجَلَالَةِ rregulli i fjalës Allah.

Shkronja L te fjala Allah lexohet:

1. (LL) e theksuar. Kur shkronja para fjalës Allah është e vokalizuar me *fet’ha* apo *damme*, atëherë L-ja lexohet LL, p.sh.:

﴿قَالَ اللَّهُ﴾	﴿عِنْدَ اللَّهِ﴾	﴿فَضَّلَ اللَّهُ﴾	﴿أَطِيعُوا اللَّهَ﴾
-----------------	------------------	-------------------	---------------------

2. (L) e patheksuar. Kur shkronja para fjalës Allah është e vokalizuar me *kesre*, atëherë L-ja mbetet L (e patheksuar), p.sh.:

﴿يَاذُنِ اللَّهِ﴾	﴿بِاللَّهِ﴾	﴿فِي سَبِيلِ اللَّهِ﴾	﴿قُلِ اللَّهُمَّ﴾
-------------------	-------------	-----------------------	-------------------

Në të dy rastet bëhet dyfishimi i L-së dhe i LL-së, por duhet kujdesur që të mos mbahen, sepse shpeshherë gabimisht edhe mbahen një notë e gjysmë apo dy nota. Pra, ato thjesht vetëm dyfishohen.

DISPOZITA E SHKRONJËS “R” حُكْمُ الرَّاءِ

R-ja është bashkëtingëllore që lëviz shumë mes theksueshmërisë dhe patheksueshmërisë.

Bashkëtingëllorja R i ka këto situata:

- A) R-ja çdoherë e theksuar (مُفَحَّمَةٌ);
- B) R-ja çdoherë e patheksuar (مُرَقَّعَةٌ); dhe
- C) R-ja me dy mundësi: e theksuar dhe e patheksuar

A) R-ja çdoherë e theksuar (الرَّاءُ الْمُفَحَّمَةُ)

Bashkëtingëllorja R del e theksuar në këto tetë raste:

1. Kur R-ja është me *fet'ha*, p.sh.: ﴿رَّءُوفٌ رَّحِيمٌ﴾; ﴿مَرَضٌ﴾, ﴿بَرَكَاتٌ﴾;
2. Kur R-ja është me *sukun*, ndërsa shkronja paraprake ka zanoren *fet'ha*, p.sh.: ﴿مَرَضَاتٌ﴾, ﴿يَرْزُقُ﴾, ﴿مَرِيَمَ﴾;
3. Kur R-ja është me *sukun* (të përkohshëm) në ndalje, shkronja para saj po ashtu është me *sukun*, kurse shkronja para kësaj të fundit është me zanoren *fet'ha*, p.sh. ﴿الصَّبْرِ﴾, ﴿وَالْفَجْرِ﴾, ﴿الْقَدْرِ﴾. Kjo vjen në shprehje edhe kur para R-së me *sukun* të përkohshëm vjen elifi i gjatë, p.sh. ﴿الْأَبْصَارُ﴾, ﴿النَّارُ﴾, ﴿الْأَنْهَارُ﴾ etj.
4. Kur R-ja është e vokalizuar me *dame*, p.sh. ﴿رُوحٌ﴾, ﴿يَاْمُرُونَ﴾, ﴿رُسُلٌ﴾;
5. Kur R-ja është me *sukun* (të përhershëm apo të përkohshëm), ndërsa shkronja paraprake është me *damme*, p.sh. ﴿يُرْسَلُ﴾, ﴿يَشْكُرُ﴾, ﴿يَاْمُرُ﴾, ﴿الْقُرْءَانُ﴾;
6. Kur R-ja është me *sukun* (të përkohshëm) në ndalje, shkronja para saj po ashtu është me *sukun* (përveç J-së), kurse shkronja para kësaj të fundit është me zanoren *damme*, p.sh. ﴿الْعُسْرِ﴾, ﴿الْيُسْرِ﴾. Kjo vjen në shprehje edhe kur para R-së me

sukun të përkohshëm vjen zanorja e gjatë Vav (و), p.sh. ﴿الْأُمُورُ﴾, ﴿لَعَفُوْهُ غَفُوْرٌ﴾, ﴿كَفُوْرٌ﴾;

7. Kur R-ja është me sukun, ndërsa para saj vjen *kesreja e përkohshme* (hemzetul-vasli), si p.sh. ﴿الَّذِي أَرْتَضَى لَهُمْ﴾, ﴿أَرْجِعُوا﴾, ﴿رَجِعِي إِلَىٰ رَبِّكَ﴾.
8. Kur R-ja është me sukun, shkronja para saj me kesre, ndërsa shkronja pas saj (në të njëjtën fjalë) është emfatike (حَرْفُ الِاسْتِعْلَاءِ), por jo me kesre, p.sh. ﴿فِرْقَانِ﴾, ﴿فِرَاطِيسَ﴾, ﴿وَأَرْصَادًا﴾;

B) R-ja çdoherë e patheksuar (الرَّاءُ الْمُرْقَقَةُ)

Bashkëtingëllorja R del e patheksuar në këto raste:

1. Kur R-ja është e vokalizuar me kesre, p.sh. ﴿رِجَالٌ﴾, ﴿رِزْقٌ﴾, ﴿رُيُودٌ﴾;
2. Kur R-ja është me sukun, ndërsa shkronja para saj është e vokalizuar me kesre, p.sh. ﴿فِرْعَوْنَ﴾, ﴿فَاصِبٍ﴾, ﴿تُنْذِرُهُمْ﴾, ﴿وَأَمْرٌ﴾;
3. Kur R-ja është me sukun (të përkohshëm) në ndalje, shkronja para saj po ashtu është me sukun, kurse shkronja para kësaj të fundit është me zanoren kesre, p.sh. ﴿وَزُرْ﴾, ﴿سِحْرِ﴾, ﴿بِالذِّكْرِ﴾. Kjo vjen në shprehje edhe kur para R-së me sukun të përkohshëm vjen zanorja e gjatë J (يـ), p.sh. ﴿نَذِيرٌ﴾, ﴿بَصِيرٌ﴾, ﴿قَدِيرٌ﴾;
4. Kur R-ja është me sukun të përkohshëm gjatë ndaljes, shkronja para saj është J (ي) me sukun, atëherë R-ja lexohet e patheksuar (lehtë), p.sh. ﴿ضَرِيرٌ﴾, ﴿خَيْرٌ﴾;
5. R-ja lexohet e patheksuar (e lehtë) edhe në ajetin 41 të sures Hud, kur R-ja ka imaleh ﴿حَبْرَئِهَا﴾. Ky rast është i vetëm në leximin e Asimit, sipas transmetimit të Hafsit, kurse sipas transmetimit të Shu'bes M-ja lexohet me U (damme), kurse fet'haja e R-së lexohet rëndom, pa imale.

C) R-ja me dy mundësi: e theksuar dhe e patheksuar

Tingulli R lexohet i theksuar dhe i patheksuar në këto situata:

1. Kur bashkëtingëllorja R është me sukun, para saj ka një shkronjë me *kesre*, kurse pas saj ka një shkronjë emfatike (حَرْفُ اسْتِعْلَاءٍ) po ashtu me *kesre*, p.sh. ﴿فَرَقِيَ كَالطُّورِ﴾

Kjo vjen në shprehje kur ndalemi me reum dhe kur vazhdojmë, ndërsa kur ndalemi me sukun, lexohet vetëm e theksuar.

2. Kur bashkëtingëllorja R është me sukun të rastit, para ka një shkronjë emfatike me sukun, ndërsa para shkronjës emfatike ka një shkronjë të vokalizuar me *kesre*, atëherë lejohet leximi i theksuar dhe patheksuar i R-së, p.sh. ﴿مِصْرَ﴾, ﴿الْقِطْرِ﴾.

Imam Xhezeriu ka preferuar që fjala ﴿مِصْرَ﴾ të lexohet me R të theksuar, kurse fjala ﴿الْقِطْرِ﴾ me R të patheksuar. Këtë preferencë e ka bërë në saxe të pozicionit që R ka gjatë vazhdimit të leximit.

Kjo dispozitë e bashkëtingëllores R, duke e marrë parasysh gjendjen e shkronjës para dhe pas saj, vlen vetëm kur R-ja është në një fjalë. Nëse shkronja para apo pas R-së është në fjalën tjetër, atëherë nuk vlejnë këto dispozita, ﴿فَاصِرٌ صَبْرًا﴾, ﴿وَلَا تُصَعِّرْ خَدَّكَ﴾ etj.

Pyetje:

- ❖ Si ndahen tingujt e gjuhës arabe për nga theksimi?
- ❖ Cilët janë tinguj çdoherë të theksuar?
- ❖ Cilët janë tinguj çdoherë të patheksuar?
- ❖ Cilët tinguj herë janë të theksuar dhe herë të patheksuar?
- ❖ Cilat janë nivelet e tingujve të theksuar dhe të patheksuar?
- ❖ Si lexohet elifi?
- ❖ Si lexohet L-ja?
- ❖ Kur R-ja lexohet e theksuar?
- ❖ Kur R-ja lexohet e patheksuar?
- ❖ Kur R-ja ka dy mundësi leximi?

KREU VI

ZGJATJE



- Tipat e zgjatjeve
- Zgjatja e shkronjave alfabetike
- Renditja e zgjatjeve për nga fortësia

ZGJATJET - المَدُّودُ

Niveli i zgjatjes së rrokjeve në gjuhën arabe është i përcaktuar dhe normativ, sepse si shkruhet ashtu edhe lexohet. Veçanërisht kur është në pyetje Kur'ani, çështja e zgjatjeve është më e theksuar dhe më precize.

Këtë e konfirmon edhe transmetimi i Katades, i cili thotë: “E pyeta Enes bin Malikun [radijall-llahu anhu] për leximin e Pejgamberit [alejhi selam]?” Tha: “E zgjaste (zërin) me përpikëri.”⁹⁸

Ky dhe shumë hadithe të tjerë e konfirmojnë faktin se zgjatjet janë praktikuar edhe nga Pejgamberi [alejhi selam], nga sahabët dhe nga tabiinët, pastaj janë transmetuar gojarisht dhe me shkrim në formë masive (mutevatir) gjeneratë pas gjenerate.

Përkufizimi i fjalës المَدُّ - el-meddu

Fjala المَدُّ *el-meddu* në aspektin gjuhësor në gjuhën arabe do të thotë *zgjatje* apo *shtim*, kurse në terminologjinë e shkencës së texhvidit përkufizohet kështu:

﴿إِطَالَةُ الصَّوْتِ بِحَرْفٍ مِنْ حُرُوفِ الْمَدِّ﴾

“zgjatja e njëres prej tri zanoreve të gjata”

Në gjuhën arabe ka tri zanore të gjata: ا - *elifi*, ي - *Jau* dhe و - *vavi*.

Si oponencë e المَدِّ *meddit* (zgjatjes) njihet قَصْرٌ *kasri* (shkurtimi), apo ndryshe quhet leximi pa zgjatje. Kasri (leximi i shkurtër pa zgjatje) është themelor, kurse meddi (zgjatja) është dytësore, prandaj kjo e fundit kërkon shkak për t’u realizuar, gjegjësisht njëren nga tri zanoret e gjata, ndërsa kasri nuk ka asnjë shkak sepse është rregull themelor.

⁹⁸ Buhariu, *Sahihu el-Buhari*, libri “Fedailu el-Kuran”, kapitulli “meddu el-kiraeti”, hadithi: 5045

Llojet e medeve

Medi ndahet në dy grupe kryesore:

1. El-meddu el-asliju - المَدُّ الْأَصْلِيُّ (zgjatja parësore). Kjo zgjatje quhet parësore sepse pas shkronjave të zgjatjes nuk vjen *hemzeja* ose *sukuni*. Të gjitha zgjatjet e këtij lloji, zgjaten dy nota, prandaj ndryshe quhen edhe el-meddu et-tabiiju zgjatje të natyrshme.⁹⁹

Ky lloj përfshin këto zgjatje:

- Medu tabi - المَدُّ الطَّبِيعِيُّ (zgjatjen e natyrshme),
- Medu bedel - مَدُّ الْبَدَلِ (zgjatjen e zëvendësimit),
- Medu ived - مَدُّ الْوُضِ (zgjatjen e kompensimit) dhe,
- Medu sile sugra - مَدُّ الصِّلَةِ الصُّغْرَى (zgjatjen e lidhjes së vogël).

2. El-meddu el-ferijju - المَدُّ الْفَرْعِيُّ (zgjatja dytësore). Kjo zgjatje quhet *zgjatje dytësore* sepse pas shkronjave të zgjatjeve vjen *hemzeja* ose *sukuni*, dhe zgjatet më shumë se dy nota.

Ky lloj i përfshin këto zgjatje:

- Medu muttasil - المَدُّ الْمُتَّصِلُ (zgjatjen e lidhur),
- Medu munfasil - المَدُّ الْمُتَفَصِّلُ (zgjatjen e ndarë),
- Medu arid li sukun - المَدُّ الْعَارِضُ لِلْسُكُونِ (zgjatjen me sukun të rastit),
- Medu lazim - المَدُّ الْأَلَزِمُ (zgjatjen e domosdoshme),
- Medu lin - مَدُّ الْيَنِ (zgjatjen e butë) dhe,
- Medu sile kubra - مَدُّ الصِّلَةِ الْكُبْرَى (zgjatjen e lidhës së madhe).

⁹⁹ Disa libra këtu e renditin edhe مَدُّ التَّكْنِينِ, e cila bëhet kur pas J-së me teshdid vjen J-ja e gjatë, por ne nuk e kemi theksuar për shkak se llogaritet zgjatje e natyrshme dhe nuk ka nevojë të ndahet veçmas.

Njësitë matëse të zgjatjeve:

Studiuesit e shkencës së texhvidit, për matjen e gjatësisë së zanoreve, kanë vendosur këto pesë njësi matëse:

- *El-kasru* - الْقَصْرُ (e shkurtër): zgjatja dy nota;
- *Fuvej el-kasri* - فَوَيْقُ الْقَصْرِ (pak më e gjatë): zgjatja tri nota;
- *Et-tevessutu* - التَّوَسُّطُ (mesatare): zgjatja katër nota;
- *Fuvej et-tevessut* - فَوَيْقُ التَّوَسُّطِ (mbi mesataren): zgjatja pesë nota;
- *Et-tul* - الطُّول ose *el-ishba'* - الإِشْبَاعُ (e gjatë): zgjatja gjashtë nota.

Si matet koha e dy notave? Koha e notave matet me dy mënyra:

- a) Përmes ngritjes së gishtave, gjegjësisht aq kohë sa merr ngritja e dy gishtave njëri pas tjetrit, aq zgjasin edhe dy notat, tre gishta për tre notat etj.
- b) Përmes përsëritjes së shkronjës së njëjtë dy herë me të njëjtën zanore, tri herë për zgjatjen tri nota etj. Pra, për ta kuptuar sa kohë merr zgjatja dy nota te fjala فَاَلْ, le ta lexojmë فَقْ. Për ta kuptuar kohën e zgjatjes katër nota te fjala مَلِكَةً mjafton ta lexojmë ل ل ل ل etj.¹⁰⁰

Sidoqoftë, mësimi dhe shtjellimi i zgjatjeve më mirë dhe më saktë bëhet në praninë e lexuesve të shkathët dhe hafizëve profesionistë.

Pyetje:

- ❧ Trego një hadith që e argumenton zgjatjen!
- ❧ Përkufizo nocionin meddun!
- ❧ Cilat janë llojet kryesore të medeve?
- ❧ Cilat janë njësitë matëse të zgjatjeve?
- ❧ Çfarë nënkuptohet me sebebi med dhe me harfi med?

¹⁰⁰ Dijetarët e vjetër dhe kurratë (lexuesit) kanë thënë se zgjatjet maten me elifa: një elif është ekuivalent me dy nota, dy elifë me katër nota, tre elifë me gjashtë nota.

1. EL-MEDDU ET-TABI'IJJU - الْمَدُّ الطَّبِيعِيُّ

El-meddu et-tabi'ij është zgjatje e natyrshme. Ky emërtim është si rezultat i natyrshmërisë së saj për folësin arab, pra ky parim praktikohet natyrshëm edhe në çdo përdorim tjetër të gjuhës arabe.

Zgjatja e natyrshme vjen në shprehje në tri raste:

- a) Kur para ا - *elifit* pa zanore (me sukun) vjen një shkronjë me zanoren E, atëherë E-ja shndërrohet në A dhe zgjatet dy nota, p.sh.: ﴿مَاءٌ﴾, ﴿قَالَ﴾, ﴿أَمَاتٌ﴾

Ndonjëherë *elifin* e zëvendëson kjo shenjë (اِ), p.sh.: ﴿مَالِكٌ﴾

- b) Kur para ي - *jaut* pa zanore (me sukun) vjen një shkronjë me zanoren I, atëherë I-ja zgjatet dy nota, kurse *Jau* nuk lexohet. P.sh.: ﴿قِيلَ﴾, ﴿فِي﴾, ﴿فِيهِ﴾;

- c) Kur para و - *vavit* pa zanore (me sukun) vjen një shkronjë me zanoren U, atëherë U-ja zgjatet dy nota, kurse *Vavi* nuk lexohet, p.sh.: ﴿يَقُولُ﴾, ﴿كَفَرُوا﴾

Në vijim do t'i trajtojmë disa çështje që lidhen me *el-medd et-tabi'ij*: Sipas të gjitha kiraeteve (leximeve të Kur'ani) zgjatja e natyrshme zgjatet vetëm dy nota, as më shumë e as më pak.

Zgjatja e elifit është dyfarëshe:

- 1- nëse E-ja është mbi bashkëtingëlloret e forta (حُصَّ صَغُطٍ قِطْ), atëherë A-ja e zgjatur është më e plotë dhe më e theksuar, p.sh.: ﴿طَاقَةٌ﴾, ﴿حَابٌ﴾, ﴿قَالَ﴾ etj.,
- 2- e kur E-ja është mbi bashkëtingëlloret e buta, A-ja zgjatet më butë, pra një shqiptim mes A dhe E, p.sh.: ﴿كَانَ﴾, ﴿مَاتَ﴾, ﴿تَابَ﴾. A-ja e butë është e saktë kur dëgjuesi nuk mund ta dallojë as A-në dhe E-në. Megjithatë shqiptimi i drejtë i të dy A-jave mësohet nga goja e hafizit apo e mësuesit profesional.

Pas shkronjave të zgjatjes (اِ , وِ , يِ), te zgjatja e natyrshme nuk vjen hemzeja e as sukuni (as teshdidi), sepse kalon në lloje tjera të zgjatjes.

Duhet pasur kujdes gjatë ndaljes, ngase shumë lexues (jo profesionistë) zgjatjen e natyrshme fundore e zgjasin më shumë seç kërkohet, p.sh. kur ndalen te fjala حَسْبًا elifin e gjatë që vjen pas shkronjës S e zgjasin tri apo më shumë nota, gjë që është e gabuar. Këtu e ngatërrojnë rastin kur *el-meddu et-tabi'ij* (zgjatja e natyrshme) shndërrohet në *el-meddu el-arid lis-sukuni* me rastin në fjalë.

Ndonjëherë zgjatjen e natyrshme fundore si te fjala وَالضُّحَىٰ e shmangin zgjatjen dhe e lexojnë gabimisht (وَالضُّحُ), ndonjëherë zgjatjen e përfundojnë me hemze dhe e lexojnë gabimisht (وَالضُّحَاءُ), e disa herë e përfundojnë gabimisht me H dhe e lexojnë (وَالضُّحَادُ)

Zgjatja e natyrshme mund të jetë dy lloje:

- 1- الْمَدُّ الطَّبِيعِيُّ الْكَلْبِيُّ *Zgjatja e natyrshme në fjalë*. Kjo përfshin krejt atë që u sqarua deri tani, d.m.th. *zgjatjen e natyrshme* që vjen brenda fjalëve kur'anore.
- 2- الْمَدُّ الطَّبِيعِيُّ الْحَرْفِيُّ *Zgjatja e natyrshme në shkronjë*. Kjo është zgjatja dy nota që vjen te shkronjat enigmatike në fillim të disa sureve, e që vjen në shprehje vetëm te gërmat (ح، ي، ط، ه، و)، të cilat janë mbledhura në togun حَيَّ طَهَّرَ, si p.sh. te këto shembuj: حم، يس، طه، الر، *كَيْسٌ* etj.

Ndonjëherë zgjatja e natyrshme vjen në shprehje vetëm gjatë ndaljes, jo edhe gjatë vazhdimit, p.sh.: ﴿كَثَلِ الَّذِي اسْتَوْفَدَ﴾.

Pyetje:

- ❖ Si formohet el-meddu et-tabi'ij?
- ❖ Në cilin grup të zgjatjeve bën pjesë medu tabi?
- ❖ Sa nota zgjatet el-meddu et-tabi'ij?
- ❖ A zgjatet elifi njësoj në të gjitha rastet dhe pse?
- ❖ Çfarë nuk duhet të vijë pas harfi medit?
- ❖ Cilat janë llojet e el-meddu et-tabi'ij?
- ❖ Cilat janë gabimet më të shpeshta në këtë teknikë?
- ❖ Sajoni el-medd et-tabi'ij në *ajetin kursij*!

2. MEDDUL-BEDEL - مَدُّ الْبَدَلِ

Medul-bedel në kuptimin etimologjik d.t.th. zgjatje e zëvendësimit, pra zgjatja e cila e zëvendëson hemzen e shndërruar në zanore të gjatë.

Kur dy hemze vijnë njëra pas tjetrës, e para me zanore, kurse e dyta me sukun, atëherë hemzeja e dytë shndërrohet në zanore të gjatë (ا، و، ي)، kurse zanorja e hemzes së parë zgjatet dy nota,¹⁰¹ p.sh.:

﴿ءَامَنَ﴾ → ﴿أَمَّنَ﴾	﴿ءَاتَيْنَا﴾	﴿ءَاتَرَ﴾	﴿ءَادَمُ﴾
﴿إِيمَانٌ﴾ → ﴿إِثْمَانٌ﴾	﴿إِيلَافٍ﴾	﴿إِيْتَايَ﴾	﴿إِيْمَانِهِمْ﴾
﴿أُرْتُوا﴾ → ﴿أُوتُوا﴾	﴿أُودُوا﴾	﴿أُوحِيَ﴾	﴿أُورِثُوا﴾

Në disa raste *medu el-bedel* vjen në shprehje vetëm në fillim, ndërsa kur lidhet me fjalën paraprake atëherë eliminohet. Kjo zgjatje vjen në shtatë fjalë kur'anore, ato janë:

Kur fillohet	Kur lidhet	Sure, ajeti
﴿إِيذَن لِّي﴾	﴿يَقُولُ أَتَذَن لِّي﴾	Teube, 49
﴿إِيْتِ﴾	﴿لِقَاءَنَا أَتَتْ﴾	Junus, 15
﴿إِيْتُونِي﴾	﴿قَالَ أَتُتُونِي﴾	Jusuf, 59
﴿إِيْتُوا﴾	﴿ثُمَّ أَتُتُوا﴾	Taha, 64
﴿إِيْتِنَا﴾	﴿يَصْلِحْ أَتُتِنَا﴾	A'raf, 77
﴿إِيْتِنَا﴾	﴿وَلِلْأَرْضِ أَتُتِنَا﴾	Fussilet, 11
﴿أُوتِينَ﴾	﴿أَلَدَى أُوْتِينَ﴾	Bekare, 283

¹⁰¹ Meddul bedel zgjatet dy nota te të gjithë lexuesit, përveç te Vershi, aty zgjatet 2, 4 dhe 6 nota. Zgjatjet mbi dy nota te Vershi nuk vlejné për *medu shebih bi el-bedel*.

Te *medul-bedel* zanorja që zgjatet është mbi ose nën hemze (apo vetëm mbi ose nën elif te botimet e Turqisë), p.sh.: ﴿إِيْمَانٌ﴾، ﴿ءَامَنَ﴾، ﴿أَوْتُوا﴾، kurse te *el-meddu et-tabi'ij* (zgjatja e natyrshme) zanorja është mbi ose nën të gjitha shkronjat tjera përveç hemzes, p.sh.: ﴿الْعَزِيْزُ﴾، ﴿يَقُوْلُ﴾، ﴿سَمِعْنَا﴾.

Nëse pas hemzes vjen një zanore e gjatë e cila në esencë nuk është konvertuar nga hemzja, atëherë këtë zgjatje disa ekspertë të texhvidit e quajnë الْمُدُّ الشَّيْبَةُ بِالْبَدَلِ (zgjatja e ngjashme me *medu bedel*), sepse këtu nuk kemi dy hemze që shkrihen në një, por kemi vetëm një hemze dhe një zanore të gjatë, p.sh.: ﴿لَيْسُوْا﴾، ﴿مُتَكَيِّبِيْنَ﴾، ﴿مَسْئُوْلًا﴾، ﴿ءَابَآءَنَا﴾ etj.

Pyetje:

- Si formohet *medul-bedel*?
- Në cilin grup të zgjatjeve bën pjesë *meddul-bedeli*?
- Sa nota zgjatet *medul-bedeli*?
- Trego dallimin e *el-meddu et-tabi'ij* nga *meddul-bedeli*!
- Çfarë është *medu shebih bi el-bedeli* dhe kur vjen?
- Gjeni tri ajete ku ka *meddul-bedel*!

3. MEDDUL-IVED - مَدُّ الْعَوَضِ

Medul-ived është zgjatja e cila e kompenson tenvinin e humbur. Këtë emërtim e ka marrë në saje të rolit që ka, sepse vjen si kompensim i nunit të humbur (të tenvinit) gjatë ndaljes, d.m.th. nuni i tenvinit *En* (ل) shndërrohet në A (ل) të gjatë dhe zgjatet dy nota, p.sh.: ﴿فَتَى﴾, ﴿نِدَاءٌ﴾, ﴿غُفُورًا﴾.

Shembujt e dhënë tregojnë se *A-ja* dynotëshe e medul-ivedit vjen në tri forma:

- Kur pas *tenvinit* (و) vjen *elifi i ngritur*, p.sh.: ﴿غُفُورًا﴾, ﴿حَكِيمًا﴾, ﴿مُؤَبِّقًا﴾;
- Kur pas *tenvinit* (و) vjen *elifi i shtrirë*, p.sh.: ﴿فَتَى﴾, ﴿هُدَى﴾, ﴿مُصَلَّى﴾;
- Kur pas *tenvinit* (و) nuk vjen asnjëri elif, p.sh.: ﴿نِدَاءٌ﴾, ﴿مَاءٌ﴾, ﴿سَوَاءٌ﴾.

Nga ky rregull përjashtohet rasti kur tenvini (و) vjen mbi T-në e rrumbullakët (ة). Nëse ndalemi në fjalët ﴿شَجَرَةً﴾, ﴿جَنَّةً﴾ etj., atëherë tenvini bie, madje edhe (ة) lexohet (و);

Disa lexues gabojnë kur e zgjatin më shumë se dy nota *medul-ivedin*, veçanërisht në namaz para *rukusë* kur e përfundojnë leximin;

Disa të tjerë gabojnë duke i dhënë një hemze të panevojshme A-së së zgjatur, në vend të ﴿عَتِيَاءٌ﴾ apo ﴿رَضِيَاءٌ﴾, thonë ﴿عَتِيَاءٌ﴾ apo ﴿رَضِيَاءٌ﴾.

Pyetje:

- ❖ Si formohe medul-ivedi?
- ❖ Në cilin grup të zgjatjeve bën pjesë?
- ❖ Sa nota zgjatet medul-ivedi?
- ❖ A ndodh medul-ivde me T-në e rrumbullakët?
- ❖ Sajoni medul-ivedin në suren Nebe, ajetet 31-40!

4. MEDDUS-SILEH – مَدُّ الصَّلَةِ

Kjo zgjatje ka të bëjë vetëm me përemrin vetor (ۛ) të gjuhës arabe, prandaj në shumë libra ky rregull njihet edhe me emrin مَدُّ هَاءِ الصَّلَةِ rregulli i përemrit.

Meddus-sileh vjen në shprehje kur H-ja dhe shkronja para saj janë me zanore, pra nuk kanë sukun. Kur H-së i plotësohen këto kushte, zgjatet, por gjatësia varet nga shkronja që vjen pas saj, gjë e cila e ndan në dy grupe:

1. *Meddus-sileti es-sugra* - مَدُّ الصَّلَةِ الصُّغْرَى (zgjatja e lidhjes së vogël), bëhet kur pas (ۛ) vijnë të gjitha shkronjat përveç هَمْزَةُ الْقَطْعِ (elifit apo elifit me heze) dhe zgjatet 2 nota, p.sh.:

﴿وَمَلَيْكَتِهِ وَرُسُلِهِ﴾	﴿فَإِنَّهُ نَزَّلَهُ عَلَى قَلْبِكَ﴾	﴿مَعَهُ رَبِّيُونَ﴾
-----------------------------	--------------------------------------	---------------------

2. *Meddus-sileti el-kubra* - مَدُّ الصَّلَةِ الْكُبْرَى (zgjatja e lidhjes së madhe) bëhet kur pas (ۛ) vjen vetëm هَمْزَةُ الْقَطْعِ (hemze me elif), atëherë zgjatet 2, 4 ose 5 nota, por më e preferuar është 4 nota, p.sh.:

﴿وَوَرَّثَهُ آبَاؤُهُ﴾	﴿فَإِنَّهُ عَائِمٌ﴾	﴿أَوْ بِهِ أَدَى﴾
------------------------	---------------------	-------------------

Kjo zgjatje quhet مَدُّ الصَّلَةِ (zgjatja e lidhjes) sepse e lidh fjalën para-prake me pasuesen në formën më të butë.

Nëse shkronja përpara H-së është me sukun ose me zgjatje, atëherë nuk kemi *meddus-sileh* (nuk zgjatet H-ja), pos në një rast, në ajetin 69 të sures Furkan: ﴿وَيَخْلُدُ فِيهِ مُهَانًا﴾;

Kusht për t'u zgjatur është që shkronja H (ۛ) të mos jetë nga rrënja e fjalës, e nëse H-ja është e rrënjës së fjalës, atëherë zanorja e saj nuk zgjatet, p.sh.: ﴿لَمْ يَنْتَهُ﴾.

H-ja nuk zgjatet edhe në këto raste, edhe pse i plotëson kushtet për zgjatje: ﴿هَذَا فَلْيَقِ إِلَيْهِمْ﴾، ﴿قَالُوا أَرْجِهْ وَأَخَاهُ﴾، ﴿وَإِنْ تَشْكُرُوا يَرْضَهُ لَكُمْ﴾

Pyetje:

- ❧ Si formohet medu sileh dhe pse quhet kështu?
- ❧ Sa nota zgjatet dhe sa është e preferuar?
- ❧ Sqaro dallimin e medu siles kubra nga sugra!
- ❧ Trego disa vërejtje rreth medu siles!
- ❧ Sajo meddus-sileh në suren Kijame, ajetet 1-19!

5. EL-MEDDU EL-MUTTASIL – الْمَدُّ الْمُتَّصِلُ

Ky rregull quhet *zgjatje e bashkëngjitur* sepse shkaku i zgjatjes (hemzeja) është bashkë me zgjatjen në të njëjtën fjalë.

Kur pas zanoreve të gjata (اَ، أُ، وُ، يَ) vjen hemzeja në të njëjtën fjalë, atëherë zanoret e gjata duhet zgjatur në cilësi të *zgjatjes së bashkëngjitur* – الْمَدُّ الْمُتَّصِلُ, p.sh.:

﴿إِسْرَءِيلَ﴾	﴿نِسَاءُكُمْ﴾	﴿الْمَلَكَةَ﴾	﴿جَزَاؤُهُمْ﴾	﴿أُولَئِكَ﴾
﴿سَيِّئًا﴾	﴿تَفْسِيرًا﴾	﴿وَجَائًا﴾	﴿بُضْيًا﴾	﴿بَرِيًّا﴾
﴿الْمَاءِ﴾	﴿شُهَدَاءَ﴾	﴿حُنَفَاءَ﴾	﴿السَّمَاءِ﴾	﴿يَشَاءَ﴾
﴿السُّوَّاءِ﴾	﴿لَتَنُوَّاءَ﴾	﴿نَبَوَّاءَ﴾	﴿فُرُوءَ﴾	﴿سُوءَ﴾

El-meddu el-muttasil zgjatet 4 ose 5 nota. Kur ndalemi dhe shkronja e fundit është hemze, atëherë zgjatet edhe 6 nota p.sh. ﴿يَشَاءَ﴾. Po ashtu duhet bërë kujdes me hemzen që të shqiptohet siç duhet, sepse dihet që hemzja me sukun ka një prerje gjatë shqiptimit. Mirëpo, nëse ndalemi në fjalën që ka *el-meddu el-muttasil* por hemzja nuk është shkronja e fundit e asaj fjale, atëherë ajo zgjatet vetëm 4 ose 5 nota, nuk lejohet të zgjatet 6 nota, si p.sh. ﴿جَاءَكُمْ﴾, ku duken edhe dy shkronja pas hemzes.

Kjo zgjatje ndryshe quhet edhe الْمَدُّ الْوَاجِبُ الْمُتَّصِلُ – *zgjatja e bashkëngjitur obligative*, sepse të gjitha kiraetet e zgjasin 4 nota e më shumë.

Pyetje:

- Përse quhet *el-meddu el-muttasil*?
- Si formohet kjo zgjatje?
- Sa zgjatet medu muttasil?
- Përse ndonjëherë quhet edhe medu vaxhib muttasil?
- Sajoni medu muttasilat në suren Tarik!

6. EL-MEDDU EL-MUNFASIL – الْمَدُّ الْمُتَفَصِّلُ

Kjo teknikë leximi quhet *el-meddu el-munfasil* (zgjatje e ndarë) sepse zanorja e gjatë (ي، و، ا) është në fund të njëres fjalë, kurse shkaku i zgjatjes, gjegjësisht hemzeja është në fillim të fjalës tjetër, d.m.th. harfi medi dhe sebebi medi janë të ndarë në dy fjalë.

Kur në fund të fjalës vjen njëra nga zanoret e gjata (ي، و، ا), ndërsa në fillim të fjalës tjetër vjen hemzeja (ء), e cila zakonisht vjen me elif (ا، إ), por ndonjëherë mund të vijë edhe vetëm me hemze (ء), atëherë zanoret e gjata zgjaten në cilësi të *el-meddu el-munfasilit* (zgjatjes së ndarë), p.sh.:

﴿يَا أَيُّهَا﴾	﴿وَإِذَا أَنْعَمْنَا﴾	﴿رَبَّنَا إِنَّكَ﴾	﴿إِنَّمَا أَنْتَ﴾
﴿يَبْنِي عَادَمَ﴾	﴿رَبِّي أَكْرَمَ﴾	﴿إِنِّي أَخَافُ﴾	﴿فِي أَنْفُسِهِمْ﴾
﴿قَامُوا إِلَى﴾	﴿تَعَفُّوا أَقْرَبُ﴾	﴿قَالُوا إِنَّمَا﴾	﴿تُوبُوا إِلَيْهِ﴾

Medi *munfasil* zgjatet 2, 4 ose 5 nota.¹⁰² Më e preferuar është zgjatja katër nota.

Kjo zgjatje vjen në shprehje vetëm nëse vazhdojmë, sepse nëse ndalemi tek zgjatja, gjegjësisht para hemzes, atëherë nuk kemi *medi munfasil*, por kemi *medi tabi* apo ndonjë zgjatje tjetër.

Të gjitha *el-meddu el-munfasil*-at duhet të kenë të njëjtën gjatësi gjatë një leximi. Nëse zgjatjen e parë të këtij lloji e kemi bërë dy nota, atëherë të gjitha të tjerat duhet të jenë nga dy. Në një seancë leximore duhet të përdoret njëra gjatësi: 2, 4 apo 5.

Gjithashtu, duhet që gjatësia e *el-meddu el-munfasilit* të mbajë nivelin e njëjtë me *meddus-sileti el-kubra*, dhe assesi të zgjatet më shumë se *el-meddu el-muttasili*.

¹⁰² Zgjatja dy nota është sipas rrugës së “Tajjibetu en-neshri” të imam Xhezeriut, kurse zgjatja katër dhe pesë nota është sipas “Shatibijes” të imam Shatibiut.

Pyetje:

- ❧ Përse quhet medu munfasil?
- ❧ Si formohet kjo zgjatje?
- ❧ Sa zgjatet medu munfasili?
- ❧ Ku dallon medu munfasili nga medu muttasili?
- ❧ Sajo mendu munfasilat në suren Kafirun!

7. EL-MEDDU EL-ARID LIS-SUKUN – الْمَدُّ الْعَارِضُ لِلْسُّكُونِ

El-meddu el-arid lis-sukun është zgjatja me sukun të rastit. Ky rregull mban këtë emër sepse shkaktuesi i zgjatjes është sukuni i rastit سَكُونٌ عَارِضٌ i cili vjen në shprehje vetëm kur ndalemi.

Kjo zgjatje bëhet kur pas zanoreve të gjata vjen vetëm një shkronjë e vokalizuar, së cilës kur ndalemi i vëmë *sukunin e rastit* (سَكُونٌ عَارِضٌ), p.sh.:

﴿تَعْمَلُونَ﴾	﴿وَتَمُودُ﴾	﴿مَتَعُ الْغُرُورِ﴾	﴿خَلِيدُونَ﴾
﴿عَذَابٍ﴾	﴿عِبَادٍ﴾	﴿مَعَ الْأَبْرَارِ﴾	﴿إِلَهُ النَّاسِ﴾
﴿يَوْمَ الدِّينِ﴾	﴿يَبْنِيهِ﴾	﴿لِلْمُصَلِّينَ﴾	﴿سَجِيلٍ﴾

Gjatësia e këtij rregulli është 2, 4 ose 6 nota. Zgjatet 2 nota sepse esenca e saj është *el-meddu et-tabi'ij*. Zgjatet 4 nota sepse sukuni është i rastit, ndërsa 6 nota zgjatet sepse ngjan me *el-meddu el-lazim* i cili shkak e ka sukunin e përhershëm.

Nga sqarimi i cituar më lartë kuptojmë se kjo zgjatje vjen vetëm në ndalje, e jo edhe gjatë vazhdimit të leximit.

Nuk është kusht që kjo të realizohet vetëm në fund të ajetit, por mund të vijë në çdo fjalë që plotësohen kushtet e cituara më lartë.

Të gjitha *el-meddu el-arid*-at duhet të kenë të njëjtën gjatësi gjatë një leximi. Nëse zgjatjen e parë të këtij lloji e kemi bërë dy nota, atëherë të gjitha të tjerat duhet të jenë nga dy. Pra, përzierja e zgjatjeve 2, 4 apo 6 nota nuk mund të jetë të pranishme në një seancë leximi.

Pyetje:

- Përse quhet *el-meddu el-arid lis-sukun*?
- Si formohet kjo zgjatje?
- Sa zgjatet *el-meddu el-arid*?
- A mund të vjen kjo zgjatje në mes të një ajeti?
- Sajo *el-meddu el-arid* në suren Buruxh!

8. EL-MEDDU EL-LAZIM – الْمَدُّ الْإِلْزَامُ

El-meddu el-lazim në aspektin gjuhësor do të thotë *zgjatje e domosdoshme*. Emërtohet kështu sepse shkaktues i zgjatjes është *sukuni* i përhershëm سُوْنٌ لَازِمٌ i cili në asnjë mënyrë nuk lihet pa u shqiptuar, pavarësisht nëse ndalemi apo vazhdojmë leximin në atë fjalë.

Kjo teknikë e zgjatjes vjen në shprehje kur pas zanoreve të gjata (اَ ، اُ ، اِ ، يَ ، يِ ، وُ ، وِ ، اِ) , vjen një shkronjë me sukun të përhershëm (këtu përfshihet edhe teshdidi). Quhet zgjatje e domosdoshme sepse në të gjitha rastet e shoqëron sukuni i domosdoshëm (سُوْنٌ لَازِمٌ).

Medi lazim ndahet në dy grupe kryesore:

- A) *El-meddu el-lazim el-kelimij* - الْمَدُّ الْإِلْزَامُ الْكَلِمِي (Zgjatja e domosdoshme në fjalë);
- B) *El-meddu el-lazim el-harfij* - الْمَدُّ الْإِلْZَامُ الْحَرْفِيُّ (Zgjatja e domosdoshme në shkronjë).

A) El-meddu el-lazim el-kelimij - الْمَدُّ الْإِلْزَامُ الْكَلِمِي

1. *El-meddu el-lazim el-kelimij el-muthekkal* - الْمَدُّ الْإِلْزَامُ الْكَلِمِي الْمُتَّكِلُ (zgjatja e domosdoshme në fjalën e rëndë). Kur pas zanoreve të gjata vjen një shkronjë me teshdid, atëherë zanoret e gjata zgjaten 6 nota, p.sh.:

﴿وَلَا الضَّالِّينَ﴾	﴿الْحَاقَّةُ﴾	﴿الصَّاحَّةُ﴾	﴿الطَّامَّةُ﴾
----------------------	---------------	---------------	---------------

2. *El-meddu el-lazim el-kelimij el-muhaffef* - الْمَدُّ الْإِلْزَامُ الْكَلِمِي الْمُخَفَّفُ (zgjatja e domosdoshme në fjalën e lehtë). Kur pas zanoreve të gjata vjen një shkronjë me sukun, atëherë zanorja e gjatë zgjatet 6 nota. Në Kur'an ka vetëm një shembull nga ky rregull, i cili përsëritet dy herë në suren Junus (51-91), p.sh.:

﴿ءَاآسَنَ وَفَدَّ كُنْثُمْ بِهِ تَسْتَعْجِلُونَ﴾	﴿ءَاآسَنَ وَفَدَّ عَصِيَّتْ﴾
--	------------------------------

B) El-meddu el-lazim el-harfij - الْمُدُّ الْاَلَزِمُ الْحَرْفِيُّ

1. *El-meddu el-lazim el-harfij el-muthekkal* - الْمُدُّ الْاَلَزِمُ الْحَرْفِيُّ الْمُثَقَّلُ (zgjatja e domosdoshme në shkronjën e rëndë). Kjo bëhet te shkronjat e alfabetit arab që vijnë në fillim të 29 sureve. Pra, kur në shqiptimin e një shkronje kemi zgjatje dhe pas saj shqiptojmë një shkronjë me teshdid, atëherë zanorja e gjatë zgjatet 6 nota të detyrueshme. Kjo, zakonisht, ndodh para *mimit*, p.sh.:

﴿اَلَمْ﴾	﴿اَلَمْصَ﴾	﴿اَلْمَرَّ﴾	﴿طَسَمَ﴾
----------	------------	-------------	----------

2. *El-meddu el-lazim el-harfij el-muhaffef* - الْمُدُّ الْاَلَزِمُ الْحَرْفِيُّ الْمُخَفَّفُ (zgjatja e domosdoshme në shkronjën e lehtë). Edhe ky rregull vjen në shprehje te shkronjat e alfabetit arab që vijnë në fillim të sureve, por këtu është kusht që pas zanores së gjatë të vjen një shkronjë me sukun, p.sh.:

﴿صَ﴾	﴿قَ﴾	﴿نَ﴾	﴿اَلرَّ﴾
﴿يَسَ﴾	﴿حَمَ﴾	﴿اَلْمَ﴾	﴿اَلَمْصَ﴾
﴿اَلْمَرَّ﴾	﴿طَسَمَ﴾	﴿كَمِيعَصَ﴾	

Të gjitha shkronjat e *el-meddu el-lazim el-harfijj* përfshihen në togun نَقَصَ عَسَلَكُمْ.

Kjo teknikë e zgjatjes çdoherë dhe në të gjitha situatat zgjatet gjashtë nota.

Fjala ﴿اَللّٰنَ﴾ në ajetin 51 dhe 91 të sures Junus është *el-meddu el-lazim*, ndërsa në rastet tjera fjala ﴿اَللّٰنَ﴾ nuk ka fare zgjatje. Kjo dallohet edhe nga vetë shenja e medit, ku në rastet kur nuk zgjatet, nuk ka as hemze dhe as shenjë të medit.

Shkronjat alfabetike në fillim të disa sureve nuk kanë një dispozitë të përbashkët të gjitha shkronjat e një togu, por secila shkronjë në vete ka dispozitë të veçantë. Pra, nuk kanë vetëm *el-meddu el-*

lazim el-harfij, por mund të kenë edhe el-meddu et-tabî'ij, medu lin, ihfa, idgam mea el-gunneh, idgam mithlejn etj.

Shembujt ﴿قُلْ ءَاللهُ اَذِنَ لَكُمْ﴾, ﴿قُلْ ءَاللهُ كَرِيْمٌ﴾ dhe ﴿ءَالْتَن﴾ mund të zgjaten me cilësinë e *el-meddu el-lazim el-klimij* apo *el-meddu el-ferkut*, por mund të zgjaten edhe dy nota me cilësinë e tes'hil, ku hemzeja e parë lexohet pastër, kurse hemzeja e dytë bëhet tes'hil.

Pyetje:

- ❦ Përse quhet medu lazim?
- ❦ Si ndahet medu lazimi?
- ❦ Cili është shkaktari i medu lazimit?
- ❦ Sa zgjaten të gjithë medu lazimat?
- ❦ Sa dispozita të zgjatjes mund të ketë në shkronjat alfabetike?
- ❦ Në sa raste paraqitet medu lazim kelimij muhaffef?
- ❦ Sajoni medu lazimet në suren el-Hakkah!

9. MEDDU EL-LIN – مَدُّ اللَّيْنِ

Medu el-lin do të thotë *zgjatje e butë*, sepse kjo teknikë mundëson ndalje të butë dhe e zmang vrazhdësinë.

Kjo zgjatje realizohet kur para V-së dhe J-së me sukun (ي، و) vjen një bashkëtingëllore me zanoren fet'ha (ـَ), kurse pas saj vjen vetëm një bashkëtingëllore. Në rastin e mësipërm, kur ndalemi, shkaktohet zgjatja e diftongut *eu* ose *ei*, p.sh.: حَوْفٌ (hauuuuf), كُورِيشٌ (kureeeesh).

Gjatësia e këtij rregulli është 2, 4 ose 6 nota. Zgjatet 2 nota sepse esenca e çdo zgjatje është 2 nota. Zgjatet 4 nota sepse sukuni është i rastit, ndërsa 6 nota zgjatet sepse ngjan me el-meddu el-arid lis-sukun i cili shkak e ka sukunin, p.sh.:

ي	رَيْبٌ	غَيْبٌ	خَيْرٌ	شَفَتَيْنِ	الصَّيْفِ
و	نَوْمٌ	خَوْفٌ	الْمَوْتُ	فِرْعَوْنٌ	يَحْشُونَ

Kjo zgjatje realizohet vetëm gjatë ndaljes. Shpeshherë, disa filletarë këtë e praktikojnë edhe gjatë vazhdimit, por një gjë e tillë nuk është e lejuar.

Në një lexim, të gjitha medu linat duhet të jenë njësoj të gjata. Nuk lejohet që njëra të jetë dy, tjetra katër ose gjashtë.

Pyetje:

- Përkufizo medu linin?
- Sa zgjatet medu lin?
- A realizohet medu lin gjatë vazhdimit?
- Gjej medu linat në suren Kurejsh!

LEXIMI I SHKRONJAVE ALFABETIKE NË FILLIM TË DISA SUREVE

Shkronjat alfabetike të cilat vijnë në fillim të disa sureve në Kur'an janë katërmëdhjetë dhe lexohen njësoj si në alfabet. Ato janë të tubuara në fjalinë:

طَّرَقَ سَمْعَكَ الصَّبِيحَةُ	apo	نُصَّ حَكِيمٌ قَطْعًا لَهُ سِرٌّ
-------------------------------	-----	----------------------------------

Dispozita e këtyre shkronjave nuk është njësoj, sepse ato mund të jenë disa syresh. Ato janë:

1. *El-meddu el-lazim el-harfij*, e cila zgjatet 6 nota, por gjerësisht është sqaruar në pjesën e *el-meddu el-lazim el-harfij*. Shkronjat e kësaj zgjatjeje përfshihen në togun: نَقَّصَ عَسَلُكُمْ, p.sh.:

﴿حَمَّ﴾	﴿يَسَّ﴾	﴿كَهَيْعَصَّ﴾	﴿الرَّ﴾	﴿طَسَمَّ﴾	﴿الْمَرَّ﴾
---------	---------	---------------	---------	-----------	------------

Zgjatja e ajnit (ع) te ﴿كَهَيْعَصَّ﴾ mund të llogaritet edhe *el-meddu el-lazim el-harfij* dhe *meddu el-lin*.

2. *Medu tabii* janë të gjitha shkronjat të cilat shqiptohen vetëm me një rrokje të hapur dhe zgjaten 2 nota, p.sh.:

﴿حَمَّ﴾	﴿يَسَّ﴾	﴿كَهَيْعَصَّ﴾	﴿الرَّ﴾	﴿طَسَمَّ﴾	﴿الْمَرَّ﴾
---------	---------	---------------	---------	-----------	------------

Shkronjat që janë medu tabi janë në togun حَيَّ طَهَّرَ

3. *Nuk ka asnjë dispozitë*. Elifi është e vetmja shkronjë që nuk zgjatet dhe, si rezultat, nuk ka asnjë dispozitë, p.sh.:

﴿الْمَ﴾	﴿الْمَصَّ﴾	﴿الرَّ﴾	﴿الْمَ﴾
---------	------------	---------	---------

Këto janë dispozitat për shkronjat alfabetike në fillim të disa sureve. Disa gabimisht u japin një dispozitë gjithë grupit të shkronjave, d.m.th. secila shkronjë ka dispozitën e vet.

Rregulli	Ndarja	Shembuj	Gjat.
EL-MEDDU ET-TABI'IJ		قَالُوا	2
MEDUL BEDEL		ءَامَنَ	2
MEDUL IVED		مُقْتَدِرًا	2
MEDUS-SILEH	El-Sugra	لَهُ مَا	2
	El-Kubra	مَا لَهُ أُخْلَدُهُ	2-4-5
EL-MEDDU EL-MUTTASIL		جَاءَ	4-5-6
EL-MEDDU EL-MUNFASIL		فِي أَنْفُسِكُمْ	2-4-5
EL-MEDD EL-ARID LISSUKUN		يُؤْمِنُونَ	2-4-6
EL-MEDDU EL-LAZIM	Harfij muthekkal	الم	6
	Harfij muhaffef	الر	
	Kelimij muthekkal	الْحَاقَّةُ	
	Kelimij muhaffef	ءَالَانَّ	
MEDU LIN		خَوْفَ	2-4-6

RENDITJA E ZGJATJEVE SIPAS FORTËSISË

Të gjitha zgjatjet nuk janë të një niveli. Disa janë më të forta e disa të tjera më të buta. Pra, kur në të njëjtën rrokje kemi dy zgjatje, atëherë ajo që është më e fortë zbatohet, kurse më e dobëta eliminohet.

Në vazhdim do t'i rendisim të gjitha zgjatjet nga më e forta deri te më e dobëta:

- ✓ El-meddu el-lazim - الْمُدُّ الْلاَزِمُ
- ✓ El-meddu el-muttasil - الْمُدُّ الْمُتَّصِلُ
- ✓ El-meddu el-arid lis-sukun - الْمُدُّ الْعَارِضُ لِلْسُّكُونِ
- ✓ El-meddu el-munfasil - الْمُدُّ الْمُتَفَصِّلُ
- ✓ Medul el-bedel - مَدُّ الْبَدَلِ

Ekspertët e texhvidit shprehen se shkak i një renditje të tillë lidhet me shkakun e zgjatjes. Aq sa është i qëndrueshëm shkak, aq i është dhënë përparësi zgjatjes.

Medet tjera nuk janë renditur sepse ato nuk mund të ndeshen me ndonjë zgjatje tjetër.

1. Ndeshja e dy zgjatjeve në një rrokje të vetme

Në vijim do të paraqesim një sërë zgjatjesh të cilat ballafaqohen njëra me tjetrën në të njëjtën rrokje, ku si pasojë merret në konsideratë vetëm njëra, gjegjësisht më e forta, p.sh.:

- ♦ te fjala **عَامِينَ** ndeshet *meddul-bedel* dhe me *meddul-lazim*. Zgjatja në rastin në fjalë llogaritet *meddul-lazim*, sepse ky është më i fortë se *meddul-bedeli*;
- ♦ te fjalët **بُرْعَاء** dhe **رَنَاء** ndeshet *meddul-bedel* dhe *meddul-muttasil*, por vetë zgjatja llogaritet *meddul-muttasil* sepse është më i fuqishëm se *meddul-bedel*;

- ♦ te fjalët **إِسْرَائِيلَ** dhe **يُرْأُونَ**, kur ndalemi, ndeshet *meddul-bedel* dhe *el-meddu el-arid lis-sukun*, mirëpo këtu llogaritet *el-meddu el-arid lis-sukun* sepse është më e fuqishme;
- ♦ te shembujt **جَاءُوا آبَاهُمْ** dhe **رَعَا أَيْدِيَهُمْ** ndeshet gjithashtu *meddul-bedel* me *el-meddul-munfasil*, por për shkak të epërsisë llogaritet *el-meddul-munfasil*;
- ♦ te fjalët **السَّمَاءِ**, **جِيءَ** e të ngjashme, kur ndalemi ndeshet *el-meddu el-muttasil* dhe *el-meddu el-arid lis-sukun*. Te shembujt e këtillë ka përparësi *meddul-muttasil*.

Ibrahim Semnudi, ekspert i disiplinës së texhvidit, renditjen e cituar më lartë të zgjatjeve e thur në poezi:

Zgjatja më e fortë është lazimi e muttasili	أَقْوَى الْمُؤَدِّ: لَا زِمٌ، فَمَا اتَّصَلَ
pastaj vjen aridi, munfasili e bedeli.	فَعَارِضٌ، فَذُو انْفِصَالٍ، فَبَدَلٌ
Kur dy sebepe në një vend takohen	وَسَبَبًا مَدًّا إِذَا مَا وَجِدَا
Më i forti i tyre aty përcaktohet.	فَإِنْ أَقْوَى السَّبَبَيْنِ انْفَرَدَا

2. Raporti i dy zgjatjeve në vende të ndryshme

Gjatë leximit të Kur'anit e kemi edhe dukurinë e ballafaqimit të dy apo më shumë zgjatjeve gjatë një leximi, por tani jo në të njëjtën rrokje por në vende të ndryshme. Këto nuk e eliminojnë njëra-tjetrën, por i imponojnë gjatësi të caktuar. Gjithashtu, duhet kuptuar se ky parim vlen për zgjatjet të cilat kanë më shumë se një alternativë të gjatësisë, p.sh.:

- ♦ *Medu arid lis-sukun me meddu lin*, p.sh.:

﴿قَالَ ءَامَنْتُمْ لَهُ قَبْلَ أَنْ ءَاذَنَ لَكُمْ إِنَّهُ لَكَبِيرُكُمُ الَّذِي عَلَّمَكُمُ السِّحْرَ فَلَسَوْفَ تَعْلَمُونَ
لَأَقْطَعَنَّ أَيْدِيَكُمْ وَأَرْجُلَكُمْ مِمَّنْ خَلَفَ وَلَا صَلْبَتَكُمْ أَجْمَعِينَ ﴿٥١﴾ قَالُوا لَا صَبْرَ

Nëse ndalemi te fjala **أَجْمَعِينَ** me dy nota, atëherë domosdo duhet ndalur edhe te **صَبْرَ** me dy nota, kuptohet nëse ndalemi. Nëse tek e para ndalemi me katër, atëherë te e dyta mund të ndalemi me

katër për t'i barazuar ose me dy, por assesi me më shumë se katër. Nëse e para zgjatet gjashtë nota, atëherë e dyta mund të zgjatet gjashtë për t'i barazuar, ose më pak. Pra, ose zgjaten njësoj, ose medu aridi më shumë e medu lini më pak.

- ♦ *Medu muttasil me medu munfasil, p.sh.:*

﴿وَالسَّمَاءِ وَالطَّارِقِ ۚ وَمَا أَدْرَاكَ مَا الطَّارِقُ ۚ﴾

Nëse e zgjasim të parën (muttasilin) katër nota, atëherë të dytën (munfasilin) mund ta zgjasim vetëm dy ose katër nota, assesi pesë ose gjashtë. Nëse të parën e zgjasim gjashtë, atëherë e dyta mund të zgjatet dy katër apo gjashtë. Çdoherë e dyta (më e dobëta) duhet të jetë njësoj si e para, ose më e shkurtër.

- ♦ *Meddu el-lin me el-meddu el-arid lis-sukun, p.sh.:*

﴿الْم ۚ ذَٰلِكَ الْكِتَابُ لَا رَيْبَ فِيهِ هُدًى لِّلْمُتَّقِينَ﴾

Nëse fjala (رَيْبَ) zgjatet dy nota, e dyta mund të zgjatet dy, katër apo gjashtë, por, nëse e para zgjatet katër, atëherë e dyta zgjatet katër dhe gjashtë nota; dhe nëse e para zgjatet gjashtë, atëherë edhe e dyta zgjatet vetëm gjashtë.

Vini re: zgjatja e dobët duhet të zgjatet më pak se zgjatja e fortë ose njësoj sa ajo, assesi më shumë.

Pyetje:

- Trego renditjen e zgjatjeve nga më e forta te më e dobëta!
- Përse disa zgjatje janë më të forta?
- Jep shembull kur dy zgjatje vijnë në të njëjtin vend!
- Sa zgjatet zgjatja e dobët vjen para të fortës?
- Sa zgjatet zgjatja e fortë kur vjen para të dobëtës?

KREU VII

NDRYSHIMET TINGULLORE



- Rregullat e nunsakinit dhe tenvinit
- Rregullat e mimsakinit
- Shkrirjet (idgamet) tjera

RREGULLAT E NUNSAKINIT (ن) DHE TENVINIT (ت) السَّكِنَةُ وَالْتَّنْوِينُ

Nunsakini dhe tenvini janë shkaktarë për një mori rregullash të texhvidit. Pra, rregullat e nunsakinit dhe tenvinit janë pesë sojesh, varësisht nga shkronja që vjen pas tyre:

1. *El-idgamu meal-gunneh* - الإِدْغَامُ مَعَ الْغُنَّةِ (shkrirje hundore);
2. *El-idgamu bila gunneh* - الإِدْغَامُ بِلَا غُنَّةٍ (shkrirje johundore);
3. *El-idh'har* - الإِطْهَارُ (shqiptimi i qartë);
4. *El-iklab* - الإِفْلَافُ (tjetërsimi);
5. *El-ihfa* - الإِخْفَاءُ (fshehja).

1. EL-IDH'HAR - الإِظْهَارُ

Kjo teknikë leximi e trajton *shqiptimin e pastër*. Quhet e tillë për shkak të shmangies së mbajtjes apo shkrirjes, prandaj dhe është teknika themelore në grupin e teknikave që dalin nga nunsakini dhe tenvini.

Kur pas *nunsakinit* ose *tenvinit* vjen njëra prej këtyre gjashtë shkronjave (ا، ع، غ، ح، خ، هـ), atëherë nunsakini apo tenvini shqiptohet qartë, nuk shkrihet dhe as nuk mbahet.

Kjo teknikë ndryshe quhet edhe *el-idh'har el-halkij* الإِظْهَارُ الْحَلْقِيّ (shqiptim i pastër grykor), sepse të gjashtë shkronjat që i përkasin kësaj teknike të leximit të Kur'anit, gjegjësisht (ا، ع، غ، ح، خ، هـ), vendartikulim e kanë grykën apo fytin.

Shembuj:

	me nunsakin (نْ)	me tenvitet		
		(ـْ)	(ـِ)	(ـَ)
ا	﴿إِنْ أَرَدْنَا﴾	﴿مُهَاجِرٌ إِلَى رَبِّي﴾	﴿أَيَّامٍ أُخَرَ﴾	﴿كُفُّوا أَعْدَاءَ﴾
ع	﴿أَنْعَمْتَ﴾	﴿عَذَابٌ عَظِيمٌ﴾	﴿يَوْمٍ عَظِيمٍ﴾	﴿أَجْرًا عَظِيمًا﴾
غ	﴿مِنْ غِلٍّ﴾	﴿عَذَابٌ غَلِيظٌ﴾	﴿عَذَابٌ غَلِيظٌ﴾	﴿مِيثَاقًا غَلِيظًا﴾
ح	﴿وَتَنْجُونَ﴾	﴿خَيْرٌ حَسَنٌ﴾	﴿حَكِيمٌ حَمِيدٌ﴾	﴿عَزِيزًا حَكِيمًا﴾
خ	﴿وَالْمُنْخَنِقَةُ﴾	﴿لَطِيفٌ خَبِيرٌ﴾	﴿كَلِمَةٍ خَبِيثَةٍ﴾	﴿لَطِيفًا خَبِيرًا﴾
هـ	﴿أَتَنْهِنَّا﴾	﴿سَلَامٌ هِيَ﴾	﴿قَوْمٍ هَادٍ﴾	﴿فَرِيقًا هَدَى﴾

Nga shembujt e cituar më lart, kuptojmë se nunsakini me ndonjëren nga shkronjat e idhharit mund të paraqiten të ndara në dy fjalë si p.sh. ﴿مِنْ خَيْرٍ﴾ apo bashkërisht në të njëjtën fjalë vetme, si p.sh. ﴿وَالْمُنْخَنِقَةُ﴾ etj.

Tenvini apo nunsakini te këto gjashtë shkronja nuk shkrihet (nuk bëhen igdam) dhe as nuk fshihen në hundë (nuk bëhen ihfa), sepse këto gjashtë shkronja janë grykore dhe nuk kanë afërsi shqiptimi me bashkëtingëlloren N. Këto gjashtë shkronja vendartikulim e kanë fytin, kurse N-ja e ka pjesën e përparme të gjuhës. Pra, arsyeja e idh'harit (shqiptimit të pastër të nunsakinit dhe tenvinit) para gjashtë shkronjave të thëna më lartë është distanca e largët mes vendartikulimit të N-së dhe vendartikulimeve të shkronjave të idh'harit.

Gjithashtu, *nunsakini* shqiptohet pastër edhe në këto raste përjashtuese nga rregulli i përgjithshëm:

- *Nunsakini* shqiptohet pastër kur vjen me V dhe J në një fjalë të vetme, p.sh. (صَنَوَانٌ ، فَنَوَانٌ ، بُنَيَانٌ ، الدُّنْيَا). Këto janë përjashtime nga *idgami mealgunneh* (shkrirja hundore), sepse vijnë në një fjalë. Ndryshe ky përjashtim quhet إِطْهَارٌ مُطْلَقٌ *shqiptim i pastër absolut*.
- Në suren Jasin ﴿يَسْ وَالْقُرْءَانَ الْحَكِيمِ﴾, kur lidhet ajeti i parë me të dytin, d.m.th. fundi i ajetit të parë përfundon me *nunsakin* (نُنْ), i cili nuk duket, pastaj në ajetin e dytë vjen bashkëtingëllorja وَ. Këtu teorikisht plotësohen kushtet për *igdam mealgunneh*, por praktikisht *nuni* bëhet *idh'har* (sipas rivajetit të Hafsit).
- Në suren Nun ﴿ن وَالْقَلَمِ وَمَا يَسْطُرُونَ﴾. Kur shqiptohet shkronja e parë, në fund del *nunsakini* (نُنْ), kurse pas tij vjen bashkëtingëllorja وَ. Edhe këtu teorikisht plotësohen kushtet për *igdam mealgunneh*, por praktikisht *nuni* bëhet *idh'har*.
Këto dy raste quhen edhe إِطْهَارٌ رَوَائِيٌّ - *shqiptimi i pastër i rivajetit*.¹⁰³
- Në suren Kijameh ﴿وَقِيلَ مَن رَّاقٍ﴾. Këtu teorikisht *nunsakini* (نُنْ) duhet të shkrihet në R (ر), por praktikisht shqiptohet pastër në cilësinë e *sektes*.

¹⁰³ Shqiptimi i pastër në suren Jasin dhe në suren Nun quhet edhe إِطْهَارٌ رَوَائِيٌّ *shqiptim i pastër i një rivajeti*, sepse i tillë është vetëm në rivajetin e Hafsit, sipas rrugës së Shatibiut, kurse disa lexime, rivajete dhe rrugë të tjera e bëjnë edhe *idgam*.

Gjatë realizimit të idh'harit (shqiptimit të qartë) duhet bërë kujdes ndaj disa gabimeve të mundshme. Shpeshherë lexuesit jo profesionistë duke u përpjekur ta shqiptojnë drejt idh'harin, e theksojnë aq shumë N-në sa që u del si kalkale, d.m.th. duhet pasur kujdes mos artikulohet tingulli Ë pas tingullit të qartë N.

Pyetje:

- Çfarë do të thotë fjala idh'har?
- Si bëhet idh'hari?
- Si quhet ndryshe idh'hari?
- Cilat janë rastet kur idh'hari bëhet në formë jo të rregullt?
- Silli katër shembuj të idh'harit!

2. EL-IDGAM MEALGUNNEH – الْإِدْغَامُ مَعَ الْغُنَّةِ

El-Idgam mealgunneh do të thotë *shkriren hundore*, sepse realizohet (shkrihet dhe mbahet) në pjesën e brendshme të hundës.

Kjo realizohet kur pas nunsakinit ose tenvinit vjen njëra prej këtyre katër shkronjave (ي، ن، م، و) në fillim të fjalës tjetër, atëherë nunsakini apo tenvini shkrihen në njëren prej këtyre shkronjave, kurse shkronjat në fjalë dyfishohen dhe mbahen dy nota.

Shkronjat e kësaj teknike përmbliidhen në togun (يُنْمُو).

Shembuj:

	me nunsakin (نْ)	me tenvitet		
		(ـَ)	(ـِ)	(ـُ)
ي	﴿فَمَنْ يَعْمَلْ﴾	﴿وَبَرِّقْ يَجْعَلُونَ﴾	﴿لَقَوْمٍ يَتَفَكَّرُونَ﴾	﴿عَيْنًا يَشْرَبُ﴾
ن	﴿مِنْ نَذِيرٍ﴾	﴿حِطَّةً نَعْفِرُ﴾	﴿يَوْمَئِذٍ نَاعِمَةٌ﴾	﴿نُورًا نَهْدِي﴾
م	﴿مِنْ مَّارِجٍ﴾	﴿قَوْلٌ مَّعْرُوفٌ﴾	﴿صِرَاطٍ مُسْتَقِيمٍ﴾	﴿فَتْحًا مُبِينًا﴾
و	﴿مِنْ وَلِيٍّ﴾	﴿إِلَٰهٌ وَاحِدٌ﴾	﴿وَلِكُلِّ وِجْهَةٍ﴾	﴿مُبَشِّرًا وَنَذِيرًا﴾

Idgam mealgunneh (shkrija hundore) realizohet edhe te shkronjat alfabetike në fillim të disa sureve, gjegjësisht në ajetin e parë të sures Shuara ﴿طَسَمَ﴾, e cila zbërthehet kështu ﴿طَا سَيْن مِيم﴾.

Për t'u realizuar shkrija hundore (idgam mealgunneh) kushtëzohet që tenvini apo nunsakini të vijë në fund të njëres fjalë, kurse ndonjëra prej shkronjave (ي، ن، م، و) në fillim të fjalës tjetër. Nëse vijnë në një fjalë, atëherë nuk realizohet ky rregull, si p.sh. (صُنُوتٌ , قِنُونٌ , بُنْيَانٌ , الدُّنْيَا). Pra, kur vijnë në një fjalë, atëherë *nunsakini* shqiptohet pastër dhe nuk realizohet shkrija. Ky shqiptim i pastër quhet *إِطْهَارٌ مُطْلَقٌ shqiptim i pastër absolut*.

Në katër shembujt e cituar më lartë përjashtohet shkrija, ngase realizimi i saj i prek shkronjat rrënjësore të fjalës dhe kështu ajo e humb mëvetësinë kuptimore dhe strukturore.

Po ashtu, idgami mealguneh (shkrija hundore) nuk realizohet edhe në fillim të sures Jasin ﴿يَسَّ وَالْقُرْآنِ الْحَكِيمِ﴾ dhe në fillim të sures Nun ﴿نَّ وَالْقَلَمِ وَمَا يَسْطُرُونَ﴾. Këto ndryshe quhen edhe *إِطْهَارُ رَوَايَةٍ* *shqiptim i pastër i një rivajeti*.¹⁰⁴

Pyetje:

- ❦ Çfarë është idgami mealguneh?
- ❦ Si bëhet idgami mealguneh?
- ❦ Cili tog i përmbledh shkronjat e idgam mealgunnes?
- ❦ Çfarë është idh'hari rivajeh?
- ❦ Trego pesë shembuj me idgam mealguneh nga Kur'ani!

¹⁰⁴ Sipas rivajetit të Hafsit dhe rrugës së Shatibiut nuk shkrihet por shqiptohet pastër, ndërsa sipas disa leximeve, rivajeteve dhe rrugëve të tjera ajo shkrihet.

3. EL-IDGAM BILA GUNNEH – الْإِدْغَامُ بِلَا غُنَّةٍ

El-idgam bila gunneh do të thotë *shkrirjen johundore*, sepse shkrirja nuk bëhet me hundë dhe nuk mbahet.

Nëse pas *nunsakinit* ose *tenvinit* vjen njëra prej këtyre dy shkronjave (ج, د), atëherë nunsakini apo tenvini shkrihen në njërën prej këtyre shkronjave, kurse shkronjat në fjalë dyfishohen dhe shkrihen plotësisht në njëra-tjetrën pa mos u mbajtur aspak.

Shembuj:

	me nunsakin (نْ)	me tenvitet		
		(ـَ)	(ـِ)	(ـِ)
ل	﴿فَمَنْ لَمْ يَحْذَ﴾	﴿حَفِظْتُ لِلْغَيْبِ﴾	﴿هُمَزَةٌ لَمْزَةٌ﴾	﴿خَيْرًا لَهُمْ﴾
ر	﴿مِنْ رَبِّهِمْ﴾	﴿عَفُورٌ رَحِيمٌ﴾	﴿عِيشَةٍ رَاضِيَةٍ﴾	﴿تَوَابًا رَحِيمًا﴾

Nga ky rregull i përgjithshëm përjashtohet vetëm një shembull, dhe atë në suren el-Kijameh, ajeti 27: ﴿وَقِيلَ مَنْ رَاقٍ﴾. Këtu teorikisht *nunsakini* (نْ) duhet të shkrihet në R (ر), por praktikisht shqiptohet pastër në cilësinë e *sektes*.

Pyetje:

- ❖ Çfarë do të thotë idgam bila gunneh?
- ❖ Si bëhet idgam bila gunneh?
- ❖ Në cilën dhe tek cila fjalë nuk bëhet idgam bila gunneh?
- ❖ Jepi tre shembuj me idgam bila gunneh!

4. EL-IKLAB - الْإِقْلَابُ

Në aspektin etimologjik fjala arabe *iklab* (إِقْلَابٌ) do të thotë *shndërrim* apo *tjetërsim*, kurse në aspektin terminologjik nënkupton rregullin kur pas *nunsakinit* ose *tenvinit* vjen shkronja B (ب), atëherë *nunsakini* apo *tenvini* shndërrohet në M (م) të fshehur dhe mbahet dy nota.

Shembuj:

me nunsakin (ن)	me tenvitet		
	(ـَ)	(ـِ)	(ـُ)
﴿مِنْ بَعْدِ﴾	﴿سَمِيعٌ بَصِيرٌ﴾	﴿نَفْسٍ بِمَا﴾	﴿شَهِيدًا بَيْنِي﴾
﴿أَنْبِيَاءَ﴾	﴿حِكْمَةً بِلِغَةٍ﴾	﴿قُرَيْبَةٍ بِطَرْتِ﴾	﴿خَبِيرًا بَصِيرًا﴾
﴿مِنْ بَقْلِهَا﴾	﴿وَتَفَاخُرٍ بَيْنَكُمْ﴾	﴿مَكَانٍ بَعِيدٍ﴾	﴿رَجْمًا بِالْغَيْبِ﴾
﴿سُنْبُلَاتِ﴾	﴿عَوَانٍ بَيْنَ﴾	﴿زَوْجٍ بِهِجٍ﴾	﴿وَبَرًّا بِوَالِدَيْهِ﴾
﴿يَتَّبِعِي﴾	﴿صُمٌّ بُكْمٌ﴾	﴿ضَلَالٍ بَعِيدٍ﴾	﴿قَوْمًا بُورًا﴾

Siç shihet në shembujt e dhënë më lartë, iklabi mund të realizohet në një fjalë të vetme dhe në dy fjalë ndarazi, gjegjësisht në fund të fjalës së parë vjen nunsakimi apo tenvini, ndërsa në fillim të fjalës së dytë vjen shkronja B.

Për artikulum të drejtë të *mimit* të iklabit, apo siç njihet ndryshe në shkencën e texhvidi edhe si المِيمُ الْمُخْفَاءُ *mimi i fshehur*, duhet pasur parasysh këto gjëra:

- N-ja të shndërrohet plotësisht në M, sepse disa e artikulojnë të ngjashme me ihfanë.
- Buza e epërme e prek lehtë buzën e poshtme, d.m.th. duhet pasur kujdes që mos krijohet hapësirë mes buzave, por as të mos bashkohen fort ato.

- Mbajtja hundore që del nga iklabi duhet të marrë cilësinë e M-së dhe jo të N-së.
- Të mos zgjatet zanorja para iklabit, sepse atëherë dalin I, U dhe A e gjatë, p.sh. nga fjala مِنْ بَعْدِ mos del مِنْ بَعْدِ apo nga مَنْ بَعْدَنَا mos dalë مَنْ بَعْدَنَا.

Pyetje:

- ❧ Çfarë do të thotë fjala el-iklab?
- ❧ Si bëhet el-iklabi?
- ❧ Trego mënyrën e artikulimit të M-së!
- ❧ Jep katër shembuj me el-iklab!

5. EL-IHFA' - الْإِخْفَاءُ

Fjala Ihfa në aspektin gjuhësor do të thotë fshehje apo mbajtje (përmes hundës), kurse në terminologjinë e disiplinës së texhvidit nënkupton kur pas *nunsakin* ose *tenvin* vjen njëra prej këtyre pesëmbëdhjetë shkronjave (ت, ث, ج, د, ذ, ز, س, ش, ص, ض, ط, ظ, ف, ق, ك), atëherë nunsakini apo tenvini fshihet me hundë dhe mbahet dy nota.

	<i>me nunsakin</i> (نْ)	<i>me tenvin</i>		
		(ـَ)	(ـِ)	(ـُ)
ت	﴿إِنْ تَمَسَّكُمْ﴾	﴿وَجَنَّتْ تَجْرِي﴾	﴿غَلِي تَجْرِي﴾	﴿يَوْمًا تُرْجَعُونَ﴾
ث	﴿مَنْ ثَقُلَتْ﴾	﴿شِهَابٌ ثَاقِبٌ﴾	﴿تُرَابٍ ثُمٌ﴾	﴿يَوْمًا ثَقِيلًا﴾
ج	﴿مَنْ جَاءَ﴾	﴿عَيْنٌ جَارِيَةٌ﴾	﴿أُمَةٌ جَائِيَةٌ﴾	﴿صَبْرًا جَمِيلًا﴾
د	﴿مِنْ دُونِ﴾	﴿كَوْكَبٌ دُرِّيٌّ﴾	﴿وَلِكُلِّ دَرَجَةٍ﴾	﴿عَمَلًا دُونَ﴾
ذ	﴿مِنْ ذَهَبٍ﴾	﴿فَاعِلٌ ذَالِكِ﴾	﴿نَفْسٍ ذَائِقَةٍ﴾	﴿نَارًا ذَاتَ﴾
ز	﴿أُنْزِلَ﴾	﴿حَمِيدٌ ۝ زَعَمَ﴾	﴿فَنِكَهَتْ رَوْحَانَ﴾	﴿عُلَمَاءَ زَكِيًّا﴾
س	﴿مِنْ سَقَرِنَا﴾	﴿كَلِمَةً سَبَقَتْ﴾	﴿بِقَلْبٍ سَلِيمٍ﴾	﴿قَوْلًا سَدِيدًا﴾
ش	﴿مِنْ شَجَرَةٍ﴾	﴿غَفُورٌ شَكُورٌ﴾	﴿صَبَّارٍ شَكُورٍ﴾	﴿عَذَابًا شَدِيدًا﴾
ص	﴿يَنْصُرُكُمْ﴾	﴿رِجَالٌ صَدَقُوا﴾	﴿مَاءٍ صَدِيدٍ﴾	﴿قَوْمًا صَالِحِينَ﴾
ض	﴿مَنْصُودٍ﴾	﴿مُسْفِرَةٌ ۝ ضَاحِكَةٌ﴾	﴿لِكُلِّ ضِعْفٍ﴾	﴿مَكَانًا صَيِّقًا﴾
ط	﴿يَنْطِقُونَ﴾	﴿بَلَدَةٌ طَيِّبَةٌ﴾	﴿سَمَوَاتٍ طِبَاقًا﴾	﴿حَلَالًا طَيِّبًا﴾
ظ	﴿مَنْ ظَلَمَ﴾	﴿سَحَابٌ ظُلُمْتُ﴾	﴿نَفْسٍ ظَلَمَتْ﴾	﴿ظِلًّا ظَلِيلًا﴾
ف	﴿يُنْفِقُونَ﴾	﴿سُنَنٌ فَسِيرُوا﴾	﴿مُخْتَالٍ فَخُورٍ﴾	﴿يَتِيمًا فَتَاوًى﴾
ق	﴿فَيَنْقَلِبُوا﴾	﴿سَمِيعٌ قَرِيبٌ﴾	﴿أَجَلٍ قَرِيبٍ﴾	﴿مَكَانًا قَصِيًّا﴾
ك	﴿مِنْكُمْ﴾	﴿وَأَجْرٌ كَبِيرٌ﴾	﴿رُسُولٍ كَرِيمٍ﴾	﴿يَوْمًا كَانَ﴾

Shembujt e lartshënuar tregojnë se nunsakini dhe shkronjat e ihfasë mund të vijnë bashkërisht në të njëjtën fjalë, si p.sh. ﴿يُفْقُونَ﴾, por edhe të ndara në dy fjalë, si p.sh. ﴿كُنْ فَيَكُونُ﴾ etj.

Fshehja e nunit apo tenvit ka tre nivele kryesore:

1. Niveli më i lartë është te shkronjat *Ta* (ط), *Dal* (د) dhe *Te* (ت), sepse vendartikulimi i këtyre shkronjave është më afër vendartikulimit të N-së, prandaj këtu ihfaja është më e latë;
2. Niveli më i ulët është te shkronjat *Kaf* (ك) dhe *Kef* (ك), sepse këto shkronja formohen shumë larg vendartikulimit të N-së dhe shumë afër grykës ku formohen shkronjat e idh'harit, prandaj ihfaja këtu shqiptohet më lehtë.
3. Niveli mesatar është te dhjetë shkronjat e mbetura, sepse ato janë në largësi mesatare me vendartikulimin e N-së.

Gjatë fshehjes së N-së së ihfarë, qoftë kur është me sukun apo te tenvini, duhet vënë re këto veprime:


- Të mos zgjatet zanorja para N-së në vend të mbajtjes së saj: disa herë zgjatet (gabimisht) E-ja dhe të bëhet A e gjatë si p.sh. te fjala اَنْتُمْ (del اَنْتُمْ); ndonjëherë zgjatet U-ja, si p.sh. te fjala كُنْتُ (del كُونْتُ) dhe disa herë zgjatet I-ja si p.sh. te fjala مِئْتُمْ (del مِئْتُمْ).
- Të mos shkrihet vokali para N-së së ihfarë, sepse ndonjëherë U-ja shqiptohet (gabimisht) mes E-së dhe U-së, kurse I-ja mes I-së dhe E-së. Pra, të artikulohet qartë vokali para N-së.

Shkronjat e ihfasë janë tubuar në vargun vijues (shkronja e parë):

صِفْ ذَا نَنَا كَمْ جَادَ شَخْصٌ قَدْ سَمَا *** دُمْ طَيْبًا زِدْ فِي ثَقْيٍ ضَعْ ظَالِمًا

Pyetje:

- ❖ Çfarë do të thotë fjala el-ihfa?
- ❖ Si bëhet el-ihfa?
- ❖ Cilat janë nivelet e shkronjave të ihfasë?
- ❖ Thuaje vargun që i përmbledh të gjitha shkronjat e el-ihfasë!
- ❖ Trego pesë shembuj ku realizohet el-ihfa!



TENVINI DHE TINGULLI ME SUKUN

Përgjatë leximit të Kur'anit, në shumë raste lexuesi ballafaqohet me tenvinin i cili ndiqet nga një tingull me sukun. Kjo ndodh kur njëra fjalë përfundon me tenvin, kurse fjala vijuese fillon me sukun. Në këtë rast vijnë dy tinguj të pavokalizuar (me sukun) njëri pas tjetrit.¹⁰⁵ Gjuha arabe nuk i duron dy sukuna njëri pas tjetrit, prandaj tingulli i parë (pra N-ja me sukun) vokalizohet me zanoren kesre.

Në mus'hafët e botuar në Turqi është vendosur një NI (نِ) e vogël nën shkronjën me tenvin, për të na treguar se në këto raste duhet shtuar edhe një kesre tenvinit, kurse në mus'hafët e botuar në botën arabe nuk ka asnjë shenjë, pra i mbetet vetë lexuesit ta diktojë këtë rregull.

Në tabelën vijuese janë dhënë disa shembuj nga ky rregull:

MUS'HAFËT E ARABISË	MUS'HAFËT E TURQISË	MËNYRA E LEXIMIT
﴿يَوْمَئِذٍ الْحَقُّ﴾	﴿يَوْمَئِذٍ الْحَقُّ﴾	(يَوْمَئِذِ الْحَقُّ)
﴿جَمِيعًا الَّذِي﴾	﴿جَمِيعًا الَّذِي﴾	(جَمِيعِنِ الَّذِي)
﴿نُوحُ ابْنُهُ﴾	﴿نُوحُ ابْنُهُ﴾	(نُوحِنِ ابْنُهُ)
﴿عَذْنِ الْتِي﴾	﴿عَذْنِ الْتِي﴾	(عَذْنِ الْتِي)
﴿لَهُوَ أَنْفَضُوا﴾	﴿لَهُوَ أَنْفَضُوا﴾	(لَهُوَنِ أَنْفَضُوا)
﴿خَيْرُ أَطْمَانَ﴾	﴿خَيْرُ أَطْمَانَ﴾	(خَيْرِنِ أَطْمَانَ)

¹⁰⁵ Çdo tenvin ka një N me sukun (نِ) në fund, i cili shqiptohet, por nuk shkruhet.

Ky rregull vjen në shprehje edhe kur lidhen dy ajete, gjegjësisht kur fjala e fundit e ajetit të parë përfundon me tenvin dhe shkronja e parë e ajetit të dytë është me sukun, atëherë vlen i njëjti rregull, p.sh.:

SHKRUHET NË MUS'HAF	LEXOHET GJATË LIDHJES
﴿قُلْ هُوَ اللَّهُ أَحَدٌ ۝ اللَّهُ الصَّمَدُ﴾	(قُلْ هُوَ اللَّهُ أَحَدٌ لِلَّهِ الصَّمَدُ)
﴿وَيُلِّ لِكُلِّ هُمْزَةٍ لُّمَزَةٍ ۝ الَّذِي ﴾	(وَيُلِّ لِكُلِّ هُمْزَةٍ لُّمَزَتَيْنِ الَّذِي)
﴿وَهُوَ عَلَى كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ ۝ الَّذِي ﴾	(وَهُوَ عَلَى كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ الَّذِي)
﴿خَلَقَ الْإِنْسَانَ مِنْ عَلَقٍ ۝ اقْرَأْ وَرَبُّكَ الْأَكْرَمُ﴾	(خَلَقَ الْإِنْسَانَ مِنْ عَلَقَيْنِ اقْرَأْ وَرَبُّكَ الْأَكْرَمُ)

Në shembujt e këtillë nuk është i vendosur N me sukun (نْ) te mus'hafët e Turqisë, sepse në fund të ajeteve preferohet ndalja dhe jo vazhdimi.

RREGULLAT E M-së ME SUKUN (م) - أَحْكَامُ الْمِيمِ السَّكِينَةِ

Bashkëtingëllorja M (م) me sukun është shkaktar për disa rregulla të texhvidit, varësisht cila shkronjë vjen pas saj.

Rregullat që përftohen nga M-ja me sukun janë tre:

1. EL-IHFA ESH-SHEFEVIJ - الْإِحْفَاءُ الشَّفَوِيُّ

El-Ihfa esh-shefevij (*fshehja buzore*) vjen në shprehje kur pas bashkëtingëllores M me sukun (م) vjen shkronja B (ب), atëherë M-ja mbahet dy nota me buzë, p.sh.:

﴿جَاءَكُمْ بُرْهَنٌ﴾	﴿يُرْذُوكُمْ بَعْدَ﴾	﴿ءَامَنْتُمْ بِهِ﴾	﴿ذَالِكُمْ بَلَاءٌ﴾
----------------------	----------------------	--------------------	---------------------

Gjatë realizimit të këtij rregulli duhet kushtuar vëmendje që M-ja të mbahet mirëfilli dy nota, të mos del e turbullt apo të shfaqet si e fshehur në ndonjë tingull tjetër. Pra, ajo shqiptohet duke i mbyllur lehtë buzët dhe pa lënë hapësirë mes tyre.

Fshehja buzore ndodh për arsye se M-ja ndan vendartikulimin e njëjtë me B-në dhe kanë shumë veti të përbashkëta me njëra-tjetrën.¹⁰⁶

Pyetje:

- ❧ Çfarë do të thotë el-ihfa esh-shefevij?
- ❧ Si bëhet el-ihfa esh-shefevij?
- ❧ Si dhe sa mbahet M-ja te el-ihfa esh-shefevij?
- ❧ Trego katër shembuj nga el-ihfa esh-shefevij!

¹⁰⁶ Në disa lexime kjo teknikë nuk realizohet, d.m.th. M-ja nuk mbahet para B-së.

2. EL-IDGAM ESH-SHEFEVIJ – الْإِذْغَامُ الشَّفَوِيُّ

El-Idgam esh-shefevij (*shkrirje buzore*) vjen në shprehje kur pas bashkëtingëllores M me sukun (م) vjen përsëri një M tjetër (م), atëherë M-ja e parë shkrihet në të dytën dhe mbahet dy nota, p.sh.:

﴿وَمِنْهُمْ مَّنْ﴾	﴿كُنْتُمْ مُسْلِمِينَ﴾	﴿وَهُمْ مُّهْتَدُونَ﴾	﴿لَهُمْ مَغْفِرَةٌ﴾
--------------------	------------------------	-----------------------	---------------------

Gabimi që shpeshherë hetohet gjatë praktikës së këtij rregulli është se gjatë mbajtjes dëgjohen dy M-ja, bile disa herë vërehet edhe një ndarje apo lloj kërcimi nga njëra M tek tjetra. Pra, mbajtja e M-së duhet të realizohet si një bashkëtingëllore e vetme e dyfishuar, e cila çdoherë mbahet dy nota.

Ky tip i idgamit paraqitet edhe te shkronjat alfabetike në fillim të disa sureve, gjegjësisht te këta shembuj:

﴿التَّصَّ﴾	zbërthehet kështu:	(أَلِفٌ لَّامٌ مِيمٌ صَادٌ)
﴿الْتَرَّ﴾	zbërthehet kështu:	(أَلِفٌ لَّامٌ مِيمٌ رَّاءٌ)
﴿الْمَّ﴾	zbërthehet kështu:	(أَلِفٌ لَّامٌ مِيمٌ)

El-Idgam esh-shefevij mund të quhet edhe idgamul-mithlejn apo idgamul-mutemathilejn (shkrirja e dy shkronjave të njëjta).

Pyetje:

- Çfarë do të thotë el-idgam esh-shefevij?
- Si bëhet el-idgam esh-shefevij?
- A vjen ky rregull te shkronjat alfabetike dhe si?
- Jepni katër shembuj me el-idgam esh-shefevij!

3. EL-IDH'HAR ESH-SHEFEVIJ – الْإِظْهَارُ الشَّفَوِيُّ

El-Idh'har esh-shefevij do të thotë *shqiptim i pastër buzor*. Kjo teknikë bëhet kur pas tingullit M me sukun (م) vijjnë këto njëzet e gjashtë tinguj:

(أ، ت، ث، ج، ح، خ، د، ذ، ر، ز، س، ش، ص، ض، ط، ظ، ع، غ، ف، ق، ك، ل، ن، ه، و، ي)

Pra, siç shihet këtu bëjnë pjesë të gjitha shkronjat përveç M-së dhe B-së. Para këtyre shkronjave, M-ja me sukun shqiptohet pastër, qartë dhe nuk mbahet, p.sh.:

ا	﴿أَلَمْ أَقُلْ﴾	ز	﴿رَمَزَا﴾	ف	﴿وَهُمْ فِيهَا﴾
ت	﴿عَلِمْتُمْ﴾	س	﴿وَالشَّمْسِ﴾	ق	﴿أَنْتُمْ قَوْمٌ﴾
ث	﴿أَمْثَلِهَا﴾	ش	﴿خِفْتُمْ شِقَاقَ﴾	ك	﴿مَثَلُهُمْ كَمَثَلِ﴾
ج	﴿لَهُمْ جَنَّاتِ﴾	ص	﴿لَكُمْ صَيْدُ﴾	ل	﴿أَمْلِكُ﴾
ح	﴿يَمْحُوتِ﴾	ض	﴿أَمْضَى﴾	ن	﴿عَلِمْنَا﴾
خ	﴿لَهُمْ خَيْرٌ﴾	ط	﴿لَهُمْ طَرِيقًا﴾	ه	﴿لَهُمْ هَٰرُونَ﴾
د	﴿الْحَمْدُ﴾	ظ	﴿وَأَنْتُمْ ظَالِمُونَ﴾	و	﴿وَقُلُوبُهُمْ رَاجِلَةٌ﴾
ذ	﴿لَهُمْ ذِكْرًا﴾	ع	﴿وَلَهُمْ عَذَابٌ﴾	ي	﴿قُلْتُمْ يَأْمُوسَى﴾
ر	﴿أَمْرًا﴾	غ	﴿فَإِنَّهُمْ غَيْرُ﴾		

El-Idh'har esh-shefevij vjen në shprehje edhe te shkronjat alfabetike në fillim të sureve, të cilat kuptohen vetëm kur zbërthehen ashtu siç lexohen, si p.sh.:

﴿الْمَص﴾	zbërthehet kështu:	(أَلِفٌ لَامٌ مِيمٌ صَادٌ)
﴿الْمَر﴾	zbërthehet kështu:	(أَلِفٌ لَامٌ مِيمٌ رَا)
﴿الر﴾	zbërthehet kështu:	(أَلِفٌ لَامٌ رَا)

Po ashtu, ndonjëherë *el-idh'har esh-shefevij* vjen i kombinuar mes shkronjave alfabetike në fillim të sureve dhe pjesës vijuese, si p.sh.:

﴿حَمَّ ۝ وَالْكِتَابِ﴾	﴿حَمَّ ۝ تَنْزِيلِ﴾	﴿الْم ۝ غُلَبَاتِ﴾	﴿طَسَمَ ۝ تِلْكَ﴾
﴿حَمَّ ۝ عَسَقَ﴾	﴿الْم ۝ تَنْزِيلِ﴾	﴿الْم ۝ أَحْسِبَ﴾	﴿الْم ۝ ذَلِكَ﴾


El-Idh'har esh-shefevi (shqiptimi i pastër buzor) vjen në shprehje edhe gjatë ndaljes kur tingulli i fundit është bashkëtingëllorja M me sukun të përhershëm apo të përkohshëm. Pavarësisht se cila shkronjë vjen pas tingullit M (م), gjatë ndaljes (apo pushimit) zbatohet el-idh'har esh-shefevij, ndërsa nëse leximi vazhdohet, atëherë dispozitën e përcakton tingulli pasues, p.sh.:

﴿ثُمَّ لَتُسْأَلُنَّ يَوْمَئِذٍ عَنِ النَّعِيمِ﴾
 ﴿يَوْمَئِذٍ يَصُدُّرُ النَّاسُ أَشْتَاتًا لَّيُرَوْا أَعْمَلَهُمْ﴾

Gjithashtu, kujdes të veçantë duhet pasur kur pas M-së me sukun vjen bashkëtingëllorja Vavi (و) dhe F (ف), sepse këto dyja kanë vendartikulimin e njëjtë dhe të përafërt me M-në, prandaj duhet pasur kujdes mos fshihet M-ja në ndonjërin prej këtyre, p.sh. ﴿عَلَيْهِمْ وَلَا الضَّالِّينَ﴾, etj.. Veçanërisht duhet vënë re Vavi (و), sepse kjo është edhe më afërt me M-në, ngase ndajnë nëngrupin e njëjtë në venformimin e buzëve. Disa studiues bashkëkohorë idh'harin shefevij te këto dy shkronja e quajnë أَشَدُّ الْإِظْهَارِ *shqiptim i pastër më i theksuar*, mirëpo mjafton të bëhet idh'har i drejtë dhe me aq mbyllet.

Pyetje:

- ❧ Çfarë do të thotë el-idh'har esh-shefevij?
- ❧ Si bëhet el-idh'har esh-shefevij?
- ❧ Trego katër shembuj me el-idh'har esh-shefevij!
- ❧ Trego ku mund të paraqitet el-idh'har esh-shefevij!



IDGAMET TJERA

Krahas *shkrirjes hundore* (meal gunne), *johundore* (bila gunne) dhe *buzore* (shefevije), ekzistojnë edhe disa idgame tjera mes tingujve të gjuhës arabe, varësisht sipas afërsisë që kanë ata me njëri-tjetrin.

Fqinjësia e tingujve (sipas vendartikulimit)

- Idgam el-mutemathilejn (إِدْغَامُ الْمُتَمَاتِلَيْنِ)
- Idgam el-mutexhanisejn (إِدْغَامُ مُتَجَانِسَيْنِ)
- Idgam el-mutekaribejn (إِدْغَامُ الْمُتَقَارِبَيْنِ)
- El-Idgam el-kamil dhe en-nakis (الإِدْغَامُ الْكَامِلُ وَالنَّاقِصُ)
- El-mutebaidani (الْمُتَبَاعِدَانِ) Ky tip nuk është idgam, por tregon dy shkronja me vendartikulime të largëta që nuk shkrihen.

Fqinjësia e vokaleve

Krahas raportit mes dy shkronjave fqinje, shihen edhe zanoret e tyre, prandaj në varësi të zanoreve kjo fqinjësi ndahen në:

- *Fqinjësi e vogël* (الصَّغِيرُ): shkronja e parë është me sukun dhe e dyta me zanore. Këtu mund të fitohen këta tipa të fqinjësisë: تَمَاتِلٌ صَغِيرٌ (قُلْ أَعُوذُ بِتَبَاعُدٍ صَغِيرٍ, (قُلْ رَبِّي) تَقَارُبٌ صَغِيرٍ, (عَبْدُكُمْ) تَجَانُسٌ صَغِيرٍ, (إِذْ ذَهَبَ) تَمَاتِلٌ صَغِيرٌ). Idgamet hyjnë brenda këtij lloji.
- *Fqinjësi e madhe* (الْكَبِيرُ): nëse të dyja shkronjat janë me zanore, atëherë kemi fqinjësi të madhe. Këtu fitohen këta tipa të fqinjësisë: تَبَاعُدٌ (حَيْثُ تُؤْمَرُونَ) تَقَارُبٌ كَبِيرٌ, (الصَّالِحَاتِ طُوبَى) تَجَانُسٌ كَبِيرٌ, (فِيهِ هُدًى) تَمَاتِلٌ كَبِيرٌ. Ky tip i fqinjësisë nuk prodhon shkrirje, pos rrallë.
- *Fqinjësi absolute* (الْمُطْلَقُ): nëse shkronja e parë është me zanore, kurse e dyta me sukun. Këtu fitohen këta tipa të fqinjësisë: تَمَاتِلٌ (حَيْثُ) تَبَاعُدٌ مُطْلَقٌ, (يَسْتَتْنُونَ) تَقَارُبٌ مُطْلَقٌ, (تُدْرِكُهُ) تَجَانُسٌ مُطْلَقٌ, (صَلَّلْنَا) مُطْلَقٌ.

Fqinjësia e vogël tregon se mundësia e shkrirjes është shumë e madhe. *Fqinjësia e madhe* nënkupton se mundësia e shkrirjes është shumë e vogël dhe *fqinjësia absolute* tregon se shkrirja është e pamundur.

إِدْغَامُ الْمُتَمَاتِلَيْنِ – IDGAM EL-MUTEMATHILEJN

Idgam el-mutemathilejn do të thotë shkrirje e dy shkronjave plotësisht të njëjta, kurse në terminologjinë e texhvidit nënkupton: paraqitjen e dy shkronjave të njëjta njëra pranë tjetrës, e para me sukun dhe e dyta e vokalizuar, atëherë e para shkrihet në të dytën dhe quhet *idgam el-mutemathilejn*.

Ky rregull nuk ka bashkëtingëllore të caktuara, por mund të vijë çdo bashkëtingëllore. Pas shkrirjes së bashkëtingëllores së parë në të dytën, e dyta dyfishohet pa u mbajtur, përveç te shkronja N dhe M, pra, te këto dy të fundit duhet mbajtur me hundë dy nota.

Këta janë shembuj me *idgam el-mutemathilejn* për çdo shkronjë:

ب	﴿وَلَا يَغْتَبِ بَعْضُكُم بَعْضًا﴾، ﴿أَنْ أَضْرِبَ بِعَصَاكَ الْحَجَرَ﴾
ت	﴿فَمَا رِيحَتِ تَجَرَّتُهُمْ﴾، ﴿إِذَا طَلَعَتْ تَزْوُرُ عَنْ كَهْفِهِمْ﴾
ذ	﴿وَذَا الثُّونِ إِذْ ذَهَبَ مُغَضَّبًا﴾
ر	﴿وَأَذْكُرْ رَبَّكَ إِذَا نَسِيتَ﴾، ﴿وَأَذْكُرْ رَبَّكَ فِي نَفْسِكَ تَضَرَّعًا وَخِيفَةً﴾
ع	﴿مَا لَمْ تَسْتَطِعْ عَلَيْهِ صَبْرًا﴾، ﴿مَا لَمْ تَسْطِعْ عَلَيْهِ صَبْرًا﴾
ف	﴿فَلَا يُسْرِفَ فِي الْقَتْلِ﴾
ك	﴿أَيْنَمَا تَكُونُوا يُدْرِكْكُمُ الْمَوْتُ﴾
ل	﴿قُلْ لَا أَسْأَلُكُمْ عَلَيْهِ أَجْرًا﴾، ﴿فَلَا تَقُلْ لَهُمَا أُفٍ﴾
م	﴿وَأَنْتُمْ مُعْرِضُونَ﴾، ﴿إِنَّا مَعَكُمْ مُسْتَمِعُونَ﴾، ﴿فَلَمَّا جَاءَهُمْ مُوسَى﴾
ن	﴿إِنْ نَسِينَا﴾، ﴿وَإِنَّا لَنْ نَدْخُلَهَا﴾، ﴿فَمَا لِلظَّالِمِينَ مِنْ نَصِيرٍ﴾
و	﴿أَوْ زُرْتُمُوهُمْ﴾، ﴿وَتَوَلَّوْا رُءُوسَهُمْ﴾، ﴿ذَلِكَ بِمَا عَصَوْا وَكَانُوا يَعْتَدُونَ﴾
ه	﴿يُوجِّهُهُ﴾، ﴿يُكْرِهُهُمْ﴾
ي	﴿بِأَيِّكُمْ﴾

Nga *idgam el-mutemathilejni* (shkrrirja e dy tingujve të njëjtë) përjash-tohen shembujt vijues dhe shumë shembuj të tjerë:

﴿فَعَلُوا وَهُمْ﴾	﴿تَفْعَلُوا وَلَنْ﴾	﴿قُولُوا وَجُوهَكُمْ﴾	﴿وَكُلُوا وَاشْرَبُوا﴾
﴿الَّذِي يُحْيِي﴾	﴿لِعِبَادِي يَقُولُوا﴾	﴿رَبِّي يَعْلَمُ﴾	﴿فِي يُوسُفَ﴾

Në këto raste shmanget idgami për shkak të zgjatjes, sepse realisht nuk bëhet fjalë për *vav* dhe *ja*, por për dy zanore të gjata.

Kjo teknikë e leximit të Kur'anit shpesh quhet edhe *إِدْغَامُ الْمُثَلَّيْنِ*, me kuptim të njëjtë, *shkrrirje e dy shkronjave krejt të njëjta*.

Pyetje:

- ❧ Çfarë do të thotë idgam el-mutemathilejn?
- ❧ Si bëhet idgam el-mutemathilejn?
- ❧ Cilat shkronja të idgam el-mutemathilejn mbahen?
- ❧ Si quhet ndryshe idgami el-mutemathilejn?
- ❧ Kur nuk bëhet idgami el-mutemathilejn?
- ❧ Trego katër shembuj me idgam el-mutemathilejn!

IDGAM EL-MUTEXHANISEJN – إِدْغَامُ الْمُتَجَانِسَيْنِ

Idgam el-mutexhanisejn do të thotë *shkrija e dy shkronjave të një vendartikulimi*. Kur dy shkronja të një vendartikulimi paraqiten pranë njëra-tjetrës, e para me sukun dhe e dyta me hareke, atëherë e para shkrihet në të dytën, kurse e dyta dyfishohet pa u mbajtur.

Në kiraetin e Asimit kjo shkrije bëhet mes këtyre shkronjave të kategorizuara në tri grupe:

I	د ↔ ت ← ط	﴿أُجِيبَتْ دَعْوَتُكُمَا﴾	﴿وَقَالَتْ طَافِقَةُ﴾	﴿عَبْدَتُمْ﴾
II	ث ← ذ ← ظ	﴿يَلْهَثُ ذَلِكَ﴾	﴿إِذْ ظَلَمُوا﴾	﴿إِذْ ظَلَمْتُمْ﴾
III	ب ← م	﴿يَبْقَىٰ أَرْكَبٌ مَّعَنَا﴾		

Nga grupi i tretë është vetëm një shembull në gjithë Kur'anin, në ajetin 42 të sures Hud.

Kjo shkrije bëhet vetëm duke e dyfishuar shkronjën e dytë, pa e mbajtur apo fshehur.

Pyetje:

- ❖ Çfarë do të thotë idgam el-mutexhanisejn?
- ❖ Si bëhet idgam el-mutexhanisejn?
- ❖ Cilat janë grupet e këtij idgami?
- ❖ Çfarë idgami bëhet këtu: i plotë apo i mangët?

IDGAM EL-MUTEKARIBEJN – إِدْغَامُ الْمُتَقَارِبَيْنِ

Idgam el-mutekaribejn do të thotë *shkrija e dy shkronjave të përafërta*. Kur dy shkronja mund të jenë të përafërta në vendartikulim, në veti apo në të dyja bashkërisht. Ku shkronja e parë është me sukun dhe e dyta me hareke, atëherë e para shkrihet në të dytën, kurse e dyta vetëm dyfishohet pa u mbajtur dy nota.

Në kiraetin e Asimit kjo shkrije bëhet mes shkronjave në vijim, të kategorizuara këto dy grupe:

I	ل ← ر	﴿بَلْ رَفَعَهُ اللَّهُ إِلَيْهِ﴾	﴿وَقُلْ رَبِّ أَرْحَمُهُمَا﴾	﴿بَلْ رَبُّكُمْ﴾
III	ق ← ك	﴿أَلَمْ تَخْلُقْهُمْ مِنْ مَّاءٍ مَّهِينٍ﴾		

Shembulli i cituar më parë në këtë grup është i vetëm në gjithë Kur'anin, pra vetëm në ajetin 20 të sures el-Murselat.

Dallimi mes shkronjave të *idgam el-mutexhanisejn* dhe *el-mutekaribejn* qëndron në vendartikulimin e shkronjave. Shkronjat e *mutexhanisejn* janë të një vendartikulimi (mahrexhi), kurse shkronjat e *mutekaribejn* nuk janë nga i njëjti vendartikulim, por janë të përafërta në vendartikulim, në veti apo në të dyja bashkërisht.

Pyetje:

- ❧ Çfarë do të thotë idgam el-mutekaribejn?
- ❧ Si dhe në cilat grupe bëhet idgam el-mutekaribejn?
- ❧ Trego tre shembuj me idgam el-mutekaribejn!
- ❧ Ku është dallimi mes idgam el-mutekaribejn dhe el-mutexhanisejn?

EL-IDGAM EL-KAMIL DHE EN-NAKIS – الْإِذْغَامُ الْكَامِلُ وَالنَّاقِصُ

Niveli i shkrirjes nuk është i njëjtë te të gjitha shkronjat e idgamit, prandaj shikuar nga ky aspekt, idgami ndahet në dy grupe: idgam kamil (shkrirje e plotë) dhe idgam nakis (shkrirje e mangët).

El-Idgam el-kamil (الْإِذْغَامُ الْكَامِلُ)

El-Idgam el-kamil do të thotë *shkrirje e plotë*. Kjo shkrirje ndodh kur shkronja e parë shkrihet tërësisht në shkronjën e dytë, pra shkronja e parë humb tërësisht dhe nuk mbetet as vetia e saj, kurse shkronja e dytë dyfishohet.

Ky rregull leximi ndryshe mund të quhet edhe *el-idgam et-tammu* (الْإِذْغَامُ التَّامُّ), e cila po ashtu do të thotë *shkrirje e plotë*.

Kjo teknikë leximi vjen në shprehje në këto raste:

- Te idgam bila gunne, p.sh. ﴿خَيْرٌ لَّكُمْ﴾, ﴿عَفْوٌ رَّحِيمٌ﴾, ﴿يَكُنْ لَهُ﴾, ﴿مِنْ رَّيْهِمْ﴾.

Të gjithë studiuesit njëzëri e pranojnë se kjo është shkrirje e plotë.

- Te një pjesë e idgam meal gunnes, gjegjësisht te shkronja N dhe M, p.sh. ﴿خَيْرٌ مَّقَامًا﴾, ﴿رَسُولًا نَبِيًّا﴾, ﴿وَإِنْ مِنْ﴾, ﴿أَنْ نَّعْبُدَ﴾ etj..

Këtë shkrirje e konsiderojnë të plotë vetëm një pjesë e studiuesve të kësaj fushe, kurse disa të tjerë e trajtojnë si shkrirje të mangët.

- Te idgam el-mutemathilejn, p.sh. ﴿أَضْرِبْ بَعْصَاكَ﴾, ﴿فَمَا زَالَتْ تِلْكَ﴾, ﴿وَأَذْكُرَّ رَبَّكَ﴾, ﴿إِذْ ذَّهَبَ﴾, ﴿يُذِرْكُمْ﴾ etj..
- Te idgam el-mutexhanisejn, p.sh. ﴿يَلْهَثَ ذَلِكَ﴾, ﴿شَهِدْتُمْ﴾, ﴿قَالَتْ طَائِفَةٌ﴾, ﴿أَرْكَبَ مَعَنَا﴾, ﴿إِذْ ظَلَمْتُمْ﴾, ﴿أُجِيبَتْ دَعْوُكُمَا﴾ etj..
- Te idgami el-mutekaribejn, p.sh. ﴿نَخْلُقْكُمْ﴾, ﴿وَقُلْ رَبِّ﴾.

Siç shihet në shembujt e lartshënuar, mbi shkronjën ku shkrihet tenvini, nunsakini apo një shkronjë tjetër, është vendosur një teshdid për të treguar se shkrirja është e plotë. Kjo finesë është e dallueshme vetëm te mus'hafet që janë të pajisur me shenjat e texhvidit.

El-Idgam en-nakis (الإِذْغَامُ النَّاقِصُ)

El-Idgam en-nakis do të thotë *shkrirje e mangët*. Kjo shkrirje realizohet kur shkronja e parë shkrihet pjesërisht, pra mëvetësia e shkronjës humb, kurse vetia e saj mbetet.

Kjo teknikë leximi vjen në shprehje në këto dy raste:

- Te idgam meal gunne, gjegjësisht vetëm te shkronja V dhe J, p.sh. ﴿إِلَٰهُ وَاحِدٌ﴾, ﴿أَنَاسٌ يَتَطَهَّرُونَ﴾, ﴿مِنْ وَرَائِكُمْ﴾, ﴿لَمَنْ يَرَى﴾ etj.. Pra, shkrirja e tenvinit apo nunsakinit te këto dy shkronja nuk është e plotë, sepse vetia hundore e nunit mbetet. Prandaj J-ja te fjala مَنْ يُقُولُ nuk nyjëtohet si te fjala قِيمٌ, ngase te rasti i parë kemi *idgam meal gunne* dhe ruhet vetia hundore e N-së së shkrirë, kurse te rasti i dytë thjesht kemi dyfishim të shkronjës J. Njëjtë janë edhe fjalët مِنْ وَائِي nga قُوَّةٌ.
- Te idgam mutexhanisejni, kur shkronja e fortë (ط) shkrihet në shkronjën e dobët (ت), p.sh. ﴿فَرَطْتُمْ﴾, ﴿أَحَطْتُ﴾, ﴿فَرَطْتُ﴾, ﴿بَسَطْتُ﴾. Këtu kemi shkrirje të mangët sepse shkronja e fortë (alveolare) nuk mund të hyjë tërësisht në shkronjën e dobët, prandaj shqiptimi i këtyre shembujve realizohet duke e shmangur kalkalen te (ط) dhe duke kaluar te shqiptimi i shkronjës (ت).

Siç shihet në shembujt e dhënë më lartë, mbi shkronjën në të cilën shkrihet tenvini, nuni me sukun apo shkronja (ط) nuk është vendosur teshdid për të treguar se shkrirja është e mangët. Ky element është i dallueshëm vetëm te mus'hafet që janë të pajisur me shenjat e texhvidit.

Pyetje:

- ❧ Çfarë është el-idgam el-kamil dhe en-nakis?
- ❧ Kur bëhet el-idgam el-kamil?
- ❧ Kur bëhet el-idgam en-nakis?
- ❧ Ku është dallimi mes këtyre dy tipave të idgami?

MIMI DHE NUNI TË DYFISHUARA – إِدْغَامُ الْمِيمِ وَالنُّونِ الْمَشْدَدَتَيْنِ

Tingujt në gjuhën arabe herë-herë paraqiten të dyfishuar me teshdid, por nuk e kanë të gjithë një dispozitë artikulimi, sepse kur tingulli M dhe N vijnë të dyfishuara, atëherë vjen në shprehje kjo dispozitë. Pra, kur M-ja dhe N-ja paraqiten të dyfishuara, atëherë mbahen dy nota, p.sh.

ن	﴿إِنَّمَا﴾, ﴿جَنَّةُ﴾, ﴿يَطْنُونَ﴾, ﴿ءَامَنَّا﴾, ﴿وَالصَّارِئِ﴾, ﴿إِنكُم﴾
م	﴿هَمَّاز﴾, ﴿فَأَمُّهُ﴾, ﴿فَأَمَّا﴾, ﴿نُسَمَى﴾, ﴿يُعَمَّر﴾, ﴿مِمَّا﴾, ﴿ثُمَّ﴾

Gjatë artikulimit të mimit dhe të nunit me sukun duhet vënë re të mos bëhet presion me ajrin në vendartikulimin e këtyre dy shkronjave, por të fshihen përmes hundës, sepse siç u potencua në vendartikulimin e hajshumit (nazofaringut), tingulli më i fuqishëm hundor është kur vjen i dyfishuar, sepse atëherë bashkohen dy tinguj hundorë, pastaj vijnë trajtat tjera.

Po ashtu, duhet spikatur faktin se *mimi* dhe *nuni* me teshdid mbahen dy nota me hundë edhe kur vijnë në fund, gjegjësisht kur janë tingulli i fundit tek i cili bëhet ndalesa apo pushimi.

Pyetje:

- A kanë të gjitha shkronjat e dyfishuara një dispozitë dhe pse?
- Çfarë dispozite ka M-ja dhe N-ja me teshdid?
- Çfarë duhet vënë re gjatë mbajtjes?
- Trego katër shembuj me M dhe me N të dyfishuar!

KREU VIII

PUSHIMI DHE FILLIMI



- Tipat e pushimit dhe të fillimit
- Sekteja
- Reumi dhe ishmami
- Shtatë elifat
- Shenjat e pushimit

NDALJA APO PUSHIMI - الْوُقُوفُ

Texhvidi është disiplinë shkencore e cila trajton në formë të detajuar edhe vendin, mënyrën dhe formën e ndaljes dhe fillimit të leximit të Kur'anit. Mungesa e shenjave të pikësimit, i ka hapur rrugën e zhvillimit të disiplinës së quajtur *disiplina e ndalimit dhe fillimit të leximit* عَلَّمَ الْوُقُوفَ الْإِبْتِدَاءَ.

Aq sa është i rëndësishëm zbatimi i zgjatjeve, shkrirjeve, mbajtjeve etj., po aq është e rëndësishme njohja e vendit dhe mënyrës së ndaljes dhe fillimit të leximit të Kur'anit.

Kjo teknikë leximi shumë pak zotërohet nga lexuesit e Kur'anit, prandaj edhe zbatimi i saj, krahas rregullave të tjera, është dukshëm i dobët.

Përvetësimi i kësaj teknike kërkon dy aftësi kryesore: a) njohjen e gjuhës (gramatikës) arabe dhe b) njohjen e transmetimeve që ndërliken me këtë problematikë.

Disa dijetarë shkencën e texhvidit e definojnë kështu "Njohjen e rregullave të shkronjave dhe parimet e ndaljes." Ky definicion e tregon vlerën e kësaj teknike të leximit, sepse ajo, në një mënyrë, e përbën gjysmën e kësaj discipline shkencore.

Ndalja gjatë leximit të Kur'anit mund të jetë në tri forma:

1. El-kat'u (الْقَطْعُ). Përmbyllje apo përfundim i një seance të leximit të Kur'anit për të mos vazhduar më andej.
Përmbyllja e leximit të Kur'anit bëhet në fund të sures apo në fund të ajetit. Edhe pse ndarja e një ajeti të gjatë në dy reqate është e lejueshme, përsëri më e preferuar është që, së paku, të përfundohet ajeti.
2. Es-sektetu (السَّكْتَةُ). Ndalje e leximit për afërsisht dy sekonda, pa marrë frymë, për të vazhduar pastaj përsëri atë;
3. El-vakfu (الْوُقُوفُ). Ndalje e leximit për një moment, për arsye të ndryshme, dhe vazhdimi përsëri me të njëjtën pas disa sekondash. Në vakf ndalemi dhe marrim frymë, kurse në sekte ndalemi dhe nuk marrim frymë, megjithatë, te të dyja leximi vazhdon përsëri.

Ndarja e fundit, vakfi, është objekt i studimit tonë në këtë pjesë, kurse sekten dhe kat'in do ta trajtojmë më vonë.

Ekspertët e rregullave të texhvidit, duke u bazuar në shkakun e ndaljes, kanë dalluar tre lloje kryesore të vakfit – pushimit:

1. الْوَقْفُ الْإِجْتِبَارِيُّ – Pushimi testues;
2. الْوَقْفُ الْإِضْطِرَّارِيُّ – Pushimi i imponuar;
3. الْوَقْفُ الْإِئْتِظَارِيُّ – Pushimi pritës; dhe
4. الْوَقْفُ الْإِخْتِيَارِيُّ – Pushimi i vullnetshëm – fakultativ;

Në vazhdim do ta trajtojmë secilin lloj të pushimit në vete, të ilustruar gjerësisht me shembuj.

1. PUSHIMI TESTUES – الْوَقْفُ الْإِخْتِيَارِيُّ

Ndalja testuese bëhet me kërkesë të mësuesit, për ta provuar lexuesin, nëse në një fjalë të caktuar ndalet në formën e duhur apo jo. Në pushimin testues, lexuesit i lejohet të ndalet në fund të çdo fjale në Kur'an, edhe aty ku nuk lejohet ndalja sepse bëhet për arsye studimi.

Pas ndaljes së këtij lloji, lexuesi mund të vazhdojë aty ku është ndaluar, por kushtëzohet që fjalia në vijim të ketë kuptim, e në të kundërtën duhet kthyer prapa nga ku plotësohet kuptimi i fjalisë.

Kjo teknikë zakonisht përdoret në fjalët që kanë disa forma të leximit dhe të të ndalurit, dhe në fjalët që përngajnë me standardin, por në realitet dallojnë gjatë ndaljes. Nga lexuesi kërkohet, nëse do ta zbatojë rregullin e duhur në fjalën e veçantë apo jo, p.sh.:

- ♦ zbatimi i *medul-ivedi* te fjalët هُنَّ dhe مَاءٌ, ku te kjo e fundit dikush ndalet gabimisht me *sukun* (مَاءٌ) e jo me elif të gjatë siç kërkohet (مَاءٌ);
- ♦ dallimi i T së rrumbullakët nga T e shtrirë në ndalje, p.sh. te fjala امْرَأَةٌ T-ja lexohet H kur ndalemi, kurse te fjala امْرَأَتٍ mbetet T;
- ♦ ndalja te shkronja R, e cila shpeshherë kur ndalemi lexohet lehtë, ndërsa kur vazhdojmë rëndë, apo anasjelltas. P.sh. fjala وَالْفَجْرِ në ndalje lexohet rëndë, kurse gjatë vazhdimit lehtë etj.;
- ♦ shqiptimi i disa shkronjave në fund të fjalës, si p.sh. shkronjat e kalkales, huruful hems (veçanërisht ك dhe ت), shqiptimi i zbehët i bashkëtingëllores H (ه) etj.;
- ♦ të ndalurit te fjala الْأَرْضُ për ta verifikuar shqiptimin e shkronjës ض, ku shpeshherë gabohet duke e shqiptuar fuqishëm, e cila në realitet duhet të shqiptohet duke i mbledhur buzët përpara, sikur të shpërthejë shqiptimi i D-së, por në fund lirohet pa zhurmë;

Shembuj të tillë ka shumë, por çdo mësues i Kur'anit i zgjedh vetë fjalët ku kërkon të ndalen nxënësit, dhe atë varësisht sipas nevojës.

Kjo ndërprerje është lejuar nga dijetarët e texhvidit.

2. PUSHIMI I IMPONUAR – الْوُقُوفُ الْإِضْطِرَّارِيُّ

Gjatë leximit të Kur'anit bëhen pushime të ndryshme. Ndërprerja e pavullnetshme e leximit të Kur'anit e cila bëhet si pasojë e kollitjes, harresës, teshtitjes, vjelljes, qarjes me dënësë, mbarimit të frymës apo të çfarëdo faktori tjetër të pavullnetshëm.

Ky lloj pushimi, njësoj si pushimi testues, është i pavullnetshëm dhe nuk është në dorë të lexuesit. Për dallim nga ndalimi paraprak (testues), ky pushim nuk është as në dorë të mësuesit, por ngjet si rezultat i shkaqeve të tjera të cituara më lartë.

Ky lloj ndalimi është i lejuar, sepse gjithçka që ndodh pa dëshirën e njeriut apo me harresë, sipas mësimave islame është krejtësisht e pranueshme dhe e pagjykuar. Vëmendja e ekspertëve të texhvidit në këtë lloj ndalimi është vënë në mënyrën se si ta vazhdojë leximin, dhe jo për ta gjykuar ndalimin, sepse ai është i pavullnetshëm.

Nëse lexuesi ndalet në krye të fjalisë ku plotësohet një kuptim i caktuar, atëherë nuk ka nevojë që të kthehet prapa, por vetëm vazhdon. E nëse ai ndalet pa e plotësuar kuptimin e fjalisë së nisur, atëherë kërkohet që të kthehet prapa për ta gjetur mundësinë më të afërt që i jep kuptim fjalisë. Pikërisht kjo e fundit, kur ndalemi në vendin e papërshtatshëm, quhet pushim i imponuar i cili kërkon të kthehemi për ta ndrequr fjalinë.

Sa u takon këtyre dy pushimeve (pushimit testues dhe të imponuar), disa ekspertë kanë numëruar edhe një lloj ndalimi tjetër i cili është i kombinuar prej këtyre dyve. Ai është *Ndalimi njoftues* apo *sqarues* – الْوُقُوفُ التَّعْرِيفِيُّ. Këtë tip ndalimi e bën mësuesi i Kur'anit, sepse ai detyrohet të ndalet për ta mësuar nxënësin.

3. PUSHIMI PRITËS – الْوَقْفُ الْإِنْتِظَارِيُّ

Ndalimi i cili bëhet për t'u kthyer dhe për t'i lexuar disa apo të gjitha versionet e mundshme të kiraeteve për atë fjalë quhet *ndalim pritës*. Quhet i tillë sepse lexuesi pret për të dëgjuar versionin tjetër të të njëjtit ajet, kurse lexuesi kthehet disa herë për ta përsëritur të njëjtën pjesë, por çdoherë prej aty ku leximi ka kuptim.

Zakonisht ky lloj leximi përdoret kur nxënësi lexon para mësuesit me disa apo me krejt kiraetet.

Ky lloj ndalimi është i lejuar nëse pushimi bëhet në vendin e duhur dhe fjalia ka kuptim, por nëse lexuesi joprofesional përpiqet të bëjë ndalime të këtilla, atëherë ka shumë gjasa që të gabojë, e sigurisht, atëherë ky veprim nuk është i lejuar.

Ja një shembull nga ky lloj i ndalimit, gjegjësisht i përsëritjes të së njëjtës pjesë disa herë:

Lexuesit	Trajtat leximore
Nafiu	﴿وَقَالَتَ هَيْتَ لَكَ﴾
Ebu Xhaferi	
Ibn Dhekvani nga Ibn Amiri	
Ibn Kethir	﴿وَقَالَتَ هَيْتُ لَكَ﴾
Hishami nga Ibn Amiri	﴿وَقَالَتَ هَيْتَ لَكَ﴾
Lexuesit e tjerë	﴿وَقَالَتَ هَيْتَ لَكَ﴾

4. PUSHIMI I VULLNETSHËM – الْوُقُوفُ الْإِخْتِيَارِيُّ

Pushimi me vetë dëshirë gjatë leximit të Kur'anit, pa kërkesë apo shtytje të jashtme, nënkupton pushimin e vullnetshëm apo fakultativ *el-vakf el-ihitijarij*.

Pasi ndalimi i vullnetshëm është i vetmi pushim i cili realizohet brenda rrjedhës normale të të lexuarit të Kur'anit, po ashtu, të bën të kuptosh se i vetmi lloj i pushimit i cili mund të përpunohet gjerësisht dhe të degëzohet.

Të ndalurit e vullnetshëm ndahet në pesë nënllaje:

4.1. Pushimi i plotësuar – الْوُقُوفُ التَّامُّ

El-vakfu et-tammu, pushim të plotësuar quajmë të ndalurit në fjalën kur'anore që nuk lidhet as gramatikisht (lidhje sintaksore) dhe as kuptimisht me tekstin pasues.

Ky përkufizim, siç duket më sipër, këtë lloj të të ndalurit e kushtëzon me shkëputje gramatikore dhe kuptimore të pjesës të cilën sapo e kemi mbaruar, me pjesën të cilën sapo do ta fillojmë pas pushimit të shkurtër.

El-vakfu et-tammu, pushimi i plotësuar mund të zbulohet lehtësisht përmes këtyre tri mënyrave:

1. **Në fund të sures.** Mbarimi i secilës sure përmbyll një tematikë të caktuar, prandaj edhe ndalimi aty përfaqëson *el-vakfu et-tammu* - dalimi e plotësuar. Në vazhdim do të sjellim vetëm tri shembuj prej tyre:

﴿لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ﴾	← Ndalim	﴿فَجَعَلَهُمْ كَعَصِفٍ مَّأْكُولٍ﴾
﴿إِذَا جَاءَ نَصْرُ اللَّهِ وَالْفَتْحُ﴾	← Ndalim	﴿لَكُمْ دِينُكُمْ وَلِيَ دِينِ﴾
﴿قُلْ أَعُوذُ بِرَبِّ الْفَلَقِ﴾	← Ndalim	﴿وَلَمْ يَكُنْ لَهُ كُفُوًا أَحَدٌ﴾

2. **Në fund të disa ajeteve.** Fundi i secilit ajet që përmbyll një tregim, përshkrim apo tematikë të caktuar, d.m.th. ajeti pasues të nisë një tregim, përshkrim apo tematikë tjetër, konsiderohet pushim i plotësuar, p.sh.:

﴿...وَمَا هِيَ مِنَ الظَّالِمِينَ بِبَعِيدٍ﴾ ﴿٨٣﴾ ۞ وَإِلَىٰ مَدْيَنَ أَخَاهُمْ شُعَيْبًا...﴾ (هود، 83-84)
﴿...إِنَّ اللَّهَ عَلَىٰ كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ﴾ ﴿٢٠﴾ يَا أَيُّهَا النَّاسُ اعْبُدُوا رَبَّكُمُ...﴾ (البقرة، 20-21)
﴿كَذَٰلِكَ يُبَيِّنُ اللَّهُ لَكُمْ ءَايَاتِهِ لَعَلَّكُمْ تَعْقِلُونَ﴾ ﴿٢٣٢﴾ ۞ أَلَمْ تَرَ إِلَى الَّذِينَ خَرَجُوا مِن دِيَارِهِمْ وَهُمْ أُلُوفٌ حَذَرَ الْمَوْتِ...﴾ (البقرة، 242-243)
﴿ذَٰلِكَ ذِكْرَىٰ لِلذَّاكِرِينَ﴾ ﴿١١٤﴾ ۞ وَأَصْبِرْ فَإِنَّ اللَّهَ لَا يُضِيعُ أَجْرَ الْمُحْسِنِينَ﴾ (هود، 114-115)

3. **Brenda një ajeti.** Përmbyllja e një tregimi, përshkrimi apo tematike të caktuar brenda një ajeti dhe fillimi i një tregimi, përshkrimi apo tematike tjetër, po ashtu, brenda të njëjtit ajet. Rasti i fundit, meqë nuk është fund ajeti apo sureje, atëherë dallohet me shenjën (في)، e cila d.m.th. se përparësi ka ndalja, por edhe vazhdimi është i lejuar.

﴿أَمْ تُرِيدُونَ أَن تَسْأَلُوا رَسُولَكُمْ كَمَا سُئِلَ مُوسَىٰ مِنْ قَبْلُ ۗ وَمَن يَتَّبِعِ الْكُفْرَ بَآلِإِيمَانٍ فَقَدْ ضَلَّ سَوَاءَ السَّبِيلِ﴾ (البقرة، 108)
﴿وَقَالُوا لَن يَدْخُلَ الْجَنَّةَ إِلَّا مَن كَانَ هُودًا أَوْ نَصْرَىٰ ۚ تِلْكَ أَمَانِيُّهُمْ ۗ قُلْ هَاتُوا بُرْهَانَكُمْ إِن كُنْتُمْ صَادِقِينَ﴾ (البقرة، 111)
﴿أَوَلَمْ يَتَفَكَّرُوا ۗ مَا بِصَاحِبِهِم مِّنْ جِنَّةٍ إِنْ هُوَ إِلَّا نَذِيرٌ مُّبِينٌ﴾ (الأعراف، 184)

Ajetet e mësipërme të të tri mënyrave të ndaljes së plotë tregojnë se të ndalurit e plotë mund të bëhet aty ku fillohet një tregim, tematikë apo përshkrim krejt i ri, aty ku fillohet me pasthirmë, pjesëz pyetëse, folje të trajtës urdhërore, ndërrimi i folësit etj.

4.2. Pushimi i mjaftueshëm – الْوَقْفُ الْكَافِي

Të ndalurit në fund të një fjalie kuptimplote e cila kuptimisht lidhet me pjesën pasuese, por gramatikisht jo, quhet pushim i mjaftueshëm.

Këtu kushtëzohet lidhshmëria kuptimore dhe shkëputja gramatikore me fjalët pasuese, për dallim nga pushimi i plotësuar ku kushtëzohej shkëputja kuptimore dhe gramatikore.

Ky pushim është i lejuar, prandaj vazhdohet leximi pa u kthyer prapa. Pushimi i mjaftueshëm mund të zbulohet lehtësisht në këto dy vende:

1. **Në fund të disa ajeteve.** Mbarimi i ajetit i cili finalizon një kuptim të caktuar të një tematike më të gjerë që ka të shtruar për momentin. Pra, me fundin e këtij ajeti përfundon një mini-ide e idesë kryesore që po trajtohet, por kushtëzohet që mos të ketë lidhje gramatikore me pjesën vijuese, p.sh.:

﴿وَالَّذِينَ يُؤْمِنُونَ بِمَا أُنزِلَ إِلَيْكَ وَمَا أُنزِلَ مِنْ قَبْلِكَ وَبِالْآخِرَةِ هُمْ يُوقِنُونَ﴾ ١ ﴿أُولَٰئِكَ عَلَىٰ هُدًى مِنْ رَبِّهِمْ وَأُولَٰئِكَ هُمُ الْمُفْلِحُونَ﴾ (البقرة)

﴿إِنَّ الَّذِينَ كَفَرُوا سَوَاءٌ عَلَيْهِمْ ءَأَنذَرْتَهُمْ أَمْ لَمْ تُنذِرْهُمْ لَا يُؤْمِنُونَ﴾ ٢ ﴿حَتَّمَ اللَّهُ عَلَىٰ قُلُوبِهِمْ وَعَلَىٰ سَمْعِهِمْ وَعَلَىٰ أَبْصَرِهِمْ غِشْوَةً وَلَهُمْ عَذَابٌ عَظِيمٌ﴾ (البقرة)

Dy ajetet e para i përshkruajnë vetitë e besimtarëve. Ajeti i parë flet për besimin në librat dhe në botën tjetër, kurse i dyti flet për shpëtimin e po këtyre besimtarëve. Pra, dy tematika të ndryshme që lidhen me një kuptim kryesor, d.m.th. vetitë e besimtarëve.

Dy ajetet tjera flasin për vetitë e jobesimtarëve. Ajeti i parë tregon se tërheqja e vërejtjes jobesimtarëve, s'u bën dobi, kurse ajeti i dytë njofton se Allahu ua ka vulosur zemrat, të dëgjuarit dhe shikimet jobesimtarëve. Dy çështje të ndryshme, por rrotullohen rreth të njëjtës tematikë të përgjithshme, vetitë e jobesimtarëve.

Nëse fundi i ajetit e përmbyll idenë kryesore, atëherë bëhet fjalë për *pushim të plotësuar*, e nëse mbarimi i ajetit e përfundon një pjesë të idesë kryesore, atëherë është *pushimi i mjaftueshëm*.

2. **Në një ajet të vetëm.** Po ashtu, *pushimi i mjaftueshëm* mund të ngjajë brenda një ajeti të vetëm. Në rastet e këtilla zakonisht vendoset shenja (ج), e cila e lejon në nivel të barabartë ndaljen dhe vazhdimin. P.sh.:

﴿فَتَلَقَّىٰ آدَامَ مِنْ رَبِّهِ ۖ كَلِمَاتٍ فَتَابَ عَلَيْهِ ۚ إِنَّهُ هُوَ التَّوَّابُ الرَّحِيمُ﴾ (البقرة)
﴿وَأَسْتَعِينُوا بِالصَّبْرِ وَالصَّلَاةِ ۚ وَإِنَّهَا لَكَبِيرَةٌ إِلَّا عَلَى الْخَاشِعِينَ﴾ (البقرة)
﴿خَلَقَ اللَّهُ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضَ بِالْحَقِّ ۚ إِنَّ فِي ذَلِكَ لَآيَةً لِّلْمُؤْمِنِينَ﴾ (العنكبوت)

Parimisht ky pushim e lejon ndaljen dhe vazhdimin në nivel të barabartë, megjithatë, kur *pushimi i mjaftueshëm* realizohet në fund të ajetit, atëherë preferohet ndalimi, sepse është sunnet ndalja në fund të të gjitha ajeteve.

Ndalimi i mjaftueshëm nuk mund të bëhet në fund të sureve, sepse çdo fund i sureve përfaqëson *ndalimin e plotësuar*.

4.3. Pushimi i kënaqshëm (i mirë) – الْوُقُوفُ الْحَسَنُ

Ky pushim vjen në shprehje kur plotësohet kuptimi i fjalisë, por lidhet gramatikisht dhe kuptimisht me pjesën vijuese.

Pra, ky pushim realizohet në fjalinë kuptimplote vetëm me gjymtyrë kryesore, d.m.th. nëse i heqim edhe një fjalë të vetme, atëherë fjalia mbetet jokuptimplote. Fakti që fjala ku jemi ndalur ka lidhje gramatikore dhe kuptimore me fjalët vijuese, tregon se jemi ndalur vetëm në skeletin e fjalisë, por shumë gjymtyrë të tjera na kanë mbetur në pjesën në vijim.

Ky pushim është i lejuar, por vazhdimi bëhet në dy lloje:

- a) nëse pjesa vijuese është shumë ngushtë e lidhur me pjesën e lexuar, atëherë duhet kthyer prapa për t'u plotësuar kuptimi dhe jo të vazhdojmë nga aty ku jemi ndalur, p.sh. nëse ndalemi te fraza *أَلْحَدُ لِلَّهِ*, kemi bërë një ndalje të mirë, mirëpo nuk guxojmë ta vazhdojmë leximin duke filluar me përcaktorin *رَبِّ الْعَالَمِينَ*, sepse këto dy pjesë janë të lidhura shumë ngushtë njëra me tjetrën.

b) nëse pjesa vijuese nuk është shumë ngushtë e lidhur me pjesën e lexuar, atëherë lejohet vazhdimi pa u kthyer prapa, p.sh. nëse ndalemi në *رَبِّ الْعَالَمِينَ* الْحَمْدُ لِلَّهِ, pastaj lirisht mund të vazhdojmë me ajetin tjetër *الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ*, ngase ata nuk janë të lidhur shumë ngushtë njëri me tjetrin.

Edhe pse funksioni gramatikor i togfjalëshit *رَبِّ الْعَالَمِينَ* dhe *الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ* është i njëjtë në raport me *رَبِّ الْعَالَمِينَ* الْحَمْدُ لِلَّهِ, përsëri konteksti i ajeteve tregon se i pari është shumë më ngushtë i lidhur me të.

Shpeshherë ndalimi i mirë përfaqësohet me shenjën (صلى), e cila i jep përparësi vazhdimit të leximit, por edhe ndalimi është i lejuar.

4.4. Pushimi i shëmtuar – الْوَقْفُ الْقَبِيحُ

Pushimi ku fjalia mbetet e pakuptimtë dhe lidhet ngushtë gramatikisht dhe kuptimisht me pjesën vijuese quhet *pushim i shëmtuar*.

Pushimi i shëmtuar nuk është çdoherë në një nivel, por varësisht prej shëmtimit kuptimor që paraqet pushimi, duke filluar nga e shëmtuara deri te më e shëmtuara:

1. Pushimi i shëmtuar i cili thjesht formon një togfjalësh apo fjali jokuptimplote, p.sh. بِسْمِ “me emrin e...” etj.
2. Pushimi i shëmtuar që jep kuptim të kundërt, mirëpo nuk prek në çështje besimore, p.sh. ﴿فَلَهَا التَّصَفُّ وَلَا يُؤْيِيهِ﴾ “Asaj (bashkëshortes) i takon gjysma dhe prindërve.” Nëse e lexojmë kështu, ajeti jep kuptim krejt të gabuar, sepse ai duhet të kumtojë këtë kuptim “Asaj (bashkëshortes) i takon gjysma, kurse prindërve, secilit një e gjashta...” Ky nivel është më i shëmtuar se i pari.
3. Pushimi i shëmtuar i cili prek në themelet e besimit quhet edhe ndalim më i shëmtuar, p.sh. قَبِيْهَتِ الَّذِي كَفَرَ وَاللّٰهُ “U hutua ai që mohoi dhe Allahu.”, kurse kuptimi i vërtetë është “U hutua ai që mohoi. Allahu nuk e udhëzon popullin zullumqar.”, pra nuk duhet të ndalemi te fjala Allah, etj. Nëse ndalja bëhet qëllimisht, me vetë dëshirë dhe kuptohet, atëherë përbën problem serioz në besimin e lexuesit. Niveli i tretë përbën kulmin e ndalimit të shëmtuar.

Pushimi i këtillë është i ndaluar, por nëse ndodh pa dëshirë apo pa e kuptuar ajetin, atëherë duhet të kthehet prej më përpara dhe të vazhdohet deri aty ku plotësohet kuptimi i duhur.

Shenjë për pushimin e shëmtuar është (لا). Kjo e ndalon rreptësisht pushimin aty, veçanërisht për nivelin e tretë. Megjithatë, (لا) nuk është vendosur në çdo ndalim të shëmtuar të mundshëm.

4.5. Pushim i domosdoshëm – الْوَقْفُ الْإِلْزَامُ

Pushimi i cili rreptësisht e ndalon vazhdimin e leximit dhe kërkon ndalje të domosdoshme quhet الْوَقْفُ الْإِلْزَامُ ndalje e domosdoshme.

Disa texhvidologë e kanë kategorizuar këtë si pjesë e pushimit të plotësuar الْوَقْفُ التَّامُّ, sepse ky pushim paraqet një kuptim disi të plotësuar.

Pushimi i domosdoshëm në mus'haf përfaqësohet nga shenja (م), e cila kërkon ndalim të domosdoshëm.

Në tërë mus'hafin, sipas kiraetit Hafs nga Asimi, ndalimi i domosdoshëm (lazim) del në njëzet e një ajete, p.sh.

وَأَمَّا الَّذِينَ كَفَرُوا فَيَقُولُونَ مَاذَا أَرَادَ اللَّهُ بِهَذَا مَثَلًا يُضِلُّ بِهِ كَثِيرًا وَيَهْدِي بِهِ كَثِيرًا ﴿٥٨﴾ (البقرة)
تِلْكَ الرُّسُلُ فَضَّلْنَا بَعْضَهُمْ عَلَى بَعْضٍ مِّنْهُمْ مَّنْ كَلَّمَ اللَّهُ ﴿٥٩﴾ (البقرة)
إِنَّمَا يَسْتَجِيبُ الَّذِينَ يَسْمَعُونَ وَالْمَوْتَى يَبْعَثُهُمُ اللَّهُ ثُمَّ إِلَيْهِ يُرْجَعُونَ ﴿٦٠﴾ (الأنعام)

Pas ndalimit të domosdoshëm në fjalën e duhur, lexuesi duhet patjetër të vazhdojë aty ku ka mbetur dhe assesi të kthehet për ta përsëritur ndonjë fjalë.

Pyetje:

- ❖ Çfarë nënkuptojmë me el-vakfin?
- ❖ Sa lloje pushimi ka në leximin e Kur'anit?
- ❖ Cilët janë llojet e pushimit të vullnetshëm?
- ❖ Trego disa shenja që u përshtaten llojeve të pushimit!

SEKTEJA – السَّكَّةُ

Në mesin e teknikave të leximit të Kur'anit fisnik është edhe *pushimi, sekteja*. Fjala *sekte* سَكَّة, në aspektin gjuhësor do të thotë *pushim apo heshtje*, kurse në terminologjinë e disiplinës së texhvidit përkufizohet në këtë mënyrë: قَطْعُ الصَّوْتِ دُونَ النَّفْسِ – “ndërprerja e zërit, pa marrë frymë.”.

Në kiraetin e Asimit, sipas transmetimit të Hafsit, sekteja ndahet në dy grupe kryesore: sekteja e domosdoshme dhe sekteja vullnetare.

Sekteja e domosdoshme

Kjo sekte është *e domosdoshme* sepse realizimi i saj është i domosdoshëm. Sipas rivajetit Hafs, është i pranishëm në katër vende në Kur'an:

1. Në suren Kehf, ajeti 1-2:

﴿الْحَمْدُ لِلَّهِ الَّذِي أَنْزَلَ عَلَى عَبْدِهِ الْكِتَابَ وَلَمْ يَجْعَلْ لَهُ عِوَجًا ۖ قَيِّمًا لِّيُنذِرَ بَأْسًا شَدِيدًا مِّنْ لَّدُنْهُ وَيُبَشِّرَ الْمُؤْمِنِينَ الَّذِينَ يَعْمَلُونَ الصَّالِحَاتِ أَنَّ لَهُمْ أَجْرًا حَسَنًا ۖ﴾

Kjo sekte është e domosdoshme vetëm atëherë kur dy ajetet i lidhim me një frymë. Nëse ndalemi në fund të ajetit të parë, atëherë nuk është nevoja të rikthehemi pas, sepse ndalja llogaritet e plotësuar dhe leximi mund të fillohet drejt me ajetin e dytë.

2. Në suren Jasin, 52: ﴿قَالُوا يَتَوَلَّوْنَآ مَنْ بَعَثْنَا مِن مَّرْقَدِنَا ۖ هَذَا مَا وَعَدَ الرَّحْمَنُ وَصَدَقَ الْمُرْسَلُونَ﴾

Edhe kjo është e domosdoshme vetëm atëherë kur nuk ndalemi te fjala që ka sekte. Nëse ndalemi në fjalën e sektes, atëherë nuk është nevoja të rikthehemi pas, sepse ndalja llogaritet e plotësuar, prandaj mund të fillohet leximi pa u kthyer prapa.

3. Në suren Kijameh, ajeti 27: ﴿وَقِيلَ مَنْ رَاقٍ ۖ﴾

Për dallim nga dy rastet e para, këtu nuk duhet ndalur, por kërkohet vazhdimi dhe realizimi i sektes, pa bërë *idgam* bila *gunne*.

4. Në suren Mutaaffifin, ajeti 14: ﴿كَلَّا بَلْ رَانَ عَلَى قُلُوبِهِم مَّا كَانُوا يَكْسِبُونَ﴾

Po ashtu, edhe këtu nuk duhet ndalur, por kërkohet vazhdimi dhe realizimi i sektes, pa bërë *idgam* mutekaribejn.

Sekteja vullnetare

Te sekteja vullnetare lexuesi është i lirë ta bëjë apo të mos e bëjë. Sektet vullnetare vijnë vetëm në dy raste në gjithë Kur'anin:

1. Lidhja e ajetit të fundit të sures *Enfal* me ajetin e parë të sures *Teube*:

﴿وَالَّذِينَ ءَامَنُوا مِن بَعْدُ وَهَاجَرُوا وَجَاهَدُوا مَعَكُمْ فَأُولَٰئِكَ مِنكُمْ وَأُولُوا الْأَرْحَامِ بَعْضُهُمْ أَوْلَىٰ بِبَعْضٍ فِي كِتَابِ اللَّهِ إِنَّ اللَّهَ بِكُلِّ شَيْءٍ عَلِيمٌ ﴿٧٥﴾﴾ (سُورَةُ التَّوْبَةِ) بَرَاءَةٌ مِّنَ اللَّهِ وَرَسُولِهِ إِلَى الَّذِينَ عَاهَدْتُم مِّنَ الْمُشْرِكِينَ ﴿٧٦﴾﴾

Lidhja mes këtyre dy sureve bëhet në tri mënyra:

- Me sekte (pushim pa marrë frymë);
- Me ndalje normale, duke marrë frymë; dhe
- Me lidhje të menjëhershme, pa sekte dhe pa ndalje, njësoj siç lidhen dy ajete të rëndoma të një sureje.

2. Ajeti 28-29 i sures el-Hakkah: ﴿مَا أَغْنَىٰ عَنِّي مَالِيَّةٌ ﴿٢٨﴾ هَلْكَ عَنِّي سُلْطَانِيَّةٌ ﴿٢٩﴾﴾

Mes këtyre dy ajeteve mund të ndalemi njësoj siç ndalemi mes dy ajeteve të rëndoma, por nëse i lidhim, atëherë kemi dy situata: ose t'i lexojmë me sekte (pushim pa marrë frymë), ose t'i shkrijmë dy H-të me cilësi të *idgam mutemathilejn*.

Sekteja vullnetare është e pranuar nga të gjithë lexuesit (kurratë), kurse *sekteja e domosdoshme* është specifikë e transmetimit të Hafsit nga Asimi.

Nuk lejohet që gjatë sektes të merret frymë, pavarësisht a hetohet apo nuk hetohet frymëmarria.

Pyetje:

- Përkufizo sekten!
- Si ndahet sekteja?
- Ku bëhet sekteja e domosdoshme dhe ku vullnetarja?
- Sa duhet pushuar gjatë sektes?

REUMI DHE ISHMAMI – الرَّؤْمُ وَالْإِشْمَامُ

Mënyrat e ndaljes në fund të fjalëve kur'anore janë të ndryshme, varësisht nga zanorja fundore që posedon.

Dy parime kryesore e cilësojnë artikulin e fjalëve fundore gjatë leximit të Kur'anit: fjalja nuk fillon me sukun dhe nuk mbaron me zanore (në artikulin). Në thelb zanorja ekziston, por artikuli i plotë i saj është i ndaluar.

Në të vërtetë, çdo fjalë në gjuhën arabe detyrimisht përfundon me njërin nga tri zanoret e saja, gjegjësisht me E, I ose U, pavarësisht nëse gjatë shkrimit apo artikulimit shmanget për arsye të ndryshme.

Kur ndalemi përgjatë leximit të Kur'anit, mënyrat e vokalizimit të fjalës së fundit janë këto:

- a) ndalja me sukun,
- b) ndalja me reum dhe
- c) ndalja me ishmam.

Sa i përket ndaljes me sukun, dihet se bëhet fjalë për ndalje të zakonshme në leximin e Kur'anit. Nëse krejt Kur'ani lexohet duke e praktikuar ndaljen me sukun, lexuesi nuk ka gabuar asgjë, dhe ka vepruar drejt. Sa u përket dy trajtave tjera (reumit dhe ishmamit), ato përfaqësojnë ndaljen profesionale që mësohet dhe praktikohet vetëm nga lexuesit profesionistë. Pra, mësimi i këtyre dy trajtave të ndaljes flet për një nivel të lartë dhe të përkryer të leximit të Kur'anit Fisnik.

Reumi – الرَّؤْمُ

Fjala رُؤْمٌ *reumun* në aspektin gjuhësor do të thotë *dëshirë* apo *kërkesë për diçka*, ndërsa në aspektin terminologjik nënkupton uljen e zërit gjatë ndaljes me damme apo me kesre, ku pjesa më e madhe e tyre humb, ndërsa një pjesë e vogël artikullohet. Dijetarët e texhvidit konstatojnë se gjatë ndaljes me reum, dy e treta e zanores damme apo kesre humb, kurse mbetet vetëm një e treta e saj, gjegjësisht mbetet vetëm aq sa mund ta dëgjojë ai që është shumë afër lexuesit, jo edhe të tjerët, p.sh.:

Me damme	﴿إِيَّاكَ نَعْبُدُ وَإِيَّاكَ نَسْتَعِينُ﴾ ﴿إِنَّ شَانِئَكَ هُوَ الْأَبْتَرُ﴾ ﴿إِنَّ اللَّهَ غَفُورٌ رَحِيمٌ﴾
Me kesre	﴿أَلَمْ تَرَ كَيْفَ فَعَلَ رَبُّكَ بِأَصْحَابِ الْفِيلِ﴾ ﴿مَلِكِ يَوْمِ الدِّينِ﴾ ﴿تَرْمِيهِم بِحِجَارَةٍ مِّن سِجِّيلٍ﴾

Siç shihet, reumi nuk bëhet me zanoren E, por vetëm me U dhe me I. Pushimi me *reum* e mban dispozitën e vazhdimit, d.m.th. fjala në të cilën pushojmë mban dispozitat sikur ta kemi vazhduar, prandaj:

1. Te ajeti ﴿إِيَّاكَ نَعْبُدُ وَإِيَّاكَ نَسْتَعِينُ﴾ nuk realizohet medu arid lis-sukuni, por zgjatet dy nota në cilësinë e medu tabisë. E nëse zgjatet më shumë se dy nota, atëherë nuk mund të ndalemi me reum;
2. Te ajeti ﴿قُلْ هُوَ اللَّهُ أَحَدٌ﴾ nuk realizohet kalkalja, por thjesht ndalemi me reum, gjegjësisht me vokalin damme;
3. Te ajeti ﴿بَلْ هُوَ كَذَابٌ أَشِرٌ﴾ R-ja fundore shqiptohet e theksuar. E nëse ndalemi me sukun d.m.th. pa reum, atëherë lexohet e patheksuar.

Gjithashtu, duhet ditur se kur ndalemi mbi fjalën me tenvin (EN apo IN), reumi bëhet pa e nyjëtuar N e tenvinit, gjegjësisht vetëm me U apo I.

Tani mund ta ndërlihim edhe kuptimin gjuhësor me atë terminologjik, sepse lexuesi përmes reumit *dëshiron* apo *kërkon* t'i japë bashkëtingëllores së fundit vokalin damme apo kesre, por realisht i jep vetëm një të tretën e këtyre zanoreve.

Në disa libra *reumin* mund ta gjejmë me emrin اِخْتِلَامٌ *ihtilasurn*.

Ishmami - اِشْمَامٌ

Fjala *ishmam* اِشْمَامٌ në aspektin gjuhësor do të thotë të japësh shenjë për diçka, kurse në aspektin terminologjik nënkupton të japësh shenjë formale për zanoren damme (U) pas artikulimit me sukun të bashkëtingëllores fundore, d.t.th. menjëherë pas shqiptimit të bashkëtingëllores së fundit, të rumbullakohen buzët për ta shqiptuar dammen pa lënë shenjë tingullore. Pra, te reumi artikullohet një e treta e dammes apo kesres,

kurse te ishmami nuk artikulohet fare dammeja, por vetëm jepet shenjë. Nëse pranë është një i verbër, nuk mund ta hetojë aspak ishmamin. P.sh.:

Me (U)	﴿الْهَنَكُمُ التَّكَاثُرُ﴾ ﴿وَهُوَ الْغَفُورُ الْودُودُ﴾
Me (Un)	﴿وَإِنَّهُ عَلَىٰ ذَٰلِكَ لَشَهِيدٌ﴾ ﴿إِنَّهُ عَلَىٰ رَجْعِهِ لَقَادِرٌ﴾

Në rastet kur fjala përfundon me tenvinin (UN), atëherë ishmami bëhet vetëm me zanoren (U).

Ishmami vjen vetëm në bashkëtingëlloren e fundit, përveç në ajetin 11 të sures Jusuf ﴿مَالِكٌ لَا تَأْمَنَّا﴾ ishmami bëhet me damme në mes të fjalës. Esenca e kësaj është ﴿مَالِكٌ لَا تَأْمَنَّا﴾, mirëpo për shkak të tri zanoreve hundore njëra pas tjetrës është realizuar asimilimi grafik i dy nunave në një, kurse për dammen e rënë jepet shenjë përmes ishmamit. Meqë dihet se ishmami vjen vetëm pas sukunit, atëherë N-ja e parë mbahet me cilësinë e ihfasë dhe jo të idgamit.¹⁰⁷

Ishmami dhe reumi nuk vijnë në shprehje edhe në këto tri situata gjatë leximit të Kur'anit:

1. Kur damme apo kesre vijnë mbi T-në e rrumbullakët (ة), p.sh.

﴿كَذَّبَتْ ثَمُودُ وَعَادٌ بِالْقَارِعَةِ﴾, ﴿وَعَلَىٰ أَبْصَرِهِمْ غِشْوَةٌ﴾. Këtu nuk zbatohet reumi dhe ishmami, sepse arabët T-në (ة) e rrumbullakët e shndërrojnë në H (ه) gjatë ndaljes.

2. Kur ndalemi te M-ja e shumësit (مُ, هُم). Në kiraetin e Asimit nuk vjen në shprehje aspak realizimi i reumit apo ishmamit në shembujt e cituar më lartë, sepse ato janë me sukun.

3. Kur zanorja e fundit nuk është themelore, por e përkohshme (aridah), atëherë nuk mund të realizohet ndalje me cilësinë e reumit apo ishmamit, siç është rasti te zanorja që vendoset për të evituar dy sukuna, p.sh. ﴿وَإِذْ أَبْتَلَىٰ﴾, ku bashkëtingëllorja Dh (ذ)

¹⁰⁷ Ishmamin në këtë ajet e pranojnë të gjithë lexuesit përveç Ebu Xhaferit i cili e bën idgam normal. Kjo fjalë sipas xhumhurit mund të lexohet edhe me reum apo ihtilas.

është vokalizuar me kesre të përkohshme, prandaj te ajo nuk kryhet ndalesë me cilësinë e reumit apo të ishmamit.

Në tabelën në vazhdim do t'i paraqesim të gjitha format e mundshme të ndaljes në fund të një fjale kur'anore.

MËNYRAT E NDALJES NË FUND TË FJALËS		
Zanorja	Shembull	Mënyra e ndaljes
Sukun	﴿فَحَدِّثْ﴾	Vetëm me sukun
Fet'ha	﴿الْكَوْثَرِ﴾	Vetëm me sukun
Kesre	﴿النَّاسِ﴾	Me sukun dhe me reum
Damme	﴿الصَّمَدِ﴾	Me sukun, me reum apo me ishmam
Tenvin UN	﴿أَحَدٌ﴾	Me sukun, reum (U) apo ishmam (U)
Tenvin IN	﴿تَضْلِيلِ﴾	Me sukun apo me reum (I)
Tenvin EN	﴿أَفْوَاجًا﴾	Me elif të gjatë

Pyetje:

- ❧ Cilat janë mënyrat e ndaljes në Kur'an?
- ❧ Çfarë është reumi dhe kur bëhet?
- ❧ Çfarë është ishmami dhe kur bëhet?
- ❧ Kur nuk vjen në shprehje reumi dhe ishmami?
- ❧ Cilat janë format e mundshme të ndaljes në fund të fjalës?

الْأَلِفَاتُ السَّبْعَةُ – SHTATË ELIFËT

Në leximin e Asimit me transmetim të Hafsit duhet vënë re edhe *shtatë elifët*, të cilët gjatë pushimit lexohen, kurse gjatë vazhdimit shmanen.

Shtatë elifët janë përfshirë në këto shtatë fjalë kur'anore:

1. Fjala (أَنَا) në gjithë Kur'anin, p.sh.: ﴿قُلْ إِنَّمَا أَنَا بَشَرٌ مِّثْلُكُمْ...﴾;

2. Fjala (لَكِنَّا) në ajetin 38 të sures El-Kehf: ﴿لَكِنَّا هُوَ اللَّهُ رَبِّي...﴾;

3. Fjala (الظُّنُونُ) në ajetin 10 të sures El-Ahzab:

﴿...وَتَظُنُّونَ بِاللَّهِ الظُّنُونُ ١٠ هُنَالِكَ ابْتُلِيَ الْمُؤْمِنُونَ...﴾

4. Fjala (الرَّسُولُ) në ajetin 66 të sures El-Ahzab:

﴿...يَقُولُونَ يَلَيْتَنَّا أَطَعْنَا اللَّهَ وَأَطَعْنَا الرَّسُولَ ٦٦ وَقَالُوا رَبَّنَا إِنَّا أَطَعْنَا سَادَتَنَا وَكُبَرَاءَنَا...﴾

5. Fjala (السَّيِّلُ) në ajetin 67 të sures El-Ahzab:

﴿...إِنَّا أَطَعْنَا سَادَتَنَا وَكُبَرَاءَنَا فَأَضَلُّونَا السَّيِّلَ ٦٧ رَبَّنَا إِنَّهُمْ ضَعُفَيْنِ مِنَ الْعَذَابِ...﴾

6. Fjala (سَلِيلًا) në ajetin 4 të sures El-Insan:

﴿إِنَّا أَعْتَدْنَا لِلْكَافِرِينَ سَلِيلًا وَأَعْلَلْنَا وَسْعِيرًا﴾ Kjo fjalë ka dy trajta leximore në kiraetin e Asimit të transmetuar nga Hafsi: trajta e parë është të lexohet me elif gjatë pushimit dhe pa elif gjatë vazhdimit, ndërsa trajta e dytë është të shmanget elifi në të dy situatat.

7. Fjala (قَوَارِيرًا) në ajetin 15 të sures El-Insan:

﴿وَيُطَافُ عَلَيْهِمْ بِآيَاتِهِ مِّنْ فَضَّةٍ وَأَكْوَابٍ كَانَتْ قَوَارِيرًا ١٥﴾, kurse në ajetin 16 elifi nuk lexohet as kur ndalemi dhe as kur e vazhdojmë leximin: ﴿قَوَارِيرًا مِّنْ فَضَّةٍ قَدَرُهَا تُقَدَّرًا ١٦﴾.

Në botimin e Kur'anit në Kompleksin e Kur'anit në Arabinë Saudi-te janë vendosur shenja të veçanta për dallimin e shtatë elifëve nga elifët e tjerë: për elifin i cili lexohet gjatë ndaljes dhe evitohet gjatë vazhdimit kanë vendosur një zero të zgjatur vertikalisht (٠), siç shihet në shembujt e mësipërm. Ndërsa për elifin dhe për të gjitha shkronjat tjera që

nuk lexohen as kur ndalemi dhe as kur e vazhdojmë leximin, kanë vendosur një rreth të rrumbullakët të ngjashëm me sukunin (۞), siç është rasti te fjala (سَلَسِلًا) ku përmes vendosjes së këtij sukuni e kanë për zgjedhur mendimin që e eviton elifin në të gjitha situatat. Po ashtu, kjo shenjë përdoret edhe në shumë raste të tjera, p.sh.: ﴿كُلُوا وَاشْرَبُوا﴾, ﴿أُولَئِكَ﴾, ﴿أُولَئِكَ﴾, ﴿سَأُورِيكُمْ﴾, ﴿وَأُولَئِكَ﴾, ﴿أُولَئِكَ﴾, ﴿وَجَاءَ﴾, ﴿مَلَأْنَاهُ﴾, ﴿بِأَيْدِي﴾, ﴿أَفَايِن﴾, etj.

Pyetje:

- ❖ Çfarë janë shtatë elifët?
- ❖ Cili nga shtatë elifët është më i shpeshtë?
- ❖ Si lexohet elifi te fjala (سَلَسِلًا)?
- ❖ Me cilën shenjë dallohen shtatë elifët?

SHENJAT E NDALJES – عِلَامَاتُ الْوَقْفِ

Leximi i Kur'anit drejtohet nga shenja të veçanta të cilat janë karakteristikë ekskluzive e Kur'anit. Ato nuk përdoren askund tjetër përveçse në Kur'an, bile as nëpër hadithe.

Në mungesë të shenjave të pikësimit, ekspertët e texhvidit kanë përpiluar këto shenja për drejtlexim të Kur'anit.

Të gjitha shenjat përfaqësojnë ndonjërin prej llojeve të ndaljes të mësuar më parë, megjithatë, siç shprehen vetë ekspertët e texhvidit, ato janë vendosur vetëm në disa prej vendeve më të spikatura, mirëpo ka edhe shumë vende të tjera që meritojnë të vendosen, por atëherë do të ngarkohej tepër teksti i Kur'anit dhe do të bëhej pothuaj jofunksional.

Në vazhdim do t'i paraqesim shenjat e dy botimeve më të përhapura në botë, veçanërisht në viset ballkanike: të Kompleksit për Botim të Kur'anit "Mbreti Fahd" dhe të Ministrisë për Çështje Fetare të Turqisë. Të gjithë botimet tjera nëpër botë, pothuaj janë të njëjta me botimet e njërës prej këtyre dy qendrave.

A) Shenjat e Kompleksit për Botim të Kur'anit "Mbreti Fahd"

م	Shenjë për ndalje të domosdoshme, pastaj nisje të leximit me pjesën vijuese pa u kthyer prapa, p.sh. ﴿إِنَّمَا يَسْتَجِيبُ الَّذِينَ يَسْمَعُونَ وَالْمَوْتَى يَبْعَثُهُمُ اللَّهُ ثُمَّ إِلَيْهِ يُرْجَعُونَ﴾ (En'am, 36)
لا	Shenjë që e ndalon pushimin dhe kërkon vazhdim të domosdoshëm, p.sh. ﴿الَّذِينَ تَتَوَفَّيْهُمْ الْمَلَائِكَةُ طَيِّبِينَ يَقُولُونَ سَلَامٌ عَلَيْكُمْ﴾ (Nahl, 32)
صل	Shenjë e cila e lejon ndaljen, por vazhdimi është më i preferuar, p.sh.: ﴿إِلَى اللَّهِ مَرْجِعُكُمْ وَهُوَ عَلَى كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ﴾ (Hud, 4)
قل	Shenjë e cila e lejon vazhdimin, por ndalja është më e preferuar, : ﴿أَلَا إِنَّهُمْ فِي مِرْيَةٍ مِّن لِّقَاءِ رَبِّهِمْ أَلَا إِنَّهُ بِكُلِّ شَيْءٍ مُّحِيطٌ﴾ (Fussilet, 54)

ج	Shenjë e cila e lejon ndaljen dhe vazhdimin e leximit në nivel të barabartë, pa e preferuar asnjërën, p.sh.: ﴿فَلَا تَحْسَبَنَّ اللَّهَ مُحِلِّفَ وَعْدِهِ ۚ رُسُلَهُ ۚ إِنَّ اللَّهَ عَزِيزٌ ذُو انْتِقَامٍ﴾ (Ibrahim, 47)
∴	Këto përsëriten dy herë dhe kumtojnë ndalim të domosdoshëm vetëm në njëërën prej tyre, e jo në të dyja, p.sh. ﴿ذَلِكَ أَلْكُتَبُ لَا رَيْبَ فِيهِ هُدًى لِّلْمُتَّقِينَ﴾ (Bekare, 2) Kjo ndalje quhet edhe وَقْفُ التَّعَانُقِ
ه	Rrethi i rrumbullakët tregon se shkronja në fjalë nuk shqiptohet fare, as kur ndalemi dhe as kur vazhdojmë, p.sh. ﴿أَلَا يَظُنُّ أُولَٰئِكَ أَنَّهُم مَّبْعُوثُونَ﴾ (Mutaffifin, 4)
و	Rrethi elipsoid tregon se shkronja në fjalë shqiptohet vetëm kur ndalemi, ndërsa kur vazhdojmë jo, p.sh. ﴿وَيُطَافُ عَلَيْهِمْ بِبَآئِنَةٍ مِّنْ فِضَّةٍ وَأَكْوَابٍ كَانَتْ قَوَارِيرًا﴾
•	- Shenjë e <i>tes'hilit</i> , p.sh. ﴿ءَاَعْجَبِي وَعَرَبِي﴾ (fussilet, 44) - Shenjë e <i>ishmamit</i> , p.sh. ﴿لَا تَأْمَنَّا﴾ (Jusuf, 11) - Nën shkronjë është shenjë e <i>imales</i> , p.sh. ﴿بِسْمِ اللَّهِ مَجْرِبَهَا وَمُرْسَهَا﴾
س	- Paraqitja e saj mbi (ص) tregon se shqiptohet vetëm (س), ndërsa (ص) eliminohet, p.sh. ﴿بَصَّطَةً﴾ (A'raf, 69); ﴿وَيَبْصُطُ﴾ (Bekare, 245). - Paraqitja e saj nën sad (ص) tregon se shumica e lexuesve e preferojnë leximin e (ص), p.sh. ﴿الْمُصِيطِرُونَ﴾ (Tur, 37)
🕌	Kjo shenjë, apo e ngjashme, vendoset në fund të ajetit në të cilin kërkohet sexhde, kurse vetë fjala e sexhdes është e veçuar me vizë sipër, p.sh. ﴿كَلَّا لَا تُطِعْهُ وَأَسْجُدْ وَاقْتَرِبْ ۝﴾

B) Shenjat e Ministrisë për Çështje Fetare të Turqisë

م	Shenjë për ndalesë të domosdoshme, por e përcaktuar nga ekspertët e texhvidit, p.sh. ﴿لَقَدْ مَنَّ اللَّهُ عَلَى الْمُؤْمِنِينَ إِذْ أَخْرَجَهُمْ مِنَ مَقْصَدِ الْأَعْدَاءِ﴾
ط	Shenjë për ndalim të plotë, pa përcaktuar nëse duhet apo nuk duhet ndalur, p.sh. ﴿وَسَيَنْجِئُكَ مِنْهُمْ رَبُّكَ وَلَسْتَ بِغَارٍ مُنْجٍ﴾
ج	Shenjë e cila të le të lirë të zgjedhësh, ndaljen apo vazhdimin, por ndalja është më e preferuar, p.sh. ﴿وَالَّذِينَ آمَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ أُولَٰئِكَ لَهُمْ أَجْرٌ غَيْرُ الْمَمْلُوكِ﴾
ص	Shenjë lehtësuese. Nëse aty të harxhohet fryma, atëherë ndalesh dhe nuk kthehesh prapa, por vazhdon nga ku ke mbetur, p.sh. ﴿مَتَاعٌ قَلِيلٌ وَلَهُمْ عَذَابٌ أَلِيمٌ﴾
ز	Shenjë e cila e lejon ndaljen, mirëpo vazhdimi ka më shumë prioritet, p.sh. ﴿وَالَّذِينَ آمَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ لَهُمْ أَجْرٌ غَيْرُ الْمَمْلُوكِ﴾
لا	Shenjë që nuk e lejon ndaljen, sepse deformohet kuptimi. Nëse lexuesi ndalet, duhet të kthehet për ta plotësuar fjalinë. E nëse (لا) është në fund të ajetit, atëherë ndalet dhe nuk ka nevojë për përsëritje, p.sh.: ﴿إِنِّي جَزَيْتُهُمُ الْيَوْمَ بِمَا صَبَرُوا أَنَّهُمْ هُمُ الْفَائِزُونَ﴾
ق	Sipas shumicës së lexuesve, shërben për vazhdim të leximit, por lejohet edhe ndalja, p.sh.: ﴿وَيُرِيكُمْ آيَاتِهِ فَآيَاتِ اللَّهِ تُشْكِرُونَ﴾
قف	Kjo shenjë d.m.th. “Ndalo!”. Ndalimi këtu bëhet për shkaqe kuptimore, p.sh. ﴿سَلَامٌ هِيَ حَتَّىٰ مَطْلَعِ الْفَجْرِ﴾
ع	Shenjë për ruku. Nëse lexuesi dëshiron ta përmbyll leximin në namaz, atëherë preferohet të njëjtën ta bëjë tek kjo shenjë, p.sh.: ﴿لَحَقُّ مَرْبٍ لَّكَ تَكُونَنَّ مِنْ لَمْ تَهَيَّئْ﴾

قصر	Kjo shkurtesë d.m.th. “Shkurto!”. Pra, sipas rregullave të përgjithshme kërkohet zgjatje, por kjo tregon se nuk duhet të zgjatet, p.sh.: ﴿الْحَيَّ كَ﴾, ﴿الْحَيَّ اَلْبَابِ﴾, ﴿نَا﴾ etj.
مد	Kjo shkurtesë d.m.th. “Zgjate!”. Pra, parimisht nuk duhet të zgjatet, mirëpo prania e kësaj shenje tregon se duhet të zgjatet, p.sh.: ﴿رُؤُسُكُمْ﴾, ﴿وَلَوْ رُؤُفٌ﴾, ﴿دَاوُدُ﴾ etj.

FILLIMI ME HEMZEN LIDHËSE

Fillimi i leximit me *hemzen lidhëse* (ا) nuk është çdoherë njësoj, sepse nuk e merr çdoherë vokalin e njëjtë. Ky problem është te mus'hafët e Arabisë, sepse ata nuk e kanë të vokalizuar hemzen lidhëse, kurse mus'hafët e Turqisë e kanë të shënuar ashtu siç lexohet, gjë e cila krijon problem gjatë lidhjes.

Këto janë mënyrat e vokalizimit të hemzes lidhëse në fillim:

- Kur *hemzeja lidhëse* vjen te emrat, përemrat lidhorë dhe të ngjashëm, çdoherë lexohet me E, p.sh. ﴿الذِينَ﴾, ﴿التَّجْمُ الْقَائِبُ﴾, ﴿الْحَمْدُ﴾.
- Kur *hemzeja lidhëse* vjen te foljet e mënyrës urdhërore që shkronjën e mesit rrënjësore e kanë U apo me foljet pasive të kohës së kaluar, atëherë edhe hemzeja lexohet me U, p.sh. ﴿اتَّبِعُوا﴾, ﴿اقْتُلُوا﴾, ﴿ادْعُوا﴾, ﴿انْظُرْ﴾.
- Kur *hemzeja lidhëse* vjen te foljet e mënyrës urdhërore që shkronjën e mesit e kanë E ose I, dhe me foljet e kohës së kaluar që fillojnë me hemze lidhëse, atëherë hemzeja vokalizohet me I, p.sh. ﴿اتَّخَذُوا﴾, ﴿اتَّبِعْ﴾, ﴿اعْلَمُوا﴾, ﴿اهْدِنَا﴾, ﴿اسْتَجِيبُوا﴾.¹⁰⁸

Këto parime vlejné edhe për fjalët që fillojnë me hemzen lidhëse në mes të ajeteve, pra kur ndalemi dhe e fillojmë leximin nga hemzeja lidhëse.

Gjithashtu, duhet ditur se hemzeja lidhëse që paraqitet në pozicionet fillestare, në mus'hafët e Turqisë është e shënuar bashkë me vokalet. Kjo është lehtësim për lexuesin fillestar, por është shumë problematike nëse leximi i fjalës me hemze lidhëse lidhet me fjalën paraprake, sepse me këtë rast hemzeja nuk e luan rolin lidhës, por shndërrohet në hemze të prerë (hemzetu el-ka't'i).

¹⁰⁸ Fjala ﴿اَتْتُونِي﴾ lexohet (ايئونني) kur fillohet me atë, sepse esenca e saj është (ايئونني).

KREU IX

RREGULLA MBI ZANORET



- Tes'hil
- Imaleh
- Theksi

TES'HILI - التَّسْهِيلُ

Tes'hili është një teknikë e rrallë në këndimin e Kur'anit. Në leximin e Hafsit nga Asimi ka vetëm një rast të *tes'hilit*.

Tes'hil التَّسْهِيلُ në aspektin gjuhësor do të thotë lehtësim, kurse në terminologjinë e disiplinës së texhvidit nënkupton: “Kur paraqiten dy hemze të vokalizuara njëra pas tjetrës, atëherë hemzeja e dytë shqiptohet mes zanores që posedon dhe zgjatjes që i përshtatet asaj zanoreje, kurse e para mbetet siç është.”¹⁰⁹

Hemzeja e dytë quhet الهمزة المُسَهَّلَةُ *hemzeja e lehtësuar* (e bërë *tes'hil*), sepse artikulimi i dy hemzeve njëra pas tjetrës është i vështirë, kështu që përmes kësaj teknike hemzeja e dytë lehtësohet, kurse hemzeja e parë quhet الهمزة المُحَقَّقَةُ *hemze e realizuar*, sepse shqiptohet pastër vokali që ka.

Duhet kujdesur që hemzeja e bërë *tes'hil* të mos shndërrohet në zgjatje të plotë, por vetëm të niset dhe pastaj menjëherë të vazhdohet me shkronjën e radhës.

Në leximin e Asimit me transmetim të Hafsit kjo teknikë paraqitet vetëm në një rast në gjithë Kur'anin, gjegjësisht në ajetin 44 të sures Fussilet: ﴿أَعْجَبِي وَعَرَبِي﴾ apo ﴿أَعْجَبِي وَعَرَبِي﴾

Shenjë e *tes'hilit* te botimet arabe është një rreth i plotë dhe i rrumbullakët mbi elif (●), kurse te botimet turke është shënimi i fjalës (تسهيل) nën elif.

Pyetje:

- ❧ Çfarë do të thotë *tes'hil*?
- ❧ Sa raste të *tes'hilit* ka në kiraetin e Asimit?
- ❧ Çfarë shenjë dalluese ka *tes'hili* nëpër mus'hefe?

¹⁰⁹ Përkufizimi në arabisht: (النُّطْقُ بِالْهَمْزَةِ الْمُسَهَّلَةِ بَيْنَ الْهَمْزَةِ الْمُحَقَّقَةِ وَحَرْفِ الْمَدِّ الْمُجَانِسِ لِحَرَكَتِهَا)

IMALE - الإِمَالَةُ

Imalja është një teknikë e rrallë në këndimin e Kur'anit, e cila në leximin e Hafsit nga Asimi paraqitet vetëm në një rast në krejt Kur'anin.

Fjala *imaleh* إِمَالَةٌ në aspektin gjuhësor do të thotë *anim* apo *pjerrësi*, kurse në aspektin terminologjik do të thotë “shqiptimi (animi) i fet’hasë kah kesreja apo i elifit të gjatë kah J-ja e gjatë”.

Ka dy lloje të imales:

1. *Imalja e vogël* (الإِمَالَةُ الصَّغْرَى) shqiptohet mes elifit dhe jaut, por më afër elifit. Kjo është e pranishme vetëm në kiraetet tjera, jo te Hafsi nga Asimi. Kjo ndryshe quhet edhe taklil.
2. *Imalja e madhe* (الإِمَالَةُ الْكُبْرَى) shqiptohet mes elifit dhe jaut, pa anuar kah asnjëra.

Te leximi i Asimit i transmetuar nga Hafsi njihet vetëm *imalja e madhe*, e cila paraqitet në një vend të vetëm në gjithë Kur'anin, më saktësisht në ajetin 41 të sures Hud: ﴿مَجْرِيهَا﴾ apo ﴿مَجْرِيهَا﴾.

Pra, këtu zgjatja realizohet e plotë (2 nota), por dallon vetëm lloji i Elifit që zgjatet.

Shenjë e imales te botimet arabe është një rreth i plotë dhe i rrumbullakët nën shkronjën R (●), kurse te botimet turke është shënimi i fjalës (إِمَالَةٌ) nën R. Ndonjë botim tjetër mund të ketë vendosur ndonjë shenjë ndryshe.

Pyetje:

- ❧ Çfarë do të thotë fjala imaleh?
- ❧ Si bëhet imalja?
- ❧ Sa raste të imales kemi në kiraetin e Asimit?
- ❧ Me cilat shenja përfaqësohet imaleja në mus'haf?

THEKSI - التَّخْرِ

Theks do të thotë shqiptimi me ton më të ngritur i një rrokjeje në një fjalë. Theksi është problem gjuhësor i cili hollësisht mësohet në fonetikë, por këtu do të trajtohet vetëm theksi i disa fjalëve të veçanta.

Profesori Ejmen Suvejd veçon pesë raste ku duhet vënë re theksin:¹¹⁰

1. Rrokja fundore e fjalëve që mbarojnë me tingull të dyfishuar, p.sh.: ﴿شَحَّ﴾, ﴿بَالِيرٍ﴾, ﴿فَاسْتَحَفَّ﴾, ﴿مُسْتَقَرٌّ﴾, ﴿لَعْفُو﴾, ﴿وَبَّتْ﴾, ﴿أَلْحَى﴾.

Këtu vjen në shprehje theksi vetëm gjatë ndaljes, ngase njëri tingull pothuaj nuk artikulohet, por përfaqësohet nga theksi. Nga ky rregull përjashtohen shkronjat e dyfishuara të *kalkales* (د, ج, ط, ب, ح, د) dhe të *gunnes* (م, ن), pra te këto nuk theksohet rrokja e fundit sepse dyfishimi ka tingëllimën apo gunnen.

2. Tingulli V (و) dhe J (ي) të dyfishuara në mes të fjalës, p.sh.:

﴿بَيِّنَتٍ﴾, ﴿يَتَأْتِيهَا﴾, ﴿كَصَبٍ﴾, ﴿إِيَّاكَ﴾, ﴿أَوَّلَ﴾, ﴿قَوَّامِينَ﴾, ﴿بِقُوَّةٍ﴾.

3. Kalimi nga zanorja e gjatë te shkronja e dyfishuar, p.sh.:

﴿حَافِينَ﴾, ﴿كَأَفَّةٍ﴾, ﴿خَاصَّةٍ﴾, ﴿أَلْحَافُهُ﴾, ﴿ضَالِّينَ﴾.

4. Zanorja e gjatë (medd apo lin) që përfundon me hemze gjatë ndaljes, p.sh.: ﴿يُضِئُ﴾, ﴿بَرِيءٌ﴾, ﴿فُرُوءٌ﴾, ﴿سُوءٌ﴾, ﴿وَالسَّمَاءُ﴾, ﴿يَشَاءُ﴾.

5. Në rastet kur nuk artikulohet elifi i dysisë apo vavi i shumësit për shkak të lidhjes, p.sh.: ﴿وَأَسْتَبَقَا الْبَابَ﴾, ﴿ذَاقَا الشَّجَرَةَ﴾. Këtu vjen në shprehje theksi për ta dalluar dysinë nga njëjësi.

Këto raste të theksit janë specifike e leximit të Kur'anit, kurse theksi fonetik është koncept më i gjerë dhe më i shpeshtë.

Pyetje:

- ❖ Çfarë është theksi?
- ❖ Ku vjen në shprehje theksi?
- ❖ Trego dallimin mes theksit fonetik dhe theksit kur'anor!

¹¹⁰ Ejmen Rushdi Suvejd, *Et-texhvidu el-musavveru*, vëllimi II, Damask, 2011

KREU X

TË GABUARIT NË LEXIM



- Gabimi i qartë
- Gabimi i fshehur

GABIMI GJATË LEXIMIT TË KUR'ANIT - اللَّحْنُ

Leximi i Kur'ani, si çdo ibadet tjetër, realizohet sipas normave dhe teknikave të përcaktuara nga Allahu [xhel-le she'nuhu] dhe të realizuara nga Muhamedi [alejhi selam], të cilat janë transmetuar me shkrim dhe gojarisht gjeneratë pas gjenerate deri në ditët tona pa u ndryshuar aspak.

Zbatimi dhe përmbajtja e këtyre rregullave është e domosdoshme, ndërsa lëshimi i ndonjëres nga rregullat e drejtleximit të Kur'anit apo çfarëdo lloj lëshimi që bie ndesh me njërin nga leximet e pranuara, llogaritet gabim. Varësisht nga shkalla e lëshimit që bëhet gjatë leximit, ashtu klasifikohet edhe lloji i gabimit.

Gabimet mund të bëhet me mus'haf të hapur, për shkak të moszotërimit të rregullave të texhvidit mirëfilli, por mund të bëhen edhe gjatë leximit përmendësh, ku kryesisht bëhen si rezultat i mospërvetësimit të denjë të pjesës së nxënë përmendësh.

Gabimet e mundshme gjatë leximit të Kur'anit janë kategorizuar në këto dy lloje:

Gabimi i qartë اللَّحْنُ الْجَلِيُّ

Gabimi i cili e çrregullon strukturën e vetë fjalës së lexuar, pavarësisht nëse e ndryshon apo nuk e ndryshon kuptimin e fjalës. Ky tip gabimi quhet i qartë, sepse vetë lëshimi bie shumë lehtë në sy, madje mund ta hetojë edhe lexuesi i thjeshtë.

Në vazhdim do t'i paraqesim tri fushat e mundshme ku mund ndodhë gabimi i qartë:

a) Gabimi në fjalë:

- Zëvendësimi i një fjale me një tjetër, p.sh. ﴿وَاللَّهُ عَزَّوَجَلِيلٌ﴾ dikush e lexon وَاللَّهُ عَزَّوَجَلِيلٌ, pra fjalën عَزَّوَجَلِيلٌ e zëvendëson me fjalën رَجِيمٌ. Gjithashtu, ndonjëherë mund të bëhet edhe zëvendësimi i një

fjalie të tërë me një tjetër, veçanërisht në përfundimet e ajeteve, të cilat përbëjnë një problem serioz edhe për vetë hafizët e Kur'anit Famëlartë.

- Shtimi i një fjale që nuk është pjesë e ajetit, p.sh. në ajetin 45 të sures Enfal ﴿...وَأَذْكُرُوا اللَّهَ كَثِيرًا لَّعَلَّكُمْ تُفْلِحُونَ﴾, dikush mund t'ia shtojë fjalën ذَكَّرَا, dhe del وَأَذْكُرُوا اللَّهَ كَثِيرًا لَّعَلَّكُمْ تُفْلِحُونَ ذَكَّرَا. Po ashtu, ka raste kur mund të shtohet edhe më shumë se një fjalë apo një fjali e tërë.
- Lëshimi i një fjale që është pjesë përbërëse e ajetit, p.sh. në ajetin 70 të sures Furkan ﴿إِلَّا مَنْ تَابَ وَآمَنَ وَعَمِلَ عَمَلًا صَالِحًا﴾, mund të lëshohet fjala عَمَلًا dhe del إِلَّا مَنْ تَابَ وَآمَنَ وَعَمِلَ صَالِحًا. Ndonjëherë mund të lëshohen edhe më shumë se një fjalë.

b) Gabimi në shkronjë:

- Zëvendësimi i një shkronje me një shkronjë tjetër, p.sh. الطَّائِفُ lexohet التَّائِفُ, shkronja ط ngatërrohet me ت; عَصَى lexohet عَصَى, shkronja ص ngatërrohet me س; مَحْذُورًا lexohet مَحْظُورًا, shkronja ط ngatërrohet me ذ etj.
- Shtimi i një shkronje (tingulli), p.sh. nëse në ajetin e fundit të sures Tekathur ﴿ثُمَّ لَنَسْأَلَنَّ يَوْمَئِذٍ عَنِ النَّعِيمِ﴾ “Pastaj, gjithsesi do të pyeteni atëherë për begatinë”, nëse ج- së i shtohet një elif, atëherë bëhet ح dhe del me kuptim të kundërt ثَمَّ لَنَسْأَلَنَّ يَوْمَئِذٍ عَنِ النَّعِيمِ “Pastaj, assesi nuk do të pyeteni atëherë për begatinë”. Ky rast tregon se një shkronjë mund ta ndryshojë krejtësisht kuptimin e fjalës, megjithatë ka edhe raste kur shtohet një shkronjë, por nuk ndryshon kuptimi kryesor i ajetit, p.sh. shtimi i pjesëzave و dhe فَ etj.
- Lëshimi i një shkronje (tingulli), p.sh. në ajetin 4 të sures Kafirun ﴿وَلَا أَنَا عَابِدٌ مَا عَبَدْتُمْ﴾, nëse لَا i hiqet elifi, atëherë ajeti del me kuptim krejt të kundërt dhe të gabuar وَلَئِنَّا عَابِدٌ مَا عَبَدْتُمْ “Gjithsesi, unë adhuroj atë që ju adhuroni”. Përveç gabimeve të cilat e ndryshojnë krejtësisht kuptimin e ajetit, ka edhe raste kur nuk preket në thelbin kuptimor të ajetit. Më të zakonshme janë lëshimet e lidhëzave وَ, فَ, etj.

c) Gabimi në vokale (hareke):

- Zëvendësimi i një zanoreje (hareke) me një zanore tjetër, p.sh. fjalën الْحَمْدُ لِلَّهِ dikush mund ta lexojë الْحَمْدُ لِلَّهِ, ku ndryshimi vokalit sigurisht që ndikon në kuptim, por nuk e tjetërsion kuptimin, kurse te fjala أَنْعَمْتُ عَلَيْهِمْ “ke furnizuar Ti”, nëse bëhet أَنْعَمْتُ عَلَيْهِمْ “kam furnizuar unë”, atëherë prek në thelbin e kuptimit dhe e deformon kuptimin e ajetit.
- Shtimi i një vokali të paqenë, p.sh. ajeti ﴿قُلْ هُوَ اللَّهُ أَحَدٌ﴾ lexohet gabimisht قُلْ هُوَ اللَّهُ أَحَدٌ, pra shtohet një damme.
Këtu bën pjesë, pra llogaritet gabim, edhe shqiptimi i vokalit të fundit gjatë ndaljes, kuptohet atëherë kur nuk duhet shqiptuar.
- Lëshimi i një zanoreje. Kjo mund të ndodhë që gjatë leximit të lëshohet një zanore çfarëdo qoftë ajo, megjithatë ky lloj gabimi është shumë i theksuar tek arabët, sepse një pjesë e tyre janë adaptuar që të mos i shqiptojnë vokalet e fundit të secilës fjalë, p.sh. الْحَمْدُ لِلَّهِ etj.

Sa u përket harekeve në fund të emrave duhet pasur një kujdes të veçantë sepse ato luajnë edhe rolin e mbaresave rasore, prandaj shpeshherë ndryshimi i tyre mund të jetë drastik në aspektin kuptimor, p.sh. ﴿إِنَّمَا يَخْشَى اللَّهَ مِنْ عِبَادِهِ الْعُلَمَاءُ﴾ “Vërtet Allahun nga robërit e Tij e kanë frikë vetëm dijetarët.”, nëse lexohet kështu إِنَّمَا يَخْشَى اللَّهَ مِنْ عِبَادِهِ الْعُلَمَاءُ “Vërtet Allahu nga robërit e Tij i ka frikë vetëm dijetarët”, kuptim i cili vjen në kundërshtim me parimet themelore të besimit islam. Këtë lloj gabimi Ebu Amër ed-Dani e quan edhe لَحْنُ الْإِعْرَابِ *gabim i mbaresave rasore*.

Gabimi i fshehur اللَّحْنُ الْخَفِيُّ

Gabimi i fshehur vjen në shprehje të rregullat e texhvidit, si p.sh. mbajtja hundore, shkrirja, zgjatja, shqiptimi i pastër etj.

Ky lloj i gabimit kryesisht lidhet me thyerje të një norme standarde të texhvidit, kurse gabimi i qartë, përveç lëshimit në fushën e texhvidit, shkakton edhe gabim gramatikor.

Gabimi i fshehur mund të jetë dylojësh:

1. Gabimi të cilin mund ta hetojë çdo lexues solid. Këtu bëjnë pjesë gabimet që ndërlidhen me realizimin apo mosrealizimin e një teknike të leximit. Pra, lexuesi nuk e bën një ihfa, idgam, zgjatje etj., ose ihfanë, igdamin, zgjatjen i bën aty ku nuk duhet.
2. Gabimi të cilin mund ta zbulojë vetëm profesionisti apo lexuesi i shkathët. Këtu nuk flitet për realizim apo mosrealizim e një teknike të leximit, por thjesht për kualitetin e zbatimit të tij, p.sh. nuk e bën ihfanë siç duhet, e mban më shumë apo më pak idgamin, e zgjat medin më pak apo më shumë se sa është e paraparë.

Në përgjithësi ky gabim nuk e ndryshon kuptimin thelbësor të fjalës apo të ajetit, edhe pse mund të prek ndonjë nuancë kuptimore dytësore.

Duhet spikatur fakti se gabimet nuk janë statike. Nëse një lëshim i caktuar llogaritet gabim në një kiraet, në tjetrin mund të mos jetë i tillë, p.sh. shqiptimi i fjalës **صِرَاط**, në disa kiraete lexohet **سِرَاط**, por shkrimi është i njëjtë (**صِرَاط**).

Dispozita e gabimeve

Gabimi çdoherë llogaritet gabim, ndërsa gabimtari mund të falet apo të merret në përgjegjësi nga Zoti [xhel-le she'nuhu]

Nëse lëshimi gjatë leximit të Kur'anit bëhet për shkak të mësimi, sepse askush nuk mësohet pa gabuar, atëherë për gabimet e këtilla të paqëllimta Allahu [xhel-le she'nuhu] nuk e ngarkon robin me përgjegjësi. Mirëpo, nëse lexuesi mund ta avancojë kualitetin e leximit, por ka stagnuar pa arsye, atëherë ka përgjegjësi para Zotit [xhel-le she'nuhu]

Dispozita e gabimeve varet prej vetë natyrës së gabimit. Aq sa është i madh gabimi, aq është i madh edhe mëkati.

Gabimin e qartë (të madh), ixhmai i dijetarëve e konsideron haram, kurse gabimin e fshehur, shumica e dijetarëve e llogarisin mekruh (të urryer), por ka prej tyre që thuan se është haram.

Gjithashtu, duhet theksuar se shqiptimi jo i drejtë i shkronjave (meharixh el-huruf) llogaritet gabim i qartë (i madh), si p.sh. fjala **﴿خَلَقَ﴾** ka krijuar të shqiptohet **خَلَقَ** ka rruar etj.

Gabimet më të shpeshta tek ne

Gabimet dhe lëshimet në leximin e Librit të Zotit në viset tona janë shumë dhe të llojllojshme. Thyerja e çdo rregulli apo teknike të leximit përbën një gabim, por ne do të përqendrohemi tek gabimet që bëhen më shpesh në trevat tona, prandaj nga përvoja dydekadëshe në mësimdhënien e Kur'anit Fisnik mund të përmbliidhen këto gabime, çdoherë duke marrë në konsideratë më të rëndësishmet dhe më të shpeshtat:

- Shqiptimi i tingujve emfatikë حُرُوفُ الْإِسْتِعْلَاءِ (حُصَّ ضَغْطُ قِطْ)
- Dallimi i elifit të gjatë të theksuar nga i patheksuari
- Dallimi i R-së së theksuar dhe të patheksuar
- Mbajtja e idgameve dhe e ihfave më pak se dy nota
- Mosmbajtja dy nota e M-së dhe N-së me teshdid

Këto janë vetëm disa gabime më të shpeshta që i kemi hasur me nxënësit dhe studentët tanë, por ka edhe raste të tjera aty-këtu.

Shumica e gabimeve vijnë si rezultat i lëshimeve që studentët i kanë bërë qysh në fazën e mektebit apo të mësimit fillestar të Kur'anit. Gjithashtu, një gabim i shpeshtë që bëhet nga mualimët e Kur'anit tek ne është se e kryejnë një hatme me talebet pa i mësuar asnjë rregull texhvidi. Ndoshta nuk duhet të mësohen të gjitha rregullat, por ato më të shpeshtat janë të nevojshme pasi të ketë fituar një shprehi minimale të leximit.

Pyetje:

- ❧ Si ndahet gabimi!
- ❧ Çfarë është gabimi i qartë!
- ❧ Çfarë është gabimi i fshehur!
- ❧ Ku mund të ndodh gabimi i qartë!
- ❧ Trego dispozitat e gabimeve në lexim të Kur'anit!
- ❧ Cilat janë gabimet më të shpeshta në mjediset tona?

KREU XI

HATMEJA DHE HIFZI



- Leximi sistematik dhe hatmeja
- Hifzi, nxënia e Kur'anit
- Metodologjia e mësimit të texhvidit

LEXIMI SISTEMATIK DHE HATMEJA

Gjëja më e dashur tek Allahu [xhel-le she'nuhu] është puna sistematike apo puna e mirë që ka marrë formën e traditës (së vetëdijshme), pavarësisht sasisë së saj. Transmeton Muslimi nga Aishja [radijall-llahu anhu] se Pejgamberi [alejhi selam] u pyet: **“Cila punë është më e dashur tek Allahu?”** – Ai tha: **“Ajo që është e vazhdueshme, qoftë edhe pak”**.¹¹¹ Ky dhe shumë tekste tjera fetare flasin për rëndësinë e sistemit të punëve në jetën e besimtarit, ndër të tjerash edhe leximi i Kur'anit.

Për të formuar një sistem në leximin e Kur'anit duhet parë se si e ka lexuar atë Muhamedi [alejhi selam], sahabët, tabiinët etj.

Leximi më i ngadalshëm

Tekstet fetare nxisin që të lexohet sa më shumë Kur'an, mirëpo dije-tarët kanë diskutuar për kohën maksimale të leximit të një hatmeje: hane-fitët mendojnë se Kur'ani duhet të bëhet hatme (së paku) çdo dyzet ditë (nga hafizi), sepse me të synohet kuptimi i domethënies së Kur'anit dhe jo vetëm leximi i thjeshtë.¹¹² Allahu i Lartësuar në Kur'anin Fisnik thotë: ﴿أَفَلَا يَتَذَكَّرُونَ الْقُرْآنَ أَمْ عَلَىٰ قُلُوبٍ أَقْفَالُهَا﴾ **“A nuk e meditoni Kur'anin apo zemrat kanë drynat e tyre?!”** (Muhamed, 24). Këtë mendim e mbajnë edhe ma-likitët, kurse hanbelitët mendojnë se është mekruh (e urryer) të vonohet hatmja më shumë se dyzet ditë, e nëse sundon frika e harresës, atëherë vonimi më shumë se dyzet ditë është haram sipas hanbelitëve.¹¹³ Mendi-mi për 40 ditët mbështetet në hadithin e Muhamedit [alejhi selam] të transmetuar nga Abdullah bin Amër, i cili e ka pyetur të Dërguarin e Allahut: **“Për sa kohë duhet lexuar Kur'ani?”** Tha: **“Për dyzet ditë”**, pastaj tha: **“Për tridhjetë ditë.”**, pastaj tha: **“Për njëzet ditë”**, pastaj tha: **“Për pesëmbëdhjetë**

¹¹¹ El-Imam Muslim, *Sahihu Muslim*, Dar Tajjibeh: 2006, hadithi nr. 216 (782), f. 354

¹¹² Ministria e Vakfit dhe e Çështjeve Fetare, *El-Meusuatu el-Fikhijjetu el-Kuvejtijjetu*, vëllimi 33, Daru Es-Safvetu, Egjipt: 1995, f. 58

¹¹³ El-Adevij ala sherhi er-risaleti, 2/448; Metalibu uli en-nuha, 1/604

ditë." Pastaj tha: "Për dhjetë ditë." dhe në fund nuk zbriti nën shtatë ditë."¹¹⁴ Megjithatë, transmetohet nga Ebu Hanifja [radijall-llahu anhu] të ketë thënë: "Kush e lexon Kur'anin dy herë në vit e ka përmbushur detyrën (farzin) ndaj tij."¹¹⁵ Mendimi i Ebu Hanifes mbështetet në leximin e fundit që Xhibrili i bëri Muhamedit [alejhi selam].

Leximi më i shpejtë

Hanefitët shprehen se nuk preferohet leximi i Kur'ani më shpejtë se tri ditë.¹¹⁶ Transmeton Abdullah bin Amër, se Muhamedi [alejhi selam] ka thënë: "Nuk e kupton ai që e lexon Kur'anin për më pak se tri ditë."¹¹⁷

Nëse i referohemi historisë islame, shohim se disa e kanë lejuar leximin më pak se tri ditë e disa të tjerë jo. Pa dashur t'i futemi këtij diskutimi, leximi më pak se tri ditë është çështje subjektive dhe individuale. Ka edhe të atillë që mendojnë se minimumi i preferuar është shtatë ditë, dhe ky mendim është më i preferuar për ditët minimale të leximit të Kur'anit.

Leximi sistematik i Muhamedit [alejhi selam]

Në menaxhimin e kohës së leximit të Kur'anit duhet marrë parasysh shumë rrethana, prandaj për lexuesin e rëndomë do të ishte mirë që hatmja të mos i zgjasë më shumë se një muaj apo dyzet ditë, kurse lexuesi i përkushtuar apo hafizi është mirë të ndjekë traditën Pejgamberike, pra ta lexojë Kur'anin për shtatë ditë.

Transmeton Evi bin Hudhejfe: *shkuam te Muhamedi [alejhi selam] me një delegacion nga fisi Thekif, kurse ai atë natë u vonua. Kur doli, tha: "E kisha për ta lexuar pjesën nga Kur'ani, prandaj nuk desha të dalë pa e lexuar atë." I pyetëm shokët e tij: "Si e ndan Muhamedi [alejhi selam] leximin e*

¹¹⁴ Ebu Davud, "Kitabu es-salati", kreu "Tahzibu el-Kur'an", hadithit numër 7443

¹¹⁵ Ministria e Vakfit dhe e Çështjeve Fetare, *vep. e cit.*, f. 59

¹¹⁶ Ganijjetu el-mutemel-li 496; tebjinu el-hakaiki 6/229; Ed-dur-retu el-muhtaru mea hashijeti Ibn Abidin 5/482

¹¹⁷ Sunenu Ebi Davud, hadithit 1394

*Kur'anit?" Thanë: "Tri, pesë, shtatë, nëntë, njëmbëdhjetë, trembëdhjetë dhe suret e shkurtra."*¹¹⁸ Në bazë të këtij hadithi, studiuesit e disiplinave kur'anore çdonjëren nga shtatë pjesët e ka përfaqësuar me shkronjën e parë të sures me të cilën fillon pjesa, pastaj i kanë vendosur në togun فمي بشوق (F, M, J, B, Sh, V dhe K).

Ditët	(فمي بشوق) - (F, M, J, B, Sh, V dhe K)			Gjithsej sure:
1.	F: Fatiha	→	Nisa	3 (pa Fatiha)
2.	M: Maide	→	Tevbe	5 sure
3.	J: Junus	→	Nahl	7 sure
4.	B: Beni Israil (Isra)	→	Furkan	9 sure
5.	Sh: Shuara'	→	Jasin	11 sure
6.	V: Ves'saf' fatu	→	Huxhurat	13 sure
7.	K: Kaf	→	deri në fund	65 sure

Ky është leximi sistematik i Muhamedit [alejhi selam], sipas të cilit Kur'ani përfundohet për një javë të plotë.

Megjithatë, me rëndësi të veçantë është raporti ynë i vazhdueshëm me Kur'anin dhe jo sasia e leximit, sepse më mirë është të lexohet çdo ditë apo sistematikisht dhe nga pak, sesa një herë lexon shumë, pastaj një kohë nuk lexon fare.

Përfundimi i njërës hatme dhe fillimi i tjetrës

Preferohet që sa herë të përfundohet një hatme, të fillohet tjetra. Pasi të përfundohet surja Nas, të lexohet surja Fatiha dhe pesë ajetet e para të sures Bekare,¹¹⁹ deri te pjesa ﴿وَأُولَٰئِكَ هُمُ الْمُفْلِحُونَ﴾, pastaj të bëhet lutja e hatmes.

¹¹⁸ Ibn Haxher El-Askalani, *El-Futuhatu er-rebbaniyyetu*, 3/229. Gjithashtu, e ka transmetuar Ebu Davudi (1393), Ibn Maxhe (1345) etj. Hadithi është *hasen*.

¹¹⁹ Abdullah Siraxhuddin, *Tilavetu el-Kur'ani el-Mexhidi*, botimi IV, Daru El-Felah, Haleb: 2002, f. 186

Transmetohet nga Abdullah ibn Abbasi [radijall-llahu anhu] se një njeri pyeti: “O i Dërguari i Allahut, cila punë është më e mirë?” Muhamedi [alejhi selam] i tha: “الْحَالُ الْمُرْتَحِلُ – *el-hal-lu el-murtehilu*” Ai pyeti: “Çfarë është الْحَالُ الْمُرْتَحِلُ – *el-hal-lu el-murtehilu*?” Muhamedi [alejhi selam] ia ktheu: “Ai që e lexon Kur’anin nga fillimi në fund dhe nga fundi në fillim.”¹²⁰

Tehlili, tekbiri dhe tahmidi

Një veprim tjetër i pëlqyer gjatë leximit të Kur’anit (gjatë hatmes) është që menjëherë pas sures *Ved-duha*, dhe pastaj pas çdo sureje deri në fund të Kur’anit, të lexohet *tehlili*, *tekbiri* dhe *tahmidi*, gjegjësisht fraza اللَّهُ أَكْبَرُ، وَاللَّهُ أَكْبَرُ، وَاللَّهُ أَكْبَرُ، وَاللَّهُ أَكْبَرُ. “Nuk ka zot tjetër përpos Allahut. Allahu është më i Madhi. Allahut i takon falënderimi.”¹²¹ Shumica e atyre që e pranojnë këtë sunet, preferojnë vetëm tekbirin.

Ky veprim është i njohur vetëm në kiraetin e Ibn Kethirit dhe jo në kiraetet tjera. Ne e kemi paraqitur sepse është një sunet që është praktikuar edhe në viset tona për shekuj me radhë, prandaj ia vlen të dihet dhe të praktikohet. Për këtë imam Shafi u ka thënë: “Nëse e le tekbirin, ke lënë një sunet të Pejgamberit [alejhi selam].”¹²² Ky prononcim i imam Shafiut është një dëshmi e fortë e kësaj tradite pejgamberike.

Ferrai thekson se pasi Muhamedit iu vonua shpallja, i erdhi Xhibrili [alejhi selam] dhe ia shpalli gjithë suren *Ed-Duha*, kurse Muhamedi [alejhi selam] nga gëzimi dhe hareja tha “Allahu ekber”.¹²³

Transmetohet nga Ahmed bin Muhammed El-Bezzij (njëri nga transmetuesit e kiraetit të Ibn Kethir El-Mekkiut), të ketë thënë: e kam dëgjuar Ikreme bin Sulejmanin të thotë: kam lexuar (Kur’an) para

¹²⁰ Ebu Neimi, *Hiljetu el-evlijai*, 2/295; Dhehebiu, *Sijeru a’lami en-nubelai*, 4/516; Tirmidhiu, *Sunen et-Tirmidhi*, hadithi nr. 2948; Hakimi, *El-Mustedreku*, 1/568-579

¹²¹ Shih: Ibn El-Xhezerij, *Tekribu en-neshri fi el-kiraati el-ashri*, Bejrut, Daru El-Kutubi El-Ilmijeti, 2002, f. 206-208; dhe të gjitha librat tjerë të kiraeteve.

¹²² Ibn El-Xhezerij, *Tekribu en-neshri fi el-kiraati el-ashri*, Bejrut, Daru El-Kutubi El-Ilmijeti, 2002, f. 207

¹²³ Ibn Kethiri, *Tefsiru el-Kur’ani el-Adhim*, vëllimi XIV, El-Faruk El-Haditheh li Et-Titaati ve En-Neshri, Kajro, 2000, f. 380

Ismail bin Abdullah bin Kostantinit, e kur kam mbërritur te surja “Ved-duha” më tha: “Merr tekbir në fund të çdo sures deri në fund, se unë kam lexuar para Abdullah bin Kethirit, e kur mbërrita te “Ved-duha” më tha: merr tekbire deri në fund.” Abdullah bin Kethiri e pat informuar se ai ka lexuar para Muxhahidit dhe e ka urdhëruar njësoj. Muxhahidi tregon se Ibn Abbasi e ka urdhëruar të veprojë ashtu. Ibn Abbasi tregon se Ubejj bin Ka’bi e ka urdhëruar ashtu, kurse Ubejj bin Ka’bi tregon se i Dërguari i Allahut e ka urdhëruar të veprojë kështu.” Hakimi thotë se ky hadith është sahih, por dy imamët nuk e kanë dhënë.¹²⁴

Tubimi i njerëzve për hatme

Tubimi i njerëzve në përfundimin e hatmes është një vepër shumë e pëlqyer. Preferohet tubimi i të afërmeve dhe i njerëzve të tjerë, sepse aty zbret mëshira e Allahut.

Këtë e pohon edhe hadithit i transmetuar nga Ebu Hurejra, ku Muhamedi [alejhi selam] ka thënë: “...Çdoherë kur tubohen njerëzit në një shtëpi prej shtëpive të Allahut, lexojnë Kur’anin, e mësojnë atë mes tyre, mbi ta zbret qetësia, i kaplon mëshira, i rrethojnë melekët dhe Allahu i përmend tek ata që janë tek Ai....”¹²⁵ Ky hadith edhe pse duket pak më i përgjithshëm, por pa asnjë dyshim e përfshin edhe rastin e tubimit për duanë e përmbylljes së leximit të Kur’anit. Jo rastësisht fillimi i kësaj pjese të hadithit është “*çdoherë kur tubohen njerëzit në një shtëpi të Zotit*”, d.m.th. bëhet fjalë për çdo tubim të hairit që bëhet brenda shtëpive të Zotit. Pastaj si veprim të parë e përmend “*lexojnë librin e Allahut*”, e që dihet se kur bëhet duaja e hatmeve nëpër xhamitë tona, fillimisht lexohen suret e fundit të Kur’anit pastaj bëhet duaja, pra, lexohet Kur’ani. Kështu që, ky hadith lirisht mund të merret si dëshmi edhe për prezantimin e njerëzve në rastet e duave të hatmeve.

¹²⁴ Kurtubiu në tefsirin e vet, 20/29 dhe tutje; Dhehebiu në “Ma’rifetu el-kurrai el-kibari, 1/175

¹²⁵ Muslimi, *Sahihu Muslimi*, hadithit: 2699

Transmetohet se Ibn Abasi [radijall-llahu anhu] kishte angazhuar një njeri për t'i vëzhguar ata që lexojnë Kur'an. Kur ata dëshironin ta përfundojnë atë, ai e informonte Ibn Abasin të marrë pjesë aty (në lutjen e fundit)."¹²⁶

Shoqëruesi i Enesit [radijall-llahu anhu] thotë: "Kur Enesi e bënte hatme Kur'anin, e tubonte familjen e vet dhe lutej."¹²⁷

Këto dhe shumë argumente tjera dëshmojnë legjitimitetin e tubimit të njerëzve në rastet e përfundimit të Kur'anit.

Fatmirësisht një veprim i tillë është traditë edhe në viset tona, ku me rastin e hatmeve që bëhen nga nxënësit e mektebeve, në hatmet e mukabeleve të Ramazanit dhe në hatmet e shumë rasteve të tjera, tubohen dhe marrin pjesë shumë njerëz, sepse bëhet dua e hatmes. Pra, tubimi në rastet e këtilla është një veprim që ka mbështetje në traditën pejgamberike, në traditën e gjeneratave të para të muslimanëve dhe fatmirësisht edhe në traditën tonë.

Mbyllja e hatmes me lutje

Imam Neveviu pohon se është mustehab i fortë (gjegjësisht sunet) të bëhet një lutje në fund të hatmes. Po ashtu, imam Neveviu thotë se përfunduesi i hatmes duhet të jetë këmbëngulës në lutje, të lutet për punë të rëndësishme, të shtojë lutjet për përmirësimin e muslimanëve dhe të udhëheqësve të tyre etj.¹²⁸

Irbad ibn Sarijeh [radijall-llahu anhu] ka transmetuar se Muhamedi [alejhi selam] ka thënë: "Kush fal një namaz farz, ka një lutje të pranuar. Po ashtu, kush e bën hatme (e përfundon) Kur'anin ka një lutje të pranuar."¹²⁹

¹²⁶ Darimiu, *Musned Ed-Darimij*, hadithi 3515

¹²⁷ Darimiu, *Musned Ed-Darimij*, hadithi 3517; Taberaniu, *El-Xhamiu el-Kebiru*, 1/242; Bejheku, *Shuabu el-imani*, hadithi 1907 etj.

¹²⁸ Imam Neveviu, *Et-Tibjan fi adabi hameleti el-Kur'ani*, botimi II, Daru el-Min'haxhi, Arabi Saudite - Xhide: 2011, f. 183-184

¹²⁹ Taberani, *El-Xhamiu es-sagiru*, 18/259

Transmetohet nga Enesi [radijall-llahu anhu] me hadith merfu': "Kush e lexon Kur'anin (hatme), e falënderon Zotin, çon salavat për Pejgamberin dhe i kërkon falje Zotit të vet, ka kërkuar mirësitë që në atë vend."¹³⁰

Përveç këtyre haditheve, ka edhe shumë hadithe të tjera dhe prononcime të gjeneratave të para për këtë çështje. Përveç kësaj, ka edhe shumë hadithe merfu'¹³¹ dhe mevkuf¹³² që i tregojnë edhe lutjet se cilat janë praktikuar, të cilat nëse shihen me vëmendje, atëherë do të shohim se janë pikërisht ato lutje që janë të shënuara në fund të mus'hafeve.¹³³

Pyetje:

- ❧ Cila punë është më e dashur te Allahu?
- ❧ Cila është koha maksimale për leximin e një hatmeje?
- ❧ Sa hatme në vit duhet bërë sipas Ebu Hanifes?
- ❧ Cila është koha minimale për leximin e një hatmeje?
- ❧ Çfarë leximi sistematik ka bërë Muhamedi [alejhi selam]?
- ❧ Si lidhen hatmet me njëra-tjetrën?
- ❧ Çfarë është sunet të veprohet nga ved-duha dhe deri në fund, pra pas leximit të çdo sureje?
- ❧ Përse preferohet tubimi i njerëzve në përfundimin e hatmes?
- ❧ Çfarë lutje preferohet në fund të hatmes?

¹³⁰ Bejhekiu, *Shuabu el-imani*, hadithit nr. 2084, vëllimi II, f. 853

¹³¹ Hadithi që transmetohet me zinxhir nga Muhamedi [alejhi selam]

¹³² Fjalët apo veprimet e transmetuara nga sahabët që nuk mbërrijnë deri te Muhamedi [alejhi selam]

¹³³ Shih gjerësisht veprat: Imam Neveviu, *Et-Tibjan fi adabi hameleti el-Kur'ani*, botimi II, Daru el-Min'haxhi, Arabi Saudite – Xhide; Abdullah Seraxhuddin, *Tilavetu el-Kur'ani el-Mexhidi*, botimi IV, Daru El-Felah, Haleb: 2002, etj.

HIFZI, NXËNIA E KUR'ANIT

Nxënia e Kur'anit në historinë islame ka filluar me Muhamedin [alejhi selam]. Në ditët e para të shpalljes, Muhamedi [alejhi selam] i pëshpëriste ajetet që i shpallëshin, nga frika e harresës, mirëpo Allahu [xhel-le she'nuhu] i kërkoi që të mos frikësohet dhe as të pëshpëritë me ngutje, sepse puna e ruajtjes (nxënies) së Kur'anit i takon Allahut. Për këtë çështje kanë zbritur këto ajete të sures el-Kijameh:

﴿لَا تُحَرِّكْ بِهِ لِسَانَكَ لِتَعْجَلَ بِهِ ۚ إِنَّ عَلَيْنَا جَمْعَهُ وَقُرْآنَهُ ۚ فَإِذَا قَرَأْتَهُ فَاتَّبِعْ قُرْآنَهُ ۚ ثُمَّ إِنَّ عَلَيْنَا بَيَانَهُ﴾

“16. Ti (Muhammed) mos shqipto atë (Kur'anin) me gjuhën tënde për ta nxënë atë me të shpejtë! 17. Sepse Ne e kemi për detyrë tubimin dhe leximin e tij! 18. E kur ta lexojnë atë ty, ti përcille me të dëgjuar leximin e tij. 19. Dhe pastaj është obligim i yni që ta shkoqisim atë.”

Këto ajete garantojnë nxënien e përkryer dhe pa asnjë lëshim të Kur'anit në tërë qenien e Muhamedit [alejhi selam]. Kjo njëherësh e përjashton mundësinë e ndonjë lëshimi në Kur'an nga ana e Muhamdit [alejhi selam]. Pastaj, ajeti i nëntë i sures Hixhr ﴿إِنَّا نَحْنُ نَزَّلْنَا الذِّكْرَ وَإِنَّا لَهُ لَحَافِظُونَ﴾ ***“Ne e zbritëm Dhikrin (Kur'anin) dhe ne jemi mbrojtësit e tij.”***, garanton se Allahu këtë libër do ta mbrojë edhe pas vdekjes së Muhamedit [alejhi selam]. Një ndër mënyrat e mbrojtjes së Kur'anit është edhe nxënia e tij përmendsh. Kështu që, nga dita e parë kur Kur'ani filloi të zbriste, numri i hafizëve nëpër botë sa vjen e shtohet, saqë vetëm në viset tona kemi qindra, ndoshta edhe mijëra hafizë, kurse në nivel botëror kap shifrën e disa milionëve.

Vlera dhe rëndësia

Dhuntia më madhështore me të cilën Allahu e ka veçuar umetin e Muhamedit [alejhi selam], duke e dalluar nga umetet e pejgamberëve paraprakë, është se zemrat e tyre i bëri enë të fjalës së Vet, kurse

kraharorët e tyre i bëri mus'hafë (regjistra) të ajeteve të Tij, të cilat nuk mund t'i shpërlajë asnjë vërshim uji dhe as mund t'i fshijë kurthi i ndonjë armiku.¹³⁴

Zoti i Madhërishëm për mbrojtjen e Kur'anit ka përgatitur një ushtri të tërë prej melekëve dhe njerëzve, me mekanizma të ndryshëm. Prandaj, vlera më e madhe e nxënies së Kur'anit është të qenët ushtar i kësaj ushtrie madhështore dhe shumë fisnike.

Allahu [xhel-le she'nuhu] në ajetin 49 të sures Ankebut, për vlerën e hafizëve thotë: ﴿بَلْ هُوَ آيَاتٌ بَيِّنَاتٌ فِي صُدُورِ الَّذِينَ أُوتُوا الْعِلْمَ وَمَا يَجْحَدُ بِآيَاتِنَا إِلَّا الظَّالِمُونَ﴾ **“Por jo, ai (Kur’ani) është plot argumente të qarta në kraharorët e atyre që u është dhënë dituria, e argumentet Tona nuk i mohon kush pos të shfrenuarve”.**

Transmetohet se Muhamedi [alejhi selam] ka thënë: “Atij që Zoti i ka falë nxënien e Libri të Tij, dhe mendon se dikujt tjetër i është dhënë diç më e mirë, ka gabuar (ka përçmuar dhuntinë e Zotit)”¹³⁵

Transmetohet nga Enesi [radijall-llahu anhu] se Muhamedi [alejhi selam] ka thënë: “Kur përfundova me punët e qiellit dhe të tokës me të cilat Allahu më kishte urdhëruar (natën e miraxhit), i thashë: “Zoti im, çdo pejgamber para meje e keni nderuar: Ibrahimin e bëre mik Tëndin, Musën e privilegjove të flasë me Ty, Davudit ia nënshtrove kodrat, Sulejmanit ia nënshtrove erën dhe shejtanët, për Isën i ngjalle të vdekurit, ndërsa për mua çfarë keni përgatitur?” (Allahu) i tha: “A nuk të kam dhënë ty gjëra më me vlerë se krejt këto?! Sa herë që përmendem Unë, përmendesh edhe ti. Kraharorët e umetit tënd i kam bërë mus'hafe dhe e lexojnë Kur'anin përmendsh. Këto nuk ia kam dhënë asnjë umeti para teje. Po ashtu, të kam dhënë nga thesaret e fronit Tim, e ajo është fraza “la havle ve la kuvvete il-la bil-lahi el-azizi el-adhimi” (Nuk ka forcë dhe fuqi tjetër pos Allahut të Lartësuar dhe të Madhërishëm).”¹³⁶

Transmetohet se Pejgamberi [alejhi selam] ka thënë: “Nëse Kur’ani është i pranishëm në një membranë (zemër), atë nuk e prek zjarri.”¹³⁷

¹³⁴ Abdullah Seraxhudin, *Tilavetu el-Kur'ani el-Mexhidi*, Daru El-Felah, Haleb: 2002, f. 95

¹³⁵ Sujutiu, *El-Xhamiu es-sagiru*, hadithit 8462 (hadith mursel).

¹³⁶ Ibn Kethir, *El-Bidajetu ve en-nihajetu*, 6/288

¹³⁷ Buhariu, *Tedhkiretu el-huffadhi*, 265

Transmeton Abdullah ibn Abbasi [radijall-llahu anhu] se Muhamedi [alejhi selam] ka thënë: “Fisnikët e umetit tim janë bartësit (hafizët) e Kur’anit dhe ata që bëjnë adhurim natën (vazhdimisht).”¹³⁸

Transmeton Abdullah bin Amër, se Pejgamberi [alejhi selam] ka thënë: “Do t’i thuhet shoqëruesit (lexuesit apo hafizit) të Kur’anit (Ditën e Kiametit): *lexo, ngjitu dhe këndo siç ke kënduar në dynja! Vendi yt (në xhenet) është në ajetin e fundit që do ta lexosh.*”¹³⁹ Ky hadith tregon se aq ajete sa kemi ditur në dynja, aq gradë do të lartësohemi në Xhenet.

Nxënia e Kur’anit përmendsh nuk është e dobishme vetëm për hafizin, por edhe për rrethin e tij, veçanërisht për prindërit dhe familjen, sepse Muhamedi [alejhi selam] ka thënë: “*Kush lexon Kur’an, e mëson përmendsh atë, hallallin e bën hallall dhe haramin e bën haram, Allahu për këtë do ta fusë në Xhenet dhe do t’i jep mundësinë e ndërmjetësimit (shefaatit) për dhjetë anëtarë të familjes të cilëve është bërë detyrim zjarri.*”¹⁴⁰ Krahës këtij hadithit, dihet se prezenca e një hafizi të Kur’anit në një mjedis të caktuar është e bereqetshme.

Hafizi ka edhe përfitime shkencore, sepse studiuesi i disiplinave islame që është hafiz i Kur’anit ka një pasqyrë më të pastër të ajeteve për gjithçka që mund t’i duhet.

Nxënies së Kur’anit i shtohet edhe më shumë vlera nëse ai kuptohet dhe praktikohet. Nëse hafizi e kupton atë që ka nxënë, atëherë llogaritet se ka një këshillues kudo që shkon, sepse në çdo pore të jetës së tij kujtesa do t’i nxjerrë përpara një ajet që do t’ia pasqyrojë atë situatë dhe do ta këshillojë.

Hafizi i denjë ka shpirt të qetë, memorie të freskët, ndjesi të qëndrueshme, është i shoqërueshëm, i dobishëm dhe shumë i vëmendshëm. Pra, hafizi është sinonim dhe shëmbëlltyrë e muslimanit shembullor.

Sigurisht, këtu bëhet fjalë për hafizët e mirëfilltë, të cilët e nxënë dhe vazhdojnë të kujdesen për nxënien. Këtu nuk është fjala për hafizët që vetëm e kanë nxënë Kur’anin dhe pastaj e kanë lënë mënjanë.

¹³⁸ El-Mundhirij, *Et-Tergibu ve et-terhibu*, 1/294

¹³⁹ Tirmidhiu, *Sunen et-Tirmidhi*, hadithi: 2914

¹⁴⁰ Tirmidhiu, *Sunen et-Tirmidhi*, hadithi: 2905

Hafizi do të arrijë vlerën e duhur atëherë kur do të jetë vazhdimisht në shoqërinë e Kur'anit, sepse vetëm atëherë mund të quhet hafiz me plot kuptimin e fjalës, dhe kur mësimet kur'anore të reflektojnë në moralin dhe jetën e tij të përditshme.

Parimet e përgjithshme për nxënien e Kur'anit

Nxënia e Kur'anit përmendësh është një punë shumë e lavdishme, prandaj duhet përmbushur dhe respektuar disa parime të përgjithshme:

1. Singëriteti vetëm për Allahun. Jo vetëm nxënia përmendsh e Kur'anit Fisnik, por çdo ibadet duhet bërë me nijet të singërtë ndaj Allahut, prandaj i Plotfuqishmi thotë: **“E ata (besimtarët) u urdhëruan që të adhuronin Allahun me përkushtim të singërtë...”** (El-Bejjine, 5).

Mësimi apo nxënia përmendsh e Kur'anit, qoftë gjithë Kur'anin apo një pjesë të tij, bëhet vetëm për hir të Allahut. Në mungesë të singëritetit, atëherë vjen në shprehje interesi personal, syfaqësia, mburrja, reputacioni apo fama, të cilat jo vetëm se e pengojnë nxënien e Kur'anit, por edhe shkaktojnë probleme në besim, sepse me këtë rast Kur'ani shfrytëzohet për përfitime të kësaj bote.

Megjithatë, duhet pasur kujdes nga vesveset (cytjet) e shejtanit, sepse ai di ta shndërrojë singëritetin në pengesë për nxënien e Kur'anit, ngase u pëshpërit kështu “pasi ti nuk mund të bëhesh plotësisht i singërtë, atëherë më mirë është që të mos e mësosh fare atë”.

Nëse pretenduesi për t'u bërë hafiz është fëmijë, atëherë pas theksimit të vazhdueshëm të singëritetit ndaj Zotit [xhel-le she'nuhu] dhe pas përpjekjes për ta lidhur emocionalisht me Librin e Tij, mund t'i jepet edhe ndonjë stimul tjetër, por çdoherë duke pasur kujdes që stimuli mos t'i kalojë në synim parësor dhe të vetëm.

2. Shmangia e mëkateve. Besimtari që ka shprehur dëshirë të mësojë Kur'anin përmendësh duhet t'u shmanget mëkateve: të distancohet nga gjërat e ndaluara dhe t'i realizojë me përpikëri detyrimet. Po ashtu, për mëkatet e kaluara duhet të pendohet dhe të kërkojë falje.

Çdo mëkat ndikon në kujtesën e njeriut, sepse mëkati konsiderohet thyerje e natyrshmërisë njerëzore, e njeriu sa herë që prek natyrshmërinë, kujtesa është e angazhuar për të luftuar me të panatyrshmen, prandaj dhe dobësohet. Veçanërisht kur vjen në shprehje fjala e Zotit, ajo çdoherë bëhet e vështirë për mëkatarin, madje edhe nëse e mëson, nuk do ta ketë për gjatë kohë.

Transmetohet se Imam Shafiu një herë i ishte ankuar mësuesit për dobësimin e nxënies, sepse para kësaj e kishte nxënë një faqe nga Kur'ani me një të lexuar. Mësuesi i kërkoi që të heqë dorë nga mëkatet. Imam Shafiu këshillën e mësuesit e hedh në poezi dhe thotë:

<i>U ankova te Vekiu për dobësinë e nxënies</i>	شَكَوْتُ إِلَى وَكَيْعٍ سُوءَ حِفْظِي
<i>Më udhëzoi që t'i la mëkatet</i>	فَأَرَشَدَنِي إِلَى تَرْكِ الْمَعَاصِي
<i>Më tha se dituria është dritë</i>	وَقَالَ لِي إِنَّ الْعِلْمَ نُورٌ
<i>E drita Zotit nuk i jepet mëkatarit</i>	وَنُورُ اللَّهِ لَا يُهْدَى لِلْعَاصِي

3. Dashuria ndaj Kur'anit. Dashuria është lëvizësi dhe motivuesi kryesor i çdo aktiviteti në jetën njerëzore. Aq sa njeriu ka dashuri ndaj Zoti, aq do të ketë edhe dashuri ndaj Librit të Zotit. Pastaj niveli i dashurisë ndaj Librit të Zotit shihet në vetë raportin e besimtarit me këtë Libër. Nuk ka asnjë kuptim që njeriu ta do Zotin dhe Librin e Tij, kurse në anën tjetër të mos i kushtojë aspak vëmendje fjalës së Tij, Muhamedi [alejhi selam] ka thënë: "...njeriu është me atë që e do."¹⁴¹ Pra, nëse duam që të reflektojmë dashuria jonë ndaj Zotit dhe ndaj Librit të Tij, atëherë duhet të merremi më shumë me të dhe të punojmë që sa më shumë ta nxëmë atë. Gjithashtu, kur besimtari nuk merret shumë me Kur'an, problemin duhet ta kërkojmë te raporti apo dashuria e zemrës së tij me Zotin.

4. Nxënia në vegjëli. Pa dyshim se nxënia në vegjëli është më e fuqishme se nxënie në moshë të shtyrë, prandaj është e njohur thënia "Nxënia në vegjëli si gdhendja mbi gurë, kurse nxënia në pleqëri si shkrimi mbi ujë."

¹⁴¹ Shuajb Arnauti, *Tahrirhu El-Musned*, hadithi: 13388

Njeriu kur lind e ka shumë të fuqishme aftësinë e nxënies dhe shumë të dobët aftësinë e të kuptuarit. Pastaj duke u rritur, aftësia e nxënies dobësohet, kurse aftësia e të kuptuarit rritet, derisa të arrijë moshën afërsisht njëzet e pesë vjeçe, ku të dy aftësitë janë në nivel pothuaj të barabartë. Pas kësaj moshe, aftësia e nxënies fillon të bjerë, kurse aftësia e të kuptuarit rritet. Kjo ndodh në rrethana normale, mirëpo kur ndërhysh ndonjë *faktor i jashtëm*, atëherë situata ndryshon krejtësisht. Kush është faktori i jashtëm? Faktor i jashtëm është pasioni, vendosmëria, vullneti, përkushtimi dhe dashuria e flakët ndaj Zotit. Pra, nëse është i pranishëm ky faktor i jashtëm, atëherë nxënia e Kur'anit është punë shumë e lehtë dhe aspak e vështirë. Ka shumë njerëz që edhe pas viteve të dyzeta, pesëdhjeta dhe shtatëdhjeta e kanë mësuar përmendësh Kur'anin.¹⁴²

5. Përzgjedhja e kohës dhe vendit. Për t'u përqendruar në nxënie të Kur'anit duhet përzgjedhur kohën dhe vendin e përshtatshëm për realizimin e saj, sepse nxënie nuk e njëjtë në çdo vend dhe në çdo kohë.

Koha më e përshtatshme për nxënie është agimi i hershëm. Allahu i Madhërishëm thotë: ﴿وَقُرْآنَ الْفَجْرِ إِنَّ قُرْآنَ الْفَجْرِ كَانَ مَشْهُودًا﴾ **"...Kur'ani (namazi) i agimit. Vërtet Kur'ani i agimit është i dëshmuar."** (El-Isra, 78). Imam Ibn Xhemaah thotë: "Koha më e mirë për nxënie është agimi i hershëm, për hulumtim është mëngjesi, për shkrim është mesdita, kurse për lexim dhe përsëritje është mbrëmja."¹⁴³ Gjithashtu, gjatë kohës së mësimi përmendësh nuk duhet qenë barku i mbushur, sepse atëherë gjaku është i përqendruar në lukth për ta tretur ushqimin.

Gjatë nxënies së Kur'anit shumë rëndësi ka edhe vendi, sepse përqendrimi në nxënie nuk është njësoj në çdo vend. Kur'ani mësohet përmendësh aty ku syri, veshi dhe gjuha pushojnë. Pra, aty ku syri nuk është i ngarkuar me objekte që e tërheqin shikimin, ku gjuha është e lirë të këndoje vetëm Kur'anin dhe ku veshi është i ekspozuar të dëgjojë

¹⁴² Jahja Gauthani, *Turukun ibdaiijetun fi hifdhi el-Kurani el-kerimi bi istihdami ilmi el-bermexheti el-lugavijeti el-asabijjeti*, ligjëratë në një trajnim në Qendrën Es-Siddik për nxënien e Kuranit, f. 11

¹⁴³ Jahja Gauthani, *vep. e cit.*, f. 12

vetëm Kur'anin. Gjithashtu, vend i rëndësishëm për këtë proces është vendi ku njeriu ndjehet rehat shpirtërisht.

6. Nxënia nga një mus'haf (botim i njëjtë). Çdo nxënës i Kur'anit gjatë procesit të nxënies regjistron imazhe të ajeteve të cilat i mëson. Kështu që, përveç nxënies së tekstit, ai merr imazh edhe për faqen që e mëson, gjegjësisht në cilën pjesë të faqes fillon dhe mbaron secili ajet, bashkë me specifikat tjera grafike që mund t'i ketë ajo faqe në atë botim. Prandaj, shfrytëzimi i mus'hafit që ka strukturë më ndryshe se ai që nxënësi e përdor zakonisht nuk është i preferuar, sepse ngatërrohen imazhet e regjistruara.

Gjithashtu, nxënësi mund të bëjë nënvizime, të vendosë shenja apo shënime tjera të rëndësishme në mus'hafin personal, ngase kjo mund ta ndihmojë nxënien.

7. Mësuesi i shkathët. Çdo nxënës patjetër të ketë një mësues i cili duhet ta dëgjojë mësimin para se nxënësi ta mësojë atë përmendësh për t'i evituar gabimet e mundshme. Po ashtu, ta dëgjojë edhe pas nxënies.

Sado i shkathët të jetë lexuesi, veçanërisht për fillestarët, prania e mësuesit është e domosdoshme, sepse lexuesi asnjëherë nuk është në gjendje t'i dallojë gabimet e veta gjatë leximit, madje edhe nëse i dëgjon lexuesit profesionistë. Dëgjimi i lexuesve profesionistë e ndihmon shumë kualitetin e nxënies, por assesi nuk mund t'i evitojë të gjitha gabimet.

8. Nxënia sistematike. Ndjekja e një sistemi dhe vazhdimësia janë shumë domethënëse për procesin e nxënies së Kur'anit. Ndërprerja dhe shtyrja sot për nesër janë punë të dëmshme për nxënien, sepse shumë njerëz e kanë lënë këtë botë me dëshirën se nesër do të mësojë një pjesë nga Kur'ani apo në të ardhmen e afërt do të jetë hafiz i Kur'anit.

Njeriu sa më shumë të mësojë përmendësh, aq më shumë e ushtron kujtesën për nxënie. Kështu që, sa herë që bën ndërprerje, i duhet t'ia nisë nga fillimi ushtrimi i kujtesës.

Nxënia sistematike nuk nënkupton nxënie të shpejtë. Nxënia e ngadalshme dhe sistematike është më e fortë se nxënia e shpejtë.

9. Kujdesi ndaj pjesëve të ngjashme. Shumë ajete kur'anore janë të ngjashme në pamje të parë, por realisht ato kanë elemente dalluese,

prandaj në raste të këtilla nxënësi i Kur'anit duhet të spikatë ndonjë dallim mes tyre për t'i mbajtur mend më mirë dhe për t'i dalluar nga njëri-tjetri.

10. Leximi me texhvid dhe me melodi. Nxënia përmendësh e Kur'anit duhet të bëhet me lexim të kulluar që u përmbahet të gjitha rregullave të texhvidit, madje qoftë edhe me mekam apo melodi të caktuar. Kështu që, nxënia e Kur'anit nuk mund të bëhet me lexim të rëndomtë siç lexojmë një libër të zakonshëm.

11. Kuptimi dhe domethënia. Një ndihmës i madh i procesit të nxënies është leximi i përkthimit të ajetit që mësohet. Nëse nxënësi është njohës i gjuhës arabe, atëherë mund të thellohet edhe më shumë në kuptimet e ajeteve për ta nxënë dhe për ta kuptuar më mirë atë.¹⁴⁴

Mënyra e nxënies përmendësh të një faqeje

Pasi të plotësohen parimet e përgjithshme, atëherë zgjedh kohën e përshtatshme, merr avdes, përqendrohu, ulu drejt në një vend të qetë dhe merr para vetes mus'hafin personal. Faqen që e ke caktuar për nxënie lexoje para mësuesit dy herë apo së paku dëgjoje dy herë nga një lexues i shkathët nga interneti. Përpiku të lexosh sadopak përkthimin apo interpretimin e asaj faqeje.

Ndaje faqen në dy apo tri pjesë, mundësisht edhe nga aspekti kuptimor, pastaj fillo lexoje pjesën e parë së paku 10 herë apo edhe më shumë. Pasi të konstatosh se e ke nxënë, atëherë mbylle mus'hafin dhe përsërite atë pjesë tri herë. Pastaj kalo në pjesën e dytë, lexoje 10 herë apo më shumë. Pasi të konstatosh se e ke nxënë, mbylle mus'hafin, përsërite tri herë atë pjesë, dhe në fund përsëriti të dy apo tri pjesët bashkërisht tri herë.

Sigurisht, ka edhe forma të tjera, bile mënyra e mësimit të një faqeje më shumë është subjektive.

¹⁴⁴ Jahja Gauthani, *vep. e cit.*, f. 12-13

Metodat e hifzit¹⁴⁵

Metodat e mësimimit të Kur'anit përmendësh janë shumë, por ne do të paraqesim vetëm më të njohurat:

- **Metoda tradicionale:** sipas kësaj metode, në fillim nxënësi e lexon gjithë Kur'anin para muhafizit me mus'haf të hapur, pastaj fillon me mësimin përmendësh të faqes së fundit të çdo xhuzi. Pasi t'i mësojë të gjitha faqet e fundit të secilit xhuz, atëherë kalon në mësimin e faqes së parafundit, të cilën e lexon bashkë me të fundit para muhafizit, pastaj të tjerat me radhë. Kështu vepron derisa të mbërrijë te faqja e parë e xhuzit.

	FAQET/DEVRET																			
	20	19	18	17	16	15	14	13	12	11	10	9	8	7	6	5	4	3	2	1
DITËT	1																			
	2 faqe																			
	3 faqe																			
	4 faqe																			
	5 faqe																			
	6 faqe																			
	7 faqe																			
	8 faqe																			
	9 faqe																			
	10 faqe																			
	11 faqe																			
	12 faqe																			
	13 faqe																			
	14 faqe																			
	15 faqe																			
	16 faqe																			
	17 faqe																			
	18 faqe																			
	19 faqe																			
	20 faqe																			

¹⁴⁵ Për më gjerësisht konsultoj veprën:

- Hajredin Hoxha, *Metodologjia e të mësuarit të Kur'anit përmendësh*, Prizren, 1995

Përmes kësaj metode, muajin e parë e mëson faqen e fundit të çdo xhuzi; muajin e dytë e mëson faqen e parafundit, por e lexon para mësuesit bashkë me të fundit; muajin e tretë e mëson faqen e tretë nga fundi, por e lexon bashkë me të parafundit dhe me të fundit. Kështu me radhë derisa të mbërrijë te faqja e parë. Me këtë metodë i bie që muajin e fundit të lexojë nga një xhuz për çdo ditë.

Kjo metodë është shumë efikase për përsëritje, sepse vazhdimisht i kthehesh asaj që ke mësuar, kurse lidhja është pak më e vështirë.

Po ashtu, kjo metodë kërkon që hifzi të mos ndalet nga fillimi deri në fund, sepse nëse bëhen pushime të gjata, atëherë ka rrezik të humb pjesa e nxënë përmendësh.

Kjo metodë është trashëguar nga koha e Perandorisë Osmane, prandaj sot përdoret në Turqi dhe në vendet që kanë qenë pjesë e Perandorisë Osmane, si Shqipëria, Bosnja, Maqedonia, Kosova etj.

- **Metoda e mësimit me rend:** Sipas kësaj metode, mësimi përmendësh i Kur'anit bëhet me rend, qoftë nga fillimi në fund apo nga fundi në fillim.¹⁴⁶ Kjo metodë kërkon një sistem të mirëfilltë të përsëritjes, sepse, krahasuar me metodën tradicionale, përsëritja është më e vështirë dhe kërkon një program të menduar mirë.

Pra, mund të mësohet ajet pas ajeti, rresht pas rreshti, faqe pas faqeje etj., por duhet qenë shumë të vëmendshëm dhe të bëhet një plan i mirë për përsëritje, në mënyrë që pjesa e mësuar të përsëritet së paku një herë në muaj.

- **Metoda e lirë:** nëse ndiqet kjo metodë, nxënësi mund të mësojë përmendësh cilën sure apo xhuz të dëshirojë, pra, nuk kushtëzohet që mësimi të jetë me rend. Mirëpo, ajo që kërkohet me ngulm është përpilimi i një plani të përsëritjes, në mënyrë që të mos kalojë kohë të gjatë pa u përsëritur.

Kjo metodë preferohet për ata që planifikojnë ta mësojnë përmendësh Kur'anin për një kohë më të gjatë. Suret që i kanë mësuar i

¹⁴⁶ Ismail bin Ibrahim esh-Sherkavi, *Muhtesar ilmi et-tenmijeti el-kur'anijeh*, Xhamiatu Bashin el-Alemijeh li el-Ulumi vel-Fununi vet-Tenmijeh, 2023, f. 49

përsërisin vazhdimisht derisa të vendosin të mësojnë një sure apo xhuz tjetër.

- **Metoda uzbeke:** në fillim nxënësi mësohet ta lexojë drejt një faqe nga Kur'ani para muhafizit. Pastaj muhafizi e detyron ta lexojë 300 herë atë duke parë në mus'haf. Kur të përfundojë, e thotë përmendësh para muhafizit dhe e le atë faqe për të filluar me tjetrën. Kështu vepron deri në fund të Kur'anit. Kur ta përfundojë këtë proces, atëherë muhafizi e obligon që ta lexojë 150 herë gjithë Kur'anin. Pasi ta përfundojë edhe këtë, atëherë i jepet titulli "hafiz i Kur'anit".

Kjo metodë përdoret në shtetet aziatike të ish-Bashkimit Sovjetik, si Uzbekistan, Kazakistan, Kirgistan, Dagistan etj.¹⁴⁷

Këto që u theksuan më lart janë metodat kryesore që ndërlidhen me mënyrën e organizimit të materies që duhet mësuar përmendësh, kurse sa i përket metodës se si nxënësi e mëson këtë materie të paracaktuar, këtu ka disa metoda tjera, p.sh.:

- **metoda e dëgjimit.** Nxënësi e kryen hifzin e Kur'anit duke e dëgjuar atë. Pjesën që e ka për ta mësuar, e dëgjon në çdo situatë: në punë, në rrugë, para gjumi etj. Kryesisht kjo metodë përdoret nga të verbrit dhe nga njerëzit që janë shumë të zënë përgjatë ditës.
- **metoda e shkrimit.** Çdo pjesë të paracaktuar për mësim, nxënësi e shkruan disa herë në fletore, në dërrasë apo në ndonjë vend tjetër. Kjo metodë më shumë përdoret në Marok dhe në Egjipt, por edhe në vise tjera afrikane. Metoda në fjalë është shumë e përshtatshme për shurdhmemecët. Sigurisht, metoda e shkrimit dhe dëgjimit mund të përdoren edhe të kombinuara.
- **Metoda e kuptimit.** Para se nxënësi ta mësojë përmendësh pjesën e caktuar, e lexon përkthimin në gjuhën e vet, madje ndonjëherë e mëson edhe përkthimin. Për këtë arsye, në disa mjedise fillimisht mësohet gjuha arabe në formë intensive, pastaj fillohet mësimi i hifzit.

¹⁴⁷ Ismail bin Ibrahim esh-Sherkavi, *vep. e cit.*, f. 50

- **metoda shoqëruese.** Dy nxënës ia lexojnë dersin njëri-tjetrit me mus'haf hapur, pastaj përmendësh. Kjo mund të bëhet me faqe, me ajete, me sure apo varësisht cilën metodë e zgjedhin.
- **metoda sudaneze,** ku mësuesi i rendit nxënësit në formë harku dhe i urdhëron ta mësojnë përmendësh pjesën e caktuar, kurse vetë qëndron në mes. Pastaj i urdhëron të ngrihen në këmbë dhe ta përsërisin pjesën e nxënë duke ecur pas njëri-tjetrit për një orë të tërë. Në fund përsëri i urdhëron të ulen dhe ta thonë përmendësh atë që e kanë përsëritur. Ndonjëherë muhafizi e urdhëron nxënësin që ta lexojë dersin në këmbë.¹⁴⁸

Përsëritja pas përfundimit të hifzit

Mësimi përmendësh i Kur'anit është një punë e vështirë, por ruajtja është edhe më e vështirë, sepse kërkon një përkushtim sistematik. Për ta ruajtur përmendësh Kur'anin, në fillim duhet të ndiqen këto faza të përfundimit të hifzit të sapomësuar:

- I. Në fazën e parë përsëritja bëhet për 90 ditë (tre muaj). Në këtë fazë kualiteti i hifzit ende është i dobët, prandaj përsëritja bëhet më ngadalë.
- II. Në fazën e dytë përsëritja bëhet për 45 ditë (një muaj e gjysmë). Në këtë fazë kualiteti i hifzit është 50 % i forcuar.
- III. Në fazën e tretë përsëritja bëhet për 30 ditë (një muaj). Në këtë fazë, kualiteti i hifzit është 60 %.
- IV. Në fazën e katërt përsëritja bëhet për 15 ditë, ku kualiteti i hifzit është 80 %.
- V. Në fazën e pestë dhe të fundit përsëritja bëhet për 7 ditë (një javë), ku kualiteti i hifzit është i lartë. Kjo fazë përfaqëson edhe leximin sistematik të Muhamedit [alejhi selam].

Në vazhdim do të jepet një tabelë ku do të sqarohen hollësisht të gjitha fazat e përsëritjes së hifzit, prandaj preferohet që të ndiqen këto faza njëra pas tjetrës.

¹⁴⁸ Ismail bin Ibrahim esh-Sherkavi, *vep. e cit.*, f. 49-55

EMRI I SURES	Faza (I)	Faza (II)	Faza (III)	Faza (IV)	Faza (V)	
	Kualiteti i dobët	Kualiteti 50 %	Kualiteti 60 %	Kualiteti 80 %	Kualiteti i lartë	
	90 ditë	45 ditë	30 ditë	15 ditë	7 ditë	
الْفَاتِحَةُ ← الْبَقَرَةُ	4 ditë	2 ditë	2 ditë	1 ditë	1 ditë	ف 149
آلْ عِمْرَانَ	4 ditë	2 ditë	2 ditë	1 ditë		
النِّسَاءِ	4 ditë	2 ditë	2 ditë	1 ditë		
الْمَائِدَةُ	4 ditë	2 ditë	2 ditë	1 ditë	1 ditë	م
الْأَنْعَامُ	4 ditë	2 ditë	2 ditë	1 ditë		
الْأَعْرَافُ	4 ditë	2 ditë	2 ditë	1 ditë		
الْأَنْفَالُ ← التَّوْبَةُ	4 ditë	2 ditë	1 ditë	1 ditë	1 ditë	ي
يُونُسُ ← يُوسُفُ	4 ditë	2 ditë	1 ditë			
الرَّعْدُ ← النِّحْلُ	4 ditë	2 ditë	1 ditë	1 ditë		
الْإِسْرَاءُ (يحيى) إِسْرَائِيلُ ← مَرْيَمُ	4 ditë	2 ditë	1 ditë	1 ditë		
طه ← الْحَجُّ	4 ditë	2 ditë	1 ditë			
الْمُؤْمِنُونَ ← الْفُرْقَانُ	4 ditë	2 ditë	1 ditë	1 ditë	1 ditë	ش
الشُّعْرَاءُ ← النَّملُ	4 ditë	2 ditë	1 ditë			
الْقَصَصُ ← الْعَنْكَبُوتُ	4 ditë	2 ditë	1 ditë			
الرُّومُ ← السَّجْدَةُ	4 ditë	2 ditë	1 ditë	1 ditë	1 ditë	و
الْأَحْزَابُ ← يس	4 ditë	2 ditë	1 ditë	1 ditë		
وَالصَّافَّاتُ ← الزُّمُرُ	4 ditë	2 ditë	1 ditë			
غَافِرُ ← الشُّورَى	4 ditë	3 ditë	1 ditë	1 ditë	1 ditë	ق
الرُّحْفُ ← الْجَانِيَةُ	4 ditë		1 ditë			
الْأَحْقَافُ ← الْحُجْرَاتُ	4 ditë		1 ditë	1 ditë		
ق ← الْحَدِيدُ	4 ditë	3 ditë	1 ditë			
الْجُزءُ 28	2 ditë				3 ditë	1 ditë
الْجُزءُ 29	2 ditë	1 ditë				
الْجُزءُ 30	2 ditë		1 ditë			

¹⁴⁹ Këto shkronja janë gërmat e para të emrave të sureve ku fillon kjo pjesë dhe janë të përmbledhura në grupin فِي بِشَوِّ. Më gjerësisht për këtë frazë mund të lexoni në sythin “Leximi sistematik i Muhamedit [alejhi selam]”, në kreun XI të këtij libri.

Mirëpo, nëse ndiqet metoda tradicionale, atëherë përsëritja fillon nga faza e tretë, sepse devrin e fundit nxënësi lexon nga një xhuz para muhafizit dhe nuk ka logjikë që pas mbarimit të devrit të fundit, përsëritjen ta bëjë më pak.

Po ashtu, një çështje shumë e rëndësishme është që mësimi i Kur'anit përmendësh të bëhet paralelisht me texhvid, sepse shpesh hasen raste ku hafizët dalin me texhvid të cunguar. Pra, muhafizi duhet të jetë i vëmendshëm që të mos ia kalojë faqet apo mësimet pa i lexuar drejt me texhvid. Për këtë arsye, në devrat (pjesët) e para nxënësit i kërkohet të lexojë më ngadalë për t'ia kontrolluar texhvidin, sepse janë pak faqe, pastaj me shtimin e devrave (apo të faqeve), rritet edhe shpejtësia e leximit, por assesi të kalohen pa texhvid.

Pyetje:

- ❧ Trego dy ajete për paprekshmërinë dhe ruajtjen e Kur'anit!
- ❧ Çfarë vlerë ka nxënia e Kur'anit përmendësh?
- ❧ Cilat janë parimet e përgjithshme për hifzin e Kur'anit?
- ❧ Si mësohet përmendësh një faqe e Kur'anit?
- ❧ Cilat janë metodat e nxënies së Kur'anit përmendësh?
- ❧ Çfarë shpejtësie duhet të mbajë lexuesi para muhafizit?
- ❧ Cilat janë fazat e përsëritjes së hifzit?

METODOLOGJIA E MËSIMIT TË TEXHVIDIT

Mësimi i rregullave të texhvidit është sfidë për çdo lexues të Kur'anit. Së pari është sfidë mësimi i texhvidit për vete dhe pastaj mësimi i të tjerëve.

Jo çdo lexues i Kur'anit mund t'ua mësojë texhvidin të tjerëve, sepse leximi i Kur'anit me texhvid për vete dhe mësimi i tjerëve janë dy gjëra të ndryshme, pra aftësia e mësimdhënies është një art në vete dhe shkathësi që kërkon një trajnim apo përvojë të caktuar.

Shpeshherë shtrohet pyetja: kur duhet të fillojë mësimi i texhvidit? Për këtë dëgjohen përgjigje të ndryshme: disa mendojnë se texhvidi duhet të mësohet pasi nxënësi ta kryejë një hatme, disa pretendojnë se texhvidin duhet ta mësojnë vetëm hoxhallarët, kurse xhemati mjafton të dijë të lexojë, e të tjerët japin mendime të ndryshme. Mirëpo, sipas analizave të bëra nga më shumë se 50 mektebe dhe nga përvoja që kanë përdorur mualimët dhe muhafizët e dalluar në vend dhe nëpër botën islame, kemi konstatuar se mësimi i texhvidit fillon që nga mësimi i shkronjës *elif*, d.m.th. që në momentin kur nxënësi fillon t'i mësojë shkronjat arabe. Kjo arsyetohet me faktin se shqiptimi i drejtë dhe i saktë i tingujve të gjuhës arabe (meharixhul huruf) është pjesa thelbësore e texhvidit, prandaj themi se texhvidi fillon paralelisht me mësimin e shkronjës së parë të alfabetit arab. Sigurisht, këtu nuk mësohen emrat e rregullave, por artikulimi i shkronjave duhet të jetë i drejtë dhe i saktë.

Gjithashtu, në shumë mektebe mësimi i texhvidit bëhet duke e mësuar një libër të caktuar nga fillimi deri në fund. Kjo metodë, jo se nuk bën, por është e vështirë për fillestarin, sepse kryesisht librat e texhvidit nëpër të gjitha gjuhët e botës janë përpiluar sipas kronologjisë dhe renditjes shkencore që kërkon vetë materia e texhvidit. Ka edhe libra të tillë që janë përpiluar sipas metodologjisë mësimore, por pastaj nxënësit që ndjekin këtë metodë kanë problem në strukturimin e materies së texhvidit.

Fazat e mësimimit të texhvidit

Zgjidhja e të gjitha këtyre dilemave dhe paqartësive është që mësimi i texhvidit të bëhet gradual dhe në disa faza, jo menjëherë të fillohet fund e krye, prandaj në vijim do të jepen katër fazat e mësimimit të disiplinës së texhvidit:

Faza e para: texhvidi i elifbasë

Kjo fazë fillon me mësimin e shkronjave të gjuhës arabe dhe përfundon me mbarimin e tyre, pra fillon me elifin dhe mbaron me shkronjën e fundit të elifbasë.¹⁵⁰ Në këtë fazë mësuesi (mualimi) duhet të bëjë kujdes në këto rregulla (të texhvidit), por pa ua mësuar nxënësve emrat e rregullave:

- Artikulimi i drejtë i çdo tingulli. Disa mualimë, për ta kaluar më shpejtë alfabetin, nuk ua mësojnë shqiptimin e drejtë nxënësve, e kjo le pasoja të mëtutjeshme tek nxënësi. Më mirë është që shkronjat të mësohen ngadalë dhe siç duhet, sesa të mësohen shpejt dhe në formë jo të drejtë.
- Artikulimi i drejtë i shkronjave të forta të cila nuk janë në gjuhën amtare të nxënësit, veçanërisht mësimi i tingujve të fortë apo emfatikë: (ظ, ق, ط, غ, ض, ص, خ), që janë të përmbledhura në frazën (خُصَّ صَغَطٌ قِطً).

Në këtë rast preferohet që nxënësit të njoftohen drejtpërdrejt me tingujt e fortë dhe jo të njoftohen përmes tingujve të lehtë, p.sh. nuk duhet prezantuar tingulli ط si versioni më i fortë i ت, por është mirë që drejtpërdrejt ta artikulojë mësuesi tingullin ط dhe të mos i lë alternativë tjetër, sepse njoftimi indirekt dhe lënia e alternativës është çdoherë një mundësi për të gabuar.

- Artikulimi i drejtë i zanoreve të shkurtra. Shumë i rëndësishëm është artikulimi i zanoreve të shkurtra qysh nga shkronja e parë

¹⁵⁰ Shkronja e fundit nuk do të thotë që patjetër të mësohet J-ja, por varësisht prej librit nga i cili mëson, sepse disa libra për mësimin e shkronjave i kanë shkronjat sipas renditjes alfabetike, kurse shumica i kanë sipas renditjeve të tjera.

(elifi), sepse në shumë mektebe zakonisht të tri zanoret e shkurtra anojnë pak kah zanorja ë, pra nuk del një U e pastër duke i rrum-bullakosur buzët, por del një U hundore. Po ashtu, edhe zanorja I artikulohet pak rëndë, por në realitet duhet pak më lehtë, pra duhet ulur pak nofulla e poshtme për t'u shqiptuar drejt. E njëjta vlen edhe për zanoren E. Kur nxënësi t'i shqipton zanoret në këtë formë me të gjithë tingujt, atëherë ky problem llogaritet i mbyllur qysh në këtë fazë.

- Artikulimi i drejtë i zanoreve të gjata. Njësoj si zanoret e shkurtra, edhe zanoret e gjata duhet shqiptuar drejt, veçanërisht zanorja e gjatë A, e cila kur vjen me tingujt e fortë shqiptohet më fortë dhe kur vjen me tingujt e butë shqiptohet më butë.

Këto udhëzime merren në konsideratë gjatë mësimi të shkronjave, edhe pse në pamje të parë duket se janë kërkesa të tepruara, por realisht ato janë shumë të lehta për fëmijët dhe të domosdoshme për të fituar një lexim të drejtë dhe të saktë në të ardhmen.

Lëshimet e mualimëve në këtë fazë u hapin rrugën gabimeve në vijimësi, pastaj sa më shumë të avancojë lexuesi i Kur'anit, aq më i vështirë bëhet përmirësimi i gabimeve.

Në këtë fazë asnjë rregull i texhvidit nuk mësohet me emër, por vetëm zbatohen ato që u theksuan më lartë.

Faza e dytë: hapat e parë të leximit

Kur nxënësi i mëson të gjitha shkronjat e alfabetit arab, fillon leximin në mus'haf. Me këtë rast fillon faza e dytë e mësimi të texhvidit, më saktësisht nga ajeti i parë që e lexon dhe derisa t'i lexojë disa faqe (ndoshta nja dhjetë faqe), pra deri kur mësuesi të konstatojë se nxënësi ka fituar shkathhtësitë themelore të leximit.¹⁵¹

Në këtë fazë u kushtohet vëmendje rregullave vijuese të texhvidit, por përsëri pa emërtime dhe tepër të thjeshtuara:

¹⁵¹ Varësisht sipas metodës: disa fillojnë leximin nga fillimi i mus'hafit, disa nga suret e shkurtra dhe disa mund të kenë tjetër metodë. Kjo varet nga metoda që ka zgjedhur mualimi.

- Vazhdon zbatimi i rregullave të fazës së parë me përpikëri.
- Mbajtja dy nota e nunit me teshdid dhe mimit me texhdid. Kjo i tregohet menjëherë në faqet e para.

Në shumë mektebe apo mjedise tjera ku mësohet Kur'ani, këtë rregull nuk e zbatojnë fare, prandaj kjo meriton të futet në përdorim qysh në fillim.

- Shndërrimi i tenvinit EN në A të gjatë kur nxënësi ndalon aty. Kjo vjen në shprehje kur nxënësi t'i ketë lexuar së paku 5 faqe nga Kur'ani.
- Mësimi se T-ja e rrumbullakët (ة) gjatë ndaljes lexohet H (ه), kup-tohet nëse këtë nuk e ka mësuar gjatë mësimit të shkronjave.
- Mësimi se gjatë ndaljes, shkronjës së fundit asnjëherë nuk i lexohet vokali, por lexohet me sukun.

Këto dhe ndonjë rregull tjetër i ngjashëm, i mësohen nxënësit në çdo dy apo tri faqe nga një, jo t'i jepen të gjitha menjëherë si informacione teorike. Edhe në këtë fazë nuk mësohen rregullat e texhvidit me emra.

Faza e tretë: fillimi i teorisë së texhvidit

Kur nxënësi të ketë kaluar sfidën e hyrjes në mus'haf dhe t'i ketë përvetësuar rregullat e fazës paraprake, gjë e cila mund të arrihet afërsisht pas leximit të një apo dy xhuzeve, atëherë hedh një hap më përpara dhe fillon t'i mësojë rregullat më të përdorura dhe më të nevojshme të texhvidit.

Në këtë fazë rregullat e texhvidit mësohen me emra, sepse nuk janë shumë dhe nxënësi tanimë ka kaluar në një nivel dhe ritëm mesatar të leximit. Rregullat që duhet të mësohen në këtë fazë janë rregullat e nunit me sukun dhe tenvinit dhe rregullat e mimit me sukun, por ngadalë duke i përvetësuar një nga një.

Rregullat e nunit me sukun, të tenvidit dhe të mimit me sukun mësohen me këtë renditje:

- Idgam meal gunne, sepse është nga rregullat më të përdorshme, ka më pak shkronja (se ihfaja dhe idhhari) dhe menjëherë i jep leximit një ngjyrim tjetër.

- Idgam bila gunne, sepse ka vetëm dy shkronja (L dhe R) dhe vjen si kontrast i idgam meal gunnes.
- Iklabi, sepse ka vetëm një shkronjë.
- Idhhari, sepse mësimi i idhharit në fillim është i paqartë për nxënësit, ngase thonë pse duhet të mësojmë një rregull që nuk ka ndonjë efekt të dukshëm.
- Ihfaja, sepse ihfaja është më e komplikuar nga tufa e rregullave të kësaj faze. Është lënë në fund për shkak se ka 15 shkronja. Kur nxënësi t'i mësuar rregullat e mëparshme të tenvinit dhe të nunit me sukun, atëherë i thuhet se ihfaja bëhet me shkronjat e mbetura. Pasi nxënësi t'i ketë përvetësuar rregullat e nunit me sukun dhe të tenvinit, atëherë vazhdon me:
- Ihfa shefevij, sepse bëhet vetëm me shkronjën B.
- Idgam shefevij, sepse bëhet vetëm me shkronjën M.
- Idhhar shefevij mbetet në fund, sepse kjo vjen në shprehje kur vijnë të gjitha shkronjat tjera përveç B dhe M.

Mësimi i rregullave të kësaj faze bëhet një pas një, pra përvetësohet mirë e para, pastaj kalohet te e dyta dhe kështu me radhë duke u përvetësuar praktikisht njëra pas tjetrës. Mualimi nuk duhet t'i mësojë një rregull tjetër pa e përvetësuar rregullin paraprak. Për shembull, nga 5 deri në 10 faqe janë të mjaftueshme për ta mësuar secilin nga rregullat vijuese, megjithatë kjo varet nga aftësia e nxënësit, dikush mund t'i përvetësojë më lehtë dhe dikush më rëndë.

Rregullat në këtë fazë mësohen me emra, por shkurtimisht, pa përjashtime dhe pa hollësi të mëdha. I rëndësishëm është përvetësimi praktik i tyre dhe njohja e ermit të rregullit.


Faza e katërt: plotësimi i texhvidit

Në këtë nivel mësohen rregullat e mbetura të texhvidit dhe me këtë mbyllet edhe faza e fundit e mësimi të tij. Mirëpo, meqë paraprakisht nxënësi ka mësuar disa rregulla, tani preferohet që mësuesi të ndjekë njërën nga dy rrugët: të vazhdojë t'ia mësojë rregullat e mbetura pa ia përsëritur ato që i ka mësuar ose t'ia mësojë rregullat e texhvidit me rend siç janë në libër.

Një parim shumë i rëndësishëm në procesin e mësimit të texhvidit është moskalimi në rregullin tjetër pa e përvetësuar rregullin paraprak, sepse atëherë do të dominojë teoria, kurse teoria pa praktikë në texhvid është e panevojshme. Gjithashtu, shtyrja e përvetësimit praktik të rregullit është joefektiv, sepse në këtë mënyrë artikulimi jo i drejtë i rregullit do të vazhdojë edhe për gjatë kohë. Sigurisht nga kjo përjashtohen raste shumë specifike, si p.sh. defekti i përkohshëm në aparatën e shqiptimit (mungesa e ndonjë dhëmbi etj.) apo defekti i përhershëm.

Pyetje:

- Kur fillon mësimi i texhvidit?
- Pse duhet texhvidi të mësohet që nga shkronja elif?
- Cilat janë fazat e mësimit të texhvidit?
- Cilat rregulla mësohen në fazën e parë?
- Cilat rregulla mësohen në fazën e dytë?
- Cilat rregulla mësohen në fazën e tretë?
- Cilat rregulla mësohen në fazën e katërt?
- Kur fillon texhvidi të mësohet me emra?
- Çfarë është e rëndësishme gjatë mësimit të texhvidit?



KREU XII

KIRAETET (TRAJTAT E LEXIMIT)



- Hyrje në disiplinën e kiraeteve

HYRJE NË KIRAETE

Kjo disiplinë shkencore është shumë e gjerë, këtui do të jepet vetëm një pasqyrë e përgjithshme për të.

Objekt i studimit të kësaj discipline janë trajtat e shqiptimit të fjalëve të Kur'anit Fisnik.

Përkufizimi

Ilmul Kiraat (عِلْمُ الْقِرَاءَاتِ) është disiplinë shkencore e cila studion mënyrën e shqiptimit të fjalëve të Kur'anit dhe trajtat e ndryshme leximore të mbështetura në transmetimet nga Muhamedi [alejhi selam]

Në këtë disiplinë mësohen të gjitha trajtat e shqiptimit dhe të shkriimit të fjalëve të Kur'anit; mësohen lexuesit, transmetuesit dhe rrugët e leximeve; gjithashtu, këtu bëhet klasifikimi i kiraeteve në mutevatir dhe ahad, cili lexim meriton të quhet Kur'an dhe cili jo etj.

Nocione të rëndësishme

- **Aslun** (أَصْلٌ) **normë**: një rregull i përgjithshëm që e karakterizon një kiraet të caktuar quhet normë e atij kiraeti, p.sh. zgjatja e hemzes në një kiraet është një normë, por edhe leximi i hemzes në një kiraet tjetër është normë për kiraetin tjetër etj. Një kiraet mund të ketë disa norma (أَصُول).
- **Fersh** (فَرْشٌ): **fersh** quhet ndryshimi që paraqitet në një fjalë kur'anore gjatë një leximi, por i njëjti është përsëritur në shumë vende pa ndjekur një normë të caktuar, p.sh. heqja ose shtimi i një shkronje në disa fjalë etj., të cilat në një kiraet tjetër janë ndryshe.
- **Kiraetun** (قِرَاءَةٌ) **lexim**: tërësia e trajtave të fjalëve kur'anore që është tubuar dhe transmetuar nga një lexues (prej dhjetë lexuesve) quhet kiraetun – lexim;
- **Kariun** (قَارِئٌ) **lexues**: personi i cili është karakterizuar me një tërësi trajtash të leximit të Kur'anit, apo personi i cili ka mbledhur një

tërësi trajtash të leximit të Kur'anit nga masa e njerëzve. Duhet ditur se shumica e lexuesve kanë qenë tabiinë, pra ata i kanë dëgjuar sahabët dhe tabiinët. Leximet e pranuar janë dhjetë.

- **Ravi (الرّأوي) *transmetues***: ravi quhet personi që ka marrë një tërësi trajtash nga lexuesi dhe e ka transmetuar më andej. Pra, nga një lexues ka dhjetëra transmetues. Megjithatë, nga çdo lexues janë veguar nga dy transmetues kryesorë, sepse këta dy përfaqësojnë gjithë materien që është transmetuar nga lexuesi në fjalë.
- **Rivajet (رواية) *transmetim***: e gjithë materia e transmetuar nga transmetuesi quhet rivajet – transmetim.
- **Tarikun (طريق) *rrugë***: e gjitha ajo që transmetohet nga ravi (pas transmetuesit) dhe deri në kodifikim quhet rrugë;
- **Vexh'hun (وجه) *trajtë***: trajtë e lejuar e një leximi të Kur'anit. Kjo përdoret kur një fjalë ka më shumë se një trajtë leximi, e njëra prej tyre quhet trajtë.

Etapat e zhvillimit

Në fillim, të gjitha disiplinat fetare janë mësuar bashkë, pa u ndarë nga njëra-tjetra, si një tërësi e pandarë dhe pa u degëzuar nëpër disiplina të ndryshme shkencore. Pastaj, për shumë arsye, filluan të lindin dhe kultivohen disiplinat fetare një nga një.

Disiplina e kiraeteve, si të gjitha të tjerat, ka kaluar në disa faza të zhvillimit të saj, deri në kodifikimin dhe standardizimin si një disiplinë e pavarur shkencore. Fazat e kësaj discipline janë:

1. Periudha pejgamberike

Të gjitha kiraetet janë të shpallura prej Allahut [xhel-le she'nuhu], të zbritura Muhamedit [alejhi salam] përmes melekut Xhibril. Pastaj Muhamedi [alejhi salam] ua mësonte sahabëve dhe ua diktonte ta shkruajnë atë. Transmetohet se Zejd bin Thabiti ka thënë: “E shkruaja shpalljen pranë të Dërguarit të Allahut, e ai më diktonte. Kur përfundoja, më

thoshte “lexoje!”, e unë e lexoja. Nëse kishte ndonjë lëshim, e përmirësonte, e pastaj unë dilja për t’ua paraqitur atë njerëzve.”¹⁵²

Gjithashtu, gjatë periudhës së Pejgamberit, sahabët filluan t’ia mësojnë në njëri-tjetrit leximin e Kur’anit bashkë me kiraetet.

Më vonë, duke u avancuar, një grup prej shtatëdhjetë sahabësh të rinj filluan t’ia mësojnë Kur’anin njëri-tjetrit dhe u quajtën *kurraë* (قُرَاء) lexues të Kur’anit. Këtu u shfaq për herë të parë termi *kurraë* (قُرَاء) lexues të Kur’anit.

2. Periudha e sahabëve dhe tabiinëve

Gjatë jetës së Muhamedi [alejhi selam], Kur’ani u shënua vetëm nëpër sende të ndryshme si rrasa, eshtra, gjethe palme etj., por asnjëherë nuk u përmbledh në një mus’haf të vetëm. Megjithatë, intensiteti i mësimin të Kur’anit asnjëherë nuk u pakësua. Qysh ditën që ka filluar të zbrësë, mësimi i tij çdoherë është shtuar dhe asnjëherë nuk është zvogëluar. Kjo thjesht është një siguri sepse ai kurrë nuk mund të falsifikohet, as edhe një gërmë e vetme. Megjithatë, mënyra se si Krijuesi e mbrojti atë libër janë të llojllojshme. Pas vdekjes së Muhamedit [alejhi selam], vdekja e shumë hafizëve dhe profesionistëve të leximit të Kur’anit, bëri që fillimisht kalifi Ebu Bekr të merr iniciativë për kodifikim të Kur’anit, e cila pastaj kurorëzohet në epokën e kalifit Osman. Në epokën e Osmanit [radijall-llahu anhu] u bë kodifikimi i Kur’anit në një mus’haf të vetëm dhe me grafinë që e kemi sot. Aty erdhën sahabë nga vende të ndryshme, të cilët, përveçse e aprovuan unanimisht, morën nga një kopje dhe e shpërndanë nëpër kryeqendrat e atëhershme islame. Pra, ata shpërndanë edhe grafinë, edhe leximet të cilat sot i njeh mbarë bota islame.

Në këtë fazë të rëndësishme për mësimin dhe studimin e Kur’anit, ku zotërues i leximit të Kur’anit ishte mbarë shoqëria, dolën edhe lexuesit profesionist të cilët gjithë diturinë e popullit të transmetuar nga Muhamedi [alejhi selam], arritën ta kanalizojnë në dhjetë kiraete mutevatire dhe disa ahade. Pra, kjo është faza e kurrave dhe transmetuesve të cilët do t’i theksojmë në sythin e radhës.

¹⁵² Taberaniu, *El-Mu’xhemu el-kebiru, hadithi*, nr. 4889. Për këtë hadith Sujutiu në “Tedribu er-ravi” 2/24 thotë: “Transmetuesit e këtij hadithi janë të besueshëm.”

3. Periudha e regjistrimit të kiraeteve

Kjo është faza kur çdo lexim mori formën e vet të shkruar dhe e gjithë dituria për leximet e Kur'anit kodifikohet nëpër libra. Gjithashtu, në këtë fazë disiplina e kiraeteve merr formën e vërtetë të një disipline të mirë-filltë shkencore.

Disa dijetarë thonë se i pari që ka shkruar për disiplinën e kiraeteve është imami Ebu Ubejd el-Kasim bin Selami (vdiq në vitin 224 h). Imam Xhezeriu thotë se i pari që ka shkruar në këtë drejtim është Ebu Hatim es-Sexhestani (vdiq në vitin 225 h). E disa të tjerë thonë se është Jahja bin Jamer (vdiq në vitin 90 h)

Imam Ahmed bin Xhubejr (vdiq më 258 h), nga qindra e mijëra lexues nëpër kryeqendrat islame, zgjodhi pesë më të mirët, leximet e të cilëve pranoheshin nga të gjithë profesionistët dhe mbarë popullata. Kështu që, e shkroi librin "*El-hamsetu*" *pesë lexuesit*.

Pastaj, imam Ibn Muxhahidi (vdiq më 324 h), duke hulumtuar dhe duke e perfeksionuar edhe më shumë disiplinën e Kiraeteve, arriti t'i dallojë shtatë lexues, prandaj dhe doli me idenë e shtatë kiraeteve në librin e tij "*Es-seb'atu*" *shtatë lexuesit*. Pas Ibn Muxhahidit, për shtatë kiraetet shkruan edhe shumë dijetarë të tjerë të spikatur, si p.sh. Ebu Muhamed Mekijj, Ebu Amër ed-Dani, Ebu Muhamed esh-Shatibij etj.

Në vijim erdhi faza e klasifikimit të kiraeteve shadh. Kjo është periudha kur u shfaqën edhe tri kushtet kryesore të kiraeteve të pranuara.

Pastaj imam Xhezeriu (vdiq më 833 h.), idesë së shtatë leximeve i bashkëngjiti edhe tri kiraete të tjera, dhe gjithsej u bënë dhjetë lexime (kiraete) të pranuara dhe plotësisht të përdorshme për mbarë umetin islam.

Me pak fjalë, kjo fazë përshin gjithë atë që u shkrua për disiplinën e kiraeteve nga dijetarët e vjetër.

4. Periudha moderne

Pas periudhës së kodifikimit dhe formësimit të kësaj disipline, me kalimin e gjeneratave, pasardhësve u mbeti vetëm t'i mësojnë dhe t'i studiojnë ato.

Kiraeti më i përhapur sot në botë është ai i Asimit, me transmetim të Hafsit. Veçanërisht në Periudhën Osmane, ku u veçua kiraeti i sapoth-eksuar. Pra, një periudhë të gjatë kohore nëpër botë ka mbizotëruar kiraeti i Asimit. Sot, falë kushteve teknologjike, shumë media, shkolla dhe institucione të ndryshme i kanë ngjallur pothuaj të gjitha leximet.

Sidoqoftë, kiraetet sot gëzojnë këtë shtrirje nëpër botë:

- Rivajeti i Hafsit nga Asimi është i shtrirë në shumicën e vendeve islame, veçanërisht në Lindje;
- Rivajeti Kalun përdoret në Libi, Tunizi dhe në disa pjesë të Algjerisë;
- Rivajeti Versh është i pranishëm në Algjeri, Marok, Mauritani dhe në pjesën dërmuese të shteteve afrikane;
- Rivajeti Durij përdoret në Sudan, Somali dhe në Hadremeut të Jemenit.

Pas periudhës së kodifikimit, transmetimi i kiraeteve në formë gojore nuk është ndërprerë dhe nuk ka rënë numri asnjëherë, çdoherë është shtuar. Pra, edhe sot kemi shumë profesionistë të kiraeteve të cilët kanë sened deri te Muhamedi [alejhi selam] për një apo për të dhjetë kiraetet.

Tri kriteret e leximeve të pranuara

Pasi mus'hafet e Othmanit u shpërndanë nëpër vende të ndryshme, ku lexuesit dhe transmetuesit e leximeve u shumëzuan aq shumë, saqë dijetarët islamë vendosën disa kriteret për t'i dalluar leximet e vërteta nga ato të gabuara. Ato janë:

1. Kiraeti duhet të ketë sened (zinxhir transmetimi) mutevatir, edhe pse disa e pranojnë edhe *sahihun meshhur* (të jetë senedi i saktë me tri rrugë transmetimi), por vetëm për studim, jo për namaz;
2. Kiraeti të përputhet me normat e gjuhës arabe (të cilitdo dialekt klasik qofshin ato);
3. Kiraeti të jetë në përputhje me grafinë e Othmanit, me mus'hafet që Othmani i dërgoi nëpër kryeqendrat islame.

Dhjetë lexuesit e Kur'anit

Bazuar në kriteret e cituara më lartë, kiraetet ndahen në:

a) *Kiraete të pranuara* (مَقْبُولَةٌ) janë leximet që i plotësojnë të tri kriteret e cituara më lartë, dhe

b) *Kiraete të papranuara* (شَادَّةٌ) janë leximet që nuk e plotësojnë njërin prej tri kriterëve të cituara më lartë.

Lexuesit dhe transmetuesit e kiraeteve të pranuara janë këta:

1. Nafiu نَافِعُ الْمَدَنِي (?-169 h). Lexues në Medinë.
 - a) Kalun قَالُون
 - b) Versh وَرْش
2. Ibën Kethiri ابْنُ كَثِيرٍ الْمَكِّي (45-120 h). Lexues në Mekë.
 - a) Bezziu الْبَزْزِيُّ
 - b) Kunbuli قُنْبُلٌ
3. Ebu Amër أَبُو عَمْرٍو الْبَصْرِيُّ (68-154 h). Lexues në Basra.
 - a) Hafs bin Omer ed-Durij حَفْصُ بْنُ عُمَرَ الدَّوْرِيِّ
 - b) Susi السُّوسِي
4. Abullah ibn Amir عَبْدُ اللَّهِ ابْنُ عَامِرٍ الشَّامِيُّ (?-118). Lexues në Sham.
 - a) Hishami هِشَام
 - b) Ibn Dhekvani ابْنُ ذَكْوَانَ
5. Asimi ibn Ebi Nexhudi أَبِي النَّجُودِ الْكُوفِيُّ (?-129). Lexues në Kufa.
 - a) Shu'be شُعْبَةَ
 - b) Hafs bin Sulejman حَفْصُ بْنُ سُلَيْمَانَ
6. Hamza حَمْزَةُ الْكُوفِيُّ (80-156). Lexues në Kufa.
 - a) Halef bin Hisham خَلْفُ بْنُ هِشَام
 - b) Halad bin Halid خَلَادُ بْنُ خَالِدٍ
7. Kesaiu الْكَسَائِيُّ (120-189). Lexues në Kufa.
 - a) Ebu Harith أَبُو الْحَارِثِ
 - b) Hafs bin Omer ed-Durij حَفْصُ بْنُ عُمَرَ الدَّوْرِيِّ

- | |
|--|
| 8. Ebu Xhafer أَبُو جَعْفَرٍ الْمَدِينِي (?-130). Lexues në Medinë.
a) Ibn Verdan اِبْنُ وَرْدَانَ
b) Ibn Xhimaz اِبْنُ جَمَاز |
| 9. Jakub bin Is'haku يَعْقُوبُ بْنُ إِسْحَاقَ الْخَضْرَمِيُّ الْبَصْرِيُّ (?-205 h). Lexues në Basra.
a) Ruvejs رُوَيْسُ
b) Ruh bin Abdulmu'min رُوحُ بْنُ عَبْدِ الْمُؤْمِنِ |
| 10. Halef bin Hisham خَلْفُ بْنُ هِشَامٍ الْبَغْدَادِيُّ (150-229). Lexues në Bagdad.
a) Is'hak bin Ibrahim إِسْحَاقُ بْنُ إِبْرَاهِيمَ
b) Idris bin Abdulkerim إِدْرِيسُ بْنُ عَبْدِ الْكَرِيمِ |

Tabela e mësipërme tregon se kemi dhjetë lexues dhe dhjetë lexime (kiraete) të pranuar. Pastaj duket se secili lexues ka nga dy transmetues kryesorë, kështu që, në tërësi janë njëzet rivajete (transmetime) të leximit të Kur'anit të transmetuara në formë mutevatire dhe plotësisht të përdorshme.

Lexuesi Asim dhe transmetuesi i tij Hafs

Meqë në mjedisin tonë është i njohur historikisht kiraeti i Asimit me transmetim të Hafsit, atëherë do të ndalemi për t'i thënë disa fjalë për biografinë e këtyre dy kolosëve të kiraeteve.

A) Asim ibn Ebi Nexhudi

Imam Asim ibn Ebu Nexhudi është tabiin i cili ka takuar njëzet e tre shokë të Muhamedit [alejhi selam]. Njihet me nofkën Ebu Bekër. Ka lindur dhe është rritur në Kufa të Irakut, vend i cili atëkohë lulëzonte në zhvillimin arsimor dhe fetar.

Karrierën e tij shkencore e filloi qysh në fëmijëri. E mësoi gjuhën arabe, e cila është çelës i disiplinave fetare, traditën pejgamberike të Muhamedit [alejhi selam], transmetoi hadithe dhe iu përkushtua gjerësisht disiplinës së kiraeteve. Preokupimi i vazhdueshëm për leximet e Kur'anit e ngriti mbi të gjithë lexuesit e Kufas dhe u bë kryesuesi i kiraetit që sot mban emrin e tij.

Për erudicionin dhe profesionalizmin e tij janë prononcuar shumë arabologë, hadithologë, kur'anologë etj.


Arabologu Jahja bin Adem, për të ka thënë: “Nuk kam parë njeri më orator dhe gojëmbël se Asimi. Kur fliste, t'i merrte mendtë nga rrjedhshmëria e të shprehurit.”

